Figura 3-41 Rezultatet e matjes së rrjedhës në hyrje të FES-it (Para dhe pas modifikimit).....	260
Figura 3-42 Aranzhimet e Kaldajës dhe FES-it në TC Kosova A.....	260
Figura 3-43 Sjellja e Përqendrimit të SO ₂	262
Figura 3-44 Ndryshimi i SO ₂ për kanal.....	263
Figura 3-45 O ₂ kundrejt. SO ₂ , NO _x	263
Figura 3-46 Temperatura e gazit kundrejt SO ₂	264
Figura 3-47 S Organik kundrejt SO ₂	264
Figura 3-48 Materia e avullueshme kundrejt SO ₂	264
Figura 3-49 Ca, S në Linjit	264
Figura 3-50 Ca/S kundrejt efikasitetit të de-SO ₂	265
Figura 3-51 Temperatura e gazit kundrejt efikasitetit të de-SO ₂	265
Figura 3-52 Furnizimi i ajrit në vatër.....	268
Figura 3-53 Organizimi i mullirit dhe atmosfera e vatrës	268
Figura 3-54 Rezultati i testit të zvogëlimit të ngarkesës së kaldajës	271
Figura 3-55 Shpërndarja e vlerës së SO ₂	274
Figura 3-56 Shpërndarja e vlerës së NO _x	274
Figura 3-57 Sistemi i FES-it me temperaturë të ulët-ulët (Sistemi i ri).....	276
Figura 3-58 Organizimi institucional për Masat në Kosovë	287
Figura 3-59 Grafiku i kosto - efektivitetit lidhur me PM ₁₀	317
Figura 3-60 Harta e përqendrimit të PM ₁₀ duke marrë parasysh të gjitha masat e lartpërmendura.....	318

Lista e Fotografive

Foto 3-1 TNP për Sektorin e Energjisë për Përgatitjen e Inventarit të Emisioneve	112
Foto 3-2 Pamje e intervistave të hulumtimit për amvisëritë nga studentët	117
Foto 3-3 Pamje e intervistave të hulumtimit për Industrinë terciare nga studentët.....	120
Foto 3-4 Pamje nga matja në TC Kosova B dhe takimi për shqyrtimin e aktivitetëve.....	145
Foto 3-5 Gjendja e organizimit të pajisjeve të matjes	146
Foto 3-6 Pamje nga shpjegimi për pajisjet në ceremoninë e dorëzim-pranimit	146

Foto 3-7 Analizatori automatik i gazit	147
Foto 3-8 Pamje nga matja e gazit të shkarkuar në TC Kosova A.....	149
Foto 3-9 Pamje nga matja e gazit të shkarkuar në TC Kosova B.....	149
Foto 3-10 Burimet e tjera të palëvizshme	153
Foto 3-11 Seminari për matjen e gazit të shkarkuar	157
Foto 3-12 Takimi për përgatitjen e orarit dhe inspektimi i SMCA-së në Obiliq	160
Foto 3-13 Inspektimi i gjendjes aktuale të SMCA-së.....	160
Foto 3-14 Ndërtimi i bazamentit prej betoni dhe zëvendësimi i kabinave.....	163
Foto 3-15 Rehabilitimi i analizatorëve dhe pastrimi i tubit të mostrimit (tubi nga Tefloni)	163
Foto 3-16 Trajnimi (ushtrimi) i matjes në emergjenca në TC Kosova A	181
Foto 3-17 Ceremonia e dorëzimit-pranimit të ekraneve në qytetin e Prishtinës	183
Foto 3-18 Lokacioni i ekranit në qytetin e Obiliqit (pranë rrugës kryesore)	185
Foto 3-19 Pamje nga diagnostikimi i JK-së	194
Foto 3-20 Pamje nga ri-funksionalizimi dhe trajnimi i JK	195
Foto 3-21 ICP-MS dhe pjesa e brendshme e ICP-MS	196
Foto 3-22 Puna e rregullimit të ICP-MS me inxhinierin nga agjenti rajonal	197
Foto 3-23 Pamje e AAS dhe inspektimit.....	197
Foto 3-24 Analiza dhe operimi i JK.....	200
Foto 3-25 Operimi i mikrovalës (nxjerrja e Hg) dhe analiza e merkurit.....	200
Foto 3-26 Mostrimi shtesë i PM në ajër në Drenas	208
Foto 3-27 Trajnimi për modelimin e simulimit	218
Foto 3-28 Matja në Furrën Rrotulluese	238
Foto 3-29 Matja në Furrën Elektrike.....	239
Foto 3-30 Matja në konvertor	239
Foto 3-31 Matja në fabrikën e Blloqeve	240
Foto 3-32 tankeri për furnizim të LPG.....	241
Foto 3-33 Pluhuri i mbledhur	241
Foto 3-34 Matja në fabrikën e Asfaltit	242
Foto 3-35 Matja në fabrikën e Riciklimit të Vajrave	244
Foto 3-36 Kabina e djegies së gazit të shkarkuar	244
Foto 3-37 Ligjëratat për rritjen e njohurisë	247

Akronimet dhe Shkurtesat

Shkurtesat	Nomenklatura Zyrtare
AA	Agjencia e Akreditimit
AAS	Spektrometri me Absorbim Atomik
AFOLU	Bujqësia, Pylltaria dhe Përdorimi Tjetër i Tokës
UA	Udhëzimi Administrativ
AQI	Indeksi i Cilësisë së Ajrit
SMCA	Stacioni i Monitorimit të Cilësisë së Ajrit
VK	Vlerësimi i Kapaciteteve
ZhK	Zhvillimi i Kapaciteteve
SMVE	Sistemi i Monitorimit të Vazhdueshëm të Emisionit
CEN	Komiteti Evropian për Standardizim
CFD	Dinamika Fluide Kompjuterike
CO	Monoksidi i karbonit
COVID-19	Epidemia Coronavirus 2019
H/L	Homologët
GP-H/L	Grupi Punues i Homologëve
DMMU (MMPHI/MMPH)	Departamenti për Mbrojtje të Mjedisit dhe Ujërave
DMMU/DMNI (MESPI/MMPH)	Divizioni për Menaxhimin e Ndotjes Industriale
BERZh	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
KE	Komisioni Evropian
VKE	Vlerat e kufirit të emisionit
Udhëzuesi EMEP/EEA	Udhëzuesi EMEP/EEA 2016 (Programi Evropian i Monitorimit dhe Vlerësimit/Agjencia Evropiane e Mjedisit) për inventarin e emisioneve të ndotësve të ajrit
KEn	Komuniteti i Energjisë
TKEn	Traktati i Komunitetit të Energjisë
FES	Filtri Elektrostatik
BE	Bashkimi Evropian
SF	Studimi i Fisibilitetit
GC-MS	Kromatografi i Gazit-me Spektrometri në Masë
GHG	Gazrat Serrë
GIS	Sistemi Informativ Gjeografik
KRK	Kamionët e Rëndë Komercialë
JK	Jon Kromatografi
ICP-MS	Spektrometri me Masë Plazmë i Lidhur në mënyrë Induktive
PNNK	Paneli Ndërkombëtar për Ndryshime Klimatike
PKIN	Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes (Ligji Nr. 03/L-043)
PIPP	Procesi Industrial dhe Përdorimi i Produkteve
IPK (MMPHI/MMPH)	Instituti për Planifikim Hapësinor
TI	Teknologjia Informative
KPK	Komiteti i Përbashkët Koordinues

JET	Ekipi i Ekspertëve të JICA-s
JICA	Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
JIS	Standardi Industrial Japoneze
AKK (MMPHI/MMPH)	Agjencia Kadastrale e Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
AMMK (MMPHI/MMPH)	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
IHMK (MMPHI/MMPH)	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
TC Kosova A	Termocentrali Kosova A
TC Kosova B	Termocentrali Kosova B
Kosova e Re	Termocentrali i Ri
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
IDM	Impianti me Djegie të Madhe
KLK	Kamionët e Lehtë Komercialë
LHV	Vlera më e Ulët e Nxehtësisë
LPG	Gazi i lëngëzuar i naftës
MCC/MFK	Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit/Fondacioni i Mijëvjeçarit i Kosovës
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
ME/MZhE	Ministria e Ekonomisë (Ish Ministria e Zhvillimit Ekonomik)
MMPHI/MMPH	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (Ish Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor)
MMPHI/MI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (Ish Ministria e Infrastrukturës)
MPBAP/MPB	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
MPB/MAP	Ministria e Punëve të Brendshme (Ish Ministria e Administratës Publike)
P/T	Procesverbali i Takimit
MM	Memorandumi i Mirëkuptimit
MITE/MTI	Ministria e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë (Ish Ministria e Tregtisë dhe Industrisë)
Direktiva e BE	Direktiva për Tavanet e Emisioneve Kombëtare (DIREKTIVA (EU) 2016/2284 për zvogëlimin e emisioneve kombëtare të ndotësve të caktuar atmosferikë)
PKZE	Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve
NMVOC	Komponimet organike të avullueshme jo-të-metanit
NO _x	Oksidet e azotit
NO ₂	Dyoksidi i azotit
O ₃	Ozoni
TNP	Trajnimi në punë
O dhe M	Operimi dhe Mirëmbajtja
PAH	Hidrokarburi Aromatik Policiklik
MDP	Matrica e Dizajnit të Projektit
PM ₁₀ , PM _{2.5} , PM ₁	Materialet Grimca me diametër prej 10µm ose më pak,

	2.5µm ose më pak dhe 1.0µm ose më pak
VP	Vetura e pasagjerëve
PO	Plani Operacional
SC	Sigurimi i Cilësisë
KC	Kontrolli i cilësisë
PSA	Procesi i Stabilizim Asociimit
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
SDG-të	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
P/D	Procesverbali i Diskutimit
SO ₂	Dyoksidet e sulfurit
PSO	Procedura Standarde Operacionale
TC	Termocentrali
TSP	Gjithsej grimca të pezulluara
USEPA	Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Mbrojtje të Mjedisit
Lart	Universiteti i Prishtinës
VOC	Komponimet Organike të Paqëndrueshme
VM	Materia e Avullueshme
SZP	Struktura e Zbërthimit të Punëve
WOM	Pa Masa
WEM	Me Masa Ekzistuese
WAM	Me Masa Shtesë
Modeli WRF	Modeli i Hulumtimit dhe Parashikimit të Motit

1. Përshkrimi i Projektit

1.1 Informata të përgjithshme për Projektin

Republika e Kosovës (këtu e tutje “Kosova”) është tërësisht e varur nga linjiti i cilësisë së dobët, të mihur në vend, si burim kryesor i energjisë për prodhimin e energjisë elektrike, ngrohjes, etj. Për këtë arsye, ndotja e ajrit në zonat urbane është bërë problem serioz mjedisor dhe efekti i saj në shëndetin e njeriut është shqetësim i madh.

Kosova po e ndjek qëllimin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (këtu e tutje “BE”). Në këtë proces Kosova ka përmyllur Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (këtu e tutje “MSA”) më 27 tetor të vitit 2015. Në të njëjtën kohë, Kosova është njëra nga palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë¹ (këtu e tutje “TKEn”) lidhur me formimin e tregut të energjisë në Evropën Juglindore (nënshkruar më 18 tetor 2007, i paraprirë nga MSA), dhe është në pozitën ku Kosova duhet t’i përgjigjet kërkesave të KEn-së¹ për pajtueshmërinë me Vlerat Kufitare të Emisioneve (këtu e tutje “VKE”) nga Impiantet me Djegie të Mëdha (këtu e tutje “IDM”). Prandaj, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës² (Ish Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, këtu e tutje “MMPHI/MMPH”) është marrë me legjislacione, zhvillimin e planeve përkatës dhe zbatimin e planeve për menaxhimin e cilësisë së ajrit dhe pajtueshmërinë e emisioneve nga IDM-të në përputhje me Direktivat e BE-së.

Nga Kosova kërkohet që t’i përmbushë standardet e Be-së, dhe situata ka mbetur prapa në këtë aspekt. Për më tepër, industritë duke përfshirë IDM-të, ngrohja në amvisëri dhe emisionet nga automjetet në Prishtinë dhe në afërsi të saj, gjithashtu dyshohen të kenë ndikim të konsiderueshëm në cilësinë e ajrit të nivelit të tokës në zonën e Prishtinës. Mirëpo, nuk janë ndërmarrë hapa që këto emisione të vlerësohen në mënyrë sistematike, dhe nuk janë planifikuar masa konkrete. Prandaj, për t’i studiuar këto çështje, është e nevojshme të sigurohet dhe vlerësohet gjendja ekzistuese e ajrit përmes të dhënave të sakta të cilësisë së ajrit dhe të mësohen teknologjitë për planifikimin e masave konkrete siç janë përgatitja e inventarit të emisioneve dhe simulimi i cilësisë së ajrit. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011³, zona urbane e Prishtinës është e banuar me rreth dyqind mijë persona (pretendohet se popullsia ditore është më shumë se dyfishi i shifrës origjinale). Megjithatë, këto aspekte deri më tani nuk janë vlerësuar bazuar në ndonjë bazë të mjaftueshme teknike. Rezultatet e fundit të monitorimit të cilësisë së ajrit në 2012 deri 2014 tregojnë nivele relativisht të larta të përqendrimit në mjedis të PM₁₀ dhe PM_{2.5} (Grimcat (këtu e tutje “PM”) në ajër). Vlerat mesatare vjetore tejkalojnë vlerën mesatare kufitare vjetore prej 40 µg/m³ dhe 25 µg/m³ përkatësisht për PM₁₀ dhe PM_{2.5}, në pothuajse të gjitha Stacionet e Monitorimit të Cilësisë së Ajrit (këtu e tutje “SMCA”) në Kosovë. Për sa i përket përqendrimit të SO₂ në vitin 2014, në

¹ TKEn është traktat që ka për synim shpërndarjen e një tregu të shëndoshë dhe të drejtë të energjisë në Bashkimin Evropian (BE) tek vendet fqinje duke shpresuar për anëtarësim në BE përfshirë Evropën Juglindore. Komuniteti i Energjisë (KEn) luan rol të rëndësishëm në promovimin e TKEn-së.

² Në fillim të Projektit ka qenë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), mirëpo në mars të vitit 2021 MMPH u integrua me Ministrinë e Infrastrukturës (këtu e tutje “MMPHI/MI”) dhe u bë Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI/MMPH).

³ Vlerësohet se popullsia ditore mund të jetë rreth gjysmë milioni duke përfshirë punëtorët që udhëtojnë nga rajonet e tjera, e që mund të jetë arsyeja për nivelin e madh të ndotjes së ajrit.

Obiliq dhe Palaj të cilat ndodhen afër TC Kosova A dhe TC Kosova B, vlerat mesatare vjetore janë afër $20\mu\text{g}/\text{m}^3$, që është vlera mesatare vjetore e kufirit në Kosovë. Për sa i përket përqendrimit të NO_2 , vlerat mesatare vjetore janë brenda vlerave mesatare vjetore të kufirit prej $40\mu\text{g}/\text{m}^3$ në të gjitha SMCA-të⁴.

Përveç PM_{10} dhe $\text{PM}_{2.5}$, intensiteti i ndotjes së ajrit në përgjithësi konsiderohet i moderuar në Kosovë. Mirëpo, duket se ka probleme për sa i përket cilësisë dhe sasisë së të dhënave të cilësisë së ajrit nga pikëpamja e vendosjes së SMCA-ve dhe gjendja e operimit dhe mirëmbajtjes (këtu e tutje "O dhe M") e analizatorëve në SMCA (ofrimi i të dhënave të parregullta i shkaktuar nga problemet, mungesa e kalibrimit, etj. në analizatorë). Ekzistojnë probleme të diskutueshme të ndotjes së ajrit nga metalet e rënda në PM në ajër. Njëra është nga një kompani (industri jo-metalike) në Drenas dhe një tjetër nga aktivitetet e kaluara industriale në Mitrovicë, edhe pse asnjëra gjendje nuk është vlerësuar për shkak të mungesës së të dhënave të mjaftueshme për cilësinë e ajrit.

Prandaj, është e rëndësishme për vendimmarrësit që t'i forcojnë kapacitetet teknike të autoriteteve përkatëse, t'i shfrytëzojnë njohuritë teknike dhe informacionin për menaxhimin e kontrollit të ajrit dhe të marrin vendime të duhura politike, si dhe t'u ofrojë qytetarëve të prekur nga ndotja e ajrit informacion të saktë për cilësinë e ajrit.

Në anën tjetër, Kosova ka dorëzuar në maj të vitit 2018 Planin përfundimtar Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve^{5,6} (këtu e tutje "PKZE") lidhur me pajtueshmërinë me VKE-të nga IDM-të të kërkuara nga KEn, dhe zbatimin e tij është i domosdoshëm. PKZE-ja kërkon që Pluhuri, SO_2 dhe NO_x nga IDM-të t'i respektojnë VKE-të e Direktivës së BE-së për IDM-të. Për t'i studiuar masat për zvogëlimin e emisioneve, kërkohet të dihet përbërja e gazit të shkarkuar nga IDM-të. Në të njëjtën kohë, bashkë me zvogëlimin e emisioneve të ndërlidhura me PKZE-në, është kërkuar përvetësimi i teknologjisë për matjen e gazit të shkarkuar. As operatorët e biznesit e as MMPHI/MMPH nuk e kanë pasur këtë kapacitet dhe MMPHI/MMPH ka kërkuar fuqishëm këtë zhvillim të kapaciteteve. Për më tepër, MMPHI/MMPH kërkon këtë teknologji për ta kontrolluar gamën e gjerë të burimeve të tjera të palëvizshme si pjesë të masave administrative mjedisore për ajër. Në të njëjtën kohë, është kërkuar zhvillimi i kapaciteteve për studimin e masave për zvogëlimin e emisioneve.

Burimi kryesor i energjisë në Kosovë është linjiti i bollshëm me cilësi të ulët. Prodhimi i energjisë me përdorim të linjtit përbën rreth 97%⁷ të energjisë elektrike të prodhuar në Kosovë. Në anën tjetër, burimet e tjera të energjisë si nafta dhe gazi duhet të importohen, gjë që gjeneron një barrë të konsiderueshme financiare për ekonominë e Kosovës. Opsionet alternative të energjisë janë të kufizuara. Pjesëmarrja e burimeve të ripërtërishme të energjisë si energjia hidroelektrike,

⁴Burimi: Raporti-Gjendja e Mjedisit 2015, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit

⁵ "DIREKTIVA 2001/80/EC" dhe "DIREKTIVA 2010/75/EU" i përcaktojnë VKE-të. PKZE-ja është definuar në "VENDIMIN E KËSHILLIT MINISTROR TË KOMUNITETIT TË ENERGJISË" 24 tetor 2013, i cili shpjegon metodën e migrimit të VKE-ve për IDM nga "DIREKTIVA 2001/80/EC" në "DIREKTIVA 2010/75/EU". Detajet shpjegohen në "UDHËZIMET E POLITIKAVË për Përgatitjen e Planeve Kombëtare për Zvogëlimin e Emisioneve PG 03/2014/19 dhjetor 2014".

⁶ PKZE-ja është miratuar nga Qeveria përmes vendimit Nr.12/49 më datën 29.05.2018.

⁷Bilanci Vjetor i Energjisë i Republikës së Kosovës 2013

energji e prodhuar nga era, fuqia fotovoltaike etj., janë ende të kufizuara dhe konsiderohen si burime plotësuese të energjisë për ta përmbushur kërkesën për energji elektrike në Kosovë.

Më shumë se tetë milion tonë linjit digjen çdo vit në IDM të Kosovës (Termocentrali Kosova A (këtu e tutje "TC Kosova A") dhe Termocentrali Kosova B (këtu e tutje "TC Kosova B"). Megjithëse janë bërë një sërë përpjekjesh për zvogëlimin e emisioneve në TC Kosova A dhe TC Kosova B, si përmirësimet në Fundërrues Elektro Statikë (këtu e tutje "FES"), sistemi i transportit hidraulik të hirit fluturues për zvogëlimin e shpërndarjes së Pluhurit, etj. ende është i nevojshëm zvogëlimi i emisioneve të Pluhurit, SO₂ dhe NO_x që të përmbushen kërkesat e PKZE-së.

Siç është përmendur më lart, është e rëndësishme që Kosova të mbështetet në fushën e kontrollit të ndotjes së ajrit për ta zbatuar PKZE-në dhe për ta krijuar bazën për menaxhimin e cilësisë së ajrit.

Në këto rrethana, Kosova kërkoi dërgimin e ekspertëve për afat të shkurtër në vitin 2013 me qëllim të mbështetjes së zhvillimit të kapaciteteve të MMPHI/MMPH në procesin e përgatitjes së udhërrëfyesit për zhvillimin e PKZE-së dhe në vitin 2014 dy zyrtarë të lartë të MMPHI/MMPH morën pjesë në programin e trajnimit të JICA për menaxhimin e cilësisë së ajrit të mbajtur në Qendrën Ndërkombëtare të Tokios. Në prill të vitit 2015, Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (këtu e tutje "JICA") dërgoi një mision kontakti në Kosovë, dhe MMPHI/MMPH dhe JICA ranë dakord të dërgojnë ekspertë duke përfshirë mbështetjen me teknologji për matjen e gazit të shkarkuar. JICA dërgoi tre ekspertë si ekip të ekspertëve "Ekspertët për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit", dhe përmes Aktivitetit Paraprak⁸ tre ekspertë bënë transferimin e teknologjisë së matjes së gazit të shkarkuar për TC Kosova A dhe TC Kosova B.

Për t'i qar para këto aktivitete, Kosova kërkoi një projekt të plotë të bashkëpunimit teknik nga JICA, dhe JICA kreu një studim të detajuar të planifikimit në tetor dhe nëntor të vitit 2016. Më 30 mars 2017 JICA dhe Kosova nënshkruan Procesverbalin e Diskutimit (këtu e tutje "P/D")

1.2 Përshkrimi i projektit

(1) Objektiva e projektit

Qëllimi i "Projektit për Zhvillimin e Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës" (këtu e tutje "Projekti") është përmirësimi i kapaciteteve të MMPHI/MMPH-së dhe organizatave dhe agjencive të saj përkatëse për menaxhimin e ndotësve të dëmshëm të ajrit, duke kontribuar kështu në planifikimin dhe zbatimin e masave më efektive për zvogëlimin e emisioneve në ajër, për mbrojtjen e shëndetit publik dhe zhvillimin e politikave të lidhura me menaxhimin mjedisor në Kosovë.

(2) Lokacioni i projektit/Zona e synuar

Zona e Prishtinës, Drenasi dhe Mitrovica

Harta në vijim paraqet zonën e synuar. Zona e Prishtinës përfshinë IDM-të, dhe është zona e synuar për të gjitha aktivitetet. Drenasi dhe Mitrovica janë zona të synuara për një pjesë të

⁸ Aktiviteti Paraprak përfshinë "Ekspertët për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit" (2015) dhe "Hulumtimi për Planifikimin e Projektit për Zhvillimin e Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës" (2016)

aktiviteteve (Monitorimi i metaleve të rënda në ajër).




Figura 1-1 Zona e Projektit

(3) Përfituesi i projektit

Përfituesi i drejtpërdrejt: MMPHI/MMPH dhe organizatat dhe agjencitë e saj relevante

Përfituesi i tërthortë: qytetarët që jetojnë në lokacionin e Projektit dhe në afërsi të tij

(4) Plan-programi (Periudha e projektit)

Periudha e planifikuar fillimisht: Tetor 2017 - Shtator 2020 (3 vite)

Periudha e rishikuar: Tetor 2017 - Qershor 2021 (3 vite dhe 9 muaj)

Periudha është rishikuar për shkak të vonësës së shkaktuar nga COVID-19

(5) Synimi i përgjithshëm, qëllimi i projektit dhe rezultatet e pritura

Synimi i përgjithshëm, qëllimi dhe rezultatet e pritura të këtij projekti janë siç vijon.

Synimi i përgjithshëm

Pala kosovare i zhvillon kapacitetet për kontrollin e ndotjes së ajrit dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit bazuar në të dhëna teknike.

Qëllimi i projektit

Të zhvillohen aftësitë teknike të palës kosovare për t'i kontrolluar burimet e emisioneve në ajër në zonën e synuar të Projektit.

Rezultatet e pritura

Rezultati 1: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për ta bërë shtjellimin e inventarit të emisioneve (këtu e tutje "IE") për IDM dhe burimet e tjera.

Rezultati 2: Zhvillohen kapacitetet për matjen e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera.

Rezultati 3: Kryhen aktivitetet e monitorimit të cilësisë së ajrit

Rezultati 4: Zhvillohen kapacitetet për analizat relevante mjedisore laboratorike për sa i përket

matjes së emisioneve dhe monitorimit të cilësisë së ajrit.

Rezultati 5: Zhvillohen kapacitetet për modelimin e simulimit të cilësisë së ajrit.

Rezultati 6: Përmirësohet vendimmarrja nga pala kosovare bazuar në të dhënat teknike për kontrollin e ndotjes së ajrit.

Rezultati 7: Zhvillohen masat e kontrollit të emisioneve në IDM.

Rezultati 8: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit.

1.3 Matrica e Dizajnit të Projektit

Projekti është zbatuar bazuar në P/D e nënshkruar më 30 mars 2017. Matrica e Dizajnit të Projektit (këtu e tutje "MDP") ka filluar bazuar në P/D e rënë dakord me palën kosovare. MDP është korrigjuar në takimin e dytë të Komitetit të Përbashkët Koordinues (këtu e tutje "KPK") të mbajtur më 9 korrik 2018. Korrigjimi kishte të bëjë me kufizimin e studimit të masat për zvogëlimin e emisioneve për IDM vetëm për TC Kosova A dhe të korrigjoheshin Treguesit Objektivist të Verifikueshëm në MDP. Për më tepër, në takimin e tretë të KPK-së të mbajtur më 25 janar 2019, MDP u korrigjua përsëri meqenëse ndërtimi i rrjetit të komunikimit të të dhënave të cilësisë së ajrit iu la MCC/MFK.

Për më tepër, JICA dhe MMPHI/MMPH ranë dakord për zgjatjen e periudhës së Projektit në korrik të vitit 2020 për shkak të pandemisë Coronavirus 2019 (këtu e tutje "COVID-19"), pasi që shtetasve japonezë nuk u lejohej të udhëtonin në Kosovë. Gjatë periudhës së zgjatur të Projektit, janë shtuar shumë aktivitete të ndryshme. Prandaj, në takimin përfundimtar të KPK-së të mbajtur në qershor të vitit 2021, u rishikuan MDP dhe Plani Operacional (këtu e tutje "PO")

MDP përfundimtare është paraqitur në Tabela 1-1 dhe PO përfundimtar është paraqitur në Figura 2-1. Procesi i rishikimit është bashkëngjitur në ANEKSIN-1 "Dokumentet e ndërlidhura me takimet e Komitetit të Përbashkët Koordinues".

Tabela 1-1 Matrica e Dizajnit të Projektit (MDP) (Ver. 4.0)

Data: 2 nëntor 2017 (Ver. 1.0)
 Data: 12 korrik 2018 (Ver. 2.0)
 Data: 5 shkurt 2019 (Ver. 2.1)
 Data: 4 gusht 2020 (Ver. 3.0)
 Data: 16 qershor 2021 (Ver. 4.0)

Titulli i projektit: Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit Kohëzgjatja e Projektit: 3 vite dhe 9 muaj (Tetor 2017 deri Qershor 2021)
 Grupi i Synuar i Projektit: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) dhe Grupi Punues i Homologëve (GP-H/L)
 Organizatat Zbatuese: MMPHI dhe GP-H/L
 Zona e Synuar e Projektit: Zona e Prishtinës, Drenasi dhe Mitrovica

Përmbledhja e narrativit	Treguesit objektivisht të verifikueshëm	Mënyrat e verifikimit	Supozimet e rëndësishme
Synimi i përgjithshëm: Pala kosovare i zhvillon kapacitetet për kontrollin e ndotjes së ajrit dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit bazuar në të dhëna teknike.	1. MMPHI nxjerr raport periodik/vjetor për cilësinë e ajrit duke përfshirë inventarin e emisioneve, vlerësimin e cilësisë së ajrit dhe rezultatet e matjes së emisioneve. 2. Plani i veprimit i palës kosovare rishikohet në bazë të të dhënave teknike.	1. Raportet “Gjendja e Ajrit” dhe “Gjendja e Mjedisit në Kosovë” 2. Pas miratimit të Planit të Veprimit për Cilësi të Ajrit, pala kosovare e përgatit raportin për “Zbatimin e Planit të Veprimit për Cilësi të Ajrit”.	
Qëllimi i projektit: Të zhvillohen aftësitë teknike të palës kosovare për t’i kontrolluar burimet e emisioneve në ajër në zonën e synuar të Projektit.	1. Masat konkrete për zvogëlimin e emisioneve iniciohen në Implantet me Djegie të Mëdha (IDM). 2. Bëhet shtjellimi i masave të kontrollit të ndotjes së ajrit për burimet e tjera të emisioneve. 3. Ndotësit dhe burimet e emisioneve me prioritet përfaqësojnë IDM-të, burimet e tjera të palëvizshme dhe burimet e tjera të emisioneve identifikohen në bazë të monitorimit të cilësisë së ajrit, inventarit të emisioneve dhe modelimit të simulimit	1. Raportet “Gjendja e Ajrit” dhe “Gjendja e Mjedisit në Kosovë” 2. Plani i Veprimit për Cilësi të Ajrit 3. Raporti i Progresit	Përkushtimi i palës kosovare për PKZE-në në kontekstin e Direktivave të Komunitetit të Energjisë/BE-së është i qëndrueshëm. Përkrahja nga Komuniteti i Energjisë/BE-ja dhe donatorët relevantë për

	dhe rishikohen dy herë gjatë Projektit për vendimmarrje.	<p>PKZE është e qëndrueshme.</p> <p>Politikat relevante të MMPHI për menaxhimin e cilësisë së ajrit në përputhje me Direktivat e BE-së mbahen të qëndrueshme.</p> <p>Mbahet funksioni rregullativ i MMPHI në kontrollin e ndotjes së ajrit.</p> <p>Mbahet bashkëpunimi mes MMPHI dhe agjencive relevante (MITN, MPBAP, ASK, KEK, etj.).</p> <p>MMPHI dhe agjencitë e ndërlidhura janë të buxhetuara si duhet dhe të plotësuara me personel.</p>
<p>Rezultatet</p> <p>Rezultati 1: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për ta shtjelluar inventarin e emisioneve për IDM-të dhe burimet e tjera.</p> <p>Rezultati 2: Zhvillohen kapacitetet për matjen e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera.</p>	<p>Treguesit objektivisht të verifikueshëm</p> <p>1.1 Inventari i Emisioneve për IDM dhe burimet e tjera për vitin aktual⁹ rishikohet të paktën dy herë.</p> <p>2.1 Matjet në terren të gazit nga oxhaku bëhen të paktën 26 herë për NOx, SO2 dhe Pluhur (T/C Kosova A: 3 kaldaja × 3</p>	<p>Mënyrat e verifikimit</p> <p>1.1 Raportet “Gjendja e Ajrit” dhe “Gjendja e Mjedisit në Kosovë”</p> <p>1.2. Raporti i Progresit</p> <p>2.1 Raporti i Progresit</p> <p>2.2 PSO-të për matjen në terren e gazit</p>
		<p>Supozimet rëndësishme</p> <p>Më shumë se 70% e anëtarëve të H/L (Homologut) dhe GP-H/L është caktuar në fillim të Projektit do të mbesin deri në fund të</p>

⁹ Viti më i fundit për të dhënat e IE-së

	kanale, T/C Kosova B: 2 kaldaja × 2 kanale). 2.2 Bëhet shpjellimi i Procedurave Standarde Operacionale (PSO) për matjet në terren të gazit nga oxhaku për IDM dhe burimet e tjera.	nga oxhaku (IDM-të, burimet e tjera të palëvizshme)	Projektit
Rezultati 3: Aktivitetet e monitorimit të cilësisë së ajrit janë të qëndrueshme	3.1 Pesë stacione të monitorimit të cilësisë së ajrit të rehabilituara përmes projektit përputhen me 6,000 orë matje efektive në vit (8,760 orë) në vitin e dytë dhe të tretë në zbatimin e Projektit. 3.2 Stërvitjet e monitorimit të ndotjes së ajrit në emergjencë kryhen të paktën tri (3) herë duke përdorur marrësit portativ të mostrës për matjet e SO ₂ , NO ₂ , PM _{2.5} dhe PM ₁₀ . 3.3 Shtjellimi i raporteve të monitorimit të cilësisë së ajrit bëhet të paktën dy herë.	3.1 Raportet “Gjendja e Mjedisit në Kosovë” dhe “Gjendja e Ajrit” 3.2 Raporti i Progresit	
Rezultati 4: Zhvillohen kapacitetet për analizat relevante mjedisore laboratorike për sa i përket matjes së emisioneve dhe monitorimit të cilësisë së ajrit.	4.1 Matjet e NO _x , SO ₂ dhe Hg për IDM-të, siç kërkohet nga Direktiva e BE-së bazuar në metodat e referencës, kryhen të paktën dy herë gjatë zbatimit të Projektit. 4.2 Bëhet shpjellimi i të tri PSO-ve për NO _x , SO ₂ dhe Hg në gazin e oxhakat për IDM-të bazuar në metodat e referencës. 4.3 Bëhet vlerësimi i rëndësisë së përmbajtjes së metaleve të rënda në PM në mjedis.	4.1 Raporti i Progresit 4.2 PSO-të për metodën e referencës për IDM-të (NO _x , SO ₂ , Hg)	
Rezultati 5: Zhvillohen kapacitetet për modelimin e simulimit të cilësisë së ajrit.	5.1 Bëhet shpjellimi i modelit të simulimit të dispersionit për vitin aktual. 5.2 Modeli i simulimit zbatohet të paktën dy (2) herë bazuar në inventarin aktual të emisioneve.	5.1 Raportet “Gjendja e Mjedisit në Kosovë” dhe “Gjendja e Ajrit” 5.2 Raporti i Progresit	
Rezultati 6: Përmirësohet vendimmarrja nga pala kosovare për kontrollin e ndotjes së ajrit bazuar në të dhënat teknike.	6.1 Rekomandimet për kontrollin e ndotjes së ajrit bëhen së paku një herë në dobi të proceseve të bëritjes së politikave relevante të palës kosovare.	6.1 Vendimi për Rishikimin e Planit të Veprimit për Cilësi të Ajrit (Analizën e zbatimit Planit të Veprimit bazuar në rekomandime)	

	<p>6.2 Publikimi dhe buletini informues për kontrollin e ndotjes së ajrit shpërndahen të paktën katër herë.</p>	<p>6.2 Raporti i Progresit 6.3 Buletini informues, etj.</p>	
<p>Rezultati 7: Zhvillohen masat e kontrollit të emisioneve në IDM.</p>	<p>7.1 Kryhen diagnozat për emisionet e NOx, SO2 dhe të pluhurit për IDM. Për TC Kosova A do të shijellohen tri masa të kontrollit të ndotjes së ajrit për secilin ndotës.</p>	<p>7.1 Raporti i Progresit</p>	
<p>Rezultati 8: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit.</p>	<p>8.1 Masat e kontrollit të ndotjes diskutohen në strategjinë e palës kosovare për cilësi të ajrit dhe plani i veprimit vlerësohet të paktën një herë.</p>	<p>8.1 Raportet “Gjendja e Mjedisit në Kosovë” dhe “Gjendja e Ajrit” 8.2 Raporti i Progresit</p>	

Aktivitetet	Inputi i Projektit	Supozimet e rëndësishme
<p>1-1 Pala kosovare bashkë me Ekspertët e JICA bëjnë përcaktimin e seksionit përgjegjës dhe krijojnë koordinimin e duhur me agjencitë relevante.</p> <p>1-2 Duke u bazuar në analizën e informacionit ekzistues, Pala kosovare me ndihmën e Ekspertëve të JICA-s vendos për kornizën e inventarit të burimeve të emisionit në zonën e Prishtinës.</p> <p>1-3 MMPHI me ndihmën e Ekspertëve të JICA-s bën planin dhe kryen studimin e inventarit të emisioneve të IDM-ve.</p> <p>1-4 MMPHI me ndihmën e Ekspertëve të JICA-s bën planin dhe kryen studimin për inventarin e emisioneve për burimet e tjera të palëvizshme.</p> <p>1-5 Pala kosovare me ndihmën e Ekspertëve të JICA-s zhvillon metodologjinë për inventarin e emisioneve për burimet e tjera si automjetet dhe fabrikat e vogla me djegie, dhe shtjellon inventarin preliminar të emisioneve.</p> <p>1-6 Bazuar në aktivitetet (1-1 deri 1-5) për burimet e emisionit, MMPHI me ndihmën e Ekspertëve të JICA-s shtjellon inventarin e integruar të emisioneve.</p> <p>1-7 MMPHI me ekspertët e JICA-s në mënyrë të pavarur kryen përgatitjen e inventarit të emisioneve, zbatimin e kontrollit të cilësisë dhe sigurimit të cilësisë së inventarit të emisioneve, dhe hartimin e planit të përmirësimit.</p>	<p>Pala japoneze</p> <p>1. Ekspertët e dërguar japonezë</p> <p>(1) Lideri i projektit/Matja në terren e gazit nga oxhaku 1/Masat e kontrollit të ndotjes së ajrit 1</p> <p>(2) Zëvendës-lider i Projektit/Inventari i emisioneve të palëvizshme/Shpalosja dhe publikimi i informacioneve dhe vetëdijesimi i publikut</p> <p>(3) Monitorimi i cilësisë së ajrit 1</p> <p>(4) Masat e kontrollit të ndotjes për termocentralet (kaldaja)</p> <p>(5) Matja në terren e gazit nga oxhaku 2/Monitorimi i cilësisë së ajrit 3</p> <p>(6) Matja në terren e gazit nga oxhaku 3</p> <p>(7) Masat e kontrollit të ndotjes për termocentralet (FES-1)</p> <p>(8) Masat e kontrollit të ndotjes për termocentralet (FES-2)</p> <p>(9) Monitorimi i cilësisë së ajrit 2</p> <p>(10) Inventari i emisioneve mobile/Masat e kontrollit të ndotjes së ajrit 2</p> <p>(11) Modeli i Simulimit</p> <p>(12) Politikat për mbrojtjen e cilësisë së ajrit</p>	<p>Pala kosovare do t'i emërohet një numër adekuat i anëtarëve të H/L dhe GP-H/L me njohuri të përshtatshme teknike.</p> <p>Pala kosovare do t'i ndërmarrë masat e nevojshme duke përfshirë privilegjet dhe përjashtimet nga tatimi në zbatimin e projektit.</p> <p>Pala kosovare do t'i ndërmarrë masat e nevojshme për t'i marrë lejet dhe autorizimet përkatëse në zbatimin e projektit.</p> <p>Pala kosovare do t'i ndërmarrë masat e nevojshme për t'i kryer matjet në terren të gazit nga oxhaku dhe punët e terrenit.</p>
<p>Pala japoneze</p> <p>1. Lideri i projektit/Matja në terren e gazit nga oxhaku 1/Masat e kontrollit të ndotjes së ajrit 1</p> <p>(2) Zëvendës-lider i Projektit/Inventari i emisioneve të palëvizshme/Shpalosja dhe publikimi i informacioneve dhe vetëdijesimi i publikut</p> <p>(3) Monitorimi i cilësisë së ajrit 1</p> <p>(4) Masat e kontrollit të ndotjes për termocentralet (kaldaja)</p> <p>(5) Matja në terren e gazit nga oxhaku 2/Monitorimi i cilësisë së ajrit 3</p> <p>(6) Matja në terren e gazit nga oxhaku 3</p> <p>(7) Masat e kontrollit të ndotjes për termocentralet (FES-1)</p> <p>(8) Masat e kontrollit të ndotjes për termocentralet (FES-2)</p> <p>(9) Monitorimi i cilësisë së ajrit 2</p> <p>(10) Inventari i emisioneve mobile/Masat e kontrollit të ndotjes së ajrit 2</p> <p>(11) Modeli i Simulimit</p> <p>(12) Politikat për mbrojtjen e cilësisë së ajrit</p>	<p>Pala kosovare</p> <p>1. Homologët dhe Anëtarët e Grupit Punues të Homologëve</p> <p>(1) Caktimi i stafit të H/L dhe GP-H/L</p> <p>(2) Kryesuesi i KPK-së</p> <p>(3) Drejtori i Projektit</p> <p>(4) Menaxheri i Projektit</p> <p>2. Sigurimi i hapësirës së nevojshme për zyrë dhe zyra e projektit në MMPHI/DMMU dhe IHMK</p> <p>3. Sigurimi i laboratorëve dhe instrumenteve laboratorike si mikro-peshorja, kabina e ajrimit, pajisja tharëse, furra, Spektrofotometria me absorbim atomik, Jon Kromatografi, etj.</p> <p>4. Sigurimi i hapësirës së siguarar për deponimin e pajisjeve të blera</p> <p>5. Sigurimi i vendit për ekranin për shfaqje të monitorimit të cilësisë së ajrit</p> <p>6. Sigurimi i mbështetjeve të nevojshme për matjet në oxhak për IDM dhe burimet e tjera të palëvizshme</p> <p>7. Marrja e lejeve dhe autorizimeve të nevojshme</p>	<p>Gjatë zbatimit të projektit, të emërohet një numër adekuat i anëtarëve të H/L dhe GP-H/L me njohuri të përshtatshme teknike.</p> <p>Pala kosovare do t'i ndërmarrë masat e nevojshme duke përfshirë privilegjet dhe përjashtimet nga tatimi në zbatimin e projektit.</p> <p>Pala kosovare do t'i ndërmarrë masat e nevojshme për t'i marrë lejet dhe autorizimet përkatëse në zbatimin e projektit.</p> <p>Pala kosovare do t'i ndërmarrë masat e nevojshme për t'i kryer matjet në terren të gazit nga oxhaku dhe punët e terrenit.</p>

<p>2-1 MMPHI dhe agjencitë relevante bashkë me Ekspertët e JICA-s marrin njohuri teorike për matjen në terren të gazit nga oxhaku për IDM përmes seminareve në Kosovë dhe në Japoni.</p> <p>2-2 MMPHI dhe agjencitë relevante bashkë me Ekspertët e JICA-s kryejnë trajnimin-në-punë për matjen në terren të gazit nga oxhaku duke i shfrytëzuar instrumentet e nevojitura duke i përfshirë gazrat standarde.</p> <p>2-3 MMPHI dhe agjencitë relevante bashkë me Ekspertët e JICA-s i zhvillojnë ekspertët për matjen në terren të gazit nga oxhaku në Kosovë.</p> <p>2-4 MMPHI dhe agjencitë relevante bashkë me Ekspertët e JICA-s e krijojnë kornizën institucionale në Kosovë për zbatimin e matjes në terren të gazit nga oxhaku.</p> <p>2-5 MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s kryejnë matjen në terren të gazit nga oxhaku për IDM dhe burimet e tjera të palëvizshme të emisioneve, dhe e konfirmojnë pajtueshmërinë me VKE-të (Vlerat Kufitare të Emisioneve)</p>	<p>2. Sigurimi i pajisjeve të nevojshme</p> <p>3. Mbajtja e seminareve lokale dhe sigurimi i dokumenteve të seminareve</p> <p>4. Zbatimi i kursit të trajnimit më Japoni</p> <p>5. Kostot e marrjes me qira të veturës për ekspertët japonezë</p>	<p>8. Kostot lokale</p> <p>(1) Pagat dhe shpenzimet e transportit për Homologët dhe anëtarët e grupit punues të homologëve</p> <p>(2) Shpenzimet administrative të projektit</p> <p>(3) Shpenzimet e udhëtimit të pjesëmarrësve në seminar</p> <p>9. Transportimi i pajisjeve për matje në terren të gazit nga oxhaku nga pala kosovare jashtë aktiviteve të Projektit</p>	<p>Para-kushtet</p>
---	---	--	---------------------

<p>3.1 MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s e bëjnë vlerësimin e stacioneve për monitorimin e cilësisë së ajrit (SMCA) në Kosovë dhe bëjnë përmbledhjen e gjendjes së analizatorëve dhe të pajisjeve.</p> <p>3.2 MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s përgatisin planin e operimit dhe mirëmbajtjes dhe planin e rinovimit për SMCA-të në Kosovë.</p> <p>3.3 MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë rehabilitimin e SMCA-ve në zonën e Prishtinës bazuar në plane (3-2).</p> <p>3.4 MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s përgatisin manualin për operimin dhe mirëmbajtjen e SMCA-ve në Zonën e Prishtinës.</p> <p>3.5 MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë kalibrimin e analizatorëve në SMCA-të në zonën e Prishtinës bazuar në manualin për operim/mirëmbajtje.</p> <p>3.6 MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s përgatisin udhëzuesin për planifikimin e rrjetit të SMCA-ve në Kosovë.</p> <p>3.7 MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s e konfirmojnë Rrjetin në mes SMCA-ve në Zonën e Prishtinës.</p> <p>3.8 MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s përgatisin PSO-në për matjen e NO2, SO2, PM10 dhe PM2.5 në mjedis përmes mostruesit portativ për nevoja emergjente.</p> <p>3.9 MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s kryejnë matjen e NO2, SO2, PM10 dhe PM2.5 në mjedis përmes mostruesit portativ bazuar në PSO (mesatarisht I orë), për nevoja emergjente.</p> <p>3.10 MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s</p>			

			<p>shfrytëzojnë rezultatet e SMCA-ve për raportin vjetor për cilësinë e ajrit si dhe për vetëdijesimin e publikut.</p> <p>3.11 Ekspertët e JICA mbajnë ligjërata për sistemin e menaxhimit të të dhënave për të dhënat e cilësisë së ajrit.</p>
4-1	<p>MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë studimin e mostrimit dhe metodologjive të matjes për IDM.</p>	4-2	<p>MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s e vënë në dispozicion për analiza Jon Kromatografin.</p>
4-3	<p>MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s kryejnë analizat përmes metodave referente për IDM duke përdorur metodën e Jon Kromatografit për SO2 dhe NOx dhe metodën e absorbimit atomik për Hg.</p>	4-4	<p>MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë shtjellimin e PSO-ve për mostrimin dhe analizën e gazit të oxhakut të IDM-ve.</p>
4-5	<p>MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë studimin e mostrimit dhe metodologjive të matjes për burimet e tjera të palëvizshme të emisioneve.</p>	4-6	<p>MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë shtjellimin e PSO-ve për mostrimin dhe metodologjive të matjes për burimet e tjera të palëvizshme të emisioneve.</p>
4-7	<p>MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s</p>		

<p>bëjnë mostrimin e Grimcave (PM) përmes Mostruesve të ajrit me vëllim të lartë së paku për 2 pika të mostrimit.</p> <p>4-8 Ekspertët e JICA-s analizojnë përmbajtjen e metaleve të rënda (Mn, Ni, As, Cd, Pb dhe Zn) në PM në laborator në Japoni</p> <p>4-9 MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s vlerësojnë rëndësinë dhe urgjencën e ndotjes së ajrit me metale të rënda.</p> <p>4-10 Ekspertët e JICA-s kryejnë diagnostikimin e ICP-MS në laboratorin e IHMK-së.</p>	
<p>5-1 MMPHI dhe agjencitë relevante bashkë me Ekspertët e JICA-s përcaktojnë seksionet përgjegjëse për modelin e simulimit dhe krijojnë koordinimin e duhur me agjencitë relevante.</p> <p>5-2 MMPHI dhe agjencitë relevante bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë mbledhjen e të dhënave ekzistuese siç janë të dhënat e monitorimit të cilësisë së ajrit, të dhënat meteorologjike, informacionet gjeografike, etj.</p> <p>5-3 MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë analizën dhe vërtetimin e vlefshmërisë së të dhënave meteorologjike për aplikimin e modelit të simulimit të dispersionit.</p> <p>5-4 MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë analizën dhe vërtetimin e vlefshmërisë së të dhënave të monitorimit të cilësisë së ajrit.</p> <p>5-5 MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë shpëllimin e modelit të simulimit të dispersionit për vitin e synuar.</p> <p>5-6 MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s</p>	

<p>bëjnë analizën e strukturës së ndotjes së ajrit.</p> <p>5-7 MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s marrin njohuri teorike të modelit të simulimit dhe e praktikojnë modelimin e simulimit përmes seminarëve dhe punëtorive.</p> <p>5-8 MMPHI me ekspertët e JICA-s përgatitet për krijimin e sistemit të zbatimit të simulimit.</p> <p>5-9 MMPHI bashkë me ekspertët e JICA analizojnë gjendjen e cilësisë së ajrit në zonën e Prishtinës.</p>	<p>6-1 Pala kosovare dhe ekspertët e JICA-s bëjnë shqyrtimin e masave për zvogëlimin e emisioneve për IDM që ndërliken me PKZE-në (Planin Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve) nga pikëpamja teknike.</p> <p>6-2 Pala kosovare dhe Ekspertët e JICA-s bëjnë shqyrtimin dhe vlerësimin e masave për zvogëlimin e emisioneve për burimet e tjera të palëvizshme nga pikëpamja teknike.</p> <p>6-3 Pala kosovare dhe Ekspertët e JICA-s i diskutojnë përmirësimet e politikave relevante bazuar në aktivitetet 6-1 dhe 6-2.</p> <p>6-4 Pala kosovare bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë shpërndarjen e njohurive relevante dhe informacioneve për kontrollin e ndotjes së ajrit të gjeneruara nga Projekti tek publiku përmes buletineve informuese dhe faqeve të internetit, etj.</p>

<p>7-1 Pala kosovare bashkë me ekspertët e JICA-s bëjnë analizimin e sjelljes së gazit të shkarkuar nga oxhaku i IDM-ve duke përfshirë SO2.</p> <p>7-2 Ekspertët e JICA-s do ta mbajnë një seminar dhe një punëtori për t'i diskutuar masat për reduktimin e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera të palëvizshme duke përfshirë teoritë fundamentale të kontrollit të emisioneve.</p> <p>7-3 Pala kosovare bashkë me ekspertët e JICA-s bëjnë zbatimin e diagnostikimit të operacioneve të IDM-ve dhe bëjnë shpjellimin e përmirësimeve operacionale për zvogëlimin e emisioneve.</p> <p>7-4 MMPHI me ekspertët e JICA-s bën majte shtesë të gazit të shkarkuar në TC Kosova A.</p>	<p>8-1 Pala kosovare bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë vlerësimin e realizueshmërisë teknike, ekonomike dhe sociale të masave të kontrollit të ndotjes për burimet e rëndësishme të emisioneve.</p> <p>8-2 MMPHI dhe agjencitë relevante bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë vlerësimin e efekteve të zvogëlimit të emisioneve përmasave të kontrollit të ndotjes për burimet e rëndësishme të emisioneve.</p> <p>8-3 MMPHI bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë vlerësimin e efekteve të përmirësimit të cilësisë së ajrit përmasave të kontrollit të ndotjes duke shfrytëzuar modelin e simulimit të dispersionit.</p> <p>8-4 MMPHI me ekspertët e JICA-s përmbledhin çështjet e ardhshme administrative duke marrë parasysh</p>
--	---

<p>projektligjin e ri për ndotjen e ajrit në Kosovë dhe konfirmon procedurat administrative dhe çështjet për rishikimin e Planit të Veprimit.</p>			
---	--	--	--

Shënim: “XX bashkë me Ekspertët e JICA-s” nënkupton “XX me asistencën e Ekspertëve të JICA-s”

1.4 Politika e zbatimit për Projektin

1.4.1 Politika bazë e zbatimit të Projektit

Qëllimi i projektit është rritja kapaciteteve të MMPHI/MMPH dhe organizatave dhe agjencive të saj relevante për menaxhimin e ndotësve të dëmshëm të ajrit, dhe kontributi në planifikimin dhe zbatimin e masave më efektive të kontrollit të ndotjes së ajrit për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe aplikimin e politikave relevante të menaxhimit të cilësisë së ajrit.

Projekti ka për qëllim që ta krijojë ciklin e menaxhimit të cilësisë së ajrit në Kosovë të paraqitur në Figura 1-2 në procesin e arritjes së Synimit të Përgjithshëm dhe Qëllimit të Projektit të përshkruara në MDP përmes zbatimit të aktiviteteve të projektit të cilat korrespondojnë me të të rezultatet të cilat mbështesin krijimin e menaxhimit të cilësisë së ajrit.




Figura 1-2 Cikli i menaxhimit të cilësisë së ajrit¹⁰

Përmbledhja e projektit është paraqitur në Figura 1-3. Rreshtat e figurës tregojnë aspektet e synuara siç janë Burimet e Emisionit (IDM, burimet e tjera të palëvizshme dhe burimet e tjera), Cilësia e Ajrit të Mjedisit/Ekspozimi i Popullatës dhe Koordinimi/Edukimi Institucional. Kolonat e figurës tregojnë çdo element të Ciklit të menaxhimit të cilësisë së ajrit. Figura gjithashtu tregon zonën e mbulimit të çdo rezultati që korrespondon me Ciklin e menaxhimit të cilësisë së ajrit.

Arritja e çdo rezultati do ta krijojë Ciklin e menaxhimit të cilësisë së ajrit, i cili çon në ndërtimin e strukturës së zhvillimit të qëndrueshëm për kontrollin e ndotjes së ajrit. Në të njëjtën kohë, kjo strukturë mund të ndihmojë rritjen e kapacitetit të përballimit të dy çështjeve (zbatimit të PKZE-së dhe themelimit të bazës për kontrollin e cilësisë së ajrit) me të cilën po merret tani Kosova.

Arritja e këtyre rezultateve kërkon mësimin dhe përvetësimin e elementeve teknike për matjen e gazit të shkarkuar dhe të masave për zvogëlimin e emisioneve (Rezultatet 2 dhe 7),

¹⁰ Republika e Kosovës: Planifikimi i detajuar i Projektit për zhvillimin e kapaciteteve për Kontrollin e ndotjes së ajrit në Republikën e Kosovës

monitorimin e ndotjes së ajrit dhe analizën e ndotësve të ajrit (Rezultatet 3 dhe 4), si dhe përgatitjen e inventarit të emisioneve dhe zbatimin e modelit të simulimit të dispersionit bazuar në këtë Inventar të Emisioneve (Rezultatet 1 dhe 5). Në bazë të këtyre rezultateve, zbatimi i Vendimmarrjes dhe Vlerësimit (Rezultatet 6 dhe 8) siç janë politikat e përmirësuara etj., gjithashtu ndihmojnë në krijimin e Ciklit të menaxhimit të cilësisë së ajrit.



Figura 1-3 Përmbledhja e Projektit¹⁰

1.4.2 Pikat që duhet konsideruar për zbatimin e Projektit

(1) Theksi i vënë mbi Zhvillimin e Kapaciteteve (këtu e tutje “Zh/K”)

Projekti i ka kryer aktivitetet duke u përqendruar në Zh/K të Homologëve (këtu e tutje “H/L”) dhe Grupeve Punuese të Homologëve (këtu e tutje “GP-H/L”).

Në aktivitetet e Projekti transferimi i teknologjisë është shtyllë e secilës fushë. Prandaj, theksi është vënë mbi zbatimin e qëndrueshëm të transferimit të teknologjisë. Projekti është përpjekur që H/L dhe GP-H/L ta thellojnë të kuptuarit e tyre për teknologjinë e transferuar për Trajnimit-në-Punë (këtu e tutje “TNP”), ligjëratave, punëtorive, seminareve, etj. Megjithëse janë ofruar Manualet dhe Procedurat Standarde Operacionale (këtu e tutje “PSO”) Projekti ka vendosur rëndësinë në transferimin e përvojës dhe njohurisë teknike në mënyrë më të detajuar. Përmes përsëritjes TNP, etj. Projekti ka pasur për qëllim nxitjen e zhvillimit të burimeve njerëzore të cilët do ta përdorin plotësisht teknologjinë e transferuar. Pritet që këto burime njerëzore ta bëjnë ngritjen e organizatave relevante dhe në të njëjtën kohë ta ndërtojnë bazën për krijimin e institucioneve dhe sistemeve për përdorimin dhe shpërndarjen e teknologjisë së transferuar.

Në Projekt, aktivitetet janë kryer ndaras në katër fusha. Për ta nxitur shkëmbimin e informacionit, Projekti ka mbajtur takime të rregullta rreth një herë në dy javë kryesisht gjatë qëndrimit të Ekipit të Ekspertëve të JICA-s (këtu e tutje “JET”) në Kosovë dhe kjo ka ndihmuar në shkëmbimin e informacionit ndërmjet GP-H/L dhe JET-it. Ndërkohë, JET-i gjithashtu ka shkëmbyer informacione me Universitetin e Prishtinës (këtu e tutje “UP”) përmes ligjëratave, meqenëse Projekti ka bashkëpunuar me UP-në në fushën e përgatitjes së inventarit të emisioneve, etj.

(2) Kryerja e Vlerësimit të Kapaciteteve

Për ta vlerësuar trendin e zhvillimit të kapaciteteve të palës kosovare gjatë periudhës së Projektit, në secilën periudhë JET-i ka bërë Vlerësimin e Kapaciteteve (këtu e tutje “VK”) të H/L dhe GP-H/L.

Qëllimi i VK-së është që të vlerësohet kapaciteti i palës kosovare nga pikëpamja e nivelit individual, niveli organizativ dhe nivelit synimi ndërlidhur me Synimin e Përgjithshëm dhe Qëllimin e Projektit. Për më tepër, kjo gjithashtu ka vlerësuar zhvillimin në krijimin e ciklit të menaxhimit të vetë-qëndrueshëm dhe konstruktiv të cilësisë së ajrit të përmendur më parë. Në të njëjtën kohë, JET-i ka bërë vlerësimin e burimeve njerëzore (anëtarët e stafit), buxhetit, burimeve institucionale siç janë kompetencat dhe marrëdhëniet e bashkëpunimit me organizatat/agjencitë e tjera relevante, pajisjeve, etj.

(3) Koordinimi me donatorë të tjerë

Në takimin e dytë të KPK-së pala japoneze propozoi mekanizmin e bashkëpunimit me donatorë të tjerë që lidhen me Projektin. Pala japoneze shprehu qëllimin e bashkëpunimit pozitiv me donatorë të tjerë dhe KPK miratoi këtë propozimin. Projekti shkëmbeu informacione në mënyrë pozitive dhe pati për synim të arrihen rezultate më efikase. Rezultatet e arritura në bashkëpunim me donatorët e tjerë janë siç vijon.

- i) Rehabilitimi i analizatorëve në SMCA (MCC/MFK)
- ii) Krijimi i rrjetit të komunikimit të të dhënave të cilësisë së ajrit (MCC/MFK)
- iii) Funksionalizimi dhe trajnimi për Spektrometrin me Masë Plazmë të Lidhur në mënyrë Induktive (këtu e tutje "ICP-MS") (MCC/MFK)

JET-i gjithashtu ka shkëmbyer informacione dhe mendime me donatorë të tjerë siç janë Banka Botërore (këtu e tutje “BB”), Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (këtu e tutje “GIZ”), GmbH dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Suedisë (këtu e tutje “SEPA”).

Paralelisht, JET-i mori pjesë në takimet e koordinimit të donatorëve lidhur me cilësinë e ajrit në Kosovë që u mbajtën më 21 dhjetor 2020 dhe 30 janar 2020, dhe shkëmbyen informacionet. Pjesëmarrësit ishin Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, Duka i Madh i Luksemburgut, Ministria e Shëndetësisë - Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, Shoqatat e Shëndetit, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, Komisioni Evropian, Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe

Zhvillimi, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë, Organizata Botërore e Shëndetësisë, Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit/Fondacioni i Mijëvjeçarit Kosovë, Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar, GIZ.

1.4.3 Politikat për secilën fushë të Projektit

Bazuar në faktet, çështjet dhe objektivat e lartpërmendura, politikat bazë për zbatimin e këtij Projekti janë përcaktuar si më poshtë.

Aktivitetet për rezultatet në këtë Projekt janë të ndara kryesisht në tri fusha, dhe çojnë në fushën e katërt siç është paraqitur në Figura 1-4. Fusha e parë është çështje lidhur me vlerësimin e efektit të secilit burim të emisionit në ajrin e mjedisit (këtu e tutje "Inventari i Emisioneve dhe Modelimi"), fusha e dytë është çështje lidhur me sistemin e monitorimit të cilësisë së ajrit përmes SMCA-ve dhe analizën e cilësisë së ajrit të mjedisit (këtu e tutje "Monitorimi i Cilësisë së Ajrit") dhe fusha e tretë është çështje lidhur me matjet e gazit të shkarkuar dhe masat për zvogëlimin e emisioneve (këtu e tutje "Matja dhe Masat për Zvogëlimin e Emisioneve"). Me arritjen e këtyre tri fushave, planet dhe projektimet e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit, politikat e kontrollit të ndotjes së ajrit, etj., bëhen të zbatueshme si "Vlerësimi për Vendimmarrje".

Në këtë dokument, burimet e mëdha të palëvizshme të emisioneve siç janë termocentralet quhen "IDM", burimet e tjera të palëvizshme të emisioneve siç janë objektet industriale quhen "burime të tjera të palëvizshme", ndërsa burimet mobile të emisionit siç janë automjetet dhe burimet të palëvizshme siç është ngrohja në amvisëri dhe shërbimet publike dhe private quhen "burime të tjera".




Figura 1-4 Struktura e Projektit

Pasqyra e politikave dhe rezultateve për secilën fushë është përshkruar siç vijon.

(1) Politika për fushën e Inventarit të Emisioneve dhe Modelimit dhe pasqyra e rezultateve

Rehabilitimi i analizatorëve në SMCA dhe përvetësimi i teknologjisë së matjes së cilësisë së ajrit të mjedisit mundëson të kuptohet gjendja e ajrit të mjedisit, mirëpo për përmirësimin e cilësisë së ajrit është e rëndësishme të planifikohen dhe zbatohen masat për kontrollin e ndotjes së ajrit me prioritet të lartë. Për ta realizuar këtë, është efektive të ndërmerren hapat në vijim. Hapat janë për ta vlerësuar kontributin e secilit burim të emisionit në ndotjen e ajrit, për të planifikuar masa për burimet me nivel të lartë të emisioneve, për ta vlerësuar efektin e secilës masë dhe për t'i dhënë secilës masë renditjen e vetë të prioritetit. Për vlerësimin e kontributit dhe vlerësimin e secilës masë, është shumë efektive të përgatitet inventari i emisioneve dhe të aplikohet modeli i simulimit të dispersionit.

Projekti vendosi rëndësi mbi përgatitjen e inventarit të emisioneve dhe zbatimin e simulimit nga pala kosovare përmes TNP, ligjëratave, punëtorive, seminareve, etj. H/L me ndihmën e JET-it u përpoqën ta krijojnë kornizën institucionale për përgatitjen e inventarit të emisioneve dhe zbatimin e simulimit të dispersionit në Kosovë.

Në fazën përfundimtare, Projekti si provë zbatoi simulimin e ndotjes së ajrit si analizë të strukturës së ndotjes së ajrit në Zonën e Prishtinës, dhe u përpoq ta bëjë vlerësimin e efektit dhe vlerësimin e kontributit të secilit burim të emisionit. Mirëpo, për shkak të besueshmërisë së ulët të të dhënave të cilësisë së ajrit nga e kaluara, Projekti nuk ka mundur ta bëjë vërtetimin e vlefshmërisë së rezultateve të simulimit. Kjo mbetet çështje për të ardhmen

Kjo është hera e parë për palën kosovare që mëson për përgatitjen e inventarit të emisioneve dhe modelin e simulimit të dispersionit dhe për këtë arsye Projekti ka mbështetur përgatitjen e manualeve për ta mbajtur qëndrueshmërinë e kryerjes së përgatitjes së inventarit të emisioneve dhe simulimit të dispersionit duke e marrë parasysh përvojën e trajnimit të dytë në Japoni.

Në Projekt, është organizuar H/L-GP i përbërë nga organizatat/agjencitë e ndërlidhura me këtë fushë dhe në të njëjtën kohë është krijuar marrëdhënia e bashkëpunimit me UP-në. Struktura e zbatimit për të cilën u ra dakord në P/D ka qenë bazike, mirëpo Projekti sipas nevojës ka bërë shqyrtimin e organizatave/agjencive dhe individëve.

Inventari i emisioneve dhe simulimi i dispersionit të ajrit janë vegla shumë efektive për ta kuptuar gjendjen e cilësisë së ajrit dhe është e rëndësishme që këto aktivitete të vazhdojnë.

(2) Politika për fushën e Monitorimit të Cilësisë së Ajrit dhe pasqyra e rezultateve

Të dhënat e cilësisë së ajrit janë bazë për të gjitha studimet siç janë të kuptuarit e gjendjes së ajrit, studimi i masave të kontrollit të ajrit, etj. dhe prandaj siguri i të dhënave të sakta të cilësisë së ajrit është i domosdoshëm. Projekti ka mbështetur

inspektimin dhe rehabilitimin e analizatorëve të cilët sigurojnë të dhëna për cilësinë e ajrit në SMCA. Paralelisht, Projekti ka ndihmuar në rritjen e kapaciteteve për operimin e analizatorëve në laboratorin e IHMK-së.

Në Kosovë, ku ekzistojnë dymbëdhjetë SMCA, të dhënat e cilësisë së ajrit nuk ishin mjaftueshëm të besueshme për shkak të mungesës së mirëmbajtjes së analizatorëve dhe të dhënat nuk ishin të organizuara mirë për shkak të papërshtatshmërisë së sistemit të mbledhjes së të dhënave. Për më tepër, nuk ka asnjë sistem për ta vlerësuar besueshmërinë e të dhënave të cilësisë së ajrit. Është e vështirë të thuhet se pala kosovare ka aftësi ta vlerësojë gjendjen e cilësisë së ajrit, dhe është e nevojshme të përmirësohet besueshmëria e të dhënave të cilësisë së ajrit.

Në anën tjetër, MCC/MFK ka mbështetur përmirësimin e cilësisë së ajrit, ka planifikuar rehabilitimin e analizatorëve në SMCA, instalimin e instrumenteve meteorologjike, krijimin e rrjetit të komunikimit të të dhënave të cilësisë së ajrit, shpalosjen e të dhënave të cilësisë së ajrit për publikun, etj. MMPHI/MMPH, JET-i dhe MCC/MFK diskutuan për ndarjen e roleve dhe u morën vesh për këtë në fillim të periudhës së dytë. Detajet janë përshkruar në 2.1 (1).

Si rezultat, Projekti realizoi rehabilitimin e analizatorëve në pesë SMCA në zonën e Prishtinës për ta përmirësuar besueshmërinë e të dhënave, dhe në të njëjtën kohë zëvendësoi kabinat e tri nga pesë SMCA-ve me kabina më të mëdha për përmirësimin e procesit të mirëmbajtjes. Për më tepër, për ta mbajtur saktësinë e të dhënave, Projekti bëri prezantimin për instrumentin e kalibrimit të analizatorëve, përgatitjen e manualit për O dhe M dhe trajnimin për O dhe M të analizatorëve. Për sa i përket rrjetit të komunikimit të të dhënave të cilësisë së ajrit, të dyja palët u pajtuat që MCC/MFK ta ndërtojë të gjithë rrjetin e komunikimit të të dhënave në Kosovë, dhe JICA në vend të kësaj zgjeroni planin origjinal për instalimin e një ekrani për shfaqjen e të dhënave në qytetin e Prishtinës në instalimin e një numri më të madh të ekraneve në Zonën e Prishtinës.

Përmes bashkëpunimit me MCC/MFK, aftësia e mbledhjes së të dhënave të cilësisë së ajrit në Kosovë është përmirësuar dukshëm. Mirëpo, ende ka probleme me sistemin e menaxhimit të të dhënave si p.sh. nuk është krijuar sistemi i kontrollit të parregullsive në të dhëna nga analizatorët dhe vërtetimit të vlefshmërisë së të dhënave përfundimtare, si dhe të kuptuarit e gjendjes së cilësisë së ajrit bazuar në të dhënat e mbledhura nuk është i mjaftueshëm.

Paralelisht, JET-i ka studiuar vendosjen optimale të SMCA-ve në Kosovë në mënyrë që të kuptohet gjendja e saktë e cilësisë së ajrit në Kosovë. JET-i gjithashtu ka trajnuar H/L në ushtrimin për matje të cilësisë së ajrit në emergjenca bë rast të emergjencave siç janë aksidentet mjedisore.

Për sa i përket rritjes së kapaciteteve për analiza në laboratorin e IHMK-së, JET-i ka mbështetur analizën e gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente¹¹. Metoda Standarde Referente është metodë të cilën e kërkon direktiva e BE-së për analizën e SO₂ dhe NO_x në gazin e shkarkuar nga IDM-të. Për sa i përket analizës së SO₂ dhe NO_x, JET-i ka përzgjedhur metodën e Jon Kromatografit (këtu e tutje "JK") dhe ka mbështetur analizat përmes trajnimit për mostrimin e gazit dhe ri-funksionalizimin e JK-së. Në të njëjtën kohë, meqenëse direktiva e BE-së gjithashtu kërkon analizën e Hg në gazin e shkarkuar nga IDM-të me djele të thëngjillit, JET-i ka mbështetur mostrimin dhe para-trajnimin për analizën e Hg dhe analizën me Spektrometër me Absorbim Atomik (këtu e tutje "AAS").

Si çështje tjetër, ekziston shqetësimi për metalet e rënda në PM në ajër. H/L bashkë me JET-in kanë bërë mostrimin e PM në Drenas dhe Mitrovicë, dhe këto mostra janë analizuar në Japoni. Të dyja rezultatet kanë treguar se disa komponentë tejkalojnë vlera udhëzuese të Japonisë, dhe është konfirmuar domosdoshmëria për monitorimin e metaleve të rënda. Në të njëjtën kohë, JET-i ka mbështetur funksionalizimin e ICP-MS për ta bërë analizën e metaleve të rënda në të ardhmen.

Mirëpo, IHMK ka probleme të tilla siç është mungesa e mjedisit të duhur dhe sistemit për punën e analizave, burime njerëzore të pamjaftueshme, etj. Tani e tutje, është e rëndësishme të krijohet sistemi i kontrollit të cilësisë për t'i garantuar rezultatet e analizës, dhe të bëhet laborator i që të vazhdojë të bëjë analiza në mënyrë të qëndrueshme.

(3) Politika për fushën e Matjeve dhe Masave për Zvogëlimin e Emisioneve dhe pasqyra e rezultateve

TC Kosova A dhe TC Kosova B, të cilat janë synimet kryesore të PKZE-së, njihen si burimet të mëdha të emisioneve në Kosovë. Strategjia e energjisë në Kosovë¹² e rishikuar në vitin 2017 thotë siç vijon.

Procesi i ndërtimit të TC të ri (këtu e tutje "TC Kosova e Re") do të vazhdojë, duke respektuar kriteret mjedisore të vendosura në Direktivën e BE-së. Koha e synuar për komisionimin e tij është përcaktuar të jetë më së voni fillimi i vitit 2023. Për ta parandaluar rrezikimin e sigurimit të furnizimit me energji elektrike, TC Kosova A do të funksionojë deri në zëvendësimin e saj me TC Kosova e Re. TC Kosova B do të vazhdojë të bartë barrën kryesore të sigurimit të furnizimit me energji elektrike. Procesi i rehabilitimit të TC Kosova B do të zhvillohet në dy faza:

- a. Faza e parë do të përfshijë intervenimet në komponentët mjedisorë për zvogëlimin e Pluhurit dhe NO_x.

¹¹ Komiteti Evropian për Standardizim (këtu e tutje "CEN") përcakton standardet në BE të ashtuquajtura Standarde EN. Standardi EN përcakton metodat e analizës për gazin e shkarkuar të ashtuquajtur Metoda Standarde Referente. Standardet EN janë të barasvlershme me Standardin Industrial në Japoni (këtu e tutje "JIS").

¹² STRATEGJIA E ENERGISË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2017 - 2026

b. Faza e dytë përfshin rehabilitimin e plotë siç është rimëkëmbja e kapacitetit të gjenerimit të energjisë elektrike, etj. duke përfshirë masat për zvogëlimin e SO₂ që do të fillojë pas fillimit të operimit të TC “Kosova e Re”.

Aktualisht, TC Kosova A dhe TC Kosova B kanë mbuluar 97% të kërkesës për energji elektrike në Kosovë dhe Kosova nuk mund të mos mbështetet në energjinë elektrike nga të dy TC-të.

PKZE-ja përfundimtare të cilën Kosova e ka dorëzuar në KEn në muajin maj të vitit 2018 thotë se TC Kosova B do të vazhdojë punën e saj përmes rehabilitimit të mbështetur nga BE-ja, por TC Kosova A do ta ndalojë punën në vitin 2023 kur TC Kosova e Re futet në funksion.

Në situatën e lartpërmendur, për rehabilitimin e TC Kosova B nga BE-ja që përfshinë masat mjedisore, masat për zgjatjen e jetës dhe përmirësimin e performancës është vendosur në periudhën e parë, dhe gjithashtu është vendosur për ndërtimin e TC Kosova e Re. Mirëpo, "Counter Global" që është investitor për TC Kosova e Re proklamoi tërheqjen nga investimi në Mars 2020 dhe plani për TC Kosova e Re tani është në pritje. Është e nevojshme të përcillet se si pala kosovare do të merret me këtë çështje, duke përfshirë rishikimin e PKZE-së.

Projekti ka bërë matjen e gazit të shkarkuar për TC Kosova A dhe TC Kosova B në periudhën e parë. Projekti ka kuptuar gjendjen ekzistuese të emisioneve nga të dy TC-të dhe këto të dhëna janë përdorur për inventarin e emisioneve nga IDM-të. Mirëpo, masat për zvogëlimin e emisioneve janë studiuar vetëm për TC Kosova A si përgjigje ndaj kërkesës së palës kosovare për të mos e studiuar TC Kosova B për shkak të marrëdhënies me BE-në.

Projekti ka mbledhur rezultatet e matjes së gazit të shkarkuar, të dhënat e operimit, të dhënat e analizës së linjtit dhe hirit fluturues, etj. dhe ka bërë studimin e masave për zvogëlimin e emisioneve. Si rezultat, në periudhën e parë janë propozuar masat për zvogëlimin e Pluhurit. TC Kosova A pranoi zbatimin e masave dhe një pjesë e masave është aplikuar në periudhën e dytë. TC Kosova A dhe JET-i kanë konfirmuar efektivitetin e masës përmes matjes së gazit të shkarkuar.

Për sa i përket burimeve të tjera të palëvizshme, JET-i ka kryer matjen e gazit të shkarkuar për katër burime të tjera të palëvizshme pas matjeve në IDM. Rezultatet e matjeve kanë treguar se disa nga komponentët e matur kanë tejkaluar VKE-të. Bashkë me matjen e gazit të shkarkuar, JET-i inspektoi dhe studioi rrjedhën e procesit të fabrikave dhe gjendjen e përdorimit të lëndës djegëse. JET-i ka propozuar masat për zvogëlimin e emisioneve për secilën fabrikë bazuar në këto studime.

VKE-të për burimet e tjera të palëvizshme janë të përshkruara në Udhëzimin Administrativ¹³ (këtu e tutje “UA”). Aktualisht MMPHI/MMPH është përpjekur që të

¹³ UDHËZIMI ADMINISTRATIV Nr. / 2007 “MBI RREGULLAT DHE STANDARDET E SHKARKIMEVE NË AJËR NGA BURIMET E PALËVIZSHME TË NDOTJES”

aplikojë VKE më të rrepta për burimet e tjera të palëvizshme përmes përpilimit të UA të ri duke i përfshirë VKE-të¹⁴ për IDM të kërkuara nga Direktiva e BE-së. Në këtë mënyrë MMPHI/MMPH është duke ndërmarrë masa legislative. Për sa i përket IDM-ve masat janë ndërmarrë në përputhje me PKZE-në. Mirëpo, për sa i përket burimeve të tjera të palëvizshme është e qartë se edhe momentalisht zbatimi i ligjit nuk është i mjaftueshëm. Ekziston problemi se raportimi i emisioneve nga objektet nuk bëhet plotësisht dhe udhëzimi nga MMPHI/MMPH nuk është në nivel të mjaftueshëm. Problemi duke se paraqitet për shkak të mungesës së njohurisë teknike dhe kapacitetit të autoritetit kompetent (MMPHI/MMPH). Në të njëjtën kohë, kjo çon kah situata ku nuk mund të nxiten kompanitë/agjencitë private për matje. Kjo është një nga çështjet më të mëdha për të ardhmen.

(4) Politika për fushën e Vlerësimit për Vendimmarrje dhe pasqyra e rezultateve

Në Kosovë me qëllim të përmirësimit të cilësisë së ajrit është zhvilluar “Plani i Veprimit për Cilësi të Ajrit¹⁵” (këtu e tutje “Plani i Veprimit”) bazuar në “Strategjinë për Cilësi të Ajrit¹⁶”. Plani i tanishëm i veprimit përmend masat e kontrollit të emisioneve për pajisjet e ngrohjes, IDM dhe objektet industriale, automjetet, etj. Mirëpo, këto masa nuk janë të propozuara në mënyrë konkrete, nuk bazohen në të dhëna teknike, etj. Prandaj, masat nuk ishin mjaftueshëm konkrete dhe nuk është bërë vlerësimi i ndikimit të secilës masë

Bazuar në informacionet nga secili rezultat Projekti ka mbështetur propozimin e masave konkrete dhe vlerësimin e jo vetëm ndikimit të tyre por edhe të kostove të nevojshme. Qëllimi i aktivitetit është jo vetëm të propozohen masat por gjithashtu që pala kosovare t’i mësojë hapat se si të përpilojë politika bazuar në të dhënat teknike nga tani e tutje.

Për sa i përket IDM-ve dhe fabrikave industriale, JET-i propozoi se është e rëndësishme për fabrikat që ta kryejnë matjen e gazit të shkarkuar dhe t’i raportojnë rezultatet si dhe t’i studiojnë masat për zvogëlimin e emisioneve bazuar në rezultatet e matjes në mënyrë të duhur, për shkak të dallimit në procese dhe përdorim të lëndës djegëse të secilës fabrikë. Në mënyrë që të realizohet kjo, operatorët e biznesit dhe MMPHI/MMPH duhet t’i forcojnë aftësitë teknike për t’i inspektuar rezultatet e matjes së gazit të shkarkuar dhe për t’i studiuar masat për zvogëlimin e emisioneve.

Për sa i përket studimit të masave, bazuar në rezultatet e tjera Projekti ndërmori procesin e vënies në listë të masave konkrete, duke përzgjedhur masa të aplikueshme dhe duke bërë vlerësimin e ndikimit dhe të kostos së masave të përzgjedhura. Inventari i emisioneve dhe simulimi të zhvilluara në Projekt u përdorën në veçanti për vlerësimin e ndikimit dhe kostos. Në të ardhmen, pritet që politikat të përpilohen në mënyrë të qëndrueshme bazuar në të dhëna teknike.

¹⁴ DIREKTIVA 2010/75/EU

¹⁵ “Plani i Veprimit” vlen për tri vite dhe zhvillohet bazuar në “Strategjinë për Cilësi të Ajrit”.

¹⁶ “Strategjia për Cilësi të Ajrit” vlen për dhjetë vite. Strategjia e tanishme është për 2013 ~ 2022.

1.5 Plan-programi i zbatimit të aktiviteteve

Si u përmend më lartë Projekti përbëhet nga katër fusha.

1.5.1 Plani dhe orari i aktiviteteve

Plani i aktiviteteve është paraqitur në Figura 1-5 dhe Plan-programi i aktiviteteve është paraqitur në Figura 1-6 në kohën e fillimit të Projektit.


Aktivitetet kryesore në fushën e Monitorimit të Cilësisë së Ajrit ishin planifikuar të përfundonin deri në fund të periudhës së dytë, meqenëse të dhënat për cilësinë e ajrit u bënë bazë për vërtetimin e vlefshmërisë së simulimit të cilësisë së ajrit.

Aktivitetet kryesore në fushën e Matjes dhe Masave për Zvogëlimin e Emisioneve ishin planifikuar gjithashtu të përfundonin deri në fund të periudhës së dytë, duke marrë parasysh situatën ku masat për zvogëlimin e emisioneve për TC Kosova A dhe TC Kosova B duhet të studioheshin dhe zbatoheshin sa më parë që të jetë e mundur për ta respektuar PKZE-në.

Disa aktivitete në fushën e Monitorimit të Cilësisë së Ajrit dhe Matjes dhe Masave për Zvogëlimin e Emisioneve gjithashtu janë planifikuar për periudhën e tretë në mënyrë që të bëhet përcjellja e rezultateve.

Aktivitetet në fushën e Vlerësimit për Vendimmarrje ishin planifikuar kryesisht për periudhën e dytë dhe të tretë, pasi që aktivitetet kishin nevojë për të dala nga rezultatet e tjera.


Orari aktual në periudhën e tretë është zgjatur për rreth 9 muaj për shkak të efektit të COVID-19. Prandaj, gjatë periudhës së zgjatur Projekti ka zhvilluar aktivitete shtesë për rritjen e kapaciteteve të H/L.



RP: Raporti i Progressit, PP Plani i punës, T në Japoni: Trajnimi në Japoni, R/F: Raporti Final

Figura 1-5 Plani i aktiviteve për secilën fushë

Orari i aktiviteve



Shënime: — Peridhja e parë; — Peridhja e dytë; — Peridhja e tretë; — Peridhja e katërt; — Peridhja e pestë; — Punët e tjera

Figura 1-6 Plan-programi i aktiviteve

1.5.2 Pikat e aktiviteteve

Në MDP të paraqitur në Tabela 1-1 janë planifikuar katër dhjetë e tetë (48) aktivitete. Në periudhën e tretë periudha e Projektit është zgjidhur nga një vit në një vit e nëntë muaj, dhe janë shtuar gjashtë aktivitete.

Projekti është ndarë në tri periudha dhe aktivitetet në secilin Rezultat janë kryer siç vijon

【Periudha e Parë】

(1) Punët për sa i përket menaxhimit të Projektit

- 1) Përpilimi dhe konsultimi i planit të punës
- 2) Përpilimi, shqyrtimi dhe konsultimi i MDP-së dhe PO si dhe mbështetja në themelimin e KPK-së dhe mbajtja e mbledhjes së KPK-së
- 3) Mbajtja e seminarit lansues të Projektit
- 5) Kryerja e vlerësimit të kapaciteteve

(2) Aktivitetet e secilit rezultat

• Aktivitetet e Rezultatit 1

Rezultati 1: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për ta shtjelluar inventarin e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera.

Aktivitetet 1.1 ~ 1.4

• Aktivitetet e Rezultatit 2

Rezultati 2: Zhvillohen kapacitetet për matjen e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera.

Aktivitetet 2.1 ~ 2.3, 2.5

• Aktivitetet e Rezultatit 3

Rezultati 3: Kryhen aktivitetet e monitorimit të cilësisë së ajrit

Aktivitetet 3.1 ~ 3.2, 3.6

• Aktivitetet e Rezultatit 4

Rezultati 4: Zhvillohen kapacitetet për analizat relevante mjedisore laboratorike për sa i përket matjes së emisioneve dhe monitorimit të cilësisë së ajrit.

Aktivitetet 4.5, 4.7 ~ 4.10

1) Aktivitetet e Rezultatit 5

Rezultati 5: Zhvillohen kapacitetet për modelimin e simulimit të cilësisë së ajrit.

Aktivitetet 5.1 ~ 5.2, 5.7

• Aktivitetet e Rezultatit 6

Rezultati 6: Përmirësohet vendimmarrja nga pala kosovare bazuar në të dhënat teknike për kontrollin e ndotjes së ajrit.

Nuk ka aktivitete

• Aktivitetet e Rezultatit 7

Rezultati 7: Zhvillohen masat e kontrollit të emisioneve në IDM.

Aktivitetet 7.1 ~ 7.2

- Aktivitetet e Rezultatit 8

Rezultati 8: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit.

Nuk ka aktivitete

【Periudha e dytë】

- (1) Punët për sa i përket menaxhimit të Projektit

- 1) Përpilimi dhe konsultimi i planit të punës
- 2) Përpilimi, shqyrtimi dhe konsultimi i MDP-së dhe PO si dhe mbështetja për mbajtjen e mbledhjes së KPK-së
- 4) Mbajtja e trajnimeve në Japoni
- 5) Kryerja e vlerësimit të kapaciteteve

- (2) Aktivitetet e secilit rezultat

- Aktivitetet e Rezultatit 1

Rezultati 1: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për ta shtjelluar inventarin e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera.

Aktivitetet 1.3 ~ 1.6

- Aktivitetet e Rezultatit 2

Rezultati 2: Zhvillohen kapacitetet për matjen e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera.

Aktivitetet 2.1 ~ 2.5

- Aktivitetet e Rezultatit 3

Rezultati 3: Kryhen aktivitetet e monitorimit të cilësisë së ajrit

Aktivitetet 3.3 ~ 3.10

- Aktivitetet e Rezultatit 4

Rezultati 4: Zhvillohen kapacitetet për analizat relevante mjedisore laboratorike për sa i përket matjes së emisioneve dhe monitorimit të cilësisë së ajrit.

Aktivitetet 4.1 ~ 4.6, 4.9, 4.10

- Aktivitetet e Rezultatit 5

Rezultati 5: Zhvillohen kapacitetet për modelimin e simulimit të cilësisë së ajrit.

Aktivitetet 5.2 ~ 5.5, 5.7

- Aktivitetet e Rezultatit 6

Rezultati 6: Përmirësohet vendimmarrja nga pala kosovare bazuar në të dhënat teknike për kontrollin e ndotjes së ajrit.

Aktivitetet 6.1 ~ 6.4

- Aktivitetet e Rezultatit 7

Rezultati 7: Zhvillohen masat e kontrollit të emisioneve në IDM.

Aktivitetet 7.1 ~ 7.3

- Aktivitetet e Rezultatit 8
Rezultati 8: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit.
Aktivitetet 8.1 ~ 8.2

【Periudha e Tretë】

(1) Punët për sa i përket menaxhimit të Projektit

- 1) Përpilimi dhe konsultimi i planit të punës
- 2) Përpilimi, shqyrtimi dhe konsultimi i MDP-së dhe PO si dhe mbajtja e mbledhjes së KPK-së
- 5) Kryerja e vlerësimit të kapaciteteve
- 6) Mbajtja e konferencës rajonale

(2) Aktivitetet e secilit rezultat

- Aktivitetet e Rezultatit 1
Rezultati 1: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për ta shtjelluar inventarin e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera.
Aktivitetet 1.4 ~ 1.6
Për më tepër, u kryen "Përgatitja e Inventarit të Emisioneve për vitin 2018 dhe rishikimi i manualit", "Kontrolli i Cilësisë (këtu e tutje "KC") dhe Aktivitetet e Sigurimit të Cilësisë (këtu e tutje "SC") për përgatitjen e inventarit të emisioneve" dhe "Studimi i planeve të përmirësimit për përgatitjen e inventarit të emisioneve".
- Aktivitetet e Rezultatit 2
Rezultati 2: Zhvillohen kapacitetet për matjen e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera.
Aktivitetet 2.2 ~ 2.5
- Aktivitetet e Rezultatit 3
Rezultati 3: Kryhen aktivitetet e monitorimit të cilësisë së ajrit
Aktivitetet 3.4 ~ 3.10
Për më tepër, u mbajt "Seminari për menaxhimin e të dhënave të cilësisë së ajrit".
- Aktivitetet e Rezultatit 4
Rezultati 4: Zhvillohen kapacitetet për analizat relevante mjedisore laboratorike për sa i përket matjes së emisioneve dhe monitorimit të cilësisë së ajrit.
Aktivitetet 4.3 ~ 4.6
- Aktivitetet e Rezultatit 5
Rezultati 5: Zhvillohen kapacitetet për modelimin e simulimit të cilësisë së ajrit.
Aktivitetet 5.4 ~ 5.7
Për më tepër, u kryen "Analiza e cilësisë së ajrit gjatë karantinës në Kosovë", "Ligjëratat për rezultatet e analizës së cilësisë së ajrit gjatë karantinës", "Mbështetja

për analizën dhe vlerësimin e të dhënave të cilësisë së ajrit gjatë një viti” dhe “Diskutimi për krijimin e kornizës për zbatimin e simulimit”.

- Aktivitetet e Rezultatit 6

Rezultati 6: Përmirësohet vendimmarrja nga pala kosovare bazuar në të dhënat teknike për kontrollin e ndotjes së ajrit.

Aktivitetet 6.2 ~ 6.4

- Aktivitetet e Rezultatit 7

Rezultati 7: Zhvillohen masat e kontrollit të emisioneve në IDM.

Aktiviteti 7.2

Për më tepër u bë “Matja e gazit të shkarkuar në TC Kosova A”.

- Aktivitetet e Rezultatit 8

Rezultati 8: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit.

Aktivitetet 8.1 ~ 8.3

Për më tepër, u kryen “Studimi i masave shtesë për kontrollin e ndotjes së ajrit”, “Llogaritja e Simulimit për masat shtesë për kontrollin e ndotjes së ajrit”, “Diskutimi për procedurën Administrative për Planin e Veprimit dhe çështjet” dhe “Studimi i vlerësimit të zbatimit të ligjeve në Kosovë”.

Në periudhën e tretë u zgjat periudha e Projektit, dhe u kryen aktivitete shtesë me qëllim të rritjes së kapaciteteve të H/L. Këto aktivitete janë përshkruar më lartë, dhe aktivitetet shtesë janë përmbledhur në tabelën në vijim.

Përmbajtja e aktiviteteve	
Rezultati 1	• MMPHI/MMPH me ndihmën e ekspertëve të JICA-s në mënyrë të pavarur kryen përgatitjen e inventarit të emisioneve, zbatimin e kontrollit të cilësisë dhe sigurimit të cilësisë së inventarit të emisioneve, dhe hartimin e planit të përmirësimit.
Rezultati 3	• Ekspertët e JICA mbajnë ligjërata për sistemin e menaxhimit të të dhënave për të dhënat e cilësisë së ajrit.
Rezultati 5	• MMPHI/MMPH me ndihmën e Ekspertëve të JICA-s analizon gjendjen e cilësisë së ajrit në zonën e Prishtinës. • MMPHI/MMPH me ndihmën e ekspertëve të JICA-s përgatitet për krijimin e sistemit të zbatimit të simulimit.
Rezultati 7	• MMPHI/MMPH me ndihmën e ekspertëve të JICA-s bën matje shtesë të gazit të shkarkuar në TC Kosova A.
Rezultati 8	• MMPHI/MMPH me ndihmën e ekspertëve të JICA-s përmbledh çështjet e ardhshme administrative duke marrë parasysh projektligjin e ri për ndotjen e ajrit në Kosovë dhe konfirmon procedurat administrative dhe çështjet për rishikimin e Planit të Veprimit.
Aktivitetet konkrete	
Aktivitetet shtesë të fazës së parë	- Punëtoritë dhe përmbledhja e rezultateve të Inventarit të Emisioneve, Masave të kontrollit të ndotjes së ajrit dhe Simulimit

(të shtuara në gusht 2020)	(Rezultatet 1 dhe 5) - Seminari për menaxhimin e të dhënave të cilësisë së ajrit (Rezultati 3) - Analiza e cilësisë së ajrit gjatë karantinës në Kosovë (Rezultati 5) - Ligjëratat për rezultatet e analizës së cilësisë së ajrit gjatë karantinës (Rezultati 5)
Aktivitetet shtesë të fazës së dytë (të shtuara në tetor 2020)	- Përgatitja e inventarit të emisioneve për vitin 2018 dhe rishikimi i manualit (Rezultati 1) - Aktivitetet e Kontrollit të Cilësisë dhe Sigurimit të Cilësisë në përgatitjen e inventarit të emisioneve (Rezultati 1) - Studimi i planeve të përmirësimit të përgatitjes së inventarit të emisioneve (Rezultati 1) - Mbështetja për analizën dhe vlerësimin e të dhënave të cilësisë së ajrit gjatë një viti (Rezultati 5) - Diskutimi për krijimin e kornizës për zbatimin e simulimit (Rezultati 5) - Mbështetja për studimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit (Rezultati 8) - Llogaritja e Simulimit për masat shtesë të kontrollit të ndotjes së ajrit (Rezultati 8) - Studimi i vlerësimit të zbatimit të ligjeve në Kosovë (Rezultati 8) - Diskutimi për procedurën Administrative për Planin e Veprimit dhe përmbledhja e çështjeve (Rezultati 8) - Matja e gazit të shkarkuar në TC Kosova A (Rezultati 7)

1.6 Shpjegimi shtesë për aktivitetet e Projektit (rregullat e ligjit në BE)¹⁷

Për të qenë vend anëtar i BE-së, secili shtet duhet t'i bindet rregullave të ligjit, të ashtuquajtura "Acquis communautaire".

Acquis communautaire janë rregulla të ligjit që mbulojnë të gjitha traktatet, legjislacionin e BE-së (rregulloret, direktivat, etj.), marrëveshjet ndërkombëtare, standardet, vendimet gjyqësore, dispozitat e të drejtave themelore dhe parimet horizontale në traktate siç janë barazia dhe mos-diskriminimi.

Të gjithë vendet anëtare dhe qytetarët e tyre duhet t'i respektojnë Acquis dhe të gjitha vendet kandidate duhet të pranojnë Acquis të plotë për t'u bërë anëtare të Bashkimit Evropian.

'Acquis' i BE-së është organi i të drejtave dhe detyrimeve të përbashkëta që janë detyruese për të gjitha vendet e BE-së, si Anëtare të BE-së. Kjo është vazhdimisht në zhvillim dhe përfshin:

- përmbajtjen, parimet dhe objektivat politike të Traktateve;
- legjislacionin e miratuar në zbatimin e traktateve dhe praktikave gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të BE-së;
- deklaratat dhe rezolutat e miratuara nga BE-ja;
- masat në lidhje me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë dhe masat në lidhje me drejtësinë dhe punët e brendshme;

¹⁷ https://europa.eu/european-union/law_en

- Marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura nga BE-ja dhe ato të lidhura nga vendet e BE-së ndërmjet tyre në fushën e aktiviteteve të BE-së.

Në pikat e përmendura më lart, legjislacioni i BE-së ndahet në atë primar dhe sekondar. Traktatet (legjislacioni primar) janë baza ose rregullat bazë për të gjitha veprimet e BE-së. Legjislacioni dytësor, që përfshin rregulloret, direktivat dhe vendimet rrjedhin nga parimet dhe objektivat e përcaktuara në traktate

Sistemi i instrumenteve ligjore të BE-së është siç vijon

	<u>Të adresuarit</u>	<u>Efektet</u>
Rregulloret	Të gjitha vendet anëtare, persona fizikë dhe juridikë	Drejtpërdrejtë të aplikueshme dhe detyruese në tërësinë e tyre
Direktivat	Të gjitha vendet anëtare ose vendet anëtare specifike	Detyruese për sa i përket rezultateve synuara. Drejtpërdrejtë të aplikueshme vetëm në rrethana të veçanta
Vendimi I	E drejtuar kah të adresuarit - Të gjitha vendet anëtare ose vendet anëtare specifike - Persona fizikë ose juridikë specifike	Drejtpërdrejtë të aplikueshme dhe detyruese në tërësinë e tyre
Vendimi II	Nuk është e drejtuar kah të adresuarit specifike	Detyruese në tërësinë e tyre
Rekomandimet	Të gjitha vendet anëtare ose vendet anëtare specifike, organet e tjera të BE-së, individët	Nuk është detyruese
Opinionet	Të gjitha vendet anëtare ose vendet anëtare specifike, organet e tjera të BE-së. Nuk është specifikuar	Nuk është detyruese

Në Aktivitetet e Projektit, ka shumë aktivitetet e ndërlidhura me Direktivat e BE-së. Shpjegimi i Direktivave të BE-së është siç vijon.

"Direktiva" është akt legjislativ që përcakton një qëllim që duhet ta arrijnë të gjitha vendet e BE-së. Mirëpo, varet nga vendet individuale që t'i hartojnë ligjet e tyre se si t'i arrijnë këto qëllime. Një shembull është "direktiva e BE-së për të drejtat e konsumatorit", e cila forcon të drejtat për konsumatorët në të gjithë BE-në, për shembull duke i eliminuar tarifatat dhe kostot e fshehta në internet dhe duke zgjatur periudhën në të cilën konsumatorët mund të tërhiqen nga një kontratë e shitjes.

Për më tepër, aktiviteti i lidhur ngushtë me Kosovën është "Procesi i Stabilizim Asociimit (këtu e tutje "PSA").

PSA është politikë e Bashkimit Evropian ndaj Ballkanit Perëndimor, e krijuar me qëllimi të anëtarësimit përfundimtar në BE. Vendet e Ballkanit Perëndimor janë përfshirë në partneritet progresiv me synim të stabilizimit të rajonit dhe krijimin e zonës së tregtisë së lirë. PSA përcakton qëllimet e përbashkëta politike dhe ekonomike megjithëse vlerësimi i progresit bazohet në meritat e vetë vendeve.

PSA u lansua në qershor të vitit 1999 dhe u përforcua në Samitin e Selanikut në qershor të vitit 2003 duke marrë elemente të procesit të anëtarësimit. Ajo qëndron në:

- Marrëdhëniet kontraktuale (Marrëveshja bilaterale e Stabilizim Asociimit (këtu e tutje "MSA"))
- Marrëdhëniet tregtare (masat autonome tregtare);
- Ndihma financiare (Instrumenti i Ndihmës së Para-anëtarësimit (këtu e tutje "IPA"))
- Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore

Qeveria e Kosovës nënshkroi MSA-në më 27 tetor 2015 dhe tani është "Kandidat i Mundshëm" për anëtarësim në BE. Prandaj, Kosova duhet t'i pranonte rregulloret e BE-së dhe të bënte transpozimin e direktivave të ndryshme të BE-së në ligjet vendore si dhe t'i zbatonte ato.

Direktivat e BE-së në lidhje me fushat e Projektit janë si më poshtë.

- DIREKTIVA 2008/50/EC për cilësinë e ajrit të mjedisit dhe ajër më të pastër për Evropën
Direktiva përcakton standardet e cilësisë së ajrit, etj., dhe kërkon monitorimin e cilësisë së ajrit dhe pajtueshmërinë me standardet, e që është direktiva më themelore për cilësinë e ajrit. Përmbajtja është reflektuar në projektligjin për mbrojtjen e ajrit.
- DIREKTIVA 2010/75/EU për emisionet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes)
Kjo është direktivë për emisionet nga IDM-të dhe impiantet për trajtimin e mbeturinave, e cila është direktiva themelore për PKZE-në. Përmbajtja pasqyrohet në projektligjin për mbrojtjen e ajrit, dhe tani është duke u hartuar UA sipas ligjit.
- DIREKTIVA (EU) 2015/2193 për kufizimin e emisioneve të ndotësve të caktuar në ajër nga impiantet me djegie të mesme
Kjo është direktivë për emisionet nga impiantet me djegie më të vogla sesa IDM-të (1MW =< hyrja termike <50MW). Përmbajtja pasqyrohet në UA sipas ligjit të ndotjes së cilësisë së ajrit, që tani është duke u hartuar.
- DIREKTIVA 2009/125/EC që krijon kornizën për përcaktimin e kërkesave të eko-dizajnit për produktet e lidhura me energjinë
Kjo është direktivë për eko-produktet, dhe në të njëjtën kohë, përcakton VKE-të për produktet. Kjo direktivë nuk është transponuar në ligjet vendore në Kosovë.
- DIREKTIVA (EU) 2016/2284 për zvogëlimin e emisioneve kombëtare të ndotësve të caktuar atmosferikë
Kjo është direktivë që obligon shtetet anëtare ta planifikojnë dhe zbatojnë zvogëlimin e emisioneve kombëtare të ndotësve të caktuar atmosferikë. Mirëpo, kjo direktivë nuk është transponuar në ligjet vendore në Kosovë. Kjo direktivë titullohet Direktiva e Tavaneve të Emisioneve Kombëtare (këtu e tutje "Direktiva NEC").

Disa nga këto direktiva nuk janë të planifikuara që të transponohen në ligjet e Kosovës, dhe ende ka pengesa për zbatim edhe nëse ato transponohen në ligje.

Përveç direktivave të përmendura më sipër, ka rregullore, etj. që ndërlidhen me marrëveshjen e Parisit.

2. Menaxhimi i Projektit

2.1 Performanca e aktiviteteve

PO e Projektit është versioni të cilin Projekti e ka planifikuar në kohën e fillimit të Projektit. Mirëpo, për shkak të efektit të pandemisë COVID-19, periudha e Projektit u zgjat për nëntë muaj. Plani i rishikuar dhe regjistri aktual i aktiviteteve, përfshirë aktivitetet shtesë gjatë periudhës së zgjatur janë paraqitur në Figura 2-1. PO fillestar është paraqitur në ANEKSIN-1 “Dokumentet e ndërlidhura me Takimet e Komitetit të Përbashkët Koordinues”

Ekzistojnë dallime ndërmjet planit origjinal dhe regjistrin aktual. Ato kryesisht kanë ndodhur për shkak të përshtatjes dhe/ose shtimit të punëve, dhe për këtë arsye rishikimi i PO nuk është kryer për pjesët origjinale të planit, por vetëm për pjesët shtesë.




Figura 2-1 Plani i aktiviteteteve dhe regjistri aktual (2/3)

Rezultati	Plan	Aktual
Zhvillohen kapacitetet për modelimin e simulimit të cilësisë së ajrit		
5.1 MAMPHI dhe agjencitë relevante me asistencën e Ekspertëve të JICA përcaktuan seksionet përfundimtare të modelit të simulimit dhe krijuan koordinimin e duhur me agjencitë e tjera të relevante.		
5.2 MAMPHI dhe agjencitë relevante me asistencën e Ekspertëve të JICA bëjnë mbledhjen e të dhënave dhe të dhënave të cilësisë së ajrit, të dhënave meteorologjike dhe të informacionit administrativ, etj.		
5.3 MAMPHI me ndihmën e Ekspertëve të JICA bëjnë analizën dhe vlerësimin e të dhënave meteorologjike për aplikimin e modelit të simulimit të dispersionit.		
5.4 MAMPHI me asistencën e Ekspertëve të JICA bëjnë analizën dhe vlerësimin e vlefshmërisë së të dhënave të monitorimit të cilësisë së ajrit.		
5.5 MAMPHI me asistencën e Ekspertëve të JICA elaboron modelin e simulimit të dispersionit për vitin e synuar.		
5.6 MAMPHI me asistencën e Ekspertëve të JICA-s bëjnë analizën e strukturës së ndodjes së ajrit.		
5.7 MAMPHI me asistencën e Ekspertëve të JICA morri njëkohuri teorike të modelit të simulimit dhe e përkulën modelimin e simulimit përmes seminareve dhe punësitorëve.		
5.8 5-8 MAMPHI me ekspertët e JICA-s përgatitën e sistemit të zbatimit të simulimit.		
Rezultati 6		
Përmirësohet vendimtarja nga pala kosovare bazuar në të dhënat teknike për kontrollin e ndodjes së ajrit.		
6.1 Pala kosovare me asistencën e Ekspertëve të JICA-s bëjnë shpërndarjen e masave për zvogëlimin e emisioneve për-IDM-të që ndërhahet me PKZE-në (Planin Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve) nga vlerësimi i të dhënave.		
6.2 Pala kosovare me asistencën e Ekspertëve të JICA-s bëjnë shpërndarjen dhe vlerësimin e masave për zvogëlimin e emisioneve për burimet e tjera të palvësishme nga përkëmbja teknike.		
6.3 Pala kosovare me asistencën e Ekspertëve të JICA-s i diskuton përmirësimet e politive relevante bazuar në ndodhjet 6.1 dhe 6.2.		
6.4 Pala kosovare me asistencën e Ekspertëve të JICA-s bëjnë shpërndarjen e njohurive relevante dhe informacioneve për kontrollin e ndodjes së ajrit të gjeneruara nga Projekti të publiku për imazh, buletineve informuese, faqeve të internetit, etj.		
Rezultati 7		
Zhvillohen masat e kontrollit të emisioneve në IDM.		
7.1 Pala kosovare me asistencën e Ekspertëve të JICA-s bëjnë analizën e sjelljes së gazit të shkaktuar nga oxhidi IDM-ve duke përfshirë SO2.		
7.2 Ekspertët e JICA-s do të mësojnë një punëtor për t'u kushtuar masat për zvogëlimin e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera të palvësishme duke përfshirë teorinë e ndodhjeve të kontrollit të emisioneve.		
7.3 Pala kosovare me asistencën e Ekspertëve të JICA-s përcaktuan diagnozën për operacionet e IDM-ve dhe shpërndarën procedurat për zvogëlimin e emisioneve.		
7.4 MAMPHI me ekspertët e JICA-s vlerëson efektet e ngarkesës gjatë operimit.		
Rezultati 8		
Pala kosovare zhvillon kapacitetet për vlerësimin e masave të kontrollit të ndodjes së ajrit.		
8.1 Pala kosovare me asistencën e Ekspertëve të JICA-s bëjnë vlerësimin e aftësisë së teknike, ekonomike dhe sociale të masave të kontrollit të ndodjes për burimet e rëndësishme të ajrit.		
8.2 MAMPHI dhe agjencitë relevante me asistencën e Ekspertëve të JICA-s bëjnë vlerësimin e efektive të zvogëlimit të emisioneve përmes masave të kontrollit të ndodjes për burimet e rëndësishme të ajrit.		
8.3 MAMPHI me asistencën e Ekspertëve të JICA-s bëjnë vlerësimin e efektive të përmirësimit të cilësisë së ajrit përmes masave të kontrollit të ndodjes duke shfrytëzuar modelin e simulimit të dispersionit.		
8.4 MAMPHI me ekspertët e JICA-s përmirësojnë procedurat administrative për Planin e Veprimit dhe çështjet duke marrë parasysh propozimin e ri në Kosovë.		

Figura 2-1 Plani i aktivitetëve dhe regjistri aktual (3/3)

Përshtatjet kryesore dhe/ose shtimi i punëve janë paraqitur në vijim. Detajet janë shpjeguar për secilin aktivitet.

1. Rezultati 3: Kryhen aktivitetet e monitorimit të cilësisë së ajrit

- Në fillimi të Projektit, MCC/MFK gjithashtu kishte planifikuar rehabilitimin e analizatorëve në SMCA dhe ndërtimin e rrjetit të komunikimit të të dhënave të cilësisë së ajrit. JICA kishte planifikuar rehabilitimin e analizatorëve dhe ndërtimin e rrjetit të komunikimit të të dhënave të cilësisë së ajrit për pesë SMCA në Zonën e Prishtinës. Në fazën e hershme të periudhës së dytë (tetor 2018) si rezultat i takimit ndërmjet JET-it dhe MCC/MFK me MMPHI/MMPH, JET-i do ta bënte rehabilitimin e analizatorëve në pesë SMCA në Zonën e Prishtinës siç ishte planifikuar, por për sa i përket ndërtimit të rrjetit të komunikimit të të dhënave të cilësisë së ajrit MCC/MFK do ta instalonte rrjetin e komunikimit të të dhënave për të gjitha SMCA-të në Kosovë pasi që pala kosovare kërkoi rrjet të integruar dhe të pavarur të komunikimit të të dhënave në Kosovë. JICA ia la ndërtimin e të gjithë rrjetit të komunikimit të të dhënave MCC/MFK. Në vend të kësaj JICA ndryshoi planin e instalimit të ekraneve për shfaqjen e të dhënave të cilësisë së ajrit: nga instalimi i një ekrani në ambient të brendshëm në qytetin e Prishtinës në instalim e ekraneve në ambient të hapur në Zonën e Prishtinës në pesë lokacione. Ndryshimi i MDP-së për shkak të këtij ndryshimi të planit u miratua në takimin e tretë të KPK-së.

Tabela 2-1 paraqet ndarjen e roleve ndërmjet JICA-s dhe MCC/MFK

Tabela 2-1 Ndarja e roleve ndërmjet JICA-s dhe MCC/MFK
(Në tabelën në vijim MMPHI/MMPH është përshkruar si MMPHI)

Fusha Teknike	MCC/MFK	JICA
3-3 MMPHI me ndihmën e Ekspertëve të JICA-s bëjnë rehabilitimin e SMCA-ve në Zonën e Prishtinës.	<ul style="list-style-type: none"> MCC/MFK bën rehabilitimin e analizatorëve në SMCA në Kosovë, përveç pesë SMCA-ve në Zonën e Prishtinës. MCC/MFK bën rehabilitimin e të gjitha instrumenteve meteorologjike për SMCA-të në të gjithë Kosovën. 	<ul style="list-style-type: none"> JICA bën rehabilitimin e analizatorëve në pesë SMCA në Zonën e Prishtinës JICA zëvendëson tri kabina të SMCA-ve nga pesë SMCA në Zonën e Prishtinës.
3-4 MMPHI me ndihmën e Ekspertëve të JICA-s përgatisin manualët për O	MCC/MFK përgatit manualët e O dhe M për SMCA, përveç pesë	JICA përgatit manualët e O dhe M për pesë SMCA-të në Zonën e Prishtinës.

dhe M të SMCA-ve në Zonën e Prishtinës.	SMCA-ve në Zonën e Prishtinës	
3-5 MMPHI me ndihmën e Ekspertëve të JICA-s bëjnë kalibrimin e analizuesve në SMCA-të në zonën e Prishtinës bazuar në manualët e O dhe M.	MCC/MFK bën kalibrimin e analizatorëve në SMCA, përveç pesë SMCA-ve në Zonën e Prishtinës.	JICA bën kalibrimin e analizatorëve në pesë SMCA-të në Zonën e Prishtinës
3-7 MMPHI me ndihmën e Ekspertëve të JICA-s ndërtojnë Rrjetin në mes SMCA-ve në Kosovë.	MCC/MFK ndërton Rrjetin e komunikimit të të dhënave ndërmjet të gjitha SMCA-ve.	Aktiviteti është anuluar për shkak të krijimit të rrjetit të integruar të komunikimit të të dhënave nga MCC/MFK.
3-10 MMPHI me ndihmën e Ekspertëve të JICA-s shfrytëzojnë rezultatet e SMCA-ve për raportin vjetor për cilësinë e ajrit si dhe për vetëdijesimin e publikut.	MCC/MFK krijon sistemin e publikimit të të dhënave të cilësisë së ajrit përmes internetit.	JICA instalon ekranet për shfaqjen e të dhënave të cilësisë së ajrit në Zonën e Prishtinës

2. Rezultati 4: Zhvillohen kapacitetet për analizat relevante mjedisore laboratorike për sa i përket matjes së emisioneve dhe monitorimit të cilësisë së ajrit.

- Në gjysmën e dytë të periudhës së parë JET-i bëri mostrimin e PM në ajër në Drenas dhe Mitrovicë, i dërgoi ato në Japoni dhe bëri analizën e metaleve të rënda në PM. Rezultati i analizës për Mitrovicën kishte komponentë të cilët tejkalonin vlerat udhëzuese të Japonisë, por rezultati i analizës për Drenasin nuk kishte kurrfarë problemi. Mirëpo, në kohën e mostrimit në periudhën e parë në Drenas, fabrika e cila supozohet të jetë ndotëse kryesore nuk ishte në operim. H/L kërkoi që analiza të përsëritet. Në periudhën e dytë, JET-i përsëri bëri mostrimin e PM në Drenas, i dërgoi mostrat në Japoni dhe ka bërë analizën e tyre. Rezultati i analizës tregoi komponentë të cilët tejkalojnë vlerat udhëzuese të Japonisë njëjtë si në rastin e Mitrovicës. Kësaj pune iu nevojiti kohëzgjatje prej një viti për shkak të periudhës së pritjes për rifillimin e punës së fabrikës.

Pala kosovare dhe pala japoneze pranuan domosdoshmërinë e monitorimit të metaleve të rënda në PM në ajër si për Drenasin ashtu edhe për Mitrovicën. Mirëpo, për t'i analizuar metalet e rënda nevojitej operimi i ICP-MS. Plani original për ICP-MS ishte konfirmimi i mundësisë së operimit. JET-i kontrollloi dhe riparoi ICP-MS dhe ICP-MS u bë operacionale. Mirëpo, H/L kërkuan që ICP-MS të bihet në gjendje për t'i analizuar metalet e rënda dhe për këtë arsye JET-i operoi dhe rregulloi ICP-MS. ICP-MS ishte në gjendje të gatshme për

analizën e metaleve të rënda. MCC/MFK do ta mbajë trajnimin për operimin e ICP-MS, dhe pastaj do të analiza me ICP-MS do të jetë në dispozicion.

3. Rezultati 7: Zhvillohen masat e kontrollit të emisioneve në IDM.

- Projekti fillimisht kishte planifikuar ta bëjë studimin e masave për zvogëlimin e emisioneve për TC Kosova A dhe TC Kosova B të cilat janë IDM-të e synuara përmes PKZE-së. Mirëpo, BE kreu studimin e fisibilitetit për rehabilitimin e TC Kosova B¹⁸, dhe vendosi ta ndihmojë rehabilitimin në aspektin teknik dhe financiar. Meqenëse BE vendosi ta mbështesë rehabilitimin e TC Kosova B, KEK kërkoi nga MMPHI/MMPH të mos i studiojë masat për zvogëlimin e emisioneve për TC Kosova B. Projekti e pranoi kërkesën, dhe vendosi t'i studiojë masat vetëm për TC Kosova A. Në anën tjetër, KEK-u dhe JET-i ranë dakord për kryerjen e matjeve të gazit të shkarkuar për TC Kosova B siç ishte planifikuar, meqenëse Projekti duhet ta dinte gjendjen ekzistuese të emisioneve ndërlidhur me Rezultatin 2.

Ndryshimi u miratua në takimin e tretë të KPK-së. Tabela 2-2 tregon ndryshimet në aktivitete për TC Kosova A dhe TC Kosova B

Tabela 2-2 Ndryshimet në aktivitetet për TC Kosova A dhe TC Kosova B
(Në tabelën në vijim MMPHI/MMPH është përshkruar si MMPHI)

Fusha Teknike	TC Kosova A	TC Kosova B	Referencë
Informacioni për të dhënat e matjes së Emisioneve (Pluhuri, SO ₂ , NO _x) dhe të dhënat e operimit për përgatitjen e Inventarit të Emisioneve për IDM	Të ekzekutohet	Të ekzekutohet	Rezultati 1: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për ta shtjelluar inventarin e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera Aktiviteti
Matja në terren e gazit nga oxhaku (Pluhuri, SO ₂ , NO _x) për pajtueshmërinë me vlerat kufitare të Emisioneve nga MMPHI			1-1 MMPHI me ndihmën e Ekspertëve të JICA-s bën planin dhe kryen studimin e inventarit të emisioneve të IDM-ve. Në këtë aktivitet nevojiten të dhënat e operimit në vijim. <ul style="list-style-type: none"> Konsumi i lëndës djegëse (linjtit) për secilën njësi Prodhimi Neto i energjisë elektrike për secilën njësi Temperatura e gazit të shkarkuar nga oxhaku Furnizimi i nxehtësisë për ngrohjen qendrore të qytetit (temperatura dhe shtypja e avullit të nxjerrë dhe sasia e tij për secilën njësi) Lartësi dhe Diametri në majë të oxhakut
			Rezultati 2: Zhvillohen kapacitetet për matjen e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera.

¹⁸ Programi IPA 2013 i Bashkimit Evropian për Kosovën: “Studimi i Fisibilitetit për masat Mjedisore dhe masat e tjera për Termocentralin Kosova B, Studimi i Fisibilitetit Versioni Përfundimtar 19 maj 2017”

			<p>Aktiviteti</p> <p>2-2 MMPHI dhe agjencitë relevante me ndihmën e ekspertëve të JICA-s kryejnë TNP për matjen e gazit të shkarkuar duke i futur në përdorim instrumentet e nevojitura duke i përfshirë gazrat standarde.</p> <p>2-5 MMPHI me ndihmën e Ekspertëve të JICA-s kryejnë matjen në terren të gazit nga oxhaku për IDM, dhe e konfirmojnë pajtueshmërinë me VKE-të (vlerat kufitare të Emisioneve)</p>
Matja e Emisioneve (SO ₂ , NO _x , Hg) me metodën standarde të referencës në përputhje me Direktivën e BE-së (2010/75/EU) nga MMPHI	Të ekzekutohet	Të ekzekutohet	<p>Rezultati 4: Zhvillohen kapacitetet për analizat relevante mjedisore laboratorike për sa i përket matjes së emisioneve dhe monitorimit të cilësisë së ajrit.</p> <p>Aktiviteti</p> <p>4.1 MMPH-ja me ndihmën e ekspertëve të JICA bën studimin e metodologjive të mostrimit dhe matjes për IDM.</p> <p>4.3 MMPHI me ndihmën e ekspertëve të JICA-s kryejnë analizat përmes metodave referente për IDM duke përdorur metodën e Jon Kromatografit për SO₂ dhe NO_x dhe metodën e absorbimit atomik për Hg.</p> <p>4.4 MMPHI me ndihmën e ekspertëve të JICA-s shtjellon PSO-të për marrjen e mostrës dhe analizës së gazit nga oxhaku i IDM-ve.</p>
Shqyrtimi dhe diskutimi i masave për zvogëlimin e Emisioneve për IDM	Të ekzekutohet	Të mos ekzekutohet	<p>Rezultati 6: Pala kosovare përmirëson vendimmarrjen bazuar në të dhënat teknike për kontrollin e ndotjes së ajrit.</p> <p>Aktiviteti</p> <p>6.1 Pala kosovare me asistencën e ekspertëve të JICA bën shqyrtimin e masave për zvogëlimin e emisioneve për IDM që ndërlidhet me PKZE-në (Planin Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve) nga pikëpamja teknike.</p> <p>6.3 Pala kosovare me ndihmën e ekspertëve të JICA-s i diskuton përmirësimet e politikave relevante bazuar në aktivitetet 6-1 dhe 6-2.</p>
Studimi i masave për zvogëlimin e Emisioneve për IDM <ul style="list-style-type: none"> • Analiza e sjelljes së gazit të shkarkuar nga IDM-të duke përfshirë SO₂ • Diagnostikimi i 	Të ekzekutohet	Të mos ekzekutohet	<p>Rezultati 7: Zhvillohen masat e kontrollit të emisioneve në IDM.</p> <p>Aktiviteti</p> <p>7.1 Pala kosovare me ndihmën e ekspertëve të JICA-s bëjnë analizën e sjelljes së gazit të shkarkuar nga oxhaku i IDM-ve duke përfshirë SO₂.</p> <p>7.2 Ekspertët e JICA-s do ta mbajnë një seminar dhe një punëtori për t'i diskutuar masat për zvogëlimin e</p>

<p>operacioneve të IDM-ve dhe shtjellimi i përmirësimeve operacionale për zvogëlimin e emisioneve.</p>			<p>emisioneve për IDM duke përfshirë teorinë themelore të kontrollit të emisioneve.</p> <p>7.3 Pala kosovare me ndihmën Ekspertët e JICA-s bëjnë zbatimin e diagnostikimit të operacioneve të IDM-ve dhe bëjnë shtjellimin e përmirësimeve operacionale për zvogëlimin e emisioneve.</p> <p>Në këtë aktivitet nevojiten aktivitetet dhe të dhënat në vijim.</p> <p>Diagnostikimi i operimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Matja e vazhdueshme e NO_x dhe SO₂ • Analiza e linjtit dhe hirit fluturues • Regjistri i detajuar i operimit (lënda djegëse, të dhënat e operimit të kaldajës dhe turbinës, etj.) <p>Inspektimi i Fundërruesit Elektrostatik</p> <p>6.2 Matja e pluhurit</p> <p>6.3 Matja e shpërndarjes së shpejtësisë brenda FES-it dhe analiza e Rrjedhës brenda FES-it përmes Dinamikës Fluide Kompjuterike (këtu e tutje “SFD”)</p> <p>6.4 Studimi i planit për përmirësimin e FES-it përmes CFD-së</p>
--	--	--	---

4. Të tjera

- Disa shtete të Ballkanit janë duke vuajtur nga ndotja e ajrit. Veçanërisht në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Maqedoninë Veriore është bërë problem serioz. Megjithëse fillimisht nuk ishte planifikuar, Projekti do ta mbajë një konferencë rajonale për zonën e Ballkanit, dhe jo vetëm që do t'i prezantojë aktivitetet e Projektit por gjithashtu do ta bëjë shkëmbimin e informacioneve për çështjet lidhur me cilësinë e ajrit në secilin shtet pjesëmarrës.

2.2 Struktura e Zbatimit të Projektit

Për zbatimin e administrimit të mbrojtjes së ajrit të mjedisit dhe planifikimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit të mjedisit, përveç me autoritetin e administrimit mjedisor është e nevojshme të krijohen marrëdhënie të afërta dhe bashkëpunuese me sektorë të ndryshëm si energjinë, trafikun, infrastrukturën, etj., sepse burimet e emisioneve dhe masat e kontrollit të ndotjes përhapen tek një gamë e gjerë e sektorëve ekonomikë. Prandaj, përveç MMPHI/MMPH e cila kërkoi projektin, Projekti studioi bashkëpunimin dhe ndarjen e roleve me organizata dhe agjenci të tjera relevante, dhe ndërtoi GP-H/L për ta mbështetur krijimin e skemës së Projektit. GP-H/L ku MMPHI/MMPH është H/P kryesor, gjithashtu përbëhet nga ME/MZhe-ja, e cila është agjenci më e lartë kompetente e KEK-ut, dhe në lidhje me zhvillimin e shtjellimit të Inventarit të Emisioneve bashkëpunohet me MITN/MTI, MMPHI/MI, MPBAP/MPB, komunën e Prishtinës, ASK-në, etj. Figura në vijim tregon kornizën e zbatimit të Projektit.





Figura 2-2 Korniza e Zbatimit të Projektit

Akronimi i secilës organizatë ose agjenci është siç vijon.

MMPHI/MMPH	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (Ish Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor)
DMMU (MMPHI/MMPH)	Departamenti për Mbrojtje të Mjedisit dhe Ujërave
Në total janë dhënë donacion dy komplete të pajisjeve të matjes, ku një komplet ka qenë nga Aktiviteti Paraprak dhe kompleti tjetër ka qenë nga Projekti. Në periudhën e tretë njëri nga dy kompletet është transferuar tek KEK-u. Nga tani e tutje pritet që IHMK dhe KEK-u t'i përdorin ato në mënyrë efektive.

Në periudhën e tretë, Projekti i dha rëndësi trajnimit për organizimin e të dhënave, analizën e të dhënave të përfituara dhe llogaritjen e gazit të shkarkuar.

Përmes këtyre aktiviteteve H/L kanë mësuar procesin e matjes së gazit të shkarkuar të paraqitur në Figura 3-11.

2) Matja e gazit të shkarkuar për IDM

Aktivitetet e matjes së gazit të shkarkuar për TC Kosova A dhe TC Kosova B janë paraqitur në Tabela 3-58.

Për TC Kosova B është kryer vetëm matja e gazit të shkarkuar me qëllim që të kuptohet situata reale e emisioneve dhe për t'i siguruar të dhënat për inventarin e emisioneve. Në anën tjetër, për TC Kosova A është kryer matja për të njëjtat qëllime si për TC Kosova B, mirëpo përveç kësaj edhe për t'i studiuar masat për zvogëlimin e emisioneve të Pluhurit, SO₂ dhe NO_x, si dhe për krahasim me rezultatet e analizës me Metodën Standarde Referente.

Pajisjet e matjes të dhëna donacion janë përdorur për këto matje. Analizatori automatik i gazit i paraqitur në Foto 3-7 është përdorur për matjen e SO₂ dhe NO_x.



Foto 3-7 Analizatori automatik i gazit

Tabela 3-58 Aktivitetet e Matjes në terren të gazit nga oxhaku

Data	Aktiviteti	Vërejtjet
Periudha e parë		
16 prill (e hënë) ~ 25 prill (e mërkurë), 2018	16~20 prill: TC Kosova A: A-4 Kanali-B Matja e gazit të shkarkuar 23 prill: TC Kosova A: A-4 Kanali-B Matja e gazit të shkarkuar dhe e Pluhurit 24 prill: TC Kosova A: A-4 Kanali-C Matja e gazit të shkarkuar dhe e Pluhurit 24 prill: TC Kosova A: A-4 Kanali-A Matja e gazit të shkarkuar dhe e Pluhurit	Paralelisht me matjet u bë mostrimi i linjtit dhe hirit fluturues Në të njëjtën kohë, u mbështet matja e shpejtësisë brenda FES-it
30 prill 2018 (e hënë)	TC Kosova A: A-3 Kanali-A: Matja e gazit të shkarkuar dhe e Pluhurit (Testi për ndryshimin e shkallës së rrjedhës së gazit të shkarkuar)	Testi për vlerësimin e efektit të normës së rrjedhës së gazit të shkarkuar në performancën e FES
2 maj (e mërkurë)~ 3 maj (e enjte) 2018	2 maj: TC Kosova A: TC A-3 Kanali-C-Matja e gazit të shkarkuar dhe e Pluhurit (Testi për ndryshimin e përmbajtjes së O2 në gazin e shkarkuar) 3 maj: TC Kosova A: A-3 Kanali-B (Testi për ndryshimin e temperaturës në dalje të mullinjve)	Matja e gazit të shkarkuar dhe mostrimi i linjtit dhe hirit fluturues Mbështetja për matjen e shpejtësisë në FES
7 maj 2018 (e hënë)	TC Kosova A: A-3 Kanali-B: Matja e gazit të shkarkuar dhe e Pluhurit (Testi për ndryshimin e numrit të mullinjve në operim)	IHMK: 2 KEK: 2 JET: 3
10 maj (e enjte) dhe 12 maj (e shtunë) 2018	Përgatitja për Matjen e gazit të shkarkuar dhe matjen e Pluhurit nga H/L	
14 maj (e hënë)~ 17 maj (e enjte) 2018	14 maj: TC Kosova B: B-1 Kanali Nr.1 Matja e gazit të shkarkuar 15 maj: TC Kosova B: B-1 Kanali-Nr.1 Matja e gazit të shkarkuar dhe e Pluhurit 16 maj: TC Kosova B: B-2 Kanali-Nr.1 Matja e gazit të shkarkuar dhe e Pluhurit 17 maj: TC Kosova B: B-2 Kanali-Nr.2 Matja e gazit të shkarkuar dhe e Pluhurit	Si test final, vetëm H/L kanë kryer matjen duke u nisur nga përgatitja deri te raportimi
Periudha e dytë		
5 nëntor (e hënë)~ 6 nëntor (e martë)	Matja e gazit të shkarkuar për testin e zvogëlimit të NO _x në TC Kosova A	Pjesëmarrës KEK: 2 (JET: 2)

2018	(kaldaja No.3)	
21 mars 2019 22 (e premte)	Mbështetja për përgatitjen e matjes së shpërndarjes së shpejtësisë brenda FES-it në TC Kosova A	Pjesëmarrës KEK: 1 (JET: 3)
25 mars 2019 (e hënë)	Mbështetja për matjen e shpërndarjes së shpejtësisë brenda FES-it në TC Kosova A	Pjesëmarrës KEK: 2 (JET: 3)
29 mars (e premte)	Përgatitja për matjen e gazit të shkarkuar në TC Kosova A	Pjesëmarrës IHMK: 1 (JET: 3)
1 prill (e hënë) ~ 4 prill (e enjte) 2019	Matja e gazit të shkarkuar në TC Kosova A (mbështetja për konfirmimin e masave për zvogëlimin e Pluhurit) 1 prill ~ 3 prill Kaldaja No.5 4 prill Kaldaja A-4	Pjesëmarrës KEK:2, IHMK:2 (JET: 3)
10 prill 2019 (e mërkurë)	Matja e gazit të shkarkuar në TC Kosova A Kaldaja nr. 5 (mbështetja për testin e zvogëlimit të SO ₂ , NO _x)	Pjesëmarrës KEK:2, IHMK:1 (JET: 2)
11 prill 2019 (e enjte)	Matja e gazit të shkarkuar në TC Kosova A Kaldaja nr. 5 (mbështetja për testin e zvogëlimit të SO ₂ , NO _x)	Njëjtë
14 prill (e hënë) ~ 18 prill (e enjte) 2019	Matja e gazit të shkarkuar në TC Kosova A Kaldaja nr. 5 (mbështetja për testin e zvogëlimit të SO ₂ , NO _x)	Njëjtë
26 prill 2019 (e premte)	Matja e gazit të shkarkuar në TC Kosova A Krahasimi me Metodën Standarde Referente: Kaldaja nr. 4	Njëjtë
30 prill (e martë)	Matja e gazit të shkarkuar në TC Kosova A Krahasimi me Metodën Standarde Referente: Kaldaja nr. 4	Pjesëmarrës KEK:1, IHMK:2 (JET: 2)
15 maj (e mërkurë)	Matja e gazit të shkarkuar në TC Kosova B: Krahasimi me Metodën Standarde Referente: Kaldaja B-1, Kanali-1	Pjesëmarrës IHMK: 1 (JET: 2)
16 maj (e enjte)	Matja e gazit të shkarkuar në TC Kosova B: Krahasimi me Metodën Standarde Referente: Kaldaja B-1, Kanali-2	Pjesëmarrës IHMK: 1 (JET: 2)
Periudha e tretë		
1 nëntor (e premte), 2 nëntor (e shtunë) dhe 4 nëntor (e hënë) 2019	Përgatitja për mostrimin e gazit të shkarkuar për Metodën Standarde Referente:	Pjesëmarrës IHMK: 1 (JET: 2)
5 nëntor 2019 (e martë)	Bartja e pajisjeve në TC Kosova A	Pjesëmarrës IHMK:2 KEK:2, (JET: 3)
6 nëntor 2019 (e mërkurë)	Matja e gazit të shkarkuar dhe Pluhurit në TC Kosova A: Krahasimi me Metodën Standarde Referente: Kaldaja nr. 4, Kanali-C	Pjesëmarrës IHMK:2 KEK:2, (JET: 2)
8 nëntor 2019 (e premte)	Matja e gazit të shkarkuar dhe Pluhurit në TC Kosova A: Krahasimi me Metodën Standarde Referente: Kaldaja nr. 4, Kanali-C	Pjesëmarrës IHMK:2 KEK:2, (JET: 2)
11 nëntor 2019 (e hënë)	Matja e gazit të shkarkuar dhe Pluhurit në TC Kosova A: Krahasimi me Metodën Standarde Referente: Kaldaja nr. 4, Kanali-C	Pjesëmarrës IHMK:2 KEK:2, (JET: 2)
12 nëntor 2019 (e martë)	Pastrimi i pajisjeve të matjes	Pjesëmarrës IHMK:1, (JET: 2)

19 nëntor 2019 (e martë)	Matja e gazit të shkarkuar dhe Pluhurit në TC Kosova A: Krahasimi me Metodën Standarde Referente: Kaldaja nr. 4, Kanali-C	Pjesëmarrës IHMK:2 KEK:2, (JET: 2)
-----------------------------	---	---------------------------------------



Foto 3-8 Pamje nga matja e gazit të shkarkuar në TC Kosova A



Foto 3-9 Pamje nga matja e gazit të shkarkuar në TC Kosova B

Në periudhën e parë, Projekti ka kryer matjen e gazit të shkarkuar për ta kuptuar gjendjen reale të emisioneve nga TC Kosova A dhe TC Kosova B. Qëllimi i matjes ishte të sigurohen të dhëna për zhvillimin e inventarit të emisioneve dhe të konfirmohet pajtueshmëria me VKE-të e përcaktuara në Direktivën e BE-së. Për TC Kosova B janë kryer vetëm matjet.

Në anën tjetër, meqenëse qëllimet e matjeve në TC Kosova A ishin të hulumtohet sjellja e Pluhurit, S_{O_2} dhe NO_x në lidhje me studimin e masave për zvogëlimin e emisioneve, të kryhen teste të ndryshme dhe të vlerësohen rezultatet e testeve, matjet gjithashtu vazhduan edhe në periudha e dytë. Për më tepër, në periudhën e dytë u bë matja për ta vlerësuar efektivitetin e masës së zvogëlimit të Pluhurit (modifikimi i brendshëm i FES-it). Projekti përfundoi aktivitetet e lartpërmendura të nevojshme për Projektin deri në fund të periudhës së dytë.

Nga gjysma e fundit e periudhës së dytë deri në gjysmën e parë të periudhës së tretë, si aktivitet shtesë Projekti ka kryer matjen me qëllim të krahasimit të rezultateve të matjes me analizator automatik me rezultatet e analizës me Metodën Standarde Referente. Mirëpo, pasi që numri i testeve është i vogël, nuk është marrë ndonjë rezultat i qartë. Detajet janë përshkruar në 3-5-1.

Të gjitha rezultatet e matjeve janë paraqitur në Shtojcën-1: Periudha e tretë: “2-2)-4 Pasqyra e të dhënave të matjes për IDM”. Rezultatet e matjes (të konvertuar në $O_2 = 6\%$ në gazin e shkarkuar) janë të paraqitura në seri-kohore në Figura 3-12. Interpretimi i

rezultateve të matjes është përshkruar në 3.8.1. Vlerat e NO_x janë relativisht stabile, mirëpo vlerat e Pluhurit dhe të SO_2 ndryshojnë në secilën matje, madje vlerat e SO_2 nganjëherë tregojnë zero. Gjithashtu është gjetur se ndryshimi i vlerave të Pluhurit dhe SO_2 në TC Kosova A është më i madh se sa ajo në TC Kosova B. Mirëpo, këto vlera të emisioneve nuk përmbushnin VKE-të për IDM në vitin 2018 siç është paraqitur në Tabela 3-59, dhe kërkohej masa. Masat janë përshkruar në 3.8.1.




Figura 3-12 Rezultatet e matjes në TC Kosova A dhe TC Kosova B

Tabela 3-59 VKE-të për IDM

(O ₂ Referente = 6%)			
	Pluhuri (mg/Nm ³)	SO ₂ (mg/Nm ³)	NO _x (mg/Nm ³)
VKE-të për 2018^{*1)}	50	400	500

*1) Sipas PKZE-së, VKE-të ndryshojnë çdo vit (shihni 3.7.1). Kjo tabelë tregon VKE-të për vitin 2018.

3) Matja e gazit të shkarkuar në burimet e tjera të palëvizshme

Projekti ka kryer matjen e gazit të shkarkuar për objektet industriale (burimet e tjera të palëvizshme) në Kosovë me qëllim të të kuptuarit të situatës reale të emisioneve dhe studimit të masave për zvogëlimin e emisioneve. Rezultatet e studimit të masave për zvogëlimin e emisioneve janë përshkruar në 3-7-1.

Kjo është lista e burimeve të tjera të synuara të palëvizshme në Kosovë.

- i) Fabrika e Ferronikelit
- ii) Fabrika e blloqeve
- iii) Fabrika e asfaltit
- iv) Fabrika e vajrave të përdorura

Aktivitetet e ndërlidhura me matjen e gazit të shkarkuar për burimet e tjera të palëvizshme janë paraqitur në Tabela 3-60.

Tabela 3-60 Matja e gazit të shkarkuar për burimet e tjera të palëvizshme

Data	Aktiviteti	Referencë
Periudha e parë		
15 shkurt 2018 (e enjte)	Inspektimi preliminar i fabrikës së Ferronikelit	Inspektorati: 1 DMMU/DMNI 1 JET: 2
21 maj 2018 (e hënë)	Inspektimi preliminar i fabrikës së blloqeve dhe fabrikës së riciklimit të vajrave	Inspektorati: 1 JET: 2
22 maj 2018 (e martë)	Inspektimi preliminar i fabrikës së asfaltit	Inspektorati: 2 IHMK: 1 JET: 2
23 maj 2018	Intervista me INKOS-in (kompania e analizave): Hulumtimi për matjen në terren të gazit nga oxhaku për burimet e tjera të palëvizshme	IHMK: 1 JET: 2
Periudha e dytë		
2 nëntor 2018 (e premte)	Kërkesa për matjen e gazit të shkarkuar	MMPHI/MMPH:3, IHMK: 2, JET: 2
6 nëntor 2018 (e martë)	Inspektimi preliminar i fabrikës së Ferronikelit	MMPHI/MMPH:3, IHMK: 2, JET: 2
8 nëntor 2018 (e enjte)	Bartja e pajisjeve tek fabrika e Ferronikelit	IHMK: 1 JET: 2
12 nëntor 2018 (e hënë)	Matjet e gazit të shkarkuar dhe Pluhurit në fabrikën e Ferronikelit (Furra rrotulluese)	MMPHI/MMPH: 3, IHMK: 2, JET: 2
13 nëntor 2018 (e martë)	Në proces e sipër	MMPHI/MMPH: 3, IHMK: 2, JET: 2
14 nëntor 2018 (e mërkurë)	Matjet e gazit të shkarkuar dhe Pluhurit në fabrikën e Ferronikelit (Konvertori)	MMPHI/MMPH:2, IHMK: 1, JET: 2
15 nëntor 2018 (e enjte)	Matjet e gazit të shkarkuar dhe Pluhurit në fabrikën e Ferronikelit (Furra elektrike)	MMPHI/MMPH: 4, IHMK: 1, JET: 2
3 maj 2019 (e premte)	Bartja e pajisjeve tek fabrika e Ferronikelit	IHMK: 1 JET: 2
6 maj 2019 (e hënë)	Matjet e gazit të shkarkuar dhe Pluhurit në fabrikën e Ferronikelit (Furra elektrike)	IHMK: 1 JET: 2
7 maj 2019 (e martë)	Matjet e gazit të shkarkuar dhe Pluhurit në fabrikën e Ferronikelit (Konvertori)	IHMK: 1 JET: 2
8 maj 2019 (e mërkurë)	Matjet e gazit të shkarkuar dhe Pluhurit në fabrikën e Ferronikelit (Konvertori) dhe mostrimi i gazit për	IHMK: 1 JET: 2

	Metodën Standarde Referente	
10 maj 2019 (e premtë)	Matja e gazit të shkarkuar dhe Pluhurit në fabrikën e blloqeve	IHMK: 1 JET: 2
Periudha e tretë		
13 nëntor 2019 (e mërkurë)	Matja e gazit të shkarkuar dhe Pluhurit në fabrikën e blloqeve	IHMK: 2 JET: 2
15 nëntor 2019 (e premtë)	Matja e gazit të shkarkuar dhe Pluhurit në fabrikën e asfaltit	IHMK: 2 JET: 2
23 nëntor 2019 24 (e premtë)	Matja e gazit të shkarkuar dhe Pluhurit në fabrikën e riciklimit të vajrave	IHMK: 2 JET: 2
25 nëntor 2019 26 (e hënë)	Organizimi i pajisjeve në fabrikën e riciklimit të vajrave dhe mirëmbajtja e pajisjeve Peshimi i Pluhurit të mostruar	IHMK: 1 JET: 1

Për sa i përket matjes për burimet e tjera të palëvizshme, Pluhuri, SO₂ dhe NO_x, janë matur njëjtë si për IDM-të. Projekti ndërmori hapat në mënyrë që anëtarët t'i vizitojnë dhe inspektojnë fabrikat e synuara dhe t'i kryejnë matjet pas konfirmimit të elementeve të nevojshme siç janë të kuptuarit e procesit, specifikimi i lokacioneve të matjes, konfirmimi i vrimave për matje dhe platformës në lokacion, etj.

Tabela 3-61 paraqet përmbledhjen e rezultateve të matjes. Interpretimi i rezultateve është përshkruar në 3.7.1. Raportet janë bashkëngjitur në shtojcën-1: periudha e dytë: “2-1)- 1~3” dhe periudha e tretë: “2-1)- 1~3”. Rezultatet e matjes tregojnë se në secilën fabrikë disa komponentë i tejkalojnë VKE-të, që do të thotë se nuk respektohet ligji. Është çështje kryesore që prej tani e tutje të kryhen matja e gazit të shkarkuar në mënyrë të duhur dhe të respektohet ligji. Kjo çështje gjithashtu është përshkruar në 3.7.1.

Tabela 3-61 Rezultatet e matjes në burimet e tjera të palëvizshme

Fabrika e Ferronikelit				
	VKE dhe të dhënat	Pluhuri (mg/Nm ³)	SO ₂ (mg/Nm ³)	NO _x (mg/Nm ³)
Ferronikeli Fabrika (Furra Rrotulluese)		Nuk ka O ₂ referente në gazin e shkarkuar (O ₂ në gazin e shkarkuar =15.1, 17.5%)		
	VKE^{*1)}	30	600	350
	Nëntor 2018	18	1.788	113
	Maj 2019	37	1.054	52
Ferronikeli Fabrika (konvertori)		Nuk ka O ₂ referente në gazin e shkarkuar (O ₂ në gazin e shkarkuar =17.0, 18.5%)		
	VKE^{*1)}	30	600	350
	Nëntor 2018	1.046	22	49
	Maj 2019	145	41	46
Ferronikeli Fabrika (Furra elektrike)		Nuk ka O ₂ referente në gazin e shkarkuar (O ₂ në gazin e shkarkuar =0.1%)		
	VKE^{*1)}	30	—	—
	Nëntor 2018	692	0	0
	Maj 2019	207	0	0

Burimet e tjera të palëvizshme				
Fabrika e blloqeve		O ₂ referente në gazin e shkarkuar =18.0%		
	VKE^{*2)}	50	500	—
	Maj 2019	1.504	1.809	22
	Nëntor 2019	1.820	1.400	26
Fabrika e asfaltit		O ₂ referente në gazin e shkarkuar =10.0%		
	VKE^{*1)}	50	400	800
	Nëntor 2019	949	212	289
Fabrika e vajrave të përdorura		Nuk ka O ₂ referente në gazin e shkarkuar (O ₂ në gazin e shkarkuar =21%)		
	VKE^{*2)}	-	-	-
	Nëntor 2019	197	19	2

*1), 2) VKE-të për secilën fabrikë janë dhënë në Kosovë siç vijon. Për fabrikat e përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-043 qeveria i jep VKE-të përmes *1) Lejes PKIN¹⁹, dhe për fabrikat e tjera VKE-të jepen përmes *2) Udhëzimit Administrativ Nr./2007²⁰.



Fabrika e Ferronikelit



Fabrika e blloqeve



Fabrika e riciklimit të mbetjeve të vajrave



Fabrika e asfaltit

Foto 3-10 Burimet e tjera të palëvizshme

(2) Krijimi i kornizës institucionale për matjen e gazit të shkarkuar

Projekti ka përfunduar transferimin e teknologjisë për matjen e gazit të shkarkuar tek MMPHI/MMPH që është autoriteti kompetent. Mirëpo, Projekti nuk mund ta arrijë qëllimin e përhapjes së teknologjisë tek bizneset private, dhe kjo mbetet çështje për të ardhmen.

Matja e gazit të shkarkuar është e domosdoshme për ta monitoruar gjendjen aktuale të emisioneve dhe për studimin e masave për zvogëlimin e emisioneve në mënyrë që të përmirësohen emisionet, dhe është një nga teknologjitë më të rëndësishme që duhet të transferohen në Projekt.

¹⁹ “Ligji Nr. 03/L-043 Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes” (këtu e tutje “PKIN”), Leja jepet bazuar në PKIN

²⁰ Udhëzimi Administrativ Nr. / 2007 “MBI RREGULLAT DHE STANDARDET E SHKARKIMEVE NË AJËR NGA BURIMET E PALËVIZSHME TË NDOTJES” Ky Ligj është planifikuar të rishikohet në Ligj më të rreptë për “KUFIZIMIN E NDOTËSVE NË AJËR NGA BURIMET E PALËVIZSHME TË NDOTJES”.

Monitorimi i gazit të shkarkuar klasifikohet në dy lloje. Një lloj është monitorimi i emisioneve me Sistemin e Monitorimit të Vazhdueshëm të Emisioneve (këtu e tutje "SMVE") dhe një tjetër është monitorimi duke përdorur matjen e tipit në grup të transferuar përmes aktiviteteve të Projektit. Mirëpo, edhe për fabrika me SMVE, matja e llojit në grup është e detyruar të bëhet rregullisht për t'i garantuar rezultatet e matura nga SMVE. Metoda e matjes për SMVE është e ashtuquajtura "Metoda Standarde Referente". Në anën tjetër, për shumë fabrika të liruar nga detyrimi për ta instaluar SMVE-në, matja e gazit të shkarkuar është masa e vetme për t'i monitoruar emisionet. Në të njëjtën kohë, matja e gazit të shkarkuar është e dobishme jo vetëm për monitorimin e emisioneve por edhe menaxhimin e O dhe M të fabrikave.

Për sa i përket monitorimit të emisioneve, rolet e DMMU/DMNI dhe Inspektoratit të cilat janë pjesë e MMPHI/MMPH janë përshkruar në Tabela 3-62. DMMU/DMNI është divizion që kryesisht i jep leje fabrikave dhe Inspektorati është divizion i cili monitoron emisionet nga fabrikat.

Tabela 3-62 Rolet e MMPHI/MMPH (DMMU/DMNI dhe Inspektorati)

	Roli	Përmbajtja e punës	Puna e KEK-ut (TC)	Puna e burimeve të tjera të palëvizshme (biznese private)
SMVE ^{*1)}	Monitorimi dhe raportimi	Konfirmimi i pajtueshmërisë me VKE-të gjatë operimit	○ TC Kosova B × TC Kosova A	I aplikohet një pjesë të operatorëve të biznesit
Matja e gazit të shkarkuar në grup	Auditimi (Monitorimi)	Konfirmimi i pajtueshmërisë dhe udhëzimi, si dhe matja e gazit të shkarkuar sipas nevojës	Pranimi i monitorimit dhe udhëzimit nga Inspektorati	Pranimi i monitorimit dhe udhëzimit nga Inspektorati
	Pranimi i raportimit	Pranimi i raportimit për emisionet aktuale, si dhe matja e gazit të shkarkuar sipas nevojës	Matja e gazit të shkarkuar nga vetë ata ^{*2)*3)} dhe raportimi tek DMMU/DMNI (Metoda Standarde Referente)	Matja e gazit të shkarkuar nga kontraktorët ^{*3)*4)} dhe raportimi tek DMMU/DMNI
Të mëposhtmet kryhen nga vetë operatorët				
Menaxhimi i operacioneve		Matja e gazit të shkarkuar për inspektime dhe përmirësimi i O dhe M	Matja e gazit të shkarkuar nga vetë ata	Matja e gazit të shkarkuar nga kontraktorët ^{*4)}

*1) TC Kosova B posedon SMVE, por TC Kosova A nuk posedon SMVE. TC Kosova A nuk ka ndonjë plan që ta instalojë SMVE sepse do të dalë nga operimi në vitin 2023.

*2) Për IDM kërkohet raportimi i emisioneve me Metodën Standarde Referente. Për burimet e tjera të palëvizshme Metoda Standarde Referente është zgjidhja më e mirë,

por raportimi bazuar në rezultatet nga analizatori automatik i gazit gjithashtu duhet të lejohet.

- *3) BE kërkon matjen e gazit të shkarkuar nga agjencitë të cilat posedojnë ISO/IEC 17025 (sistemi i menaxhimit të laboratorit), por aktualisht nuk ka ndonjë agjenci të tillë në Kosovë.
- *4) Është e vështirë për operatorët e biznesit privat që ta bëjnë matjen vetë, dhe është e zakonshme që për matje të kontraktohen agjencitë e jashtme. Mirëpo, meqenëse aktualisht në Kosovë nuk ka agjenci e cila mund t'i kryejë matjet, ata duhet të kenë kontratë me agjenci nga shtetet e tjera.

Përhapja e matjes së gazit të shkarkuar mendohet të bëhet në hapat e ardhshëm.

- 1) Auditimi dhe monitorimi i emisioneve nga fabrikat nga ana e qeverisë (Inspektorati dhe DMMU/DMNI), konfirmimi i emisioneve përmes matjes së gazit të shkarkuar dhe udhëzimi sipas nevojës, dhe përmes këtyre aktiviteteve forcimin i të kuptuarit për kryerjen e matjeve të gazit të shkarkuar dhe raportimin.
- 2) Përhapja e matjes së gazit të shkarkuar dhe raportimit të rezultateve për IDM siç është TC Kosova A dhe burimet e tjera të palëvizshme, dhe përhapja e matjes për O dhe M të fabrikave.
- 3) Nxitja e komercializimit të biznesit të matjes së gazit të shkarkuar përmes përhapjes së matjeve. Promovimi i agjencive private të matjes dhe zhvillimi i kapaciteteve për autorizim teknik nga Agjencia e Akreditimit (këtu e tutje "AA") në MITN, dhe pastaj matja e gazit të shkarkuar nga agjencitë e akredituara private për matje

Deri tani, projekti ka krijuar teknologjinë për matje të gazit të shkarkuar brenda qeverisë përmes aktiviteteve duke përfshirë Aktivitetin Paraprak, e që korrespondojnë me hapin 1). TC Kosova A gjithashtu përfitoi teknologjinë që korrespondon me hapin 2). Mirëpo, për sa i përket hapit 1), është vështirë të thuhet se auditimi dhe monitorimi për fabrika është duke funksionuar mirë. Detajet janë përshkruar në 3.7.1. Për sa i përket hapave 2) dhe 3) kërkohet përhapja e matjes dhe nxitja e agjencive private për matje. Në Projekt në rast se ishte bërë një marrëveshje ndërmjet MMPHI/MMPH dhe një agjencie private ose publike për sa i përket transferimit të teknologjisë së matjes, Projekti do t'i mbështeste agjencitë e tilla. Mirëpo, ky aktivitet nuk është kryer meqenëse marrëveshjet nuk janë bërë.

Aktualisht, është një agjenci e cila ka mundësinë që të kryejë matjen e gazit të shkarkuar, mirëpo edhe kjo agjenci nuk ka ose teknologji të mjaftueshme (nuk ka teknologji për matjen e Pluhurit) ose pajisje të pranueshme të matjes. Prandaj, disa fabrika në Kosovë i kanë raportuar rezultatet e matjes duke kontraktuar agjenci nga shtetet e tjera. Në Kosovë, është vetëm një kompani private e mundshme, mirëpo është problematike për MMPHI/MMPH që ta mbështesë një kompani private të veçantë. Në të njëjtën kohë, megjithëse MMPHI/MMPH jep mbështetje, mendohet se vazhdimësia e matjes së gazit të shkarkuar nuk është reale përveç nëse matja e gazit të shkarkuar themelohet si biznes.

MMPHI/MMPH që është autoriteti kompetent dhe operatorët e biznesit të cilët operojnë

burimet e tjera të palëvizshme nuk kanë njohuri të duhur për matjen e gazrave të shkarkuar dhe vlerat e emisioneve, dhe për më tepër, nuk ka agjenci matëse që kanë njohuri të duhura për matje. Kur operatorët e biznesit kërkojnë matje nga agjencitë vendore për matje, agjencitë kryejnë matje shumë elementare ose përdorin llogaritjet, dhe për këtë arsye, besueshmëria e rezultateve detyrimisht është shumë e ulët. Përmes aktiviteteve të Projektit, Kosova tani është në pozitë ku MMPHI/MMPH dhe KEK kanë anëtarë që janë në gjendje t'i kryejnë matjet e duhura.

Për ta krijuar kornizën institucionale për matjen e gazit të shkarkuar nga tani e tutje, ekzistojnë çështjet në vijim.

- i) Inspektorati dhe DMMU/DMNI: Forcimi i kapacitetit të auditimit dhe monitorimit përmes përvetësimit të njohurive për matjen e gazit të shkarkuar dhe emisionet
- ii) Vazhdimi i matjes së gazit të shkarkuar dhe rritja e shfrytëzimit të rezultateve të matjes për përmirësimin e operimit në KEK

Për të kryer analiza të gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente është e nevojshme që KEK-u dhe IHMK të bashkëpunojnë, meqenëse vetëm IHMK posedon JK-në.

- iii) Zbatimi i matjes së saktë të gazit të shkarkuar dhe raportimi nga operatorët e biznesit për burimet e tjera të palëvizshme
- iv) Themelimi i matjes së gazit të shkarkuar si biznes përmes përhapjes së matjes dhe mbështetjes teknike për kompanitë private.
- v) Marrja e ISO/IEC 17025 nga agjencitë për matje
- vi) Krijimi i strukturës për matjen e gazit të shkarkuar: MMPHI/MMPH duhet ta sigurojë strukturën për matjen e gazit të shkarkuar, ashtu si nevojitet, derisa matja dhe raportimi i gazit të shkarkuar të përhapet mirë në të gjithë Kosovën. Për këtë qëllim, është e rëndësishme të sigurohen tre persona në IHMK që të jenë përgjegjës për këtë punë. Mirëpo, aktualisht janë vetëm dy punonjës, dhe njëri nga ta është kryesisht i ngarkuar me punët e analizave. Edhe pse IHMK gjithmonë vuan nga mungesa kronike e personelit, është e dëshirueshme të përforcohet personeli me të paktën një person, nëse është e mundur dy persona.

Projekti ka vendosur rëndësinë mbi transferimin e teknologjive për matjen e gazit të shkarkuar tek MMPHI/MMPH dhe KEK-u, dhe ka arritur qëllimin. Nga tani e tutje, është e domosdoshme të zbatohet ligji për fabrikat private në pronësi të operatorëve të biznesit që ta bëjnë matjen e gazit të shkarkuar dhe raportimin. Për këtë qëllim, është e rëndësishme që autoriteti kompetent (MMPHI/MMPH) ta përmirësojë informimin dhe njohurinë për matjen e gazit të shkarkuar, udhëzojë në mënyrë të duhur fabrikat private, ta bëjë të detyrueshëm matjen e gazit të shkarkuar dhe raportimin si dhe ta rrisë njohurinë për rëndësinë e pajtueshmërisë me VKE-të. Aktualisht këto janë çështjet e mëdha.

Këtë herë, Projekti mbajti një seminar për fabrikat private (kryesisht impiantet e mëdha), agjencitë private për matje, Universitetin, etj. për sa i përket të kuptuarit të rëndësisë së

matjes së gazit të shkarkuar.

Tabela 3-63 Seminari për matjen e gazit të shkarkuar

Data	Aktiviteti	Vërejtjet
13 shkurt 2020 (e enjte) 9:00 ~ 12:00	Seminari për matjen e gazit të shkarkuar për operatorët privatë, Universitetin, etj.	Kompanitë dhe Universiteti: 6 H/L: 6 JET: 2



Foto 3-11 Seminari për matjen e gazit të shkarkuar

3.3.2 Vlerësimi i Treguesve objektivisht të verifikueshëm në MDP

Treguesit Objektivisht të Verifikueshëm për Rezultatin 2 janë “2.1 Matjet në terren të gazit nga oxhaku bëhen të paktën 26 herë për NO_x, SO₂ dhe Pluhur (TC Kosova A: 3 kaldaja × 3 kanale, T/C Kosova B: 2 kaldaja x 2 kanale) dhe “2.2 Bëhet shtjellimi i Procedurave Standarde Operacionale (PSO) për matjet në terren të gazit nga oxhaku për IDM dhe burimet e tjera të palëvizshme”.

Matjet e gazit të shkarkuar për IDM u kryen për shumë qëllime siç janë sigurimi i të dhënave për inventarin e emisioneve, kryerja e TNP për t’i mësuar teknologjitë e matjes, sigurimi i të dhënave bazë për studimin e masave të për zvogëlimin e emisioneve për IDM, dhe për t’i krahasuar rezultatet e matjes me analizatorin automatik të gazit me rezultatet e analizës me Metodën Standarde Referente. Si rezultat, në periudhën e parë ka pasur dymbëdhjetë ditë matje për TC Kosova A (tetë ditë për Kaldajën Nr.3 dhe katër ditë për Kaldajën Nr.4) dhe katër ditë për TC Kosova B (dy ditë për Kaldajën Nr. 1 dhe dy ditë për Kaldajën No.2). Në periudhën e dytë, kishte njëmbëdhjetë ditë për TC Kosova A (dy ditë për Kaldajën Nr.3, pesë ditë për Kaldajën Nr.4 dhe pesë ditë për Kaldajën Nr.5) dhe dy ditë për TC Kosova B (dy ditë për Kaldajën Nr.1). Në periudhën e tretë, kishte katër ditë për TC Kosova A (katër ditë për Kaldajën Nr.4). Është kryer një numër i mjaftueshëm i matjeve.

Janë përgatitur dy PSO për matjet e gazit të shkarkuar. Njëra është për matjen e SO₂ dhe NO_x me analizator automatik të gazit dhe tjetra është për matjen e Pluhurit. PSO-të për burimet e tjera të palëvizshme janë të njëjta me ato për IDM meqenëse pajisjet e përdorura dhe procedurat janë të njëjta. PSO-të janë të bashkëngjitura në Shtojcën-1.

3.3.3 Zhvillimi i kapaciteteve përmes aktiviteteve

Siç është thënë më lart, matja e gazit të shkarkuar është teknologji e rëndësishme në mënyrë

që MMPHI/MMPH ta konfirmojë gjendjen e pajtueshmërisë me VKE-të, dhe në mënyrë që fabrikat t'i menaxhojnë operacionet dhe emisionet. Transferimi i teknologjisë për matjen e gazit të shkarkuar ka vazhduar nga Aktiviteti Paraprak dhe në Projekt, dhe H/L arritën në nivelin ku ata mund të bënin matjet. Mirëpo, matja e gazit të shkarkuar do të thotë që ata të mund të kalojnë përmes procesit të përgatitjes për matje, matjen, pastrimin dhe organizimin e pajisjeve dhe përpilimin e raportit. JET-i u përpoq ta transferojë tërë procesin gjatë kohëzgjatjes së Projektit përmes TNP. H/L e kuptuan shumë mirë rëndësinë e procesit dhe mund ta kryejnë procesin, ku ajo që ata përjetuan në përmes trajnimeve në Japoni kontribuoi mjaft shumë në këtë aspekt. H/L përmirësuan kapacitetin e tyre mjaft shumë.

Përfundimisht është e dëshirueshme që në Kosovë të gjitha fabrikat të kryejnë matje të duhur të gazit të shkarkuar dhe raportimin, si dhe që VKE-të e tyre të jenë në pajtueshmëri me ligjin. Zbatimi i ligjit është çështja kryesore, meqenëse ligji nuk respektohet edhe pse përcakton matjen dhe raportimin si të detyrueshme në Kosovë. Prandaj, hapi i parë është që personat përgjegjës ta thellojnë njohurinë për emisione dhe ta ndërtojnë kapacitetin për t'i udhëzuar në mënyrë të duhur fabrikat private (kjo çështje është përshkruar në 3.7.1). Projekti ka ndërtuar sistemin për MMPHI/MMPH për t'i kryer matjet dhe tani është e domosdoshme që MMPHI/MMPH ta shfrytëzojë këtë sistem dhe ta përhapë teknologjinë e matjes.

3.4 Rezultati 3: Kryhen aktivitetet e monitorimit të cilësisë së ajrit.

Aktivitete në Rezultatit 3 janë zbatuar me qëllim të sigurimit të të dhënave të sakta të cilësisë së ajrit dhe ofrimit të të dhënave për publikun në mënyrë të shpejtë. Këto aktivitete kryesisht janë rehabilitimi i analizatorëve në SMCA, trajnimi për O dhe M të analizatorëve që të jenë në gjendje të ofrojnë të dhëna stabile dhe të qëndrueshme dhe instalimi i ekraneve për shfaqjen e të dhënave të cilësisë së ajrit për t'iu ofruar qytetarëve të dhëna. Për më tepër, Projekti ka studiuar vendosjen optimale të SMCA-ve në të ardhmen në Kosovë dhe ka transferuar teknologjinë e matjes së cilësisë së ajrit për raste të emergjencës.

3.4.1 Aktivitetet

Aktivitetet janë të ndara në katër fusha të cilat janë rehabilitimi dhe trajnimi për O dhe M të analizatorëve në SMCA, studimi i vendosjes optimale të SMCA-ve, transferimi i teknologjisë së matjes së cilësisë së ajrit për raste emergjente dhe instalimi i ekraneve për shfaqjen e të dhënave të cilësisë së ajrit. Në periudhën e tretë është shtuar një aktivitet për shkak të zgjatjes së periudhës së Projektit.

(1) Rehabilitimi i analizatorëve në SMCA dhe trajnimi për O dhe M të analizatorëve

Aktivitetet e ndërlydhura me përcaktimin e gjendjes së analizatorëve në SMCA përfshijnë inspektimin e SMCA-ve (në tërë vendin), rehabilitimin (SMCA-të në zonën e Prishtinës: 5 stacione), përgatitja e manualit të mirëmbajtjes dhe trajnimi për kalibrimin e analizatorëve bazuar në manual.

1) Inspektimi i gjendjes aktuale të SMCA-ve

Tabela 3-64 tregon aktivitetet e inspektimit të SMCA-ve për ta kuptuar gjendjen aktuale, në mënyrë që të zbatohet rehabilitimi.

Për pesë ditë duke filluar nga 4 qershori i vitit 2018, Projekti ka kryer inspektimin e njëmbëdhjetë SMCA-ve (përveç Brezovicës) në tërë Kosovën kryesisht për diagnostikimin e analizatorëve. Rezultatet e këtij inspektimi siguruan të dhënat bazë për rehabilitimin e analizatorëve të pesë SMCA-ve në zonën e Prishtinës, dhe në të njëjtën kohë këto rezultate gjithashtu u shkëmbyen si referencë për rehabilitimin e analizatorëve të shtatë SMCA-ve të tjera nga MCC/MFK në gjysmën e dytë të vitit 2019. Kishte zvogëlim të parregullsive dhe mosfunksionimeve krahasuar me "studimin e detajuar të planifikimit të projektit të zhvillimit të kapaciteteve për kontrollin e ndotjes për burimet kryesore të palëvizshme të emisioneve" të kryer në tetor dhe nëntor të vitit 2016. Arsyeja e përmirësimit ishte kryesisht për faktin se që nga qershori 2017 është siguruar një buxhet për mirëmbajtje prej 150,000 euro në vit.

Tabela 3-64 Inspektimi i gjendjes aktuale të SMCA-ve për planifikimin e rehabilitimit

Data	Aktiviteti	Referencë
Viti 2018, periudha e parë		
17 prill (e martë)	Takimi me MCC/MFK	Diskutimi për aktivitetet e planifikuara
11 maj (e premte)	Takimi me MCC/MFK	Diskutimi për ndarjen e detyrave dhe rrjetin e komunikimit të të dhënave
25 maj (e premte)	Takimi me MCC/MFK dhe KE	Diskutimi për rrjetin e komunikimit të të dhënave
4 qershor (e hënë)	Takimi me IHMK dhe nën-kontraktorin Diagnostikimi i stacionit të IHMK-së.	Në takim morën pjesë znj. Letafete dhe katër (4) nga stafi i IHMK-së. Një (1) nga stafi i IHMK-së mori pjesë në diagnostikim. Analizatorët për PM ₁₀ /PM _{2.5} u kontrolluan ditën e ardhshme.
5 qershor (e martë)	Diagnostikimi i SMCA-ve tek Rilindja, Obiliqi, Palaj dhe Dardhishta. Riparimi i disa analizatorëve.	IHMK: 1 Në krahasim me dy vite më parë, numri i pajisjeve të prishura ishte zvogëluar, kalibrimi (zero dhe span) gjithashtu ishte bërë, etj. Mirëpo, pllaka "motherboard" e analizatorit të CO në stacionin e Palaj ishte e prishur dhe analizatori i SO ₂ në stacionin e Dardhishtës nuk ishte i instaluar, ndërsa ishte vjedhur në nëntor 2015.
6 qershor (e mërkurë)	Diagnostikimi i SMCA-ve në Mitrovicë, Drenas dhe Pejë. Riparimi i disa analizatorëve.	Njëjtë si më lartë janë vërejtur përmirësime, mirëpo stacioni i Pejës kishte vetëm Grimm 180 (PM ₁₀ /PM _{2.5}) ashtu si dy vite më parë. Në SMCA-në e Mitrovicë, temperatura e dhomës ishte 40 gradë dhe analizatorët nuk funksiononin siç duhet sepse kondicioneri i ajrit ishte prishur. Funkcioni i ftohjes i analizatorit të NO _x ishte nuk punonte.

		Pas pesë (5) ditësh u instalua kondicioneri i ri i ajrit.
7 qershor (E enjte)	Diagnostikimi i SMCA-ve në Gjilan, Hani të Elezit dhe Prizren. Riparimi i disa analizatorëve. Takimi përmbledhës për rezultatet e inspektimit.	IHMK: 1 Në SMCA-në e Hanit të Elezit tharësi i ajrit i Grimm 180 ishte i prishur. Në SMCA-në e Prizrenit mungonte analizatori i SO ₂ . Në takimin përmblyës morën pjesë znj. Letafete dhe dy (2) nga stafi i IHMK-së.
8 qershor (e premte)	Në SMCA-në e IHMK-së, si provë, u bë kalibrimi i analizatorit SO ₂ duke përdorur kalibruesin (SG741) të ofruar nga JICA.	IHMK: 1



Foto 3-12 Takimi për përgatitjen e orarit dhe inspektimi i SMCA-së në Obiliq



Foto 3-13 Inspektimi i gjendjes aktuale të SMCA-së

Rezultati i inspektimit të SMCA-ve është bashkëngjitur në Shtojcën-1 “Periudha e dytë: 3-2)-1 Përmbledhja e Inspektimit të Stacioneve të Monitorimit të Cilësisë së Ajrit në të gjithë Kosovën”. Përmbledhja është paraqitur në Tabela 3-65. Gjendja e analizatorëve gjatë kohës së inspektimit është renditur përmes vlerësimit.

2) Rehabilitimi i analizatorëve në pesë (5) SMCA në zonën e Prishtinës

Projekti ka kryer rehabilitimin e analizatorëve në pesë SMCA në zonën e Prishtinës në periudhën e dytë nga maji deri në qershor të vitit 2019. Të gjithë analizatorët nga pesë SMCA-të janë sjellë në dhomën e laboratorit të IHMK-së dhe janë riparuar në mënyrë të përgjithshme përmes procedurave të pastrimit, çmontimit, zëvendësimit të pjesëve, montimit dhe konfirmimit të funksionimit. Pas montimit të analizatorëve,

kontrolli zero/span u bë në IHMK, analizatorët përsëri u instaluan në SMCA, u nxehtën për më shumë se 24 orë dhe pastaj u bë kalibrimi me shumë pika. Për më tepër, nga pesë SMCA në zonën e Prishtinës, tri nga to kanë përfshirë punën e zëvendësimit të kabinave të vogla me kabina më të mëdha. Për shkak të kabinave të vogla, nuk ka hapësirë për personin përgjegjës të punojë brenda SMCA-së, kështu që puna e mirëmbajtjes duhet të kryhet me derë të hapur. Gjatë motit me shi, shiu hynte brenda SMCA-së dhe nuk mund të kryhej puna e mirëmbajtjes. Për shkak të hapësirës së vogël në kabinë, ka pasur problem serioz me rritjen e temperaturës brenda kabinës për shkak se temperatura bëhej e lartë gjatë stinës së verës dhe analizatorët ndaleshin për shkak të tejnxejes. Këto defekte janë zgjidhur me instalimin e kabinave të mëdha me performancë të lartë të izolimit ndaj nxehtësisë dhe kondicioner të ajrit me kapacitet të madh.

Tabela 3-65 Përmbledhja e rezultateve të inspektimit të SMCA-ve

	Data e inspektimit	Marka e pajisjes	Viti i instalimit të stacionit	Kategoria sipas JET	NOX	SO2	O3	CO	PM10	PM2.5	Pajisjet shtesë	Vërejtjet
IHMK	4-Jun-2018	Thermo	2010	Te pa i gjatshme	Thermo 42i	Thermo 43i	Thermo 48i	Thermo 48i	Grimm Model180	Grimm Model180	Sonmix 3057B	SMCA gjendet brenda obrorit të observatorit meteorologjik, Bulevardi Bili Clinton gjendet 90 m në veri të SMCA-së Viti i prodhimit të analizatorit nuk është në dispozicion në pajisje
Numri serik					CM09190041	CM09190042	CM09190051	CM09440024	18A11044	18A11044		
Data e prodhimit					2009 ose 2010	2009 ose 2010	2009 ose 2010	2009 ose 2010	-	-		
Gjendja					d	c	c	d	c	c		
Rilindja/MMPH	5-Jun-2018	EAS Emomet Teledyne API	2009	Te përgjithshme	200E	100E	400E	300E	Grimm Model180	Grimm Model180		SMCA gjendet në zonën e ndërtesës së përbashkët eventitare, përfshirë MMPH-në. Megjithatë gjendet në zonën e gëllbër, rreth Luan Haradinaj gjendet 15 m në Juglindje të SMCA-së.
Numri serik					4067E	3199E	2829E	2854E	18A11037	18A11037		
Data e prodhimit					2011	2011	2011	2011	-	-		
Gjendja					d	c	c	c	c	c		
Palaj	5-Jun-2018	Teledyne Api	2012	Monitorimi i burimit	1200	1100	1400	Nuk ka analizator	Grimm Model180	Grimm Model180		SMCA gjendet brenda zonës së punësorë së Ferrocenitralit Kosova B. Instalimi i SMCA-së është mbështetur nga Banka Botërore dhe është dorëzuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.
Numri serik					496	414	445		18A12096	18A12096		
Data e prodhimit					2012	2012	2012		-	-		
Gjendja					c	c	c	Problem i shtatë duhet të zëvendësohet.	d	d		
Dardhishhtë	5-Jun-2018	Teledyne Api	2012	Monitorimi i burimit	1200	Nuk ka analizator	1400	1300	Grimm Model180	Grimm Model180		SMCA gjendet pranë shkollës së fillores. Analizatori i SO2 dhe Laptopi janë vjedhur në muajin nëntor 2015. Instalimi i SMCA-së është mbështetur nga Banka Botërore dhe është dorëzuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.
Numri serik					499		441	383	18A11041	18A11041		
Data e prodhimit					2012		2012	2012	-	-		
Gjendja					c	Te vendosura në një shtet të vitit 2015	c	c	d	d		
Obiliqi	5-Jun-2018	Teledyne Api	2012	Monitorimi i burimit	1200	1100	1400	1300	Grimm Model180	Grimm Model180		SMCA-A ja gjendet pranë shkollës së fillores. Instalimi i SMCA-së është mbështetur nga Banka Botërore dhe është dorëzuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.
Numri serik					500	411	445	372	18A12096	18A12096		
Data e prodhimit					2012	2012	2012	2012	-	-		
Gjendja					c	c	d	c	c	c		
Mitrovica	6-Jun-2018	Thermo	2011	Te pa i gjatshme	Thermo 42i	Thermo 43i	Thermo 48i	Thermo 48i	Grimm Model180	Grimm Model180		SMCA gjendet brenda obrorit të shkollës fillore. Viti i prodhimit të analizatorit nuk është në dispozicion në pajisje
Numri serik					CM09440052	CM09440051	CM09440005	CM09190000	18A12097	18A12097		
Data e prodhimit					2009 ose 2010	2009 ose 2010	2009 ose 2010	2009 ose 2010	-	-		
Gjendja					d	d	d	c	d	d		
Drenasi	6-Jun-2018	EAS Emomet Teledyne API	2011	Te pa i gjatshme	200E	100E	400E	300E	Grimm Model180	Grimm Model180		SMCA-A ja gjendet brenda hapësirës për parkim të Qendrës së Promovimit të të Drejtave të Gruas në Drenas. Mirëpo, numri i autometeve në hapësirën për parkim është i vogël.
Numri serik					4046	3195	445	2950	18A11071	18A11071		
Data e prodhimit					2012	2012	2012	2012	-	-		
Gjendja					c	c	d	c	c	c		
Peja	6-Jun-2018		2012	Te pa i gjatshme	Nuk ka analizator	Nuk ka analizator	Nuk ka analizator	Nuk ka analizator	Grimm Model180	Grimm Model180	Feora (PM2.5) Mostues me vë	SMCA gjendet brenda obrorit të observatorit meteorologjik. Në vitin 2016 u detyruan ta të vizituar nga obrori i shkollës fillore në qendër të qytetit.
Numri serik									18A11043	18A11043		
Data e prodhimit									-	-		
Gjendja					Duhet të instalohet një t.i.	Duhet të instalohet një t.i.	Duhet të instalohet një t.i.	Duhet të instalohet një t.i.	d	d		
Hani i Elezit	7-Jun-2018	EAS Emomet Teledyne API	2012	Monitorimi i përgjithshme	200E	100E	400E	300E	Grimm Model180	Grimm Model180		SMCA gjendet brenda obrorit të shkollës fillore. SMCA-A ja gjendet diku rreth 630m në veri të fabrikës së çimentos Sharrcom.
Numri serik					4068	3198	2820	2830	18A11035	18A11035		
Data e prodhimit					2011	2011	2011	2011	-	-		
Gjendja					d	e	c	c	d	d		
Prizren	7-Jun-2018	EAS Emomet Teledyne API	2012	Te pa i gjatshme	200E	Nuk ka analizator	400E	300E	Grimm Model180	Grimm Model180	Feora (PM2.5) Mostues me vë	SMCA-A ja gjendet në zonën e parkimit të ndërtesës së zyrës së kryetarit të komunës. Për një muaj gjatë sezonit të verës hapësira për parkim është e hapur për publikun kryesisht qytetarë që shihen nga kulla e jashtme. SMCA gjendet në një park të vogël pranë rrugës kryesore. Ligi i SMCA-së është stacion rrugor.
Numri serik					4065		2827	2849	18A11042	18A11042		
Data e prodhimit					2011		2011	2011	-	-		
Gjendja					c	Duhet të instalohet një t.i.	c	d	c	c		
Gjilan	7-Jun-2018	EAS Emomet Teledyne API	2012	Pastrë rrugë si Tullku	200E	100E	400E	300E	Grimm Model180	Grimm Model180	Feora (PM2.5) Mostues me vë	SMCA gjendet në një park të vogël pranë rrugës kryesore. Ligi i SMCA-së është stacion rrugor.
Numri serik					4063	3197	2830	2851	18A11036	18A11036		
Data e prodhimit					2011	2011	2011	2011	-	-		
Gjendja					c	c	e	c	c	c		

Shënimi: kategoria e gjendjes
 Shkëlqyeshëm: Shkëlqyeshëm nënkupton se gjendja e analizatorit është pothuajse si të ishte i ri.
 Mirë: Mirë nënkupton se analizatori mund të operojë si duhet për më shumë se 6 muaj pa ndërprerje në veçantë të gjendjes.
 Duhet: Duhet nënkupton se analizatori mezi mund të operojë dhe se ka nevojë për mirëmbajtje të menjhershme.
 Shumë duhet: Shumë duhet nënkupton se analizatori nuk mund të operojë dhe ka nevojë për riparim ose zëvendësim të menjhershëm.

Rehabilitimi në esencë është riparim i përgjithshëm i analizatorit. Dy nga stafi i IHMK-së të cilët janë përgjegjës për menaxhimin e cilësisë së ajrit kanë marrë pjesë në këto punë gjatë tërë kohës, dhe kaluan nëpër përvojën e riparimit të përgjithshëm si dhe kanë fituar njohuri dhe aftësi për riparim, që gjithashtu nevojitet për mirëmbajtjen ditore. Është bërë çmontimi, pastrimi dhe zëvendësimi i pjesëve të prishura të analizatorëve të NO_x, SO₂, O₃ dhe CO dhe pastrimi i celulës me tretës. Ka qenë përvoja e parë e kësaj natyre për dy punonjësit përgjegjës të IHMK-së. Gjithashtu kërkohej që të përgatiten pjesët rezervë, pajisjet, menaxhimi i orarit, etj. për punën e ardhshme të riparimit gjeneral. Kjo ka qenë mundësi e mirë për zhvillim të kapaciteteve.

Përveç punës së riparimit gjeneral të analizatorëve, stafi i IHMK-së gjithashtu bëri pastrimin e elementit me shumë dalje (vegël e cila shpërndanë ajrin e mostruar në secilin analizator) dhe tubat nga Tefloni në SMCA. Muret e brendshme të elementit të shumëfishtë (manifold) dhe tubit nga Tefloni ishin jashtëzakonisht të ndyra dhe nuk ishin pastruar për një kohë të gjatë. Siç është përshkruar në Shtojcën-1, Periudha e tretë: 3-3)-1 Manuali i Mirëmbajtjes së SMCA-ve” nga tani e tutje këto duhet të pastrohen një herë në vit.

Tabela 3-66 Aktivitetet: Rehabilitimi i analizatorëve në 5 SMCA dhe zëvendësimi i 3 kabinave

Data	Aktiviteti	Referencë
Viti 2019, periudha e dytë		
30 prill (e martë)	Analizatorët e SMCA-ve (Obiliq, Dardhishtë dhe Palaj) janë zhvendosur në IHMK	JET-i, H/L në trajnim për Jon Kromatograf
2 maj (e enjte)	Çmontimi dhe dërgimi i tri kabinave (Obiliq, Dardhishtë dhe Palaj) në IHMK	IHMK: 2
3 maj (e premte)	Ndërtimi i themelit (Obiliq dhe Dardhishtë)	E dëshmuar nga JET-i
6 maj (e hënë)	Ndërtimi i themelit (Palaj)	E dëshmuar nga JET-i
7 maj (e martë)	Kompletimi i punës së themelit (Obiliq, Dardhishtë dhe Palaj)	E dëshmuar nga JET-i
10 maj (e premte)	Inspektimi i dërgesës së pjesëve rezervë dhe materialit shpenzues nga Austria	JET
13 maj (e hënë)	Puna e rehabilitimit Plan-programi i punës së rehabilitimit dhe TNP	JET
15 maj (e mërkurë)	Fillimi i rehabilitimit të analizatorëve dhe TNP, përgatitja e kabinave të reja në depo	IHMK: 2
16 maj (e enjte)	Rehabilitimi i analizatorëve dhe TNP, përgatitja e kabinave të reja në depo	IHMK: 2
17 maj (e premte)	Rehabilitimi i analizatorëve dhe TNP, dërgimi i kabinës së re në Dardhishtë	IHMK: 2
18 maj (e shtunë)	Rehabilitimi i analizatorëve dhe TNP, dërgimi i kabinës së re në Obiliq	IHMK: 2
20 maj (e hënë)	Rehabilitimi i analizatorëve dhe TNP, Kalibrimi zero i analizatorëve për NO _x , O ₃ , SO ₂ dhe CO në Obiliq, Dardhishtë	IHMK: 2

	dhe MMPHI/MMPH/Rilindja	
21 maj (e martë)	Kalibrimi shumë pikësh i analizatorëve në SMCA (IHMK) dhe TNP, dërgimi i kabinës së re në Palaj	IHMK: 2
22 maj (e mërkurë)	Kalibrimi shumë pikësh i analizatorëve në SMCA (Palaj) dhe TNP	IHMK: 2
23 maj (e enjte)	Rehabilitimi i analizatorëve të SMCA-së, kalibrimi i analizatorit të O ₃ (IHMK) dhe TNP	IHMK: 2
24 maj (e premte)	Përmbledhja e rehabilitimit të analizatorëve, Pyetje dhe përgjigje, riparimi i ventilatorit të mostruesit të gazit (IHMK)	IHMK: 2
27 maj 28 (e hënë)	Inspektimi i zëvendësimit të kabinave dhe kërkesa për korrigjime (Obiliq dhe Dardhishtë)	E dëshmuar nga JET-i
29 maj 30 (e martë)	Ndërtimi i rrethojës (Palaj)	E dëshmuar nga JET-i
29 maj (e mërkurë)	Ndërtimi i rrethojës (Palaj) Inspektimi i rinovimit të SMCA-ve (Obiliq dhe Dardhishtë)	E dëshmuar nga JET-i
31 maj 32 (e enjte)	Inspektimi i ndërtimit të rrethojës (Palaj) Dorëzimi i çelësave të tri kabinave të SMCA-ve nga kontraktori tek JET-i	E dëshmuar nga JET-i
3 qershor (e hënë)	Dorëzimi i çelësave të tri kabinave të SMCA-ve nga JET-i tek IHMK-ja	IHMK: 2 dhe drejtoresha e Institutit




Foto 3-14 Ndërtimi i bazamentit prej betoni dhe zëvendësimi i kabinave



Foto 3-15 Rehabilitimi i analizatorëve dhe pastrimi i tubit të mostrimit (tubi nga Tefloni)

Raporti i detajuar i punës së rehabilitimit është bashkëngjitur në Shtojcën-1 "Periudha e Dytë: 3-2) -4, Rehabilitimi i SMCA-ve në zonën e Prishtinës" dhe raporti i detajuar i zëvendësimit të kabinave është bashkëngjitur në Shtojcën-1 "Periudha e Dytë: 3-2)- 3 Zëvendësimi i kabinave për 3 (tri) SMCA në Zonën e Prishtinës".

Rehabilitimi duhet të bëhet 7 deri 8 vite pas instalimit ose rehabilitimit të analizatorëve. Është e nevojshme që të zëvendësohen përbrenda rreth 12 viteve pas instalimit ose rehabilitimit. Për më tepër, është e dëshirueshme të përditësohen pajisjet

meteorologjike pas pesë viteve pasi që periudha e vlefshmërisë së certifikimit është zakonisht pesë vite.

Orari i rehabilitimit dhe zëvendësimit janë paraqitur në Tabela 3-67.

3) Kalibrimi i analizatorëve

Detajet e kalibrimit janë bashkëngjitur në Shtojcën-1 "Periudha e Tretë: 3-3) -1 Manuali i Mirëmbajtjes së SMCA-ve". Në parim i ndjek standardet e BE-së.

IHMK është përgjegjëse për mirëmbajtjen e SMCA-ve në Kosovë dhe për O dhe M të SMCA-ve në Kosovë. Kur analizatorët dhe pajisjet janë dhënë donacion nga BE nga viti 2011 deri në vitin 2012, është përfshirë edhe holluesi i gazit standard (me gjenerator të gazit zero dhe gjenerator të O₃ të instaluar përbrenda), por nuk është përdorur nga stafi i IHMK-së. Sipas stafit të IHMK-së nuk është dhëna asnjë trajnim se si të përdoret ai.

Analizatori i NO_x dhe analizatori i SO₂ të instaluar në SMCA në Kosovë kanë të instaluar përbrenda gjeneratorë të gazit standard të quajtur tube përshkuese të cilët mund të gjenerojnë gaz të NO₂, respektivisht gaz të SO₂. Më parë IHMK ka përdorur këtë metodë për kalibrimin e analizatorëve. Mirëpo, metoda e tubit përshkues nuk është e përshtatshme për kalibrim, por mund të përdoret për kontrollin e operimit dhe funksionimit të analizatorëve, për shkak se përqendrimi i gazit të gjeneruar luhetet për rreth 15%. Analizatori i O₃²¹ nuk është kalibruar asnjëherë pas instalimit. Analizatori i CO është kalibruar me gazin nga bombola e gazit standard të CO të sjellë në vitin 2012, por nuk është kalibruar pasi që gazi i CO në bombole është zbratur. Në Projekt, për pesë stacionet në zonën e Prishtinës, janë siguruar një kalibrues i gazit standard (me gjenerator të gazit zero dhe gjenerator të O₃ të instaluar përbrenda) dhe pesë komplete të gazrave standarde të përbëra nga bombolat e NO, SO₂ dhe CO, dhe është kryer trajnimi për kalibrim.

O dhe M për të gjitha 12 stacionet kryhet nga personat përgjegjës të IHMK-së dhe/ose kompania private e kontraktuar e cila zgjidhet përmes tenderimit për çdo vit. Aktualisht, kompanitë e mirëmbajtjes në Kosovë nuk kanë aftësitë për t'i kalibruar në mënyrë të duhur analizatorët e NO_x, SO₂, O₃ dhe CO. Për të kryer disa riparime më të avancuar dhe kalibrimet janë thirrur inxhinierët nga agjencitë nga Austria ose Sllovenia. Si rezultat i trajnimit të mbajtur për stafin e IHMK-së në periudhën e dytë dhe të tretë, stafi i IHMK-së fitoi aftësi për ta kryer kalibrimin. Nga tani e tutje, është e nevojshme që stafi i IHMK-së ta udhëzojë kontraktorin dhe t'i kalibrojnë analizatorët bashkë. Është e dëshirueshme që të transferohet teknologjia tek kontraktori, ashtu që inxhinieri i kontraktorit gjithashtu të mund ta bëjë kalibrimin.

²¹ Metoda standarde për kalibrim të analizatorit të O₃ është sistemi i gjurmueshmërisë që e bën Fotometrin Standard Referent si metodë të parë standarde. Metoda e dytë dhe e tretë standarde caktohen në nivel vendor dhe kalibrimi kryhet duke bërë kalibrimin e analizatorit të O₃ me metodën e tretë standarde. Në Japoni, metoda standarde është ndryshuar nga Titrimi i fazës së gazit (GPT) në sistemin e gjurmueshmërisë që e bën Fotometrin standard referent nga Instituti Kombëtar i ShBA-ve për Standarde dhe Teknologji si standard të parë. Në manualin për matjen e vazhdueshme të ajrit nga Ministria e Mjedisit (botimi i gjashtë), GPT përcaktohet në JIS B 7957 Aneksi-3. Metoda është përshkruar që të mund të përdoret për metodën e konfirmimit të ndjeshmërisë së analizatorit standard në komuna, megjithëse nuk përdoret për ta vlerësuar ndjeshmërinë e analizatorit standard. Sistemi i gjurmueshmërisë për O₃ është themeluar vetëm në tetëmbëdhjetë shtete në botë deri në maj të vitit 2018. Prandaj, Projekti ka përdorur metodën e Titrimin të fazës së gazit (GTO) për kalibrimin e analizatorëve të O₃ si metodën e dytë më të mirë duke përdorur SG-471 të siguruar nga Projekti.

Shpeshësia e kalibrimit sipas standardit të BE-së është një herë në çdo dy javë për kontrollin zero-span dhe një herë çdo tre muaj për kalibrimin me shumë pika. Koha e nevojitur për katër lloje të analizatorëve është rreth 4 orë për kontrollin zero-span dhe rreth 6 deri 7 orë për kalibrimin me shumë pika, dhe duhet një ditë e tërë për ta kalibruar vetëm një stacion.

Për më tepër, dy H/L përgjegjës për SMCA në IHMK, nuk janë të dedikuar vetëm për O dhe M të SMCA-ve, por gjithashtu bëjnë monitorimin e dheut, etj., marrin pjesë në punëtori, takime, etj. Duke i marrë parasysh këto kushte, është e pamundur të bëhet kalibrimin me shpeshësinë e përcaktuar në standardin e BE-së. Tani për tani, është rekomanduar që shpeshësia të përgjysmohet siç është paraqitur në Tabela 3-68.

Në të ardhmen e afërt është e këshillueshme që të kalohet në shpeshësinë e kalibrimit të përcaktuar me standardin e BE-së, gjë që kërkon shtimin e së paku një punonjësi të dedikuar për mirëmbajtjen e SMCA-ve.

Tabela 3-68 Shpeshësia e rekomanduar e kalibrimit si hap i parë

Ndotësit e ajrit	Standard i BE-së	Kontrolli Zero/Span	Kalibrimi me shumë pika
NO _x	BS EN 14211, 2012	Çdo katër javë	Çdo gjashtë muaj
SO ₂	BS EN 14212, 2012	Çdo katër javë	Çdo gjashtë muaj
O ₃	BS EN 14625, 2012	Çdo katër javë	Çdo gjashtë muaj
CO	BS EN 14626, 2012	Çdo katër javë	Çdo gjashtë muaj

Trajnimi për kalibrimin e analizatorëve ka filluar në janar të vitit 2019, para kryerjes së rehabilitimit të analizatorëve. Aktivitetet e trajnimit për kalibrimin e analizatorëve për O dhe M janë paraqitur në Tabela 3-69.

Projekti e bëri trajnimin sa më praktik që është e mundur në mënyrë që t'i përmbushë nevojat e H/L siç është kontrolli për dështime si dhe kalibrimi përmes TNP. Për shembull, kur është shfaqur parregullsi në analizator, gazrat standarde për kalibrim dhe kalibruesi janë bartur në SMCA dhe më pastaj është bërë kalibrimi.

Gjatë rehabilitimit në maj të vitit 2019, analizatorët për të cilët është kryer riparimi gjeneral janë sjellë prapa në SMCA. Pas ri-instalimit, ata janë nxehur dhe më pastaj është kryer rregullimi i pikës-zero dhe kalibrimi me shumë pika bashkë me H/L. Si rezultat, H/L kanë akumuluar mjaft shumë përvojë.

Tabela 3-69 Aktivitetet: Kalibrimi dhe O dhe M

Data	Aktivitetet	Vërejtjet
Periudha e dytë		
16 janar 2019 (e mërkurë)	Kalibrimi i analizatorit të NO _x duke përdorur kalibruesin (SG-741)	IHMK: 3
18 janar 2019 (e premte)	Kalibrimi i analizatorit të CO duke përdorur kalibruesin (SG-741)	IHMK: 1
21 janar 2019	Kalibrimi i analizatorit të NO _x duke përdorur	Nga JET-i

(e hënë)	kalibruesin (SG-741) për zgjidhjen e problemeve në laboratorin e kalibrimit në IHMK.	
22 janar 2019 (e martë)	Kalibrimi i analizatorit të SO ₂ duke përdorur kalibruesin (SG-741)	IHMK: 1
30 janar 2019 (e mërkurë)	TNP e kalibrimit të analizatorit të NO _x duke përdorur kalibruesin (SG-741) në SMCA (Hani i Elezit)	IHMK: 2
15 prill 2019 (e hënë)	Trajnimi për pastrimin e tubit të mostrimit (TNP)	IHMK: 2
18 prill 2019 (e enjte)	Trajnimi në terren i kalibrimit duke përdorur kalibruesin dhe bombolat me gaz standard në SMCA (Obiliq)	IHMK: 2
23 prill 2019 (e martë)	Trajnimi për kalibrimin e analizatorëve të NO _x dhe O ₃ me GPT (Titrim të fazës së gazit) në laboratorin e kalibrimit (IHMK)	IHMK: 2
25 prill 2019 (e enjte)	Trajnimi në terren i kalibrimit të analizatorëve të CO, SO ₂ , NO _x dhe O ₃ duke përdorur kalibruesin (SG-741) dhe bombolat me gaz standard në SMCA (Prizren)	IHMK: 2
26 prill 2019 (e premte)	Trajnimi për llogaritjen e efikasitetit të konvertorit të analizatorit të NO _x me GPT (IHMK)	IHMK: 2
10 qershor 2019 (e hënë)	Kalibrimi zero i analizatorit të NO _x për zgjidhje të problemeve, (MMPHI/MMPH/Rilindja)	IHMK: 2
11 qershor (e martë)	Kalibrimi i analizatorit të NO _x dhe kalibrimi zero i analizatorit të SO ₂ , TNP (MMPHI/MMPH/Rilindja)	IHMK: 1
12 qershor (e mërkurë)	TNP i kalibrimit të analizatorit të NO _x (GPT), kalibrimit të analizatorit të O ₃ dhe kalibrimit të analizatorit të SO ₂ duke përdorur kalibruesin (SG-741) dhe bombolat e gazit standard në SMCA (MMPHI/MMPH/Rilindja)	IHMK: 2
14 qershor (e premte)	Zgjidhja e problemeve të analizatorit të NO _x (MMPHI/MMPH/Rilindja)	IHMK: 1
Periudha e tretë		
13 nëntor 2019 (e mërkurë)	Ligjërata për aktivitetet e monitorimit të cilësisë së ajrit ^{*1)}	IHMK: 2

*1) Ligjëratat e mbajtura janë siç vijon

- Është thelbësore që të bëhet kontrolli i rregullt zero-span dhe të mbahet regjistri i tyre. Është rekomanduar shpeshësia e kontrollit zero/span dhe me IHMK-në janë shkëmbyer fletët e regjistrimit
Kontrolli zero/span: çdo katër javë
Kalibrimi me shumë pika: një herë në çdo 6 muaj
- Menaxhimi i të dhënave: Është ligjëruar prezantimi i shembullit të Japonisë për sa i përket menaxhimit të të dhënave. Si pika kontrolluese të nevojshme për konfirmimin e të dhënave:, është ligjëruar rëndësia e krahasimit të vlerave të matura me regjistrin e mirëmbajtjes së analizatorëve në secilin SMCA në mënyrë që të gjeten parregullsitë si vlera shumë të ulëta të vazhdueshme të përqendrimit, zhvendosja zero dhe zhvendosja span, dhe për ta konfirmuar marrëdhënien me motin, marrëdhënien me stacionet në afërsi, etj.

4) O dhe M për SMCA-të:

Manuali i O dhe M është bashkëngjitur në Shtojcën-1 "Periudha e Tretë: 3-3) -1 Manuali i Mirëmbajtjes së SMCA-ve". Shembujt janë paraqitur siç vijon.

Ndarja e roleve ndërmjet IHMK-së dhe kontraktorit si dhe shpeshësia e secilës punë janë përshkruar në manualin e mirëmbajtjes së SMCA-ve. O dhe M i SMCA-ve kryhet bashkë nga H/L i IHMK-së dhe kompania e mirëmbajtjes të cilës i është dhënë puna për secilin vit. Ndarja e roleve është paraqitur në Tabela 3-70. Rrjedha e punës dhe shpeshësia e saj janë paraqitur në Tabela 3-71.

Tabela 3-70 Caktimi i roleve ndërmjet IHMK-së dhe kontraktorit

IHKM	Kontraktori	Frekuenca
Përgatitja e planit të kontrollit të SMCA-ve		Çdo vit
	Inspektimi, pastrimi i SMCA-ve, plotësimi i listës kontrolluese	Çdo 2 javë
	Zëvendësimi i filtrit të pluhurit	Çdo 2 javë ose çdo muaj
	Kontroli Zero/Span	çdo muaj
	Kontroli për rrjedhje, kalibrimi i rrjedhës	Çdo 2 muaj
Kalibrimi me shumë pika	Kalibrimi me shumë pika	Çdo 6 muaj
Kontroli i të dhënave nga distanca Kontroli për të dhëna të parregullta ose të pavlefshme.		Çdo ditë
Njoftimi i kontraktorit për ngjarjen e vlerave të parregullta		Sipas nevojës
Përgjigja ndaj ngjarjes së të dhënave të parregullta Kontroli i SMCA-ve	Përgjigja ndaj ngjarjes së të dhënave të parregullta, Kontrolli i SMCA-ve	Sipas nevojës me kontraktorin
	Diagnostikimi i problemeve (Nëse është e nevojshme të kontaktohet EAS Envimet ose Altes)	Sipas nevojës
	Dorëzimi i raportit të diagnostikimit të problemeve	Sipas nevojës
Përgatitja, dorëzimi i raportit javor të matjes		Çdo javë
Mbikëqyrja e kontraktorëve		Sipas nevojës

Tabela 3-71 Rrjedha e punëve në IHMK dhe në SMCA

Shpeshësia/Koha e mirëmbajtjes	Rrjedha e punës në IHMK	Rrjedha e punës në SMCA
Çdo mëngjes	• Kontrolli i të dhënave nga distanca.	• Komunikimi me stafin në IHMK.

	<ul style="list-style-type: none"> • Kontrolli për të dhëna të parregullta ose të pavlefshme. • Kontrolli për mesazhe të paralajmërimit nga 12 SMCA. • Mbikëqyrja e kontraktorit. 	
Çdo javë	<ul style="list-style-type: none"> • Përgatitja, dorëzimi i raportit javor të matjes tek MMPHI/MMPH 	
Çdo dy javë		<ul style="list-style-type: none"> • Inspektimi, pastrimi i SMCA-ve, plotësimi i listës kontrolluese. • Zëvendësimi i filtrit të pluhurit varësisht nga niveli i pluhurit. • Inspektimi, pastrimi i SMCA-ve, plotësimi i listës kontrolluese.
Çdo muaj		<ul style="list-style-type: none"> • Zëvendësimi i filtrit të pluhurit varësisht nga niveli i pluhurit. • Kontrolli Zero/Span • Kalibrimi i presionit • Pastrimi i filtrit të ventilatorit • Testi për rrjedhje (pompa e brendshme) • Kalibrimi i rrjedhës • Kontrolli i sensorit të presionit
Çdo 6 muaj		<ul style="list-style-type: none"> • Kalibrimi me shumë pika
Çdo vit	<ul style="list-style-type: none"> • Përgatitja e planit të kontrollit të SMCA-ve. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërrimi ose pastrimi i linjave të mostrimit midis elementit të shumëfishtë (manifold) dhe hyrjes së analizatorit. • Zëvendësimi të filtrit DFU
Çdo servisim ose riparim		<ul style="list-style-type: none"> • Kalibrimit Zero/Span • Kalibrimi i presionit • Kalibrimi i rrjedhës
Sipas nevojës	<ul style="list-style-type: none"> • Njoftimi i kontraktorit për ngjarjen e vlerave të parregullta. • Zgjidhja e problemit <p>Nëse është e nevojshme, të kontaktohet distributori zyrtar ose prodhuesi</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Përgjigja ndaj ngjarjes së të dhënave të parregullta • Kontrolli i SMCA-ve

(2) Menaxhimi i të dhënave

Tabela 3-72 parqet listën e pikave të nevojshme për t'i menaxhuar SMCA-të në mënyrë të qëndrueshme dhe gjendja ekzistuese e tyre. Projekti në bashkëpunim me MCC/MFK ka bërë përmirësimin e monitorimit të të dhënave të cilësisë së ajrit dhe sistemit të mbledhjes duke u përqendruar në rehabilitimin e analizatorëve në SMCA dhe kanë krijuar sistemin për ofrimin e të dhënave të sakta. Kjo ka arritur në fazën “3. Krijimi i sistemit për monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së ajrit”, por nga tani e tutje kërkohet të krijohet “4. Menaxhimi i të dhënave të cilësisë së ajrit”.

Tabela 3-72 Gjendja aktuale dhe pikat për operimin e duhur dhe të qëndrueshëm të SMCA-ve prej tani e tutje

Faza e aktiviteteve për krijimin e sistemit të	Aktivitetet mbështetëse dhe/ose	Vërejtjet dhe/ose
--	---------------------------------	-------------------

menaxhimit të cilësisë së ajrit ^{*1)}	gjendjet në periudhën e parë dhe të dytë	aktivitetet në të ardhmen, etj.
<p>1. Optimizimi i objekteve dhe vendosjes së SMCA-ve</p> <p>SMCA-të vendosen në mënyrë që ta arrijnë qëllimin e të kuptuarit të vazhdueshëm të gjendjes së ndotjes së ajrit në zonën e caktuar, kontributin e secilit burim në ndotje të ajrit, identifikimin e zonave me ndotje të madhe, vlerësimin e efektit të masave për kontrollin e ndotjes së ajrit, etj.</p>		
1) Numri dhe vendosja e SMCA-ve	Vazhdon gjendja ekzistuese Propozimi i vendosjes së përshtatshme të SMCA-ve	Studimi i vendosjes së SMCA-ve shtesë dhe/ose zhvendosja e SMCA-ve bazuar në rezultatin e simulimit të dispersionit
2) Zëvendësimi i kabinave të SMCA-ve	Zbatimi i instalimit të kabinave më të mëdha të tri SMCA-ve në zonën e Prishtinës	Përmirësimi i mjedisit të mirëmbajtjes për mirëmbajtjen e analizatorëve me instalimin e kabinave më të mëdha të SMCA-ve (Realizimi i operimit të qëndrueshëm)
<p>2. Analizatorët e cilësisë së ajrit dhe Operimi dhe Mirëmbajtja (O dhe M)</p> <p>Për të kryer monitorim të vazhdueshëm të duhur të cilësisë së ajrit, nuk kërkohet vetëm të kuptuarit e parimeve të matjes dhe konfigurimit të analizatorëve por gjithashtu edhe e teknologjive si punët e mirëmbajtjes ditore, aftësitë e kalibrimit për ta siguruar saktësinë e matjes, etj. Është e domosdoshme që analizatorët të mirëmbahen si duhet dhe të mbahet saktësia e matjes bazuar në njohuritë e lartpërmendura.</p>		
1) Kryerja e rehabilitimit të analizatorëve	JICA: Kryerja e rehabilitimit të analizatorëve të pesë SMCA-ve në zonën e Prishtinës. Zëvendësimi i analizatorëve të shtatë SMCA-ve në Kosovë nga MCC/MFK. Instalimi i instrumenteve meteorologjike për të gjitha SMCA-të nga MCC/MFK	Operimi dhe mirëmbajtja e duhur për të gjithë analizatorët duhet të jetë e qëndrueshme.
2) Sistemi i menaxhimit të O dhe M	Vazhdon gjendja ekzistuese ku IHMK kontraktin kompaninë për mirëmbajtje	IHMK kërkon përforcimin e stafit për përmirësim. Kërkohet zhvillimi i kapaciteteve të kompanisë së mirëmbajtjes.
3) Organizimi i regjistrimit të menaxhimit	Forcimi i menaxhimit nga IHMK Mbështetja për përpilimin e planit të menaxhimit të O dhe M dhe planit të zëvendësimit	Kërkohen Plan-programi, regjistri i O dhe M, regjistri i mirëmbajtjes së analizatorëve, raporti i mirëmbajtjes së SMCA-ve, etj.
4) Mirëmbajtja e analizatorëve	Futja në përdorim e instrumentit të kalibrimit dhe trajnimi për kalibrim. Finalizimi i PSO-së për kalibrimin e analizatorëve dhe manualit për O dhe M të analizatorëve Të fillohet të përdoret regjistri i kontrollit zero/span	Kryerja e punëve të operimit dhe mirëmbajtjes ashtu si është planifikuar. Kërkohet vazhdimi i aktivitetit të kalibrimit të analizatorëve duke përdorur gazin span dhe kalibruesin.

<p>3. Krijimi i sistemit për monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së ajrit</p> <p>Sistemi i monitorimit të vazhdueshëm të cilësisë së ajrit funksionon në mënyrë efikase për t'i ndërmarrë masat e nevojshme në mënyrë spontane për situata të emergjencës që ndikojnë në shëndetin e njeriut, për ta informuar publikun përmes internetit për gjendjen aktuale të ndotjes së ajrit, etj. duke e pasur të ditur situatën në kohë reale të gjendjes së ndotjes së ajrit.</p>		
1) Krijimi i sistemit	MCC/MFK ka ndërtuar rrjetin e komunikimit të të dhënave të SMCA-ve dhe do t'i ruajë të dhënat nga të gjitha SMCA-të në server në Kosovë	Zbatimi i kontrolli të të dhënave dhe analiza e të dhënave përmes të dhënave të ruajtura në server. Duhet të konsiderohen alarmimet për ndotje të ajrit, etj.
<p>4. Menaxhimi i të dhënave të cilësisë së ajrit</p> <p>Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së ajrit është i nevojshëm për të siguruar ruajtje të cilësisë së lartë të të dhënave dhe vazhdimësi. Prandaj, kërkohet mirëmbajtja për analizatorë. Mirëpo, të dhënat e matjes mund të kenë parregullsi për shkak të dështimit të analizatorëve, etj. dhe është e nevojshme që këto të dhëna të fshihen.</p>		
1) Finalizimi i të dhënave të matjes	Vazhdon gjendja ekzistuese (finalizuar nga personi përgjegjës në IHMK) Projekti ka prezantuar procedurën e finalizimit në Japoni	Kontrolli ditor, konsiderimi i transformimit të regjistrave të O dhe M në të dhëna, ekzaminimi i detajuar i të dhënave, trajtimi i të dhënave të parregullta dhe procedura e fshirjes së të dhënave, metoda e korigjimit të të dhënave, etj. (përforsimi i stafit është i pashmangshëm)
2) Ruajtja e të dhënave të matjes	Ruajtja e të dhënave të matjes përmes rrjetit të MCC.MFK (të gjitha të dhënat duke përfshirë të dhënat meteorologjike)	Është e nevojshme të ruhen të dhënat e papërpunuara të matjes si dhe të dhënat e përpunuara përmes procedurës 1) Finalizimi i të dhënave të matjes
3) Trajtimi i të dhënave të matura	Vazhdon gjendja ekzistuese (të trajtuara nga personi përgjegjës në IHMK)	Finalizimi i të dhënave për orë, mesatarja e 8 orëve maksimale ditore, mesatarja ditore, mujore dhe vjetore
4) Sigurimi i të dhënave	Vazhdon gjendja ekzistuese	Publikimi raporteve duke përfshirë të dhënat statistikore, etj. pas finalizimit të të dhënave

*1) Faza e aktiviteteve: Përgatitja fazave duke iu referuar kapitujve “Manuali i monitorimit të vazhdueshëm të cilësisë së ajrit (botimi i gjashtë)” (titulli i përafërt) nga Ministria e Mjedisit në Japoni.

1) Shembuj të problemeve me të dhëna

Për sa i përket SMCA-ve, në studimin e periudhës së dytë janë gjetur probleme specifike siç janë të dhënat e parregullta, përpunimi jo i duhur i të dhënave, etj. Shembujt konkretë janë siç vijon.

1) Trajtimi jo i duhur i parregullsive të analizatorëve

Pas punës së rehabilitimit të analizatorëve që përfundoi në fillim të qershorit të vitit 2019, u gjetën parregullsi në të dhënat nga dy analizatorë (Analizatori i NO_x Prishtinë/Rilindje dhe analizatori i O₃ Prishtinë/IHMK). Analizatorët vazhdimisht tregonin vlera negative, që do të thotë se ata kanë probleme. Shkaku i dështimit të analizatorit të O₃ në SMCA në IHMK ishte mbajtësi i filtrit dhe Projekti e riparoj me ndërrimin e pjesëve. Shkaku i dështimit të analizatorit të NO_x në SMCA Rilindja, i cili gjithashtu kishte problem, ishte kanali i rrjedhës së linjës së gazit të mostruar, dhe ky analizator u dërgua për riparim tek agjencia përgjegjëse në Austri.

Dy H/L nga IHMK kanë marrë pjesë në këto aktivitete të cilat janë kryer si një nga trajnimet për zgjidhje të problemeve për analizatorë. Këto probleme mund të gjeten nga personi përgjegjës duke i kontrolluar çdo mëngjes të dhënat e matjes së secilit SMCA siç është përshkruar në Tabela 3-72.

i) Zhvendosja zero

Inspektimi i të dhënave të monitorimit të cilësisë së ajrit nga e kaluara ka treguar zhvendosje të të dhënave, të paraqitur në Figura 3-13. Në figurë, të dhënat e SO₂ kanë pasur zhvendosje të madhe në muajin dhjetor 2018. Shkaku i zhvendosjes së të dhënave supozohet të krijohet nga puna e kalibrimit të analizatorit. Mirëpo, pasi që nuk kishte evidencë të punës së kalibrimit, përmbajtja e punës dhe gjendja e analizatorit para dhe pas kalibrimit nuk ishin të ditura. Prandaj, besueshmëria e të dhënave është dëmtuar shumë.




Figura 3-13 Shembuj të zhvendosjes zero

Në shembullin e mësipërm, konsiderohet se pika zero është rregulluar dhe pastaj të dhënat e matura ishin ulur. Nëse ka regjistrimit të përqendrimit (ppb ose $\mu\text{g}/\text{m}^3$) i cili është rregulluar para dhe pas rregullimit të pikës-zero, të dhënat mund të korrigojnë dhe është e mundur që të përdoren për llogaritjen e të dhënave statistikore, analizën dhe studimin e të dhënave të cilësisë së ajrit dhe vlerësimin e vlefshmërisë së rezultateve të simulimit të cilësisë së ajrit.

Manuali i mirëmbajtjes së SMCA-ve përshkruan në mënyrë të qartë se si të mbahet regjistri i kontrollit zero-span dhe kalibrimit me shumë pika. Fleta e kontrollit zero/span për SO_2 është paraqitur në Tabela 3-73. Gjatë kryerjes së kontrollit zero-span rreth çdo katër javë, pikat në vijim duhet të plotësohen dhe të regjistrohen në fletë dhe të ruhen.

- Data dhe koha
- Emërtimi i SMCA-së (lokacioni)
- Numri serik i analizatorit
- Vlera e lexuar (ppb) e gazit zero para dhe pas rregullimit të zeros (plus vlera zhvendosjes dhe vlera e pjerrësisë)
- Vlera e lexuar (ppb) e gazit span para dhe pas rregullimit të spanit (plus vlera zhvendosjes dhe vlera e pjerrësisë)

Tabela 3-73 Fleta e kontrollit zero/span

SO ₂ zero span check (minimum requirement of calibration)					
Name of monitoring station :					
Manufacture of SO ₂ analyzer :		Telecyne			
Serial No. of SO ₂ analyzer :					
Date (yyyy, mm, dd) :					
Gas concentration generated		Zero Gas with 2.0 liter/min flow (0 ppb)		Span Gas, assuming 90 ppm of SO ₂ cylinder gas is used. (200 ppb)	
		Before entering Zero (ppb)	After entering Zero (ppb)	Before adjusting span (ppb)	After adjusting span (ppb)
SO₂	Reading value (example: 1.9 ppb)				
	Offset value (example: 71 mV)				
	Slope (Telecyne) (Example: 1.096)				
Pressure of Cylinder gas before calibration (bar/Mpa) :					
Pressure of Cylinder gas after calibration (bar/Mpa) :					

Në Figura 3-13 është vlerësuar se rreth $100 \mu\text{g}/\text{m}^3$ (38 ppb) është zhvendosur në analizatorin e SO_2 në Obiliq dhe rreth $50 \mu\text{g}/\text{m}^3$ (19 ppb) është zhvendosur në analizatorin e SO_2 në Prishtinë/IHMK para dhe pas servisimit. Nëse për kontrollin zero/span bëhet regjistrimi në fletën e kontrollit zero/span dhe kjo ruhet, atëherë korrigjimi i të dhënave mund të bëhet para servisimit dhe është e mundur të rivendoset besueshmëria e të dhënave para servisimit.

Si shembull, pjesa e mëposhtme tregon metodën për korrigjimin e të dhënave në rast të zhvendosjes së pikës para dhe pas kalibrimit. Supozohet se zhvendosja zero ndodhë siç është paraqitur në Figura 3-14, dhe shkalla e plotë është 200 ppb ($526 \mu\text{g}/\text{m}^3$). Standardi i BE-së (SO_2 : BS EN 14212, 2012) përcakton zhvendosjen e zeros ± 4.0 ppb. Kur zhvendosja zero është përbrenda ± 4.0 ppb për SO_2 , nuk bëhet asnjë korrigjim. Nëse zhvendosja ndodhë si funksion i kohës mund të bëhet korrigjimi i të dhënave. Tabela 3-74 tregon se si të bëhet korrigjimi kur zhvendosja e zeros ndodhë si funksion i kohës.




Figura 3-14 Shembull i zhvendosjes zero

Tabela 3-74 Metoda e korrigjimit kur zhvendosja e zeros ndodhë si funksion i kohës

	Niveli i supozuar i zeros (ppb)	Korrigjimi (ppb)	Të dhënat pas korrigjimit
Kontrolli fillestar i zero	0	0	Vlera e matur
Pas 5 ditëve	2	-2	Vlera e matur -2
Pas 10 ditëve	4	-4	Vlera e matur -4
Pas 15 ditëve	6	-6	Vlera e matur -6
Pas 20 ditëve	8	-8	Vlera e matur -8
Pas 25 ditëve	10	-10	Vlera e matur -10
Pas 30 ditëve	12	-12	Vlera e matur -12

Problemet e lartpërmendura mendohet se shkaktohen nga mungesa e sistemit të menaxhimit të të dhënave të cilësisë së ajrit. Pasi që procedurat si finalizimi i të

dhënave të matura dhe përpunimi i të dhënave nuk janë adekuate, është e domosdoshme që të ndërtohet sistemi i menaxhimit të të dhënave.

Në aktivitetet në periudhën e tretë, Projekti mbajti ligjëratë për sistemin e menaxhimit të të dhënave.

Aktivitetet shtesë në periudhën e tretë		
7 dhjetor 2020	Seminari për menaxhimin e të dhënave të cilësisë së ajrit	2 H/L

Përmbajtja e detajuar është paraqitur në Shtojcën-1 Të tjera (9) “3)-4 Seminari për menaxhimin e të dhënave të cilësisë së ajrit”. Në këtë seminar, u prezantuan rëndësia dhe domosdoshmëria e menaxhimit të të dhënave të cilësisë së ajrit. Të dhënat e cilësisë së ajrit janë bazë për të gjitha studimet që lidhen me cilësinë e ajrit siç janë vlerësimi, analiza, etj. dhe kërkohet saktësia e të dhënave. Menaxhimi i të dhënave është sistem për ta garantuar saktësinë e të dhënave, dhe është një çështje e madhe për palën kosovare. Krijimi i sistemit kërkon përvojë, teknologji, etj., dhe është e dëshirueshme që në të ardhmen të ketë trajnime nga donatorë të huaj për ta përmirësuar saktësinë e të dhënave.

(3) Studimi i shpërndarjes optimale të SMCA-ve

“1. Është studiuar optimizmi i objekteve të SMCA-ve dhe vendosja e tyre” në Tabela 3-72. Udhëzimi për shpërndarjen e përshtatshme të SMCA-ve në Kosovë është bashkëngjitur në Shtojcën-1 “Periudha e tretë: 3-2-2) Udhëzimi për shpërndarjen e duhur të SMCA-ve”. Janë përgatitur draft udhëzimet dhe bazuar në takimin e paraqitur në Tabela 3-75, dhe janë përmbledhur opinionet nga pala kosovare siç vijon.

Tabela 3-75 Aktiviteti: Shpërndarja e duhur e SMCA-ve

Data	Aktiviteti	Vërejtjet
Periudha e tretë		
25 nëntor 2019 (e hënë)	Projekti dëgjoi mendimet për “Udhëzimi për shpërndarjen e duhur të SMCA-ve” para se të mbahej punëtorja. Projekti adoptoi mendimin se Direktiva e BE 2008/50/EC (21 maj 2008) duhet të përfshihet në udhëzime.	IHMK: Z. Shkumbin Shala
25 nëntor 2019 (e hënë)	Projekti dëgjoi mendimet për “Udhëzimi për shpërndarjen e duhur të SMCA-ve” para se të mbahej punëtorja. Nëse është e mundur preferohet rritja e numrit të SMCA-ve, por kjo do të ishte e vështirë pa mbështetjen financiare të donatorëve.	IHMK: Znj. Letafete Latifi
27 nëntor 2019 (e mërkurë)	Punëtorja për “Udhëzimi për shpërndarjen e duhur të SMCA-ve” u mbajt dhe të gjithë	MMPHI/MMPH: 4 Ministria e Punëve

	pjesëmarrësit nga MMPHI/MMPH u pajtuan me draftin original. Lokacionet e mundshme shtesë për SMCA-të në të ardhmen janë miratuar gjithashtu.	të Brendshme: 1 Komuna e Prishtinës: 1
29 nëntor 2019 (e premtë)	Projekti raportoi rezultatet e punëtorisë për “Udhëzimi për shpërndarjen e duhur të SMCA-ve” dhe dëgjoi mendimet e H/L. Rezultatet e punëtorisë janë pranuar. Ideja e dhënies përparësi mirëmbajtjes së SMCA-ve aktuale gjithashtu u pranua.	IHMK: 2: (Z. Shkumbin Shala dhe Z. Mentor Shala)
29 nëntor 2019 (e premtë)	Projekti raportoi rezultatet e punëtorisë për “Udhëzimi për shpërndarjen e duhur të SMCA-ve” dhe dëgjoi mendimet e H/L. Ideja e dhënies përparësi mirëmbajtjes së SMCA-ve aktuale gjithashtu u pranua.	IHMK: 1 (Znj. Letafete Latifi)

Së pari, Direktiva e BE-së 2008/50/EC (21 maj 2008) përmban standardet e vendosjes së SMCA-ve dhe Kosova e përmbushë numrin minimal.

Për sa i përket vendosjes së SMCA-ve ekzistuese, pesë SMCA janë vendosur për monitorimin e burimeve të mëdha të emisioneve, të cilat janë tri për TC Kosova A dhe TC Kosova B, një për Fabrikën e Ferronikelit në Drenas dhe një për fabrikën e Çimentos në Han të Elezit. Stacioni në Drenas është 1.8 km në jug-jugperëndim të fabrikës së Ferronikelit dhe stacioni në Han të Elezit është 0.6 km në veri të fabrika e çimentos dhe të dy stacionet në të njëjtën kohë funksionojnë si stacione me prapavijë urbane. SMCA në Brezovica është stacion me prapavijë rurale i vendosur në Malin e Sharrit. Ekzistojnë gjashtë SMCA me prapavijë urbane, të cilat janë: dy në qytetin e Prishtinës në veri dhe qendër (kryeqyteti, me popullsinë më të madhe), një në Prizren në jug (popullsia e dytë për kah madhësia), një në Pejë në perëndim (popullsia e katërt për kah madhësia), një në Gjilan në perëndim (popullsia e gjashtë për kah madhësia) dhe një në Mitrovicë në veri (popullsia e tetë për kah madhësia, por gjithashtu ekziston deponia e mbeturinave industriale). Këta dymbëdhjetë SMCA janë të vendosura në ekuilibër të mirë dhe për këtë arsye Projekti nuk ka propozuar ndonjë ndryshim në vendosjen ekzistuese të SMCA-ve

Projekti propozoi vendosjen e SMCA-ve shtesë duke iu referuar udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit të Japonisë “Standardi i trajtuar nga sekretari për monitorim të vazhdueshëm të gjendjes së ndotjes së ajrit” i datës 30 gusht 2013.

Projekti ka propozuar vendosjen e pesë SMCA-ve shtesë të cilat janë: një në Ferizaj (popullsia e tretë për kah madhësia), një në Gjakovë (popullsia e pestë për kah madhësia), një në Fushë Kosovë (pranë Prishtinës, popullsia po rritet) dhe dy në Prishtinë për ta mënjeluar devijimin e vendosjes brenda Prishtinës.

Mirëpo duhet t’i jepet prioritet çështjeve në vijim: Të jetë e mundur të sigurohen të dhëna për cilësinë e ajrit nga 12 SMCA-të aktuale, të jetë e mundur të ndërmerren masat e duhura për parregullsinë e të dhënave dhe të kryhet menaxhimi i duhur i mirëmbajtjes. Pas arritjes

së këtyre kushteve, duhet të merret parasysh vendosja e propozuar. Pala kosovare pranoi këtë propozim.

Tabela 3-76 paraqet rezultatin e përmbledhjes së informacioneve për lokacionet shtesë të SMCA-ve që duhet propozuar si plan për të ardhmen. Kjo tregon listën e SMCA-ve në të ardhmen për përveç informacionit për SMCA-të ekzistuese. Lokacionet e SMCA-ve janë paraqitur në Figura 3-15.

Tabela 3-76 Propozimi i Pesë SMCA-ve shtesë për të ardhmen

Klasifikimi	Numri i SMCA-ve ekzistuese	Numri i rekomanduar SMCA-ve	SMCA-të shtesë të propozuara	Vërejtjet
Prapavija	1	1	—	Brezovica
Prapavijë urbane përveç Prishtinës	4	7	Ferizaj Gjakova Fushë Kosova	Ferizaj, popullsia e tretë për kah madhësia Gjakovë: popullsia e pestë për madhësia Fushë Kosovë: shihet si pjesë e Prish dhe popullsia është në rritje
Shërbejnë si stacione me prapavijë urbane dhe për monitorim të burimeve specifike të emisioneve	2	2	--	Drenas dhe Hani i Elezit
Me prapavijë urbane në Prishtinë	2	4	Kodra e Trimave Lagjja e Spitalit	Eliminohet devijimi i lokacioneve brenda Prishtinës
Monitorimi i burimeve specifike të emisioneve	3	3	--	Në rast se nuk vendosen SMCA-të shtesë, është i mundur zhvendosja si lëvizja nga Dardhishta në Fushë Kosovë, etj.
Totali	12	17	5	

Shënim) përveç SMCA-ve të lartpërmendura ekziston edhe një stacion i lëvizshëm.

Tabela 3-77 Propozimi për shtimin e SMCA-ve në të ardhmen bashkë me informacionin për SMCA-të ekzistuese

Emërtimi	Lloji i monitorimit të cilësisë së ajrit	Viti i instalimit	Popullsia (Regjistri mi, 2011)	Furnizuesi	Riparimi i përgjithshëm i analizatorit	Zëvendësimi i analizatorit	Vërejtjet

Republika e Kosovës Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit
Raporti i Përfundimit të Projektit

					it		
IHMK	Prishtina SMCA me prapavijë urbane	2009	198.897 (I pari në Kosovë)	EAS Environment /Teledyne API	Maj 2019	-	SMCA gjendet brenda oborrit të observatorit meteorologjik. Bulevardi Bill Clinton gjendet 90m në veri të SMCA-së. Viti i prodhimit të analizatorit nuk është në dispozicion në pajisje.
Rilindja/MMPH	Mirëpo SMCA tek Rilindja mund të jetë SMCA urbane e trafikut për shkak të efektit të emisioneve nga rruga	2010		EAS Environment /Teledyne API	Maj 2019	-	SMCA gjendet në zonën e ndërtesës së përbashkët qeveritare, përfshirë MMPH-në. Megjithatë gjendet në zonë të gjelbër, rruga Luan Haradinaj gjendet 15 m në Juglindje të SMCA-së.
Kodra e Trimave		-		-	-	-	Mund të pritët përqendrim i lartë i ndotësve të ajrit për shkak të topografisë. Eliminohet përparësia në vendosjen e SMCA-ve dhe bëhet shpërndarja e barabartë.
Lagjja e Spitalit		-		-	-	-	Pritet dendësi e lartë e popullsisë. Eliminohet përparësia në vendosjen e SMCA-ve dhe bëhet shpërndarja e barabartë.
Palaj	Obiliq Burimet e emisioneve/ TTP Kosova A dhe B Monitorimi	2012	Komuna e Obiliqit 21,549	Teledyne API	Maj 2019	-	SMCA gjendet brenda oborrit të punëtorisë së TC Kosova B. Instalimi i SMCA-së është mbështetur nga Banka Botërore dhe i është dorëzuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.
Dardhishtë		2012		Teledyne API	Maj 2019	-	SMCA gjendet pranë shkollës fillore. Analizatori i SO ₂ dhe Llaptopi janë vjedhur në nëntor të vitit 2015. Instalimi i SMCA-së është mbështetur nga Banka Botërore dhe i është dorëzuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.
Obiliqi		2012		Teledyne API	Maj 2019	-	Lokacioni i SMCA-së gjendet pranë qendrës për kujdes shëndetësor. Instalimi i SMCA-së është mbështetur nga Banka Botërore dhe i është dorëzuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.
Mitrovica	SMCA me prapavijë urbane	2011	71.909 (E teta në Kosovë)	Teledyne API	-	Nëntor 2019	Lokacioni i SMCA-së gjendet brenda oborrit të shkollës fillore. Viti i prodhimit të analizatorit nuk është në dispozicion në pajisje.
Drenasi	SMCA me prapavijë urbane dhe monitorim të burimit të emisioneve	2011	58.531	Teledyne API	-	Nëntor 2019	SMCA-ja gjendet brenda oborrit të Qendrës për Promovim të Drejtave të Gruas në Drenas. SMCA-ja gjendet diku rreth 1.6km në lindje të fabrikës së Ferronikelit. Është zhvendosur 0.4 km në perëndim të lokacionit të mëparshëm të SMCA-së në pranverë të vitit 2019. Tani gjendet 1.8 km jug-jug-perëndim nga fabrika e Ferronikelit.
Peja	SMCA me prapavijë urbane	2012	96.450 (E katërta në Kosovë)	Teledyne API	-	Nëntor 2019	SMCA gjendet brenda oborrit të observatorit meteorologjik. Në vitin 2016 IHMK u detyrua ta lëvizë nga oborri i shkollës fillore në qendër të qytetit.
Hani i Elezit	SMCA me prapavijë urbane dhe monitorim të burimit të emisioneve	2012	9.403	Teledyne API	-	Nëntor 2019	SMCA gjendet brenda oborrit të shkollës fillore. SMCA-ja gjendet diku rreth 630m në veri të fabrikës së çimentos Sharrcem.
Prizren	SMCA me prapavijë urbane	2012	177.871 (E dyta në Kosovë)	Teledyne API	-	Nëntor 2019	SMCA-ja gjendet në zonën e parkimit të ndërtesës së zyrës së kryetarit të komunës. Për një muaj gjatë sezonit të verës hapësira për parkim është e hapur për publikun kryesisht qytetarë që kthehen nga bota e jashtme, prandaj mund të ndikohet nga gazrat e shkarkuara nga automjetet. Në pranverë të vitit 2019 është zhvendosur në oborrin e shkollës fillore, 1.2 km në Veriperëndim të lokacionit të mëparshëm të SMCA-së. Nuk është në qendër të qytetit.

Gjilani	SMCA me prapavijë urbane	2012	90.178 (E gjashta në Kosovë)	Teledy ne Api	-	Nëntor 2019	SMCA gjendet në një park të ngushtë pranë rrugës kryesore. Lloji i SMCA-së është stacion i trafikut urban. Në pranverë të vitit 2019 është zhvendosur në oborrin e shkollës fillore, 0.9 km në Veriperëndim të lokacionit të mëparshëm të SMCA-së. Lloji i SMCA-së është ndryshuar nga SMCA e trafikut urban në SMCA me prapavijë urbane.
Brezovica	SMCA me prapavijë rurale	2012	68	Teledy ne Api	-	Nëntor 2019	Stacioni i monitorimit të mjedisit që gjendet në resortin e skijimit në lartësi mbidetare prej 1,500 m. Në vitin 2014 pajisjet janë zhvendosur në stacionin e Drenasit. Në tetor të vitit 2016 kabina është shtrembëruar për shkak të erës së fortë dhe nuk ka qenë e mundur të përdoret më. Matja ka rifilluar në nëntor të vitit 2019.
Ferizaj	SMCA me prapavijë urbane	-	108.610 (E treta në Kosovë)	-	-	-	Është komuna e tretë më e madhe sipas numrit të popullsisë. Rekomandohet që të ketë SMCA.
Gjakovë	SMCA me prapavijë urbane	-	94.556 (E pesta në Kosovë)	-	-	-	Është komuna e pestë më e madhe sipas numrit të popullsisë. Rekomandohet që të ketë SMCA.
Fushë Kosovë	SMCA me prapavijë urbane	-	34.827	-	-	-	Mund të konsiderohet si pjesë e Prishtinës. Rekomandohet që të ketë SMCA.

: SMCA shtesë të rekomanduara




Figura 3-15 Lokacionet e SMCA-ve ekzistuese dhe të propozuara

(4) Ushtrimi i matjes së cilësisë së ajrit në raste emergjente

PSO për matjen e NO₂, SO₂, PM₁₀ dhe PM_{2.5} të mjedisit për raste emergjente është paraqitur në Shtojcën-1 “Periudha e tretë: 3-3)-2 PSO për NO₂, SO₂, PM₁₀, PM_{2.5} në Emergjenca”.

Matja e cilësisë së ajrit në emergjenca është për t’iu përgjigjur aksidenteve, siç janë eksplozimet ose zjarri në fabrika dhe objekte për deponimin e lëndës djegëse, zjarrit në pyje, etj. Kjo është matje për t’iu përgjigjur menjëherë një rasti të emergjencës dhe për të kuptuar shpejtë se sa serioze është gjendja e ndotjes së ajrit. Prandaj, pajisjet për matje në emergjenca përzgjidhen me përparësi për mbartshmërinë e lehtë dhe shpejtësinë. Pasi që saktësia dhe preciziteti janë inferiore ndaj analizatorëve të instaluar në SMCA, nuk është e mundur që të plotësohen të dhënat e monitorimit të cilësisë së ajrit nga SMCA.

Tabela 3-78 paraqet ushtrimin e matjes së cilësisë së ajrit në raste emergjente.

Trajnimi i parë është bërë në Prizren, dhe trajnimi i dytë dhe i tretë janë bërë në TC Kosova A, ku përqendrimi i PM në ajër është supozuar të jetë relativisht i lartë. Në trajnimin e tretë të matjes, njëri nga matësit digjital të pluhurit ishte i pajisur me se separator të grimcave PM₁₀ me ciklon, tjetri ishte i pajisur me se separator të grimcave PM_{2.5} me ciklon, dhe u provuan dy matje në të njëjtë kohë. Si rezultat, u dëshmuar se përqendrimi është PM₁₀> PM_{2.5}, dhe madje edhe instrumenti i thjeshtë i matjes (matësi digjital i pluhurit) mund të maste me një shkallë të caktuar të saktësisë. Një H/L nga IHMK dhe një H/L nga TC Kosova A fituan njohurinë për t’i matur vetë të gjithë ndotësit.

Tabela 3-78 Aktiviteti: Ushtrimi i matjes së cilësisë së ajrit në raste emergjente

Data	Aktiviteti	Vërejtjet
Viti 2019, periudha e dytë dhe periudha e tretë		
25 prill (e enjte)	Metoda e operimit të matësit digjital të pluhurit për matje të PM ₁₀ dhe PM _{2.5} është demonstruar në SMCA (Prizren).	Pjesëmarrës IHMK: 2
3 qershor (e hënë)	Ushtrimi për matje në emergjenca është kryer në TC Kosova A duke përdorur tubin e detektimit për (SO ₂ , NO ₂ , NO _x) dhe matësin digjital të pluhurit për PM ₁₀ , PM _{2.5} .	Pjesëmarrës KEK 2 IHMK: 2
14 nëntor (e enjte)	Ushtrimi për matje në emergjenca është kryer në TC Kosova A duke përdorur tubin e detektimit për (SO ₂ , NO ₂ , NO _x) dhe matësin digjital të pluhurit për PM ₁₀ , PM _{2.5} . E gjithë procedura u krye nga H/L.	Pjesëmarrës KEK: 1 IHMK: 1



Foto 3-16 Trajnimi (ushtrimi) i matjes në emergjenca në TC Kosova A

(5) Instalimi i ekraneve për shfaqjen e të dhënave të cilësisë së ajrit

Siç u tha më parë, pasi që Projekti e la ndërtimin e rrjetit të komunikimit të të dhënave për cilësinë e ajrit në zonën e Prishtinës në përgjegjësi të MCC/MFK, Projekti ndryshoi planin e instalimit të ekraneve për shfaqjen e të dhënave të cilësisë së ajrit nga instalimi i një ekrani në ambient të brendshme në qytetin e Prishtinës në instalimin e një numri më të madh të ekraneve në ambient të hapur në katër lokacione në qytetin e Prishtinës dhe një lokacion në qytetin e Obiliqit.

Projekti fillimisht planifikoi t'i shfaqë të dhënat e marra nga rrjeti i ndërtuar nga MCC/MFK, por për shkak të vonesës në ekzekutimin e buxhetit të qeverisë në ShBA, kah fundi i vitit 2017, JET-i vendosi t'i ndajë punët e instalimit në ato në periudhën e dytë dhe ato në periudhën e tretë. Në periudhën e dytë u instaluan ekranet në katër lokacione në qytetin e Prishtinës dhe filluan zyrtarisht t'i shfaqin të dhënat në pjesën e parë të periudhës së tretë. Në periudhën e tretë Projekti priti për krijimin e rrjetit të komunikimit të të dhënave të MCC/MFK dhe ndërroi burimin e të dhënave nga rrjeti i KE në rrjetin e MCC/MFK në nëntor të vitit 2019. Për më tepër, Projekti instaloi një ekran për shfaqjen e të dhënave në Obiliq, por shfaqja e të dhënave filloi në maj të vitit 2020 për shkak të efektit të COVID-19. Aktivitetet lidhur me instalimin e ekraneve për shfaqjen e të dhënave janë paraqitur në Tabela 3-79.

Tabela 3-79 Aktivitetet lidhur me instalimin e ekraneve për shfaqjen e të dhënave

Data	Aktivitetet	Vërejtjet
Periudha e dytë		
23 prill 2019 (e martë)	Shpjegimi i tenderimit të hapur për punën e periudhës së dytë	
29 prill 2019 (e hënë)	Përcaktimi i kontraktorit dhe kontrata për punën e instalimit të ekraneve	
6 qershor 2019 (e enjte)	Hulumtimi në terren i lokacioneve për ekrane	MMPHI/MMPH: 1 IHMK: 1; Komuna: 2, Kontraktori: 2, JET: 2
17 qershor 2019 (e hënë)	Takimi për metodën e përditësimit të të dhënave dhe dizajnin e ekranit	IHMK: 2, Kontraktori: 2, JET: 2
28 qershor 2019 (e premte)	Takimi për dizajnin e ekranit	IHMK: 2, Kontraktori: 2, JET: 2
26 gusht 2019 (e hënë)	Instalimi i ekraneve për shfaqjen e të dhënave në katër lokacione në qytetin e Prishtinës	
Periudha e tretë		
25 tetor 2019 (e premte)	Ceremonia e dorëzimit-pranimimit të ekraneve	Ministri i MMPHI/MMPH, Përfaqësuesi kryesor i Zyrës së JICA-s për Ballkanin dhe shumë të tjerë
4 nëntor 2019 (e hënë)	Takimi me Kryetarin e Obiliqit Marrëveshja për instalimin e ekranit	Kryetari i Obiliqit dhe dy të tjerë MMPHI/MMPH: 2, JET: 3

11 nëntor 2019 (e hënë)	Marrëveshja për lokacionin për instalimin e ekranit	Obiliq: 2 JET: 2
16 nëntor 2019 (e hënë)	Kontrata për punën e instalimit të ekranit (kontraktori i njëjtë si për punën e më parme)	
Fundi i muajit nëntor 2019	Ndërrimi i burimit të të dhënave nga rrjeti i KE në rrjetin e MCC/MFK	
Fillimi i muajit mars 2020	Instalimi i ekranit në Obiliq	
10 maj 2020 (e diele)	Filloi të shfaqë të dhëna	

Në periudhën e dytë meqenëse rrjeti i komunikimit të të dhënave i MCC/MFK ende nuk ishte funksional, ekranet filluan të pranojnë të dhëna të cilësisë së ajrit nga rrjeti i KE dhe filluan të shfaqin të dhëna. Rrjeti i KE mbulonte të dhënat nga tetë SMCA në Kosovë por jo edhe për tri SMCA të tjera (Obiliq, Palaj dhe Dardhishtë). Prandaj, Projekti e shtyu instalimin e ekranit në Obiliq për periudhën e tretë. Projekti instaloi ekranet në katër lokacione në qytetin e Prishtinës dhe vendosi t'i shfaqë të dhënat për Prishtinën. Ekranet zyrtarisht filluan t'i shfaqin të dhënat më 25 tetor të vitit 2019 kur u mbajt ceremonia e dorëzimit-pranimit, menjëherë pas fillimit të periudhës së tretë.



Foto 3-17 Ceremonia e dorëzimit-pranimit të ekrameve në qytetin e Prishtinës

Më 6 qershor 2019, përveç JET-it dhe kontraktorit, të gjitha palët relevante si MMPHI/MMPH, komuna e Prishtinës dhe IHMK inspektuan katër lokacionet e ekrameve në qytetin e Prishtinës. Më pas lokacionet janë autorizuar nga MMPHI/MMPH. Më pastaj, dizajni i ekranit është diskutuar ndërmjet MMPHI/MMPH dhe JET-it, dhe është vendosur për këtë çështje pas shpjegimit që i është dhënë komunës së Prishtinës.

Në periudhën e tretë, Projekti i ofroi komunës së Obiliqit instalimin e një ekрани për shfaqjen e të dhënave. Oferta u pranua nga Kryetari i Komunës së Obiliqit dhe më pas u vendos për lokacionin e ekranit përmes diskutimit me zyrtarët e komunës së Obiliq.

Në muajin nëntor 2019 MCC/MFK përfundoi punën e ndërtimit të rrjetit të komunikimit të të dhënave që mbulon të gjitha SMCA-të në Kosovë dhe Projekti ndërroi burimin e të dhënave për ekranet nga rrjeti i KE në rrjetin e MCC/MFK. Në të njëjtën kohë, ky ndryshim mundësoi pranimin e të dhënave nga SMCA-të në Obiliq. Përfundoi ndërtimi i rrjetit të komunikimit të të dhënave i MCC/MFK, rehabilitimi i të gjithë analizatorëve për shtatë

SMCA jashtë zonës së Prishtinës, dhe në të njëjtën kohë, u bë rinovuan dhe instaluan të gjitha instrumentet meteorologjike për të gjitha SMCA-të. Ndërtimi i rrjetit të komunikimit të të dhënave i MCC/MFK gjithashtu e bëri të mundur që të sigurohen jo vetëm të dhënat e cilësisë së ajrit por gjithashtu edhe të dhënat meteorologjike. Pas ndërtimit, rrjeti i KE u zëvendësua me rrjetin e MCC/MFK.

Lokacionet dhe dizajni i ekranit janë siç vijon.

1) Lokacionet e ekraneve për shfaqjen e të dhënave

- Lokacione në qytetin e Prishtinës

Numri i lokacioneve: katër lokacione (gjashtë ekrane)

- i) Para MMPHI/MMPH: një ekran
- ii) Brenda parkut pranë godinës së komunës së Prishtinës: një ekran
- iii) Qendra e qytetit (Sheshi Nëna Terezë): dy ekrane (për të dyja drejtimet)
- iv) Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë: dy ekrane (për të dyja drejtimet)

2) Pasqyra e ekranit për shfaqjen e të dhënave (paraqitur në Figura 3-17)

- Monitor i tipit vertikal

Përmbajtja e ekranit: të dhënat e cilësisë së ajrit nga SMCA-të (SO₂, NO, NO₂, CO, O₃, PM_{2.5}, PM₁₀) dhe temperatura e mjedisit

Gjuha: Shqipe, Serbe dhe Angleze

Ekranet në qytetin e Prishtinës: shfaqja e të dhënave nga SMCA para
MMPHI/MMPH

Ekranet në qytetin e Obiliqit: shfaqja e të dhënave nga SMCA në Obiliq




Figura 3-16 Lokacionet e ekraneve në qytetin e Prishtinës

- Lokacioni në qytetin e Obiliqit (një ekran)




Foto 3-18 Lokacioni i ekranit në qytetin e Obiliqit (pranë rrugës kryesore)



Figura 3-17 Ekran për shfaqjen e të dhënave

Në ekran shfaqen rezultatet e matjes së shtatë ndotësve dhe në të njëjtën kohë shfaqet Indeksi i Cilësisë së Ajrit (këtu e tutje “AQI”) si tregues i gjendjes së ajrit.

AQI arrihet duke adoptuar Indeksin më të keq për pesë komponentë (duke përjashtuar NO dhe CO) në përputhje me kriterin e vendimit²² të paraqitur në Tabela 3-80. AQI paraqitet në ekran dhe përshkrimi²² i secilit nivel të AQI është shpjeguar në Tabela 3-81.

Tabela 3-80 kriteri i vendimit për AQI e përcaktuar nga BE

Pollutant	Niveli i Indeksit					
	(bazuar në përqendrimin e ndotësit në $\mu\text{g}/\text{m}^3$)					
	I mirë	I kënaqshëm	Mesatar	I ndotur	Shumë i ndotur	Jashtë-zakonisht i ndotur
PM _{2.5}	0-10	10-20	20-25	25-50	50-75	75-800
PM ₁₀	0-20	20-40	40-50	50-100	100-150	150-1200
NO ₂	0-30	30-90	90-120	120-230	230-340	340-1000
O ₃	0-40	50-100	100-130	130-240	240-380	380-800
SO ₂	0-50	100-100	200-350	350-500	500-750	750-1250

²² <https://airindex.eea.europa.eu> : European Air Quality Index

Tabela 3-81 përshkrimi i secilit nivel të AQI

Indeksi AQ	Popullata e Përgjithshme	Popullata e Ndjeshme
I mirë	Cilësia e ajri është e mirë. Shijoni aktivitetet tuaja të zakonshme në natyrë.	Cilësia e ajri është e mirë. Shijoni aktivitetet tuaja të zakonshme në natyrë.
I kënaqshëm	Shijoni aktivitetet tuaja të zakonshme në natyrë	Shijoni aktivitetet tuaja të zakonshme në natyrë
Mesatar	Shijoni aktivitetet tuaja të zakonshme në natyrë	Konsideroni t'i zvogëloni aktivitetet intensive në natyrë, nëse keni simptoma.
Indotur	Konsideroni t'i zvogëloni aktivitetet intensive në natyrë, nëse keni simptoma siç janë djegie të syve, kollitje ose djegie të fytit	Konsideroni t'i zvogëloni aktivitetet fizike veçanërisht në natyrë, në veçanti nëse keni simptoma.
Shumë i ndotur	Konsideroni t'i zvogëloni aktivitetet intensive në natyrë, nëse keni simptoma siç janë djegie të syve, kollitje ose djegie të fytit	Zvogëloni aktivitetet fizike veçanërisht në natyrë, në veçanti nëse keni simptoma.
Jashtëzakonisht i ndotur	Zvogëloni aktivitetet fizike në natyrë.	Shmanguni aktivitetet fizike në natyrë.

3.4.2 Vlerësimi i Treguesve Objektivist të Verifikueshëm në MDP

Treguesit Objektivist të Verifikueshëm janë: “Pesë stacione të monitorimit të cilësisë së ajrit të rehabilituara përmes projektit përputhen me 6,000 orë matje efektive në vit (8,760 orë) në vitin e dytë dhe të tretë të zbatimit të Projektit”, “Stërvitjet e monitorimit të ndotjes së ajrit në emergjencë kryhen të paktën tri herë duke përdorur marrësit portativ të mostrës për matjet e SO₂, NO₂, PM_{2.5} dhe PM₁₀” dhe “Të paktën dy herë bëhet shtjellimi i raporteve të monitorimit të cilësisë së ajrit”.

Rehabilitimi i pesë stacioneve në zonën e Prishtinës u krye në maj të vitit 2019. Rehabilitimi i analizatorëve për gjashtë parametra: NO_x, SO₂, O₃, CO, PM₁₀ dhe PM_{2.5} u bë në pesë SMCA, Prishtinë/KHMI, Prishtinë/Rilindje, Obiliq, Dardhishte dhe Palaj. Derisa të përfundonte aktiviteti i rindërtimit të rrjetit për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave të matjes nga MCC/MFK në nëntor 2019, ruajtja e të dhënave për matjen e pesë SMCA-ve në Zonën e Prishtinës nuk kishte përfunduar. Prandaj, numri i të dhënave të vlefshme për një vit u konfirmua gjatë vitit nga 1 tetori 2019 (kur të dhënat kanë filluar të mblidhen) deri më 30 shtator 2020. Rezultatet janë paraqitur në Tabela 3-82.

Tabela 3-82 Të dhënat e vlefshme për orë për vit në SMCA-të e rehabilituara (njësia: numri i të dhënave të vlefshme për orë)

	O ₃	SO ₂	NO	NO ₂	CO	PM ₁₀	PM _{2.5}
IHMK	8083	8025	8181	8181	8174	8547	8547
Rilindja	7711	7956	7573	7572	7857	8278	8278
Obiliq	7896	8387	8353	8353	7588	8706	8707
Dardhishtë	8253	8137	8327	8327	8220	8224	8224
Palaj	8294	8374	8388	8389	8294	8698	8698

Në pesë SMCA-të e rehabilituara në zonën e Prishtinës, numri i të dhënave të vlefshme të matjes ka tejkaluar 6,000 orë dhe monitorimi i 6,000 orëve/vit është arritur për të gjitha elementet e matjes.

Ushtrimi i matjes së cilësisë së ajrit në rast të emergjencës është mbajtur tri herë: më 25 prill 2019, 3 qershor 2019 dhe 14 nëntor 2019. Në këtë mënyrë është arritur treguesi objektivisht i verifikueshëm.

Raportet e monitorimit të cilësisë së ajrit publikohen në faqen e internetit të AMMK-së²³ për çdo muaj. Për më tepër, në faqen e internetit të KEPA publikohet “Gjendja e Ajrit” për 2018 dhe 2019, që është e barasvlershme me dokument zyrtar për cilësi të ajrit²⁴. Në këtë mënyrë është arritur treguesi objektivisht i verifikueshëm “Të paktën dy herë bëhet shtjellimi i raporteve të monitorimit të cilësisë së ajrit”.

3.4.3 Zhvillimi i kapaciteteve përmes aktiviteteve

Aktivitetet e ndërlidhura me përcaktimin e gjendjes së analizatorëve në SMCA mund të ndahen në (a) Inspektimin e SMCA-ve (në tërë vendin) dhe rehabilitimin (SMCA-të në zonën e Prishtinës: 5 stacione), (b) Përgatitjen e manualit për mirëmbajtje dhe trajnimin për kalibrimin e analizatorëve bazuar në manual. H/L kanë kaluar nëpër përvojë dhe kanë mësuar punët në vijim përmes TNP:

- Inspektimin për të parë nëse analizatorët në SMCA janë duke operuar në mënyrë normale dhe janë duke treguar vlera të matura të sakta,
- Kontraktimin jashtë të punës së rehabilitimit duke përfshirë krijimin e listës së pjesëve të nevojshme bazuar në inspektim,
- Procedurën e punës së riparimit gjeneral.

Për më tepër, H/L për herë të parë bëri pastrimin e elementit me shumë dalje (vegël e cila shpërndanë ajrin e thithur në secilin analizator i cili është nga qelqi) dhe tubat e mostrimit nga aty deri tek analizatorët. Kjo nuk është bërë për pothuajse tetë vite prej që është instaluar SMCA dhe është punë shumë e rëndësishme për ta siguruar besueshmërinë e të dhënave. Konsiderohet se aftësia bazike është përmirësuar, por nuk është në nivelin në të cilin mund të zbatohet riparimi

²³ <https://www.ammk-rks.net/?page=1,163>

²⁴ <https://www.ammk-rks.net/?page=1,21>

i ardhshëm i përgjithshëm, duke përfshirë planifikimin, në mënyrë të pavarur pa ndihmën nga jashtë. Kalibrimi i analizatorëve bazuar në manual i cili është proces mjaft i komplikuar mund të bëhet nga një H/L përgjegjës.

Arsyeja pse u bë e mundshme kalibrimi i analizatorëve është se kapaciteti i H/L u përmirësua përmes trajnimit, në veçanti TNP, si dhe sigurimi i gazrave standarde dhe kalibruesit me gjenerator të gazit standard dhe gjenerator të ozonit të instaluar përbrenda, të cilat u përgatitën dhe u transferuan në IHMK nga ana e Projektit. Kalibrimi u bë i mundshëm përmes donacionit të pesë kompleteve të bombolave të gazit standard të NO, gazit standard të SO₂, gazit standard të CO dhe rregullatorit me pastërtisë së lartë i cili korrespondon me secilën bombolë në pesë stacionet në Zonë e Prishtinës. Gazrat standarde dhe kalibruesi nuk janë dhënë për 7 stacionet tjera ku rehabilitimin e ka bërë MCC/MFK, por konsiderohet se IHMK do t'i përdorë ato për mirëmbajtjen e SMCA-ve në të gjithë vendin. Mirëpo, dy H/L të cilët aktualisht janë përgjegjës për Rezultatin 3, (O dhe M i SMCA-ve), gjithashtu janë përgjegjës për përgatitjen e raporteve mujore, ndotjen e dheut dhe pjesëmarrjen në konferenca, trajnime dhe punëtori të cilat mbahen jashtë shtetit. Kompania private e kontraktuar përmes për mirëmbajtje përmes tenderit ende nuk ka kapacitet që ta bëjë vetë kalibrimin dhe është e nevojshme që të transferohet teknologjia tek kompania private. Mirëmbajtja e qëndrueshme do të jetë e vështirë pa punësimin e së paku edhe një punonjësi në IHMK.

Për sa i përket ndërtimi të rrjetit të komunikimit të të dhënave e cilësisë së ajrit, komunikimit të të dhënave dhe ekraneve për shfaqjen e të dhënave të cilësisë së ajrit, H/L i kanë siguruar këto pajisje përmes donatorëve siç janë MCC/MFK dhe JICA. Se si të përdoret rrjeti i komunikimit të të dhënave, sistemi i komunikimit dhe ekranet për shfaqjen e të dhënave si dhe si të sigurohet vlefshmëria e të dhënave dhe O dhe M e pajisjeve janë çështje për të ardhmen.

3.5 Rezultati 4: Zhvillohen kapacitetet për analizat relevante mjedisore laboratorike për sa i përket matjes së emisioneve dhe monitorimit të cilësisë së ajrit.

Për sa i përket zhvillimit të kapaciteteve për analiza laboratorike, Projekti ka mbështetur H/L që të jenë të aftë për ta analizuar gazin e shkarkuar nga IDM me Metodën Standarde Referente dhe ta përmirësojnë teknologjinë e analizave laboratorike përmes ri-funksionalizimit dhe operimit të analizatorëve të nevojitur për Metodën Standarde Referente. Në ndërkohë, Projekti ka mbështetur palën kosovare në monitorimin e metaleve të rënda në PM në ajër dhe në gjykimin e nevojës për monitorim të vazhdueshëm të metaleve të rënda. Në të njëjtën kohë, për ta mbështetur monitorimin Projekti gjithashtu ka ndihmuar me ri-funksionalizimin e ICP-MS ashtu që H/L t'i analizojnë vetë metalet e rënda.

3.5.1 Aktivitetet

- (1) Analiza e gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente dhe matja e merkurit total në gazin e shkarkuar

Direktiva e BE-së kërkon monitorimin e vazhdueshëm të Pluhurit, SO₂ dhe NO_x për IDM përmes matjes dhe raportimit, por në të njëjtën kohë për t'i garantuar rezultatet e matjes, një

herë në vit gjithashtu kërkon analizën me Metodën Standarde Referente për SO₂ dhe NO_x dhe matjen me metodën e mostrimit iso-kinetik për Pluhur. Për më tepër, në rastin e IDM-ve të cilat përdorin thëngjillin si lëndë djegëse, gjithashtu kërkon analizën e merkurit (Hg). Metoda Standarde Referente është metodë që duhet të përcaktohet si metodë standarde për SO₂ dhe NO_x, dhe direktiva e BE²⁵ kërkon këtë metodë për analiza të gazit të shkarkuar. Tabela 3-83 tregon standardet në BE dhe Japoni për analizën e SO₂ dhe NO_x. Detajet janë përshkruar në Shtojcën-1: Periudha e Tretë “4-1)-1 Metoda Standarde Referente për matjen e gazit”.

Tabela 3-83 Krahasimi i metodave të analizës së gazit të shkarkuar ndërmjet BE dhe Japonisë

Metodat e analizës		EU ^{*1)}		Japonia ^{*2)}	
		SO ₂	NO _x	SO _x ^{*3)}	NO _x
Metoda e Jon kromatografit (JK)		○		○	○
Metoda e Titrimtit	Metoda ARSENAZO III			○	
	Metoda Thorin	○		○	
	Metoda e Neutralizimit përmes Titrimtit			○	
Metoda e Kemiluminescës			○		○
Metoda e shpërndarjes së dritës					○
Metoda absorbtiometrisë (metoda NEDA, metoda Zn-NEDA, metoda PDS)					○

*1) BE: SO₂: EN¹¹ 14791 NO_x: EN 14792

*2) Japoni: SO_x: JIS¹¹ K 0103 NO_x: JIS K 0104

*3) Për sa i përket oksideve të sulfurit, standardet e BE-së kanë për synim SO₂, ndërsa standardet e Japonisë kanë për synim SO_x. SO_x zakonisht përbëhet nga SO₂ dhe SO₃. Metoda e JK bën analizën e SO_x.

Direktiva e BE-së kërkon analizën me standarde EN ose metoda të barasvlershme për IDM ku kryhet matja e vazhdueshme e gazit të shkarkuar. Në Kosovë ligji që planifikohet të rishikohet gjithashtu do të kërkojë metodën e analizës me standarde EN ose metoda të barasvlershme të miratuara si standarde ndërkombëtare.

Siç është paraqitur në tabelë, standardet EN përcaktojnë metodën e JK ose metodën e titrimtit për analizë të SO₂ dhe vetëm metodën e kemiluminescës për analizën e NO_x. Në projekt për SO_x dhe NO_x është përzgjedhur metoda e JK si Metodë Standarde Referente e adoptuar nga JIS. Metoda e kemiluminescës është metodë tashmë e adoptuar në analizatorin automatik të gazit të prezantuar nga Projekti, dhe nëse përdoret mund të

²⁵ Kërkesa për Metodën Standarde Referente është përshkruar në PJESËN 3 të ANEKSIN V në DIREKTIVËN 2010/755/EU e cila përcakton kornizën për emisione industriale për Impiantet me Djegie të Mëdha.

përmbushet standardi EN për NO_x . Metoda e kemiluminescencës detekton NO_x në mënyrë të drejtpërdrejt me anë të sensorit, por metoda e JK bën analizën e NO_x në mënyrë sasiore duke absorbuar NO_x nga gazi i shkarkuar, dhe metoda e mostrimit të gazit është e ndryshme nga ajo me metodën e kemiluminescencës. Projekti vendosi ta përdor metodën e JK meqenëse metoda e JK është metoda më e zakonshme në Japoni, analiza e NO_x me JK kryhet njëjtë si ajo për SO_x dhe analiza është kryer në mënyrë sasiore.

Për sa i përket matjes së merkurit total, është përzgjedhur metoda e AAS pasi që IHMK ka në posedim AAS-në dhe ata janë të familjarizuar me përdorimin e tij.

Të mëposhtmet janë shpjegimet të secilës metodë të analizës. Detajet janë përshkruar në Shtojcën-1: Periudha e Tretë “4-1)-1 Metoda Standarde Referente për matjen e gazit”.

1) Analiza e gazit të shkarkuar me JK

Për t'i analizuar SO_x dhe NO_x është e nevojshme të kalohet nëpër procedurën ku gazi i shkarkuar absorbohet në tretje dhe analizohet me JK.

Figura 3-18 paraqet rrjedhën e analizës. Gazi i shkarkuar absorbohet në tretës të ndarë për SO_x dhe NO_x . Tretjet janë sjellë në IHMK dhe janë analizuar me JK pasi që janë holluar në përqendrimin e duhur. Tretjet për mbajnë agjent oksidues (tretja e peroksidit të hidrogjenit: H_2O_2), dhe SO_x dhe NO_x oksidohen në jone (SO_4^- , NO_3^-), dhe më pastaj analizohen këto jone. Detajet e mostrimit të gazit janë përshkruar në Shtojcën-1: Periudha e dytë “4-3)-1 PSO për mostrimin e gazit për SO_x ” dhe Periudha e tretë “4-3)-2 PSO për mostrimin e gazit për NO_x ”. Përgatitja e tretjeve standarde është përshkruar në Shtojcën-1: Periudha e tretë “4-2)-1 PSO (JK-Reagjentët, tretja standarde dhe mostër)” dhe metoda e analizës me JK është përshkruar në Shtojcën-1: Periudha e tretë “4-2)-2 PSO (JK-Operimi)”




Figura 3-18 Rrjedha e analizës për SO_2 dhe NO_x me JK

2) Analiza e merkurit total

Ri-funksionalizimi i JK dhe ICP-MS janë përshkruar në vijim.

i) Ri-funksionalizimi i JK

Meqenëse JK nuk ishte përdorur fare nga koha kur ishte sjellë në IHMK rreth vitit 2012, në periudhën e parë përmes diagnostikimit Projekti specifikoi pjesët e dëmtuara dhe pjesët e nevojshme rezervë. Në periudhën e dytë JK u riparuar dhe ri-funksionalizua dhe u mbajt trajnimi për operim.

Tabela 3-84 tregon aktivitetet për sa i përket ri-funksionalizimit të JK.

Tabela 3-84 Aktivitetet e ri-funksionalizimit të JK

Data	Aktivitetet	Vërejtjet
Periudha e parë		
5 qershor 2018 (e martë)	Diagnostikimi i gjendjes së përkeqësimit të JK, larja e tubit të kalimit të likuidit, kontrolli i funksionimit të sensorëve për pompën e furnizimit të likuidit, kontrolli i brendshëm i JK, etj.	Këto aktivitete janë kryer me ndihmën e inxhinierit nga agjenti rajonal për zonën e Ballkanit. Tretjet e nevojshme si tretjet për shpëlarje, tretjet e fazës mobile dhe tretjet standarde për diagnostikim janë përgatitur nga H/L.
5 qershor 2018 (e martë)	Kontrolli operacional i auto-mostruesit, detektorit, etj.	
7 qershor 2018 (e enjte)	Kontrolli i funksionimit të auto-mostruesit dhe detektorit, si dhe kontrolli i gjendjes së kolonave	
8 qershor 2018 (e premte)	Kontrolli operacional i valvuleve brenda auto-mostruesit	
Periudha e dytë		
12 nëntor 2018 (e hënë)	Arritja e inxhinierit nga agjenti rajonal për zonën e Ballkanit	Arritja e inxhinierit
13 nëntor 2018 (e martë)	Riparimi i JK	Pjesëmarrës nga IHMK: 4 Puna e riparimit është kryer përderisa H/L kanë qenë prezent dhe kanë bërë pyetje
14 nëntor 2018 (e mërkurë)		
15 nëntor 2018 (e enjte)		
16 nëntor 2018 (e premte)		
19 nëntor 2018 (e hënë)	Përgatitja për trajnimin e operimit të JK	Arritja e inxhinierit nga agjenti rajonal për zonën e Ballkanit
20 nëntor 2018 (e martë)	Trajnimi i operimit të JK	Pjesëmarrës nga IHMK: 3
21 nëntor 2018 (e mërkurë)		
22 nëntor 2018 (e enjte)		
23 nëntor 2018 (e premte)		



Foto 3-19 Pamje nga diagnostikimi i JK-së

Projekti komunikoi paraprakisht me agjentin rajonal për zonën e Ballkanit për ri-funksionalizimin e JK dhe ka blerë pjesët të nevojshme për diagnostikim. Në muajin qershor 2019 inxhinieri nga agjenti rajonal vizitoi IHMK-në dhe bëri diagnostikimi dhe specifikoi pjesët që duhet riparuar si dhe pjesët e nevojshme rezervë. Në periudhën e dytë bazuar në raportin nga agjenti, Projekti ka blerë pjesët e nevojshme rezervë dhe agjenti riparoj dhe ri-funksionalizoi HK, dhe pastaj mbajti trajnimin për operimin e JK. Detajet janë përshkruar në Shtojcën-1: Periudha e dytë: “4-2)-4 Raporti për Jon Kromatografin” dhe Periudha e dytë: ”4-2)-5 Versioni i detajuar i Raportit për Jon Kromatografin”.

Ri-funksionalizimi dhe trajnimi është mbajtur nga inxhinierët për një periudhë prej dy javëve duke filluar nga 12 nëntori 2018. Në javën e parë është riparuar JK. Meqenëse JK nuk i ishte operuar për një kohë të gjatë dhe nuk ishte mbajtur në gjendje të mirë, nuk ishte e lehtë të riparohej JK. Për riparimin dhe operimin e JK u nevojiti kohë për shkak të bllokimit të tubit për kalimin e likuidit dhe mosfunksionimit të disa pjesëve, mirëpo në fund JK u ri-funksionalizua duke i përdorur pjesët e blera rezervë, etj. Në javën pasuese u bë trajnimi. Inxhinieri nga agjenti rajonal shpjegoi parimet dhe operimin e JK, dhe nën udhëzimin e inxhinierit H/L vetë punuan me JK. Nën udhëzimin e JET-it H/L gjithashtu përgatitën tretjet e nevojshme siç janë tretja e fazës mobile dhe tretja e kalibrimit. Përkundër kohë së shkurtër të trajnimit, H/L mësuam procedurën e përgjithshme të operimit siç është startimi, analiza, konfirmimi i rezultateve të analizës, etj. Gjatë trajnimit H/L morën pjesë në mënyrë aktive duke i bërë pyetje inxhinierit, duke i përsëritur procedurat e operimit, duke bërë përmbledhjen e aktiviteteve, etj.

Pas trajnimit H/L kërkoi nga JET-i që të japë udhëzime se si ta operojnë JK-në vetë në mënyrë që të mësojnë edhe më shumë për operimin e JK dhe ta bëjnë analizën e cilësisë së ujit të lumenjve. JET-i iu dha shpjegim dhe vërejtje për metodën e përgatitjes së tretjeve, frekuencën e operimit të JK-së, etj.



Foto 3-20 Pamje nga ri-funksionalizimi dhe trajnimi i JK

Projekti e ka përdorur JK-në në muajin maj 2019 dhe ka konfirmuar operimin normal të JK-së. Si rezultat, mendohet se personeli i IHMK ka mësuar se si ta përdor JK-në.

ii) Ri-funksionalizimi i ICP-MS

Për dallim nga rasti i JK-së, Projekti nuk kishte planifikuar ta bëjë ri-funksionalizimin e ICP-MS, por fillimisht kishte planifikuar të vendoset se si të trajtohet ai bazuar në rezultatet hulumtimit të nevojës për monitorimin e metaleve të rënda në PM në ajër. Mirëpo, siç është përshkruar në seksionin e ardhshëm, u konfirmua nevoja për monitorimin e metaleve të rënda dhe u bë e nevojshme që të analizohen metalet e rënda me ICP-MS. Në anën tjetër, MCC/MFK kishte planifikuar trajnimin për operimin e ICP-MS si përgjigje ndaj kërkesës së palës kosovare. Projekti tashmë kishte konfirmuar mundësinë e ri-funksionalizimit të ICP-MS në periudhën e parë, por puna nuk përfshinte rregullimin e ICP-MS për analizë të metaleve të rënda meqenëse vetëm diagnostikimi i ICP-MS ishte në sferën e punëve të Projektit. MCC/MFK ka marrë vesh se kërkohet puna e rregullimit për herë të parë kur e ka ndier nga Projekti, por MCC/MFK nuk kishte në plan mbulimin e shtrirjes së punëve për shërbimet e kontraktorit. Prandaj, ishte e vështirë të kryhen punët e rregullimit.

Në këtë situatë, H/P kërkoi nga pala japoneze që ta bëjë kryerjen e punës së rregullimit të ICP-MS në mënyrë që të jetë e mundur të bëhet analiza e metaleve të rënda në PM në ajër. Projekti vendosi ta kryejë këtë punë pasi që qëllimi i kësaj përputhej me vetë qëllimin e Projektit për zhvillimin e kapaciteteve për monitorimin e cilësisë së ajrit.

Tabela 3-85 paraqet aktivitetet për ri-funksionalizimin e ICP-MS. Detajet janë përshkruar në Shtojcën-1: Periudha e dytë: Periudha e dytë: “4-2)-1 Raporti i servisimit (ICP-MS)” dhe Periudha e dytë: “4-2)-2 Raporti për ICP-MS”

Tabela 3-85 Aktivitetet për ri-funksionalizimin e ICP-MS

Data	Aktivitetet	Vërejtjet
Periudha e parë		
16 maj 2018 (e mërkurë)	Transportimi i ICP-MS në Kroaci	

16 qershor 2018 (e hënë)	Arritja e ICP-MS pas riparimit dhe inspektimit	
Periudha e dytë		
6 maj 2019 (e hënë) ~ 10 maj 2019 (e premte)	Puna e rregullimit me inxhinierin nga agjenti rajonal për zonën e Ballkanit	Inxhinieri nga agjenti rajonal: 1 IHMK: 1, JET: 1
13 maj 2019 (e hënë) ~ 18 maj (e shtunë) 2019	konfirmimi i operimit me anë të punës së rregullimit	IHMK: 1, JET: 1
20 maj 2019 (e hënë) ~ 23 maj 2019 (e hënë)	konfirmimi i operimit me anë të punës së rregullimit	IHMK: 1, JET: 1
Periudha e tretë		
21 nëntor 2019 (e enjte)	Mirëmbajtja e ICP-MS	IHMK: 1, JET: 1
26 nëntor 2019 (e martë)	Kontrolli i operimit të ICP-MS	IHMK: 1, JET: 1
2 dhjetor 2019 (e hënë)	Mirëmbajtja e ICP-MS	IHMK: 1, JET: 1
3 dhjetor 2019 (e martë) 5 dhjetor 2019 (e enjte)	Mirëmbajtja e ICP-MS	IHMK: 1, JET: 1

Në muajin shkurt të vitit 2018, Projekti paraprakisht inspektoi pjesën e brendshme të ICP-MS, dhe zbuloi se një pjesë e telave brenda ICP-MS ishin ngrënë nga miu dhe kishte shumë pika të shkëputura siç tregohet në Foto 3-21. Projekti u këshillua me agjentin rajonal për zonën e Ballkanit i cili është i certifikuar nga prodhuesi për diagnostikimin dhe riparimin e ICP-MS duke përfshirë riparimin e telave. Si rezultat, Projekti vendosi ta dërgojë ICP-MS në Kroaci ku gjendet agjenti rajonal, meqenëse ata mund të merreshin me problemet në mënyrë fleksibile për shkak se kishin shumë inxhinierë dhe pjesë rezervë.

Pas bërjes së kontratës me agjentin rajonal për zonën e Ballkanit, ICP-MS u dërgua në Kroaci dhe u bë riparimi i telave. Pastaj ICP-MS u diagnostikua dhe në muajin shtator 2018 ICP-MS u dërgua prapa në IHMK. Rezultatet e diagnostikimit konfirmuan se ICP-MS është në gjendje të rregullt dhe i gatshëm për operim.



Foto 3-21 ICP-MS dhe pjesa e brendshme e ICP-MS

Në periudhën e dytë projekti përsëri bëri kontratë me agjentin rajonal në mënyrë që të bëhet rregullimi i ICP-MS për analizën e metaleve të rënda. Nga 6 maji 2019 inxhinieri nga agjenti rajonal ka vizituar IHMK-në dhe bashkë me H/L dhe JET-in

ka bërë rregullimin e ICP-MS për analizën e metaleve të rënda, dhe e ka përfunduar punën.



Foto 3-22 Puna e rregullimit të ICP-MS me inxhinierin nga agjenti rajonal

Mirëpo, ende mbeti problemi ku plazma në ICP-MS e cila është pjesa më e rëndësishme zhdukej brenda tridhjetë minutave apo aty diku pas startimit të pajisjes. Meqenëse një nga arsyet supozohej të jetë kapaciteti i ulët i detektimit i plazmës, JET-i mbështeti përmirësimin e detektorit dhe operimi u bë i qëndrueshëm pas përmirësimit. Si problem tjetër, kapaciteti i ventilatorit thithës nuk ishte i mjaftueshëm dhe JET-i propozoi IHMK-së përmirësimin e këtij problemi. Përmes këtyre aktiviteteve ICP-MS u ri-funksionalizua për të qenë në gjendje që t'i analizojë metalet e rënda.

Trajnimi i operimit të ICP-MS ishte planifikuar të mbahet nga MCC/MFK, dhe pas trajnimit pritet që personeli i IHMK-së ta bëjnë analizën e metaleve të rënda në PM në ajër në mënyrë të pavarur. Mirëpo, ende mbetet çështja se pala kosovare nuk mund ta bëjë mostrimin e PM_{10} të cilën e kërkon Direktiva e BE-së për monitorimin e metaleve të rënda. Projekti nuk ka përgatitur PSO meqenëse trajnimi i operimit mbahet nga MCC/MFK.

iii) Mbështetja për analizën e merkurit total me AAS

AAS që përdoret për analizën e merkurit total ishte instrument që tashmë përdorej në IHMK. Mirëpo, gjendja e mirëmbajtjes nuk ishte e mirë, dhe në muajin qershor 2018 JET-i udhëzoi H/L se si ta bëjnë mirëmbajtjen e AAS.



Foto 3-23 Pamje e AAS dhe inspektimit

Për ta analizuar merkurin total është e nevojshme të analizohet merkuri në gjendje të gaztë dhe merkuri në gjendje të ngurtë në gazin e shkarkuar. Për ta

analizuar merkurin total është e nevojshme që të bëhet shpërbërja e filtrave në të cilët është mbledhur Pluhuri në gazin e shkarkuar, të nxirret merkuri i ngurtë dhe të konvertohet në tretje (para-trajtim) duke aplikuar acidolizën nën presion të mikrovalës dhe metodën e dekompozimit. Prandaj, JET-i transferoi këtë metodë dhe kushtet e trajtimit të saj, si dhe teknikat për operimin e aparatit për trajtimin me mikrovalë. JET-i përgatiti PSO-në për përgatitjen e tretjeve për analizën e merkurit total. Kjo është përshkruar në Shtojcën-1, Periudha e tretë: “4-2)-3 PSO (Hg për AAS, Reagjentët)”.

2) Analiza e gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente

Si rezultat i ri-funksionalizimit të JK-së Projekti filloi ta aplikojë Metodën Standarde Referente për analizë të gazit të shkarkuar. Nga muaji prill 2019 Projekti bëri mostrimin e gazit të shkarkuar në TC Kosova A, TC Kosova B dhe fabrikën e Ferronikelit dhe analizoi gazin e shkarkuar me Metodën Standarde Referente.

Ky aktivitet ishte planifikuar të përfundojë në periudhën e dytë, por H/L kërkuan trajnim shtesë për operimin e JK dhe para-trajtimin dhe analizën e merkurit, dhe JET-i pranoi kërkesën dhe mbajti trajnim shtesë në periudhën e tretë.

i) Aktivitetet për analizën e gazit të shkarkuar

Për sa i përket analizës së gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente, Projekti bëri mostrimin dhe analizën e gazit në aktivitet e Rezultatit 2. Mostrat e SO_x dhe NO_x janë analizuar me JK dhe merkuri është analizuar me AAS. Për analizë të merkurit kërkohet që të analizohet merkuri në gjendje të gaztë dhe merkuri në gjendje të ngurtë. Merkuri në gjendje të gaztë absorbohet në tretje dhe analizohet me AAS, por analiza e merkurit në gjendje të ngurtë kërkon një proces më të ndërlikuar ku merkuri në Pluhur nxirret me acid të fortë dhe pastaj analizohet me AAS.

Tabela 3-86 paraqet aktivitetet në IHMK për analizë me JK dhe atë për merkuri.

Tabela 3-86 Aktivitetet për analizë me JK dhe analizë të merkurit

Data	Aktivitetet	Vërejtjet
Periudha e dytë		
2 maj 2019 (e hënë)	Ligjërata për analizë me JK	IHMK: 1
3 maj 2019 (e premte)	Mbështetja për analizë të Hg me AAS	IHMK: 1
7 maj 2019 (e martë)	Përgatitja e tretjes absorbuese për mostrimin e gazit të shkarkuar	IHMK: 1
10 maj 2019 (e premte)	Trajnimi për analizë me JK	IHMK: 1
13 maj 2019 (e hënë)	Trajnimi për analizë me JK	IHMK: 1
14 maj 2019 (e martë)	Trajnimi për analizë me JK	IHMK: 1
15 maj 2019 (e mërkurë)	Trajnimi për analizë me JK	IHMK: 1
16 maj 2019 (e hënë)	Trajnimi për analizë me JK	IHMK: 1
17 maj 2019 (e premte)	Trajnimi për analizë me JK,	IHMK: 1

	Mbështetja e procesit të para-trajtimit për analizë të merkurit	
18 maj (e shtunë) 2019	Trajnimi për analizë me JK	IHMK: 1
20 maj 2019 (e hënë)	Trajnimi për analizë me JK, Mbështetja e procesit të para-trajtimit për analizë të merkurit	IHMK: 1
21 maj 2019 (e martë)	Trajnimi për analizë me JK, Mbështetja e analizës së merkurit me AAS	IHMK: 1
22 maj 2019 (e mërkurë)	Trajnimi për analizë me JK, Mbështetja e analizës së merkurit me AAS	IHMK: 1
23 maj 2019 (e hënë)	Trajnimi për analizë me JK	IHMK: 1
Periudha e tretë		
20 nëntor 2019 (e mërkurë)	Kontrolli i operimit të JK	IHMK: 1
21 nëntor 2019 (e enjte)	Kontrolli i operimit të JK	IHMK: 1
25 nëntor 2019 (e hënë)	Analiza e gazit të shkarkuar me JK	IHMK: 1
27 nëntor 2019 (e mërkurë)	Para-trajtimi i merkurit në gjendje të ngurtë (Hg)	IHMK: 1
28 nëntor 2019 (e enjte)	Para-trajtimi i merkurit në gjendje të ngurtë (Hg), Trajnimi për operimin e JK	IHMK: 1
29 nëntor 2019 (e premte)	Para-trajtimi i merkurit në gjendje të ngurtë (Hg), Trajnimi për operimin e JK, Trajnimi për operimin e AAS	IHMK: 1
2 dhjetor 2019 (e hënë)	Kontrolli i operimit të JK	IHMK: 1
3 dhjetor 2019 (e martë)	Trajnimi i operimit të JK	IHMK: 1
4 dhjetor 2019 (e mërkurë)	Trajnimi i operimit të JK	IHMK: 1
5 dhjetor 2019 (e enjte)	Trajnimi i operimit të JK	IHMK: 1
6 dhjetor 2019 (e premte)	Organizimi i operimit të JK (përpilimi i PSO-së)	IHMK: 1
7 dhjetor 2019 (e shtunë)	Organizimi i operimit të JK (përpilimi i PSO)	IHMK: 1

Mostrimi i gazit të shkarkuar për analizë me JK kërkon përgatitjen e tretjes absorbuese. Mirëpo, meqenëse stafi përgjegjës nuk ishte i familjarizuar për trajtimin e reagjentëve brenda laboratorit, JET-i udhëzoi stafin përgjegjës për reagjentët e nevojshëm, përqendrimin, sasinë e kërkuar, etj. dhe stafi përgatiti tretjet me ndihmën e JET-it.

Në periudhën e tretë stafi i IHMK-së dhe JET-i diskutuan dhe planifikuan punë për çdo ditë, dhe pas konfirmimit të përmbajtjes teknike të punës së asaj dite siç janë përgatitja e tretjes së mostrës për analizë, përgatitja e tretjes, operimi i analizatorëve, etj. Stafi i IHMK-së filloi punën me ndihmën e JET-it. Për sa i përket operimit të analizatorëve, meqenëse operimi i softuerit të analizatorëve është i komplikuar, stafi i IHMK-së bëri përsëritjen e procedurave kryesisht për startim, procedurë të analizës, konfirmim të rezultateve, etj. Si organizim të aktivitetit përfundimtarë JET-i dhe H/L së bashku përpiluan PSO-të.



Foto 3-24 Analiza dhe operimi i JK



Foto 3-25 Operimi i mikrovalës (nxjerrja e Hg) dhe analiza e merkurit

ii) Rezultatet e analizës së gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente

Tabela 3-87 paraqet rezultatet e analizës së gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente dhe analizës së merkurit. Kur është bërë mostrimi i gazit për Metodën Standarde Referente, paralelisht është bërë matja me analizatorin automatik të gazit. Në tabelë janë paraqitur edhe rezultatet e SO_x (ose SO₂) dhe NO_x me metodën e JK e edhe me analizatorin automatik të gazit. Në të njëjtën kohë janë paraqitur edhe rezultatet e merkurit. Përmes analizave të linjtit dihet se linjiti në Kosovë përmban mercuri, mirëpo përmes të gjitha analizave laboratorike nuk është detektuar mercuri në gazin e shkarkuar.

Detajet janë përshkruar në Shtojcën-1: Periudha e dytë “4-1)-1 Metoda Standarde Referente për matjen e gazit”.

Tabela 3-87 Rezultatet e analizës së gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente dhe analizës së merkurit

Data		26 prill 2019	30 prill 2019	8 maj 2019	15 maj 2019	16 maj 2019
Objekti		TC Kosova A	TC Kosova A	Ferronikeli	TC Kosova B	TC Kosova B
Kanali Nr.		Nr.5-Kanali C	Nr.5-Kanali C	Furra Rrotulluese	Nr.1-1	Nr.1-2
Pika	Njësia	—	—	—	—	—
SOx (JK)	mg/Nm ³	1.912	1.614	3.155	529	1.244
SO ₂ (PG)		1.535	782	1.221	206	580
NOx (JK)	mg/Nm ³	660	771	109	850	819
NOx (PG)		367	396	70	431	483
Hg (Pluhur)	mg/Nm ³	N.D	N.D	—	N.D	N.D
Hg (Gaz)		N.D	N.D	—	N.D	N.D

Data		6 nëntor 2019	8 nëntor 2019	11 nëntor 2019	19 nëntor 2019
Objekti		TC Kosova A	TC Kosova A	TC Kosova A	TC Kosova A
Kanali Nr.		Nr.5-Kanali C	Nr.5-Kanali C	Nr.4-Kanali C	Nr.4-Kanali C
Pika	Njësia	—	—	—	—
SOx (JK)	mg/Nm ³	500	6	322	1.983
SO ₂ (PG)		125	1	213	897
NOx (JK)	mg/Nm ³	1.048	1.209	1.013	755
NOx (PG)		340	386	354	288
Hg (Pluhur)	mg/Nm ³	N.D	N.D	N.D	N.D
Hg (Gaz)		N.D	N.D	N.D	N.D

Vlerat e mësipërme janë vlera të drejtpërdrejta të dala nga analiza. Ato nuk janë të konvertuara në O₂ referente.

JK: Jon Kromatografi

PG: Analizatori automatik i gazit

Hg (Pluhuri): Merkuri në gjendje të ngurtë

Hg (Gazi): merkuri në gjendje të gaztë

N.D.: Nuk është Detektuar (Kufiri i poshtëm i detektimit: Hg: 0.002mg/Nm³)

Krahasimi ndërmjet rezultateve të analizës me Metodën Standarde Referente dhe rezultateve të matura me Analizator automatik të gazit në të njëjtën kohë, janë paraqitur në Figura 3-20. Si rezultat është e dukshme se rezultatet e analizës me Metodën Standarde Referente janë gjithmonë pothuajse dy herë më të mëdha sesa rezultatet e matura me Analizatorin automatik të gazit.

Një nga shkaqet e dallimi supozohet të jetë absorbimi i SO₂ dhe NOx nga uji i kondensuar në tubin e mostrimit të përdorur për Analizatorin automatik të gazit.




Figura 3-20 Krahasimi ndërmjet rezultateve të analizës me Metodën Standarde Referente dhe rezultateve të matura me Analizator automatik të gazit

Pamje e matjes së gazit të shkarkuar me Analizatorin automatik të gazit Figura 3-21. Në rastin kur vrimat e matjes gjenden në vende të larta siç janë oxhaqet dhe kanalet në vende të larta, gjatësia e tubit të mostrimit do të jetë 30 deri 50m. Në tri objekte ku Projekti bëri matje gjatësia e tubit ka qenë 30 deri 50m. Gazi i shkarkuar ka përmbajtje të lartë të lagështisë dhe gazi është ftohur dhe lagështia në gaz është kondensuar në ujë gjatë rrugës nga vrima e mostrimit deri te analizatori. Uji i kondensuar mund ta absorbojë SO₂ dhe NO_x dhe përmbajtja e tyre mund të bëhet më e ulët. Meqenëse sasi e ujit të kondensuar varet shumë nga përmbajtja e lagështisë në gazin e shkarkuar, temperatura e ajrit në mjedis, etj. Efekti në rezultatet e matjes mund të ndryshojë në secilën matje.




Figura 3-21 Pamje e matjes së gazit të shkarkuar me Analizatorin automatik të gazit

Në anën tjetër, mostrimi i gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente supozohet se ndikohet shumë pak nga uji i kondensuar meqenëse sasia e ujit të kondensuar është shumë e vogël për shkak të mostrimit të gazit menjëherë afër

vrimes së mostrimit, dhe përveç kësaj i gjithë uji i kondensuar rikuperohet në tretjen absorbuese. Kjo mund të jetë një nga arsyet, por aktualisht arsyeja nuk është identifikuar.

Në aktivitetet shtesë në periudhën e tretë, Projekti u përpoq ta analizonte gazin e shkarkuar duke bërë mostrimin në lokacione të ndryshme në linjën e mostrimit në mënyrë që ta bënte krahasimin e efektit të kondensimit në linjën e mostrimit. Mirëpo, ka pasur dallime të mëdha ndërmjet rezultateve dhe numri i rezultateve nuk ishte i mjaftueshëm. Prandaj, nuk është arritur ndonjë rezultat i qartë. H/L duket se e kuptojnë mostrimin dhe analizat me Metodën Standarde Referente, por JET nuk ka mundur t'i përcjellë procedurat aktuale të kryera nga H/L. Prandaj, JET ka kuptuar se është e nevojshme të kryhen pak më shumë trajnime duke përfshirë konfirmimin e atyre procedurave.

Duke marrë parasysh supozimin e mësipërm, duhet t'i kushtohet vëmendje pikave në vijim.

- Ekziston dallim i madh ndërmjet rezultateve të analizës me Analizator automatik të gazit dhe rezultateve të analizës me Metodën Standarde Referente. Kjo është vërejtur në momentet e fundit të Projektit, dhe nuk është identifikuar arsyeja meqenëse nuk ka pasur kohë për ta konfirmuar atë. Në Projekt rezultatet e matjes me Analizator automatik të gazit janë përdorur ashtu siç kanë qenë. Për ta identifikuar arsyen është e nevojshme që shumë herë të bëhet mostrimi dhe analiza e gazit të shkarkuar të njëjtë për të dyja metodat.
- Mendohet se është efektive të adoptohet metoda e JK për Metodën Standarde Referente, veçanërisht për NO_x, pasi që metoda e mostrimit të gazit është e ndryshme.
- Është e nevojshme që t'i kushtohet vëmendje që gjatësia e tubit të mostrimit të jetë sa më e shkurtër që është e mundur, të parandalohet që lagështia në gaz të mos kondensohet duke e mbajtur tubin e mostrimit ngrohët, etj. Mirëpo, praktikisht është e vështirë të mbahet ngrohët tubi i gjatë 30 deri 50m. Kur përdorimi i tubit të gjatë për mostrim është i pashmangshëm pa e mbajtur atë të ngrohtë, duhet të konsiderohet që në të njëjtën kohë të kryhen të dy metodat (analizatori automatik i gazit dhe Metoda Standarde Referente) dhe të krahasohen rezultatet.
- Në rast se instalohet SMVE, tubat e mostrimit në përgjithësi mbahen të ngrohta. Në këtë rast mund të bëhet shmangia nga efekti i lartpërmendur. Në TC Kosova B tubi i mostrimit është i izoluar, por nuk është konfirmuar se a punon si duhet apo jo.

Projekti ka mbështetur ri-funksionalizimin e JK dhe ICP-MS. Këta dy analizatorë kanë filluar operimin dhe kapaciteti për analiza në IHMK është përmirësuar. Në të njëjtën kohë, H/L kanë fituar përvojën për ta përdorur JK për detyra aktuale të analizës së gazit të

shkarkuar me Metodën Standarde Referente. Në të njëjtën kohë, është krijuar korniza për aplikimin e Metodës Standarde Referente për TC Kosova A dhe TC Kosova B.

Aktualisht, dy objektet në Kosovë për të cilat kërkohet aplikimi i Metodës Standarde Referente janë dy IDM-të, dhe në të njëjtën kohë agjencia vetëm IHMK është agjenci e cila posedon JK (TC Kosova B ka një JK por nuk mundet t'i analizojë anionet, që është synim i Projektit). Prandaj, kërkohet që KEK dhe IHMK të bashkëpunojnë për ta aplikuar Metodën Standarde Referente. Në të ardhmen është e dëshirueshme që metoda t'i aplikohet të gjitha fabrikave, por duke marrë parasysh situatën ku shumë fabrika private nuk kryejnë matje të duhur të gazit të shkarkuar, është e dëshirueshme që të bëhet matje e duhur e gazit të shkarkuar duke përfshirë matjen me Analizatorin automatik të gazit.

Për më tepër, përvetësimi i metodës së mostrimit të gazit dhe ri-funksionalizimi i dy analizatorëve mund të aplikohen jo vetëm për Metodën Standarde Referente por gjithashtu për shumë detyra të tjera siç janë analiza e cilësisë së ajrit, analiza e cilësisë së ujit, etj. Prandaj, është e rëndësishme të sqarohen nevojat për këto teknologji dhe të përdoren ato në mënyrë efektive.

(3) Metalet e rënda në PM

Si aktivitet në periudhën e parë, përmes mostruesit me vëllim të lartë është bërë mostrimi i Grimcave totale të suspenduara (këtu e tutje “TSP”) të PM në ajër në Drenas dhe Mitrovicë, dhe filtrat e mostruar janë dërguar në Japoni. Analiza e metaleve ë rënda është bërë në Japoni. Standardi i BE-së kërkon analizën e metaleve të rënda në ajër në PM₁₀. Prandaj, në Drenas dhe Mitrovicë është kryer në total 4 herë mbledhja e PM₁₀ me mostrues me vëllim të ulët në të njëjtën kohë me mbledhjen e TSP me mostrues me vëllim të lartë. Këto mostra gjithashtu janë analizuar në Japoni. Bazuar në rezultatet e këtyre analizave janë vlerësuar rëndësia dhe urgjenca e monitorimit të metaleve të rënda në Kosovë, dhe rezultatet e mostrimit të TSP me mostrues me vëllim të lartë dhe të mostrimit të PM₁₀ me mostrues me vëllim të ulët janë krahasuar dhe ekzaminuar.

Tabela 3-88 Aktivitetet e mostrimit të PM në ajër në Drenas dhe Mitrovicë

Data	Aktiviteti	Referencë
Viti 2018, periudha e parë		
15 maj (e martë)	Shpjegimi i mostrimit të PM në Drenas dhe Mitrovicë	Shpjegimi preliminar i mostrimit të PM dhe kërkesa për bashkëpunim.
28 maj (e hënë)	Takimi me MMPHI/MMPH/IHMK për planifikimin e mostrimit të PM	Znj. Nezakete e informoi Kryetarin e Drenasit dhe shefin e sektorit të mjedisit në Mitrovicë. Z. Shkumbin nga IHMK-ja iu bashkua aktivitetëve.
29 maj (e martë)	Vizita preliminare e pikave të mostrimit të PM	Dy (2) nga stafi i IHMK-së iu bashkua aktivitetëve. Dy (2) pika në Drenas dhe gjashtë (6) pika në Mitrovicë u përzgjedhën si

		pika të mostrimit.
30 maj (e mërkurë)	Mostrimi i PM (filloi mostrimi i parë në Drenas)	Dy (2) nga stafi i IHMK-së iu bashkua aktiviteteve. Mostrimi i TSP përmes Mostruesit me Vëllim të Lartë filloi në dy (2) pika në Drenas.
31 maj (e enjte)	Mostrimi i PM (filloi mostrimi i parë në Mitrovicë)	Mostrimi në Drenas përfundoi dhe u bë lëvizja në Mitrovicë. Mostrimi i TSP përmes Mostruesit me Vëllim të Lartë filloi në dy (2) pika në Mitrovicë.
1 qershor (e premte)	Mostrimi i PM (filloi mostrimi i dytë në Mitrovicë) Mostrimi paralel i TSP dhe PM ₁₀ në pikën nr.4.	Një (1) nga stafi i IHMK-së iu bashkua aktiviteteve. Mostrimi përfundoi në pikant nr.1 dhe nr.2, dhe u bë lëvizja dhe filloi mostrimi në pikat nr.3 dhe nr.4 në Mitrovicë.
2 qershor (e shtunë)	Mostrimi i PM	Përfundoi mostrimi në pikat nr.3 dhe nr.4 në Mitrovicë.
11 qershor (e hënë)	Mostrimi i PM (filloi mostrimi i tretë në Mitrovicë) Mostrimi paralel i TSP dhe PM ₁₀ në pikën nr.5.	Filloi mostrimi në pikat nr.5 dhe nr.6 në Mitrovicë.
12 qershor (e martë)	Mostrimi i PM (filloi mostrimi i katërt në Mitrovicë) Mostrimi paralel i TSP dhe PM ₁₀ në pikën nr.1.	Dy (2) nga stafi i IHMK-së iu bashkua aktiviteteve. Mostrimi përfundoi në pikant nr.5 dhe nr.6, dhe u bë lëvizja dhe filloi mostrimi në pikat nr.1 dhe nr.2 në Mitrovicë.
13 qershor (e mërkurë)	Mostrimi i PM (filloi mostrimi i dytë në Drenas) Mostrimi paralel i TSP dhe PM ₁₀ në pikën nr.1.	Përfundoi mostrimi në pikat nr.1 dhe nr.2 në Mitrovicë. Mostruesit në të dy pikat operuan vetëm për 2 orë për shkak të temperaturës së lartë, dhe u bë lëvizja për në Drenas. Mostrimi i TSP përmes Mostruesit me Vëllim të Lartë filloi në dy (2) pika në Drenas.
14 qershor (e enjte)	Mostrimi i PM	Mostrimi përfundoi në Drenas.

Analiza e PM në ajër është kryer në përputhshmëri me metodën e mostrimit dhe analizës të përcaktuar në “Manualin e teknologjisë së kontrollit të ndotjes së ajrit” të Japonisë (Prill, 2011, Divizioni i Mjedisit të Ajrit, Byroja për Menaxhim Mjedisor, Ministria e Mjedisit). Mirëpo, nuk janë adoptuar rezultatet e analizës duke përdorur mostruesin e ajrit me vëllim të ulët në posedim të IHMK-së, pasi që rezultatet mund të ndikohen nga kontaminimi i shkaktuar ose nga mjedisi i laboratorit ose vetë mostruesi me vëllim të ulët.

1) Rezultati i analizës së metaleve të rënda

Rezultatet e analizës së metaleve të rënda në periudhën e parë janë paraqitur në Tabela 3-89 dhe Tabela 3-90.

Në Mitrovicë, rezultati i analizës së Mn (Mangan) tejkalon vlerën e udhëzimit në Japoni (140 ng/m^3 si vlerë mesatare vjetore) në mostrat e marra në Nr.3 dhe Nr.4 nga 1 deri 2 qershor 2018, megjithëse standardi mjedisor për Mn nuk ekziston në BE. Në të njëjtën kohë, rezultati i analizës së As (Arsenit) tejkalon vlerën e udhëzimit në Japoni (6 ng/m^3 si vlerë mesatare vjetore) në mostrat e marra në Nr.3 nga 1 deri 2 qershor 2018. Në BE standardi mjedisor për As në PM_{10} gjithashtu është mesatarja vjetore prej (6 ng/m^3).

Asnjë nga rezultatet e analizës së mostrave nga Drenasi nuk tejkalon vlerën udhëzuese të Japonisë dhe standardin mjedisor të BE-së.

Tabela 3-89 Rezultati i analizës së metaleve të rënda në PM në ajër në Mitrovicë

Lokacioni	Nr.1 Mitrovicë	Nr.2 Mitrovicë	Nr.3 Mitrovicë	Nr.4 Mitrovicë	Nr.5 Mitrovicë	Mitrovicë Nr. 6	Vlera Udhëzuese në Japoni (TSP, Mesatarja Vjetore)	Standardet mjedisore në BE (PM_{10} , Mesatarja vjetore)
Mostrimi (24 orë)	31/5~ 1/6/2018	31/5~ 1/6/2018	1/6~ 2/6/2018	1/6~ 2/6/2018	11/6~ 12/6/2018	11/6~ 12/6/2018		
Vendi i mostrimit	Kolegji i Biznesit	Shtëpia në veri	Shkolla Filllore	Parku Alba	Shtëpia pranë hekurudhës	Shtëpia në perëndim		
TSP ($\mu\text{g/m}^3$)	36.1	78,3	55,4	160	61,1	91,7	-	-
Mn(ng/m^3)	47.4	88,1	169	204	31,5	58,0	140	-
Ni(ng/m^3)	3.1	<1.4	2.7	18,0	<1.4	3.4	25	20
As(ng/m^3)	1.5	2,9	17	2,1	0,8	0,8	6	6
Cd(ng/m^3)	0.69	0,60	2,13	0,70	<0.5	<0.5	-	5
Pb($\mu\text{g/m}^3$)	<0.05	0.03	0,25	0,02	<0.05	<0.05	-	0,5
Zn($\mu\text{g/m}^3$)	0.19	0,16	1,40	0,29	0,12	0,08	-	-

Shënim: Qelizat e hijezuara me ngjyrë të kuqe tregojnë tejkalimin e vlerës udhëzuese në Japoni (mesatarja vjetore)

Tabela 3-90 Rezultati i analizës së metaleve të rënda në PM në ajër në Drenas

Lokacioni	Nr.1 Drenas	Nr.2 Drenas	Nr.1 Drenas	Nr.2 Drenas	Vlera Udhëzuese në Japoni (TSP, Mesatarja Vjetore)	Standardet mjedisore në BE (PM_{10} , Mesatarja vjetore)
Mostrimi (24 orë)	30/5/~ 31/5/2018	30/5/~ 31/5/2018	13/6~ 14/6/2018	13/6~ 14/6/2018		
Lokacioni i mostrimit	1.2 km në jug të fabrikës	1.5 km në verilindje të fabrikës	1.2 km në jug të fabrikës	1.5 km në verilindje të fabrikës		
TSP ($\mu\text{g/m}^3$)	43.1	58,4	52,0	46,2	-	-
Mn(ng/m^3)	37.3	38,6	21,9	23,7	140	-
Ni(ng/m^3)	<1,4	3,2	<1,4	7,4	25	20
As(ng/m^3)	<0.6	<0,6	<0,6	<0,6	6	6
Cd(ng/m^3)	<0.5	<0.5	<0.5	<0.5	-	5

Pb($\mu\text{g}/\text{m}^3$)	<0.05	<0.05	0.05	<0.05	-	0,5
Zn($\mu\text{g}/\text{m}^3$)	0.04	0,02	0,03	<0,02	-	-

Duke gjykuar nga rezultatet e matjes, rekomandohet që metalet e rënda në Mitrovicë (së paku Mn dhe As) të monitorohen vazhdimisht. Koha e mostrimit ishte 24 orë, por vlerat standarde mjedisore (BE) dhe vlera e udhëzimit (Japoni) e metaleve të rënda në ajër janë të caktuara të jenë vlera mesatare vjetore. Edhe nëse vlera mesatare e matjes 24-orëshe tejkalon standardin mjedisor, nuk mund të vihet në përfundim se ka tejkalim të vlerave standarde mjedisore nga pikëpamja e mesatares vjetore. Në parim rekomandohet që të bëhen matjet një herë në muaj, ose të paktën 4 deri 6 herë në vit, dhe pastaj të llogaritet vlera mesatare për ta bërë krahasimin me vlerat udhëzuese ose standardet mjedisore.

Tabela 3-91 Aktivitete për vlerësimin e metaleve të rënda në PM në ajër

Data	Aktiviteti	Vërejtjet
Periudha e dytë		
19 tetor 2018 (e premte)	Diskutimi për rezultatet e analizës së metaleve të rënda në PM të mostruara në Drenas dhe Mitrovicë.	Pjesëmarrës IHMK: 3
22 tetor 2018 (e hënë)	Diskutimi për rezultatet e analizës së metaleve të rënda në PM të mostruara në Drenas dhe Mitrovicë.	Pjesëmarrës IHMK: 2
25 janar 2018 (e premte)	Takimi i tretë i KPK-së Projekti ka bërë shpjegimin e rezultateve të analizës së metaleve të rënda në PM në Drenas dhe Mitrovicë. Pala kosovare do të vazhdojë monitorimin e metaleve të rënda në PM në ajër. Pranimi nga pala japoneze për mostrimin e serishëm të PM në ajër në Drenas dhe analizën e serishme të metaleve të rënda në Japoni	Pjesëmarrës Anëtarë të KPK-së: 7 JICA: 4 Vëzhgues: 3 JET: 4 GP-H/L, etj.: 2

Si përgjigje ndaj këtyre shpjegimeve, monitorimi i metaleve të rënda në PM në ajër do të vazhdojë në të ardhmen, së paku në Mitrovicë. Mirëpo, në kohën e mostrimit të parë të PM në ajër në Drenas, në maj dhe qershor 2018, fabrika e Ferronikelit e cila supozohet se është burim i emisioneve, nuk punonte. Pasi që fabrika e Ferronikelit rifilloi punën, dhe në përgjigje të kërkesës nga MMPHI/MMPH, mostrimi i PM në ajër në Drenas u krye përsëri. Mostrimi u krye në fund të muajit maj 2019.

Tabela 3-92 Aktivitetet e mostrimit shtesë të PM në ajër në Drenas

Data	Aktiviteti	Vërejtjet
Periudha e dytë		
27 maj 2019 (e hënë)	Pastrimi i Mostruesit të ajrit me vëllim të lartë.	Pjesëmarrës IHMK: 2

28 maj 2019 (e martë)	Fillimi i mostrimit në pikën Nr.1 dhe pikën Nr.2 në Drenas për ditën e parë.	Pjesëmarrës IHMK: 2
29 maj 2019 (e mërkurë)	Ndalja e mostrimit. Fillimi i mostrimit në pikën Nr.1 dhe pikën Nr.2 në Drenas për ditën e dytë.	Pjesëmarrës IHMK: 2
30 maj 2019 (e hënë)	Ndalja e mostrimi në pikat Nr.1 dhe Nr.2 në Drenas.	JET
3 qershor 2019 (e hënë)	Peshimi i filtrave përmes demonstrimit dhe TNP	Pjesëmarrës IHMK: 2

Për sa i përket mostrave nga Pika Nr. 2 nga 29 deri më 30 maj, përqendrimi i Ni (Nikelit) ka treguar 35ng/m^3 , që tejkalon vlerën udhëzuese në Japoni. Vlera udhëzuese e Japonisë për Ni është 25ng/m^3 si mesatare vjetore. Në BE, standardi mjedisor duke përdorur PM_{10} për Ni është 20ng/m^3 (mesatare vjetore).




Foto 3-26 Mostrimi shtesë i PM në ajër në Drenas

Tabela 3-93 Rezultati i përqendrimit të metaleve të rënda në TSP në Drenas (2019)

Lokacioni	Nr.1 Drenas	Nr.2 Drenas	Nr.1 Drenas	Nr.2 Drenas	Vlera Udhëzuese në Japoni (TSP, Mesatarja Vjetore)	Standardet mjedisore në BE (PM ₁₀ , Mesatarja vjetore)
Mostrimi (24 orë)	28/5/~ 29/5/2019	28/5~ 29/5/2019	29/5~ 30/5/2019	29/5~ 30/5/2019		
Lokacioni i mostrimit	1.2 km në jug të fabrikës	1.5 km në verilindje të fabrikës	1.2 km në jug të fabrikës	1.5 km në verilindje të fabrikës		
TSP (µg/m³)	28,2	93,2	30,1	78,3	-	-
Mn(ng/m³)	4.9	9,7	5,6	19,6	140	-
Ni(ng/m³)	2.9	14,8	3,5	35,0	25	20
As(ng/m³)	<0.15	0.6	0,2	0,7	6	6
Cd(ng/m³)	<0.06	0.43	0,05	0,41	-	5
Pb(µg/m³)	0.001	0,005	0,001	0,004	-	0,5
Zn(µg/m³)	0.008	0,090	0,009	0,105	-	-

Shënim: Celulat e hijezuara tejkalojnë vlerën udhëzuese në Japoni (mesatarja vjetore)

Si përgjigje ndaj rezultatit të përqendrimit të metaleve të rënda në TSP në Drenas, MMPHI/MMPH ka vendosur të vazhdojë me monitorimin e metaleve të rënda në PM në ajër si në Mitrovicë po ashtu edhe në Drenas.

2) Mostrimi i PM për monitorimin e metaleve të rënda në PM në ajër

Në BE mostrimi i PM për analiza të metaleve të rënda në ajër bëhet me përdorimin e mostruesit të ajrit me vëllim të ulët (këtu e tutje “Metoda e BE” ku grimcat e mbledhura janë PM₁₀), e në anën tjetër, mostrimi i PM në Japoni bëhet me përdorimin e mostruesit të ajrit me vëllim të lartë (këtu e tutje “Metoda Japoneze” ku grimcat e mbledhura janë TSP). Kosova që ka për qëllim të bëhet anëtare e BE-së synon ta adoptojë metodën e BE-së. Në periudhën e parë në maj dhe qershor të vitit 2018, metoda e BE-së e mostrimit dhe metoda japoneze e mostrimit janë kryer paralelisht dhe në mostruesin për metodën e BE-së (e quajtur “Tecora”, mostrues me vëllim të ulët) që e ka në posedim IHMK-ja janë gjetur problemet në vijim.

- Softueri është i vjetër dhe nuk mund të komunikojë me kompjuterin për shkak të sistemit të ndryshëm operativ.
- Të dhënat e mostrimit si vëllimi i thithjes totale, temperatura mesatare, shtypja mesatare, vëllimi i thithjes i konvertuar në 20 °C, 1 atm, etj., nuk mund të merren.
- Mostruesi ishte shumë i ndotur dhe gjatë mostrimit në periudhën e parë, në maj dhe qershor 2018, është vërejtur përqendrim i parregullt. (Ekziston mundësia se brendësia e mostruesit ishte kontaminuar)

Për këtë arsye mund të merren parasysh opsionet në vijim.

- a) Të blihet mostruesi i ri me vëllim të ulët i PM₁₀, dhe të kryhet mostrimi me metodën e BE-së.
- b) Problemet e Tecora-s të rregullohen dhe të zbatohet metoda e BE-së.
- c) Të përdoret metoda japoneze me mostrues me vëllim të lartë e prezantuar nga Projekti dhe të bëhet mostrimi në përputhje me metodën japoneze.
- d) Të bëhet kombinimi i metodës së BE-së dhe metodës japoneze.

Çështja është se cila alternativë të përzgjidhet. Tabela 3-94 paraqet karakteristikat e metodës japoneze dhe metodës së BE-së.

Tabela 3-94 Metoda japoneze dhe metoda e BE-së për mostrimin e PM në ajër (madhësia e grimcave dhe metoda)

Emërtimi i metodës	Emri i grimcave të mbledhura	Përkufizimi	Pajisja e mostrimit
Metoda japoneze	TSP (Grimcat totale të suspenduara)	Të gjitha grimcat e suspenduara në ajër	VL (Mostruesi i ajrit me vëllim të lartë: në të vërtetë deri në diametër 30 µm)
Metoda e BE-së	PM ₁₀ (Grimca 10)	Diametri 10µm ose më pak (zvogëlim i efikasitetit për 50%)	VU (Mostruesi i ajrit me vëllim të ulët) për PM ₁₀

Marrëdhënia përfshirës ndërmjet TSP dhe PM₁₀ është paraqitur në Fig.2.




Figura 3-22 Marrëdhënia përfshirëse ndërmjet TSP dhe PM₁₀

Mostruesi i ajrit me vëllim të lartë mbledh TSP, të cilat në të vërtetë janë PM me diametër deri në 30 µm dhe mostruesi me vëllim të ulët mbledh PM me diametër 10 µm ose më pak. Kur bëhet krahasimi i peshës së metaleve të rënda të përmbajtura në 1 m³ të ajrit në 20 ° C dhe 1 atm (µg /m³), sasia e metaleve të rënda në TSP është më e madhe se ajo në PM₁₀ bazuar në parimin e paraqitur në Figura 3-22. Marrëdhënia shprehet përmes këtij ekuacioni.

Sasia e metaleve të rënda në TSP (µg/m³) □ Sasia e metaleve të rënda në PM₁₀ (µg/m³)

Prandaj, kur bëhet mostrimi në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë, vlera e matur me metodën japoneze tregon gjithmonë vlerë më e madhe se ajo e matur me metodën e BE-së. Me fjalë të tjera, metoda japoneze gjithmonë vlerëson përqendrimin në anë më të sigurt sesa metoda e BE-së nga pikëpamja e ekspozimit të popullsisë ndaj metaleve të rënda.

Duke i marrë parasysh opsionet e përzgjedhjes së metodës së BE-së apo metodës japoneze b) Riparimi i mostruesit me vëllim të ulët nuk është i arsyeshëm meqenëse prodhuesi dhe agjenti nuk i janë përgjigjur kërkesës së IHMK-së në të kaluarën. a) Blerja e mostruesit të ri të ajrit me vëllim të ulët kërkon së paku një vit për shkak se duhet bërë alokimi i buxhetit nga MMPHI/MMPH dhe mund të ketë mangësi në buxhet. c) Pala kosovare nuk dëshiron që ta adoptojë metodën japoneze në baza të përhershme. Projekti rekomandon kryerjen e matjeve duke përdorur metodën japoneze që përdor mostruesin e ajrit me vëllim të lartë përkohësisht deri sa të blihet mostruesi i PM₁₀ për metodën e BE-së (Opsioni d). Mostruesi me vëllim të lartë mund të përdoret si rezervë pas blerjes së pajisjes me metodë të Be-së, pasi që vlerëson përqendrimin në anën më të sigurt.

3.5.2 Vlerësimi i Treguesve objektivisht të verifikueshëm në MDP

Treguesit objektivisht të verifikueshëm në MDP kanë “Matjet e NO_x, SO₂ dhe Hg për IDM-të,

siç kërkohet nga Direktiva e BE-së bazuar në metodat e referencës, kryhen të paktën dy herë gjatë zbatimit të Projektit”, “Bëhet shtjellimi i të tri PSO-ve për NO_x, SO₂ dhe Hg në gazin e oxhakut për IDM-të bazuar në metodat referente” dhe “Bëhet vlerësimi i rëndësisë së përmbajtjes së metaleve të rënda në PM në mjedis”.

Matjet e NO_x dhe SO₂ janë bërë tetë herë në IDM (TC Kosova A: gjashtë herë, TC Kosova B: dy herë) dhe një herë në fabrikën e Ferronikelit. Matja e merkurit total është bërë tetë herë në IDM njëjtë si matja e NO_x dhe SO₂. Matja e merkurit total nuk është bërë në fabrikën e Ferronikelit. Kushti për të bërë matje më shumë se dy herë është plotësuar.

Për analizë me JK janë përpiluar katër PSO. Një është për mostrimin e gazit për NO_x dhe një për mostrimin e gazit për SO₂, një për përgatitjen e tretjeve për analiza me JK dhe një për operimin e JK-së. Për analizë e merkurit janë përpiluar dy PSO. Një është për mostrimin e gazit dhe një për përgatitjen e tretjeve standarde dhe reagjentëve. Prandaj, për Metodën Standarde Referente janë përpiluar në total gjashtë PSO.

Treguesi Objektivisht i Verifikueshëm për monitorimin e metaleve të rënda është “Bëhet vlerësimi i rëndësisë së përmbajtjes së metaleve të rënda në PM në mjedis”. Në Mitrovicë dhe Drenas disa komponentë në PM të mostruar tejkalojnë vlerat udhëzuese të Japonisë. Kështu, u bë vlerësimi i përmbajtjes së metaleve të rënda në PM në ajër dhe MEMPHI/MMPH në takimin e tretë të KPK-së ka vendosur ta monitorojë PM në ajër.

Në këtë mënyrë janë arritur të gjithë Treguesit e Rezultatit 4.

3.5.3 Zhvillimi i kapaciteteve përmes aktiviteteve

Projekti ka pasur për qëllim zhvillimin e kapaciteteve për analiza laboratorike. H/L kanë mësuar dhe përvetësuar teknologjinë e operimit të JK përmes aktiviteteve të analizës së gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente. Për sa i përket analizave, është e rëndësishme që të përvetësohet teknologjia për analiza, por në të njëjtën kohë të mësohen teknikat e sakta të mostrimit në mënyrë që të garantohen rezultatet e analizës. H/L kanë mësuar procesin e një sërë aktiviteteve të cilat janë mostrimi, para-trajtimi dhe analiza për sa i përket analizës së gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente. Për më tepër, H/L kërkuan trajnim shtesë në mënyrë që ta thellojnë të kuptuarit e këtyre aktiviteteve, dhe H/L kanë përvetësuar teknologjinë dhe kanë përmirësuar kapacitetet. Nga tani e tutje, është e rëndësishme se si të përdoret kapaciteti i përvetësuar. E njëjta gjë mund të thuhet për përdorimin e teknologjisë së operimit të dhe analizës me ICP-MS.

Për sa i përket monitorimit të metaleve të rënda në ajër, Projekti siguroi mostruesin me vëllim të lartë, dhe pala kosovare ka përvetësuar teknologjinë për mostrimin e PM në ajër. Në të njëjtën kohë, Projekti ka zbuluar se mostruesi me vëllim të ulët i sjellë në IHMK nga Be-ja në të kaluarën nuk funksiononte si duhet. Analizat e metaleve të rënda u kryen në Japoni, por ICP-MS është ri-funksionalizuar përmes riparimit dhe rregullimit përmes Projektit, dhe tani është gati për analizën e metaleve të rënda. Për zbatimin e analizës është duke u pritur për trajnimin nga MCC/MFK.

Për sa i përket monitorimit të metaleve të rënda në PM në ajër, është e dëshirueshme që të

bëhet mostrimi dhe analiza një herë në muaj, për shkak se metalet e rënda në PM vlerësohen duke përdorur vlerën mesatare vjetore, por nevojitet që kjo të bëhet së paku katër herë në vit.

Në IHMK është vetëm një inxhinier i cili mund ta operon ICP-MS, prandaj është e nevojshme që të rritet numri i stafit së paku për një punonjës.

Për sa i përket mostrimit të PM, një opsion është që puna të kontraktohet jashtë tek sektori privat, pasi që puna e mostrimit të PM nuk është aq e vështirë.

3.6 Rezultati 5: Zhvillohen kapacitetet për modelimin e simulimit të cilësisë së ajrit.

3.6.1 Aktivitetet

Janë mbajtur seminare, ligjërata dhe trajnime-në-punë (TNP) në mënyrë që H/L ta zhvillojnë kapacitetin e tyre lidhur me modelimin e simulimit atmosferik. Simulimi i bazuar në inventarin e parë të emisioneve të zhvilluar nga grupi i inventarit të emisioneve në periudhën e dytë quhet “modeli i parë i simulimit” dhe ai i bazuar në inventarin e dytë të emisioneve quhet “modeli i dytë i simulimit”. Lista e aktiviteteve të mbajtura është paraqitur në Tabela 3-95. Këto aktivitete kanë përmirësuar aftësinë e tyre për ta ndërtuar modelimin e simulimit atmosferik. Lista e materialeve të përdorura është bashkëngjitur në Shtojcën -1.

Tabela 3-95 Seminaret, ligjëratat dhe TNP për modelimin e simulimit atmosferik

Periudha e parë		
Data	Përmbajtja	Pjesëmarrës
11/12/2017 (e hënë)	Plani i punës për Modelin e simulimit (Struktura e Zbërthimit të Punëve (SZP) për Aktivitetin 5), Hyrje për Modelin e simulimit Të dhënat e nevojshme meteorologjike dhe gjeografike	H/L: 5
20/12/2017 (e mërkure)	Disponueshmëria e të dhënave të nevojshme meteorologjike dhe gjeografike në Kosovë Caktimi i mbledhjes së secilës së dhënë ndërmjet anëtarëve të H/L	H/L: 3
14/5/2018 (e hënë)	Para-përpunuesi i të Dhënave të Lartësisë: Instalimi i programit, shkarkimi dhe aranzhimi i të dhënave hyrëse, ekzekutimi i programit, kontrolli i outputit	H/L: 4
17/5/2018 (e enjte)	Para-përpunuesi i të Dhënave të Lartësisë: Trajnimi shqyrtues Para-përpunuesi i të Dhënave të Përdorimit të Tokës: Instalimi i programit, shkarkimi dhe aranzhimi i të dhënave hyrëse, ekzekutimi i programit, kontrolli i outputit	H/L: 5
18/5/2018 (e premte)	Para-përpunuesi i të Dhënave të Lartësisë: Trajnimi shqyrtues Para-përpunuesi i të Dhënave të Përdorimit të Tokës: Trajnimi shqyrtues Para-përpunuesi i të Dhënave të Gjeografike: Ekzekutimi i programit, kontrolli i outputit	H/L: 4

21/5/2018 (ehënë)	Në përgjithësi: Trajnimi shqyrtues Vlerësimi i të dhënave të monitorimit të ajrit të mjedisit	H/L: 4
Periudha e dytë		
12/11 (e hënë) ~ 13/11 (e martë) 2018	Ligjëratat dhe trajnimi për përgatitjen e të dhënave të ajrit në shtresën e lartë dhe para-procesori i saj	H/L: 5
15 (e enjte) ~ 16 (e premte) nëntor 2018	Ligjëratat dhe trajnimi për përgatitjen e të dhënave të ajrit në sipërfaqe dhe para-procesori i saj	H/L: 5
21/11 (e mërkure), 23/11 (e premte), 30/11 (e premte) 2018	Ligjëratat dhe trajnim për modelin meteorologjik	H/L: 5
14 (e enjte) ~ 15 (e premte), 20 (e mërkurë) shkurt 2019	Llogaritja e emisioneve të burimeve pikore dhe para-procesori i saj (shpërndarja kohore dhe hapësinore) dhe përgatitja e dosjes hyrëse	H/L: 6
20 (e mërkure) ~ 22 (e premte), 25 (e hënë) shkurt 2019	Trajnimi për zbatimin e programit kryesor (Main) të modelit të dispersionit të ajrit	H/L: 6
24 (e premte) 29 (e mërkurë) maj, 6 (e enjte) ~ 7 (e premte) qershor 2019	Llogaritja e emisioneve të burimeve të zonës dhe para-procesori i saj	H/L: 6
10 (e hënë) 13 (e enjte) ~ 14 (e premte) qershor 2019	TNP për zbatimin e modelit të dispersionit të ajrit duke përdorur emisionet e burimeve të zonës	H/L: 6
Periudha e tretë		
7/11/2019 (e enjte)	Trajnimi për kontrollin e të dhënave të SMCA-ve	H/L: 5
19/11/2019 (e martë)	Trajnimi për modelimin e simulimit (sektori i Mbeturinave)	H/L: 1
21/11/2019 (e enjte)	Trajnimi për modelimin e simulimit (sektori i Mbeturinave)	H/L: 6
12/2/2020 (e mërkure)	Krijimi i të dhënave të emisioneve të burimit të linjës nga Automjetet duke i përdorur të dhënat GIS, Trajnimi për llogaritjen e modelit të simulimit	H/L: 3
19/2/2020 (e mërkure)	Krijimi i të dhënave të emisioneve të burimit të linjës nga Automjetet duke i përdorur të dhënat GIS, Trajnimi për llogaritjen e modelit të simulimit	H/L: 3
26/2/2020 (e mërkure)	Krijimi i të dhënave të emisioneve të burimit të linjës nga Automjetet duke i përdorur të dhënat GIS, Trajnimi për llogaritjen e modelit të simulimit, Vizualizimi i rezultatit të simulimit	H/L: 3
3/3/2020 (e enjte)	Seminari i përgjithshëm për modelimin e simulimit për anëtarët e grupeve të tjera punuese	H/L: 3
Aktivitetet shtesë në periudhën e tretë		
18/11/2020 (e mërkure)	Diskutimi për krijimin e kornizës për zbatimin e simulimit	H/L: 8

25/11/2020 (e mërkure)	Diskutimi për krijimin e kornizës për zbatimin e simulimit	H/L: 6
30/11/2020 (e hënë)	Analiza e cilësisë së ajrit gjatë karantinës në Kosovë Ligjëratat për rezultatet e analizës së cilësisë së ajrit gjatë karantinës	H/L: 4
2/12/2020 (e mërkure)	Llogaritja e Masave për Amvisëri të cilat kalojnë në Ngrohje me Energji Elektrike	H/L: 7
16/12/2020 (e mërkure)	Llogaritja e Masave për Amvisëri të cilat kalojnë në Ngrohje me Energji Elektrike	H/L: 6
13/1/2021 (e mërkure)	Konfirmimi i Progresit të Aktiviteteve Shtesë nga Distanca	H/L: 6
20/1/2021 (e mërkure)	Llogaritja e Masave për Amvisëri të cilat kalojnë në Ngrohje me Energji Elektrike	H/L: 5
27/1/2021 (e mërkure)	Ushtrimi për përgatitjen e Hartës së Përqendrimit	H/L: 2
4/2/2021 (e enjte)	Llogaritja e Masave për Amvisëri të cilat kalojnë në Ngrohje me LPG	H/L: 4
10/2/2021 (e mërkure)	Llogaritja e Masave për Amvisëri të cilat kalojnë në Ngrohje me LPG	H/L: 5
12/2/2021 (e mërkure)	Llogaritja e Masave për Rregulloren me Numër të Regjistrimit të Automjetit	H/L: 4
22/2/2021 (e hënë)	Llogaritja e Masave për Rregulloren me Numër të Regjistrimit të Automjetit	H/L: 4
3/3/2021 (e mërkure)	Përgatitja për seminarin përmbledhës për Grupin e modelimit të simulimit	H/L: 5
9/3/2021 (e martë)	Përgatitja për seminarin përmbledhës për Grupin e modelimit të simulimit	H/L: 5
18/3/2021 (e enjte)	Përgatitja për seminarin përmbledhës për Grupin e modelimit të simulimit	H/L: 5
24/3/2021 (e mërkure)	Seminari Përmbledhës me ZQ të JICA-s - Arritjet e Grupit të modelimit të simulimit	H/L: 5. ZQ e JICA-s, Zyra e JICA-s për Ballkanin
8/4/2021 (e enjte)	Modelimi i simulimit për fabrikën e blloqeve	H/L: 5
21/4/2021 (e mërkure)	<u>Diskutimi për Raportin Përfundimtar</u>	H/L: 3

(1) Mbledhja e të dhënave hyrëse (Aktiviteti 5-2)

Janë mbledhur të dhënat e nevojshme për krijimin e modelit të simulimit të dispersionit atmosferik. Progresi i mbledhjes së të dhënave ishte siç vijon. Përmbledhja e të dhënave të siguruara është paraqitur në Tabela 3-97.

1) Të dhënat meteorologjike

Të dhënat e monitorimit për orë në stacionin automatik të IHMK-së janë përdorur si të dhëna meteorologjike në nivel të tokës në zonën e synuar. Figura 3-23 tregon trëndafilin e erës për periudhën e synuar të modelimit të simulimit të dytë, që është për një vit nga 19 janari 2018 deri më 18 janar 2019. Të dhënat e matjes manual të

IHMK-së dhe të dhënat e matjes në aeroport (të shkarkuara nga baza publike e të dhënave) nuk janë përdorur për shkak të mungesës së shumë të dhënave. Përmes diskutimeve me personelin e aeroportit që bën matjet meteorologjike është konfirmuar se të dhënat e ajrit në shtresën e lartë nuk maten në Kosovë. Janë përdorur të dhënat nga një shtet fqinj si pika më e afërt ndër pikat në dispozicion të të dhënave, duke supozuar se ndodhen në të njëjtin sistem meteorologjik për shkak të afërsisë si shtet fqinj.




Figura 3-23 Grafiku i trëndafilit të erës për periudhën e synuar (19.1.2018 ~ 18.1.2019)

2) Mbledhja e të dhënave të monitorimit të cilësisë së ajrit

Për vlerësimin e vlefshmërisë së rezultateve të simulimit janë përdorur të dhënat e monitorimit për një vit nga janari i vitit 2018 në SMCA në zonën e synuar. Të dhënat e matjes janë siguruar nga IHMK-ja pastaj janë organizuar dhe vlerësuar. Rezultatet e vërtetimit të vlefshmërisë së të dhënave të matura të cilësisë së ajrit janë paraqitur në Tabela 3-96. Kontrolli i të dhënave është bërë përmes procedurës në vijim.

Hapi 1: Të përjashtohen vlerat të cilat mungojnë ose vlerat që qartas janë të parregullta, siç janë vlerat që duket se janë matur gjatë procesit të kalibrimit ose punës së mirëmbajtjes, vlerat konsektive zero ose vlerat negative.

Hapi 2: Të bëhet krahasimi i vlerave të përqendrimit ndërmjet pesë stacioneve në Zonën e Prishtinës dhe përjashtohen pjesët të cilat nuk janë të besueshme bazuar në modelet e variacionit kohor, renditjen e vlerave absolute dhe karakteristikat e secilit ndotës.

Hapi 3: Të përzgjidhen të dhënat për vërtetimin e vlefshmërisë së simulimit, nëse të dhënat e mbetura për orë pas shqyrtimit të mësipërm të detajuar janë më shumë se 60% të numrit total të orëve të mbuluara nga simulimi.

Të dhënat për PM₁₀ dhe PM_{2.5} në periudhën e synuar të modelit të simulimit të dytë, që është prej janarit të vitit 2018 deri në janar të vitit 2019, kanë qenë relativisht të besueshme. Vetëm në stacioni Palaj, të dhënat e vlefshme nuk e kanë arritur 60%. Në

anën tjetër, kishte dallim të madh ndërmjet stacioneve në të dhënat e monitorimit të SO₂, dhe ka pasur shprehje të jashtëzakonshme në seritë kohore. Për shkak të saktësisë së dyshimtë, të dhënat e SO₂ nuk janë përdorur për vërtetimin e vlefshmërisë së rezultateve të modelit të simulimit.

Tabela 3-96 Vërtetimi i Vlefshmërisë së të Dhënave të Monitorimit të Cilësisë së Ajrit

PM ₁₀ µg/m ³	Vlera e vëzhguar	Numërimi i të dhënave	Të dhëna të vlefshme (%)
Rilindja	32.4	8430	96,2%
IHMK	40.9	8735	99,7%
Palaj	21.2	4709	53,8%
Obiliqi	38.1	7245	82,7%
Dardhishtë	33.1	6597	75,3%

PM ₂ µg/m ³	Vlera e vëzhguar	Numërimi i të dhënave	Vlera e vëzhguar
Rilindja	—	—	—
IHMK	—	—	—
Palaj	15.9	5800	66,2%
Obiliqi	64.3	8098	92,4%
Dardhishtë	—	—	—

NO _x µg/m ³	Vlera e vëzhguar	Numërimi i të dhënave	Vlera e vëzhguar
Rilindja	—	—	—
IHMK	32.0	2694	30,8%
Palaj	16.1	8519	97,2%
Obiliqi	30.0	8491	96,9%
Dardhishtë	27.1	8299	94,7%

NO ₂ µg/m ³	Vlera e vëzhguar	Numërimi i të dhënave	Vlera e vëzhguar
Rilindja	39.5	8312	94,9%
IHMK	28.5	5182	59,2%
Palaj	9.8	6279	71,7%
Obiliqi	17.8	8615	98,3%
Dardhishtë	17.6	8307	94,8%

3) Të dhënat e Lartësisë mbidetare dhe Përdorimit të tokës

Informacioni për shpërndarjen e popullsisë, rrjetin rrugor dhe përdorimin e tokës të nevojshme për shpërndarjen hapësinore të emisioneve është siguruar nga stafi i MMPHI/MMPH i cili punon me GIS, i cili iu bashkua anëtarëve të grupit të H/L në vitin 2018.

Tabela 3-97 paraqet të dhënat e mbledhura.

Tabela 3-97 Të dhënat e Mbledhura për Modelimin e Simulimit

Pikat e nevojshme			Modelimi i Simulimit i fazës së parë	Modelimi i Simulimit i fazës së dytë
Të dhënat meteorologjike të sipërfaqes	Shpejtësia e erës	për orë	- Një muaj (19.01.2018 - 18.02.2018) Të dhënat e stacionit automatik të motit të IHMK-së - Të dhëna për orë - Duke filluar nga 01.2018 (aktualisht në punë) - Nuk ka mbulim të Reve, Lartësi të Kufirit të sipërm Baza e Integruar e të Dhënave për Sipërfaqen (ISD) - Nuk ka mbulim të Reve, Shtypje, Reshje	- Një vit (19.01.2018 - 18.01.2019)
	Drejtimi i erës	për orë		
	Temperatura	për orë		
	Mbulesa e reve	për orë		
	Lartësia e tavanit	për orë		
	Shtypja e sipërfaqes	për orë		
	Lagështia relative	për orë		
	Shkalla e reshjeve	për orë		
	Kodi i llojit të reshjes	për orë		
Të dhënat e ajrit në shtresën e lartë	Shpejtësia e erës	së paku dy herë në ditë	- Një muaj (19.01.2018 - 18.02.2018)	- Një vit (19.01.2018 - 18.01.2019)
	Drejtimi i erës	së paku dy herë në ditë		
	Temperatura	së paku dy herë në ditë		
	Presioni	së paku dy herë në ditë		
Të dhënat Gjeografike	Lartësia		GMTED2010 - të dhënat në dispozicion	
	Kategoritë e përdorimit të tokës		Karakterizimi i Mbulimit Global të Tokës (GLCC) - të dhënat në dispozicion	
Të Dhënat e Monitorimit të Cilësisë së Ajrit në Mjedis	NO _x	për orë	Të dhënat e monitorimit të IHMK - Të dhëna për orë	
	SO ₂	për orë		
	PM ₁₀	për orë		
	PM _{2.5}	për orë		
	CO	Për orë		
Shpërndarja kohore dhe hapësinore e Burimeve të Emisioneve	Amvisëritë		Të shpërndara në secilin rrjet si burim i zonës në përputhje me shpërndarjen e popullsisë së secilës komunë	Shpërndarja e emisioneve është modifikuar, duke supozuar se shumica e amvisërive në zonën ku ka ngrohje qendrore nga Termokosi nuk përdorin lëndë djegëse për ngrohje në shtëpitë e tyre.
	Automjetet		Të shpërndara në secilin rrjet si burim i zonës në përputhje me gjatësinë totale të rrugës në secilin rrjet	Emisionet nga secili segment i rrugës janë llogaritur dhe shpërndarë si burim i linjës për rrugë kryesore të cilat janë studiuar përmes numërimit të trafikut në këtë Projekt. Emisionet nga rrugët e tjera janë shpërndarë si burim i zonës për secilin rrjet.

(2) Llogaritja e modelit të simulimit

Rrjedha e llogaritjes së programeve të simulimit është paraqitur në Figura 3-24.

Pas shqyrtimit dhe rishikimit të programeve të ekzekutuara në periudhën e parë dhe të dytë, është bërë trajnimi për përgatitjen e të dhënave për burime të ndryshme të emisioneve, ekzekutimi i programit të llogaritjes së simulimit dhe përpilimi i hartave të përqendrimit duke përdorur GIS-in.






Figura 3-24 Rrjedha e llogaritjes së programeve të modelit të simulimit





Foto 3-27 Trajnimi për modelimin e simulimit



Pasi që inventari i dytë i emisioneve është finalizuar në mars të vitit 2020, llogaritjet e simulimit të dytë janë bërë duke shfrytëzuar këtë inventar. Rezultatet e krahasimit ndërmjet vlerave të llogaritura dhe vlerave të vëzhguara në SMCA janë paraqitur në Tabela 3-98, dhe harta e përqendrimit e rezultateve të llogaritura përbrenda periudhës së synuar të modelit të simulimit të dytë (një vit duke filluar nga 19 janari i vitit 2018) është paraqitur në Figura 3-25.



Vlera kufitare për shëndetin e njeriut
Mesatarja ditore: $50\mu\text{g}/\text{m}^3$, < 35 herë/vit
Mesatarja vjetore: $40\mu\text{g}/\text{m}^3$



Vlera kufitare për shëndetin e njeriut
Vlera për orë: $200\mu\text{g}/\text{m}^3$, < 18 herë/vit
Mesatarja vjetore: $40\mu\text{g}/\text{m}^3$



Vlera kufitare për shëndetin e njeriut
Vlera për orë: $350\mu\text{g}/\text{m}^3$, 24 herë ose më pak
Mesatarja ditore: $125\mu\text{g}/\text{m}^3$, 3 ditë ose më pak
për vit

Figura 3-25 Harta e përqendrimit e llogaritur me modelin e Simulimit
(duke përfshirë emisionet nga termocentralet, automjetet, amvisëritë, bizneset e vogla,
pluhurin Fugitiv nga mihja e thëngjillit dhe deponia e thëngjillit)

Vlera kufitare për shëndetin e njeriut²⁶

²⁶ DIREKTIVA 2008/50/EC E PARLAMENTIT DHE KËSHILLIT EVROPIAN e datës 21 maj 2008 për cilësinë e ajrit të

Më poshtë gjeni përmbledhjen e rezultateve aktuale të llogaritjes.

1) Rezultatet

- Përqendrimi i shumicës së ndotësve në stacione janë nënvlerësuar në modelet e simulimit në krahasim me vlerat aktualisht të vëzhguara në SMCA, dhe modelet e simulimit dhe inventarët e emisioneve duhet të përmirësohen.
- Burimet më të mëdha të emisioneve të ndotësve të ajrit në Zonën e Prishtinës janë termocentralet me djegie të thëngjillit. Mirëpo, kontribuuesit më të mëdhenj në nivel të tokës për PM janë burimet e emisioneve nga amvisëritë siç është ngrohja, dhe automjetet kontribuojnë mjaft shumë lidhur me NO_x.
- Duhet të theksohet se rezultatet e mësipërme ende janë në fazën e provës.

2) Çështjet

- Për ta ndërtuar modelin e simulimit, është e nevojshme që të krahasohen të dhënat e vëzhguara dhe të dhënat e llogaritura në mënyrë që të bëhet vlerësimi i vlefshmërisë së rezultateve të llogaritjes. Mirëpo, siç është paraqitur në 3-6-1(1) 2), të dhënat e vëzhguara nga monitorimi për periudhën e synuar u zbulua të jenë të dyshimta. Për ta vërtetuar vlefshmërinë e modelimit të simulimit është e nevojshme besueshmëria e të dhënave të monitorimit.
- Pasi që në Kosovë nuk janë gjetur të dhënat e ajrit në shtresën e lartë, janë përdorur të dhënat e vëzhguara nga shteti fqinj.
- Modeli i simulimit mund të përmirësohet duke përcaktuar modele kohore më të sakta
- Për sa i përket PM₁₀, Grimcat sekondare nuk janë marrë parasysh.

Tabela 3-98 Krahasimi ndërmjet vlerave të vëzhguara dhe vlerave të llogaritura
(Periudha e synuar e modelit të dytë simulimit, 19/1/2018 - 18/1/2019)

PM ₁₀ µg/m ³	Termoce ntrali	Transporti	Amvisëritë	Bizneset e Vogla	Pluhuri Fugitiv	Mbeturinat	Vlera e llogaritur	Vlera e vëzhguar
Rilindja	1.0	8,0	36,7	2,8	0,4	0,000	48,9	32,4
IHMK	1.1	2,9	23,5	1,5	0,9	0,000	29,9	40,9
Palaj	1.3	0,4	6,7	0,5	8,6	0,002	17,5	-
Obiliqi	2.1	0,7	11,6	1,1	4,3	0,001	19,9	38,1
Dardhishtë	1.8	0,7	13,6	1,0	8,5	0,003	25,6	33,1

NO _x µg/m ³	Termoce ntrali	Transporti	Amvisëritë	Bizneset e Vogla	Pluhuri Fugitiv	Mbeturinat	Vlera e llogaritur	Vlera e vëzhguar
Rilindja	2.6	125,2	2,8	6,7	0,0	0,001	137,3	-
IHMK	3.0	51,9	1,8	3,4	0,0	0,003	60,2	32,0
Palaj	3.5	6,6	0,8	1,2	0,0	0,040	12,2	16,1

mjedisit dhe ajër më të pastër për Evropën

Obiliq	6.5	12,0	1,5	2,7	0,0	0,029	22,7	30,0
Dardhishtë	5.2	11,6	1,5	2,3	0,0	0,071	20,6	27,1

SO ₂ µg/m ³	Termoenergjia Centrale	Transporti	Amvisëritë	Bizneset e Vogla	Pluhuri Fugitiv	Mbeturinat	Vlera e llogaritur	Vlera e vëzhguar
Rilindja	4.5	0,2	3,1	1,9	0,0	0,000	9,7	—
IHKM	5.2	0,0	2,5	1,0	0,0	0,001	8,6	—
Palaj	5.8	0,0	4,4	0,4	0,0	0,007	10,6	15,95
Obiliq	9.9	0,0	8,4	0,8	0,0	0,005	19,0	—
Dardhishtë	8.3	0,0	6,6	0,7	0,0	0,012	15,6	—

(3) Aktivitetet shtesë në periudhën e tretë

• **Analiza e cilësisë së ajrit gjatë karantinës**

Si aktivitete shtesë në periudhën e tretë, u kryen analiza e të dhënave të cilësisë së ajrit pasi besueshmëria e të dhënave është përmirësuar për shkak të rehabilitimit të analizatorëve dhe instrumenteve meteorologjike dhe krijimit të rrjetit të komunikimit të të dhënave.

Projekti ka analizuar cilësinë e ajrit gjatë periudhës së karantinës për shkak të COVID-19 (Mars deri në Prill 2020) bazuar në të dhënat e siguruar për këtë periudhë. Detajet janë paraqitur në Shtojcën-1, Periudha e Tretë, Të tjera (9) "3) -1 Analiza e Cilësisë së Ajrit gjatë karantinës". NO_x u zvogëlua dukshëm për shkak të zvogëlimit të vëllimit të trafikut gjatë karantinës. Mirëpo, SO_x nuk ka ndryshuar, dhe PM nuk ka ndryshuar pasi që sezoni i ngrohjes tashmë ka kaluar.

• **Mbështetja për analizën dhe vlerësimin e të dhënave të cilësisë së ajrit gjatë një viti**

Të dhëna të sakta të cilësisë së ajrit gjatë një viti (katër sezone) janë në dispozicion për shkak të përfundimit të rehabilitimit të analizatorëve në të gjitha SMCA-të në Kosovë në nëntor të vitit 2019 si dhe zgjatjes së periudhës së Projektit. Prandaj, Projekti ndihmoi në analizën nga pala kosovare të të dhënave dhe vlerësimin e gjendjes së cilësisë së ajrit për një vit.

Tabela 3-99 tregon orët e vlefshme të të dhënave të monitorimit të cilësisë së ajrit dhe mbulimin kohor në vitin 2020 për secilin SMCA. Për sa i përket PM₁₀, PM_{2.5} dhe NO₂, pothuajse të gjitha SMCA-të mbulojnë më shumë se 8,000 orë të të dhënave të vlefshme për cilësinë e ajrit dhe mbulimi kohor është më i lartë se 90%. Që nga përfundimi i rehabilitimit të analizatorëve në nëntor të vitit 2019, është gjetur se O dhe M për analizatorë është kryer në mënyrë të duhur.

Tabela 3-99 Orët e vlefshme të të dhënave të monitorimit të cilësisë së ajrit dhe mbulimi kohor në vitin 2020 për secilin SMCA

Lokacioni i SMCA	PM ₁₀		PM _{2.5}		NO ₂		O ₃		SO ₂		CO	
	Orët e vlefshme	Mbulimi kohor (%)	Orët e vlefshme	Mbulimi kohor (%)	Orët e vlefshme	Mbulimi kohor (%)	Orët e vlefshme	Mbulimi kohor (%)	Orët e vlefshme	Mbulimi kohor (%)	Orët e vlefshme	Mbulimi kohor (%)
Brezovica	7717	87,85	7709	87,76	6675	75,99	6923	78,81	6449	73,42	5827	66,34
Dardhishtë	8037	91,50	8124	92,49	8043	91,56	7761	88,35	8034	91,46	7744	88,16
Drenasi	8313	94,64	8312	94,63	8002	91,10	8162	92,92	7322	83,36	7122	81,08
Gjilani	7855	89,42	7855	89,42	7217	82,16	7324	83,38	6565	74,74	5585	63,58
Hani i Elezit	7945	90,45	7945	90,45	7335	83,50	7277	82,84	7615	86,69	5483	62,42
Mitrovicë	8336	94,90	8336	94,90	7831	89,15	7415	84,41	7976	90,80	6812	77,55
Obiliq	8590	97,79	8590	97,79	8184	93,17	7872	89,62	8172	93,03	8059	91,75
Palaj	8582	97,70	8582	97,70	8247	93,89	8176	93,08	8235	93,75	7194	81,90
Peja	8697	99,01	8697	99,01	8169	93,00	8138	92,65	7300	83,11	7859	89,47
Prishtina, IHMK	8525	97,05	8525	97,05	8287	94,34	8158	92,87	8181	93,14	8248	93,90
Prishtina, Rilindja	8573	97,60	8573	97,60	7970	90,73	8067	91,84	8230	93,69	8146	92,74
Prizreni	8660	98,59	8660	98,59	8022	91,33	8154	92,83	8120	92,44	6062	69,01
Mobil	1071	12,19	1071	12,19	909	10,35	2342	26,66	2475	28,18	2440	27,78


Orët e tejkalimit të vlerës kufitare ditore të PM₁₀ në vitin 2020 janë nga 48 orë në Han të Elezit deri në 117 orë në Gjilan, duke përjashtuar ato në Brezovicë që është SMCA me prapavijë rurale e vendosur në një vend të izoluar. Në rastin e NO₂, O₃ dhe SO₂, nuk është gjetur pothuajse asnjë tejkalim i vlerave kufitare.

Trendi i të dhënave mujore në vitin 2020 është paraqitur në Figura 3-26.

PM₁₀ dhe PM_{2.5} janë më të lartat në janar dhe të dytat më të larta në nëntor. Në sezonin e verës, ato janë shumë të ulëta. Vlera mesatare e PM është e lartë në Gjilan dhe Pejë.

NO₂ është më i larti në janar dhe relativisht i ulët nga prilli deri në shtator. NO₂ më i lartë vërehet në Prishtinë, Rilindje.

O₃ është më i larti në prill dhe më i ulëti në nëntor. O₃ është shumë i lartë në Brezovicë i cili është SMCA me prapavijë rurale, pasi ka shumë pak ndikim të NO_x nga automjetet dhe burimet e palëvizshme.






Figura 3-26 Trendi mujor i të dhënave të cilësisë së ajrit (2020)

Figura 3-27 tregon tendencën e kohës së ditës së PM_{2.5} për stinët e vitit. Në shumicën e ASMCA-ve, PM_{2.5} është i lartë në vjeshtë dhe dimër. Gjatë një dite, PM_{2.5} është i ulët nga 15:00 deri në 16:00 dhe i lartë nga 20:00 deri në 22:00. Në Brezovicë, PM_{2.5} është pak i lartë në verë, por nuk varet nga koha e ditës gjatë gjithë vitit.




Figura 3-27 Trendi i kohës së ditës së PM_{2.5} për stinët e vitit (2020)

• **Korniza institucionale për Modelim të Simulimit**

Për ta bërë aktivitetin e modelimit të simulimit të qëndrueshëm pas këtij projekti, është e nevojshme që të përgatiten elementet si në vijim.

- Sqarimi i hapave të nevojshëm të përfshirë në modelimin e simulimit
- Pajtimi për rolet dhe përgjegjësitë e organizatave të ndërlidhura
- Përcaktimi si detyrë qeveritare

Grupi i modelimit të simulimit bëri një listë të hapave të nevojshëm për modelimin e simulimit, pastaj diskutuan për rolet dhe përgjegjësitë për secilin hap me IHMK-në, AMMK-në dhe DMMU-në.

Rolet dhe përgjegjësitë e pajtuara ndërmjet tri institucioneve janë paraqitur në Tabela 3-100.

Tabela 3-100 Rolet dhe përgjegjësia për modelimin e simulimit

Aktiviteti			Përshkrimi	Organizatrat Përgjegjëse
Mbledhja e të Dhënave; Të Dhënat e Monitorimit të Cilësisë së Ajrit	NO _x	për orë	Të dhënat e monitorimit të IHMK - Të dhëna për orë	IHMK/Sektori i Monitorimit të Ajrit
	SO ₂	për orë		
	PM ₁₀	për orë		
	PM _{2.5}	për orë		
	CO	për orë		
Mbledhja e të Dhënave; Të dhënat meteorologjike të sipërfaqes	Shpejtësia e erës	për orë	- Viti i synuar Të dhënat e stacionit automatik të motit në IHMK - Të dhënat për orë - Ka filluar më 01.2018 (ende punon) - Nuk ka mbulim të Reve, lartësi të tavanit Baza e Integruar e të Dhënave për Sipërfaqen (ISD) - Nuk ekziston mbulimi i Reve, Presioni, Reshjet	IHMK/ sektori i meteorologjisë
	Drejtimi i erës	për orë		
	Temperatura	për orë		
	Mbulesa e reve	për orë		
	Lartësia e tavanit	për orë		
	Shtypja e sipërfaqes	për orë		
	Lagështia relative	për orë		
	Shkalla e reshjeve	për orë		
Kodi i llojit të reshjes	për orë			
Mbledhja e të dhënave; Të dhënat e ajrit në shtresën e lartë	Shpejtësia e erës	së paku dy herë në ditë	- Viti i synuar Baza e të dhënave të radio-sondës NOAA/ESRL - Nuk ka të dhëna në Kosovë	IHMK/ sektori i meteorologjisë
	Drejtimi i erës	së paku dy herë në ditë		
	Temperatura	së paku dy herë në ditë		
	Shtypja	së paku dy herë në ditë		
	Lartësia	së paku dy herë në ditë		
Mbledhja e të Dhënave; Të Dhënat Gjeografike	Lartësia		GMTED2010 - Ofruesi: Topografia Gjeologjike e SHBA-ve (USGS) dhe Agjencia Kombëtare e Inteligjencës Gjeo-hapësinore (NGA) - Rezolucioni: 30, 15, 7.5 arc-sekondë - Formati: GEOTIFF - Sistemi Koordinativ Gjeografik WGS84	AMMK/Drejtorja për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit/Sektori i GIS (Të dhënat në rrjet janë nga Instituti për Planifikimi Hapësinor)
	Kategoritë e përdorimit të tokës		Karakterizimi i Mbulimit Global të Tokës (GLCC) - Ofruesi; Topografia Gjeologjike e SHBA (USGS) - Rezolucioni: 30 arc-sekondë (~1 km) - Data e të Dhënave 1997 (Versioni 1), 1999 (Versioni 2)	AMMK/Drejtorja për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit/Sektori i GIS (Të dhënat në rrjet janë nga Instituti për Planifikimi Hapësinor)
Mbledhja e të Dhënave;	Inventari i Emisioneve			Drejtorja për Vlerësimin e Gjendjes Mjedisore/Grupi i

Të dhënat e emisioneve				Inventarit të Emisioneve
Mbledhja e të Dhënave; Shpërndarja kohore dhe hapësimore e Burimeve të Emisioneve	Termocentrali		<ul style="list-style-type: none"> - Shpërndarja hapësimore: Koordinatat e oxhakut, lartësia e oxhakut, shpejtësia e gazit, etj. - Shpërndarja kohore: Konstante 	Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes Mjedisore/Grupi i Inventarit të Emisioneve
	Amvisëritë		<ul style="list-style-type: none"> - Shpërndarja hapësimore: Të shpërndara në secilin rrjet si burim i zonës në përputhje me shpërndarjen e popullsisë së secilës komunë - Shpërndarja kohore: Konstante 	Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes Mjedisore/Grupi i Inventarit të Emisioneve
	Automjetet		<ul style="list-style-type: none"> - Shpërndarja hapësimore: Emisionet nga secili segment i rrugës janë llogaritur dhe shpërndarë si burim i linjës për rrugë kryesore të cilat janë studiuar përmes numërimit të trafikut në këtë Projekt. Emisionet nga rrugët dytësore janë shpërndarë si burim i zonës për secilin rrjet. - Shpërndarja kohore: Ndryshimi në 24 orë nga hulumtimi i vëllimit të trafikut 	Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes Mjedisore/Grupi i Inventarit të Emisioneve
Përgatitja e të dhënave hyrëse për modelimin e simulimit nga të dhënat e mbledhura	Të Dhënat Monitorimit të Cilësisë së Ajrit		<ul style="list-style-type: none"> - Vërtetimi i vlefshmërisë së të dhënave të MCA-së: Kontrolli i numrit të të dhënave që mungojnë, të dhënat e parregullta, etj. - Llogaritja e përqendrimit mesatar në periudhën e synuar 	IHMK/Spektori i Monitorimit të Ajrit
	Të dhënat meteorologjike		<ul style="list-style-type: none"> - Vërtetimi i vlefshmërisë së të dhënave meteorologjike: Kontrolli i numrit të të dhënave që mungojnë, të dhënat e parregullta, etj. - Konvertimi i të dhënave origjinale: Programet READ62, SMERGE 	IHMK/Spektori i Monitorimit të Ajrit
	Të Dhënat Gjeografike		<ul style="list-style-type: none"> - Konvertimi i të dhënave origjinale: Programet TERREL, CTGPROC, MAKEGEO 	IHMK/Spektori i Monitorimit të Ajrit
	Të dhënat e emisioneve		<ul style="list-style-type: none"> - Konvertimi i të dhënave origjinale: Dosjet Excel në dosje CALPUFF.INP 	IHMK/Spektori i Monitorimit të Ajrit
Modelimin e Simulimit	Llogaritja e modelimit të simulimit		<ul style="list-style-type: none"> - Vërtetimi i vlefshmërisë së të dhënave të MCA - Kontrolli i numrit të të dhënave që mungojnë, të dhënat e parregullta, etj. - Llogaritja e përqendrimit mesatar të periudhës së synuar 	IHMK
	Vërtetimi i vlefshmërisë së rezultatit		<ul style="list-style-type: none"> - Vërtetimi i vlefshmërisë së të dhënave meteorologjike: Kontrolli i numrit të të dhënave që mungojnë, të dhënat e parregullta, etj. - Konvertimi i të dhënave origjinale: Programet READ62, SMERGE 	IHMK
	Përgatitja e Hartës së Përqendrimit		<ul style="list-style-type: none"> - Vizualizimi i rezultatit të llogaritjes duke përdorur GIS-in 	IHMK
Shfrytëzimi për politik-bërje dhe komunikim me publikun	Politik-bërja		<ul style="list-style-type: none"> - Përpilimi i Masave - Vlerësimi i efektit të masave në procesin e përpilimit të Strategjisë/Planit të Veprimit për Cilësi të Ajrit 	DMMU

			- Vendimi për Politika	
	Komunikimi me Publikun		-	Varësisht nga Qëllimi (nën udhëzimin e Zyrës për komunikim me publikun)
	Bashkëpunimi me akademinë		- Kontrolli i cilësisë së modelit të simulimit	IHMK

1) Modelimi i Simulimit për vlerësimin e efektit të masave

Për t'i vlerësuar masat shitesë, grupi i modelimit të simulimit ka kryer llogaritjen duke përdorur modelimin e simulimit. Pala kosovare ka kryer llogaritjen duke përdorur Kompjuterin për simulim në Kosovë, dhe JET-i ka mbështetur operimin e tyre nga distanca (në mënyrë virtuale). Përmes këtyre trajnimeve, pala kosovare ka përmirësuar aftësinë e tyre për ta kryer llogaritjen e simulimit në mënyrë të pavarur. Rezultati do të tregohet në fletën e vlerësimit të përshkruar në Rezultatin 8.

3.6.2 Vlerësimi i Treguesve objektivisht të verifikueshëm në MDP

Treguesit e përcaktuar në MDP për ta verifikuar arritjen e Rezultatit 5 janë “5.1 Bëhet shtjellimi i modelit të simulimit të dispersionit për vitin aktual” dhe “5.2 Modeli i simulimit zbatohet të paktën dy herë bazuar në inventarin aktual të emisioneve”.

Treguesit e MDP-së për Rezultatin 5 janë arritur, pasi që modeli i simulimit është zbatuar për vitin 2018 duke përdorur inventarin e dytë të emisioneve të përgatitur në Rezultatin 1, siç është përshkruar në 3-6-1.

3.6.3 Zhvillimi i kapaciteteve përmes aktiviteteve

H/L kanë mësuar qëllimin e modelit të simulimit, si të operojnë me programin dhe si t'i analizojnë kushtet e ndotjes së ajrit duke krijuar harta të shpërndarjes së përqendrimit me përdorimin e GIS. H/L kanë mësuar se si t'i ekzekutojnë programet jo vetëm përmes ligjëratave por duke operuar vetë me program në Kompjuter përmes një sërë ushtrimesh praktike.

Përveç kësaj, ligjëratat për përpilimin e inventarit të emisioneve, i cili është i lidhur ngushtë me ndërtimin e modelit të simulimit, u bënë bashkë me grupin e punës të simulimit, dhe kjo ka siguruar të kuptuarit më të mirë të marrëdhënies ndërmjet inventarëve të emisioneve dhe modeleve të simulimit, si dhe njohuritë themelore të nevojshme për ta analizuar situatën e ndotjes së ajrit duke përdorur këto modele.

Në anën tjetër, në mënyrë që pala kosovare ta zbatojë modelin e simulimit e pavarur në të ardhmen, është e nevojshme të përmirësohen njohuritë dhe aftësia, pasi që vetëm disa prej H/L duket se kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme. Për më tepër, llogaritja e modelit të simulimit nuk është specifikuar në përshkrimin e punës së MMPHI/MMPH. Është thelbësore të caktohet llogaritja e modelimit të simulimit si punë e MMPHI/MMPH, në mënyrë që të mbahet dhe përmirësohet në mënyrë të qëndrueshme kapaciteti i zbatimit të simulimit në Kosovë.

3.7 Rezultati 6: Pala kosovare përmirëson vendimmarrjen bazuar në të dhënat teknike për kontrollin e ndotjes së ajrit.

Në Rezultatin 6 Projekti ka mbështetur vendimmarrjen e palës kosovare për masat e kontrollit të ndotjes së ajrit duke studiuar masat për zvogëlimin e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera të palëvizshme.

3.7.1 Aktivitetet

Projekti ka mbështetur vendimmarrjen e palës kosovare për masat e kontrollit të ndotjes së ajrit duke studiuar masat për zvogëlimin e emisioneve për TC Kosova A në përputhje me PKZE-në dhe të kuptuarit e emisioneve aktuale, si dhe duke studiuar masat për zvogëlimin e emisioneve për burimet e tjera të palëvizshme.

Projekti, në përgjigje të kërkesës nga pala kosovare, nuk ka studiuar masat për zvogëlimin e emisioneve për TC Kosova B, pasi puna e rehabilitimit nga BE tani është në proces e sipër, dhe Projekti ka kufizuar studimin e vetëm për TC Kosova A. TC Kosova A është planifikuar të ndalojë punën në vitin 2023 pas fillimit të punës së termocentralit të ri (Kosova e Re), dhe për këtë arsye, investimi është shumë i kufizuar.

Termocentrali ri quhet "Kosova e Re" kapaciteti i gjenerimit të energjisë elektrike i së cilës është 500 MW (informacione të tjera thonë 450 MW). Kompania me bazë në Londër për investime në energji "Contour Global" përfundoi kontratën e Partneritetit Publiko-Privat me Qeverinë e Kosovës në vitin 2017. Termocentrali planifikohet të fillojë punën në vitin 2022 deri 2023. Mirëpo, Contour Global u tërhoq nga ndërtimi i termocentralit në mars të vitit dhe aktualisht plani për ndërtimin e termocentralit të ri është në pritje dhe përgjigja nga pala kosovare duhet të përcillet nga afër, duke përfshirë rishikimin e PKZE-së. Në anën tjetër, në rast të investimeve në TC Kosova A, është e nevojshme të bëhet studimi gjithëpërfshirës, pasi që objektet janë të vjetra dhe të degraduara, dhe performanca është e ulët, etj. Investimet duhet të konsiderohen jo vetëm për zvogëlimin e emisioneve, por gjithashtu për masat për renovimin e pajisjeve, zgjatjen e jetëgjatësisë, rritjen e efikasitetit të gjenerimit të energjisë elektrike, etj. Në këtë situatë, Projekti i përqendroi studimet në masat relativisht më pak të kushtueshme dhe të arsyeshme për zvogëlimin e emisioneve.

Meqenëse PKZE ka filluar nga viti 2018 kërkohej reagim i shpejtë, dhe për këtë arsye aktivitetet janë caktuar për gjysmën e parë të periudhës së Projektit. Pasi që investimet janë të kufizuara, Projekti është përqendruar në studimin e masave të përballueshme dhe të arsyeshme dhe i ka propozuar disa masa. Një pjesë e propozimeve në realitet janë aplikuar në TC Kosova A dhe kjo u bë një nga rezultatet e mëdha të Projektit.

Në anën tjetër, për sa i përket burimeve të tjera të palëvizshme, Projekti ka bërë studimin kryesisht në gjysmën e dytë të Projektit pas përfundimit të studimit për IDM. Bazuar në rezultatet e matjes së gazit të shkarkuar dhe rezultatet e inspektimit të procesit dhe lëndëve djegëse të konsumuara, Projekti ka kuptuar situatën reale të emisioneve dhe masat për zvogëlimin e emisioneve, dhe ka propozuar pikat të cilat duhet të përmirësohen. Menaxhmenti i MMPHI/MMPH që është autoriteti kompetent është çelësi i zbatimit të sugjerimeve.

(1) Aktivitete për sa i përket IDM-ve

Në Aktivitetin Paraprak janë studiuar masat për zvogëlimin e emisioneve për IDM paralelisht me matjen e gazit të shkarkuar. PKZE kërkon që Pluhuri, SO₂ dhe NO_x nga IDM-të t'i përmbushin VKE-të në përputhje me Direktivën e BE-së për IDM-të. Qëllimi i Aktivitetit Paraprak ishte ta mbështesë palën kosovare që TC Kosova A dhe TC Kosova B të cilat janë IDM në Kosovë të planifikojnë masa konkrete për zvogëlimin e emisioneve për t'i përmbushin VKE-të.

Aktivitetet në Aktivitetin Paraprak kanë qenë siç vijon.

- Mbështetja e palës kosovare në përpilimin e PKZE-së të dorëzuar në KEn
- Mbështetja e palës kosovare për ta kuptuar gjendjen aktuale të emisioneve nga TC Kosova A dhe TC Kosova B dhe për të planifikuar masat për zvogëlimin e emisioneve
- Për të dhënë referencë për masat e zvogëlimit të emisioneve në të ardhmen përmes prezantimit të teknologjive për zvogëlimin e emisioneve të Japonisë

Aktiviteti Paraprak ka bërë studimin për ta kuptuar gjendjen aktuale të emisioneve dhe propozimeve për masat e zvogëlimit të emisioneve, dhe ka mbështetur përpilimin e PKZE-së.

Pas fillimit të Projektit, ka vazhduar studimi i masave për zvogëlimin e emisioneve megjithëse studimi është kufizuar në vetëm TC Kosova A.

Përmbajtja e aktiviteteve në Aktivitetin Paraprak është siç vijon.

1) Aktivitete për sa i përket përpilimit të PKZE

Kosova është nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKEn). Duke iu referuar udhëzimeve të politikave të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Palët Kontraktuese të TKEn janë të obliguara ta zhvillojë PKZE-në. Ky Traktat obligon zbatimin e 'Acquis Communautaire' të BE-së, në veçanti për mjedisin, përmes zbatimit të Direktivave 2001/80/EC dhe 2010/75/EU për kufizimin e emisioneve të ndotësve të caktuar në ajër nga Impiantet me Djegie të Mëdha (IDM) nga secila Palë Kontraktuese.²⁷ PKZE vendos rëndësinë mbi planin për t'i përmbushur VKE-të për SO₂, NO_x dhe Pluhur nga IDM-të përmes zvogëlimit gradual të emisioneve specifike dhe sasisë së emisioneve të ndotësve të lartpërmendur. Synimet e zvogëlimit të emisioneve dhe afati për t'i përmbushur kërkesat e Direktivës 2010/75/EU janë të specifikuara siç vijon.

Në direktivën e BE synim janë impiantet me nxehtësi hyrëse prej 50MW dhe më shumë, dhe VKE-të ndryshojnë bazuar në llojin e lëndës djegëse të përdorur (ngurtë, lëngshme ose të gaztë), fillimi i operimit, shkalla e nxehtësisë hyrëse (VKE-të ndryshojnë nga 50 deri 500 MW dhe janë konstante për më shumë se 500MW) dhe llojet e objekteve/pajisjeve (kaldaja, turbina me gaz, etj.).

²⁷ <https://energy-community.org/aboutus/howweare.html>

Në Kosovë vetë TC Kosova A dhe TC Kosova B janë synim i PKZE-së, dhe bazuar në faktin se IDM-të në Kosovë nuk janë të reja dhe si lëndë djegëse konsumojnë linjitin, VKE-të për vitin 2018 janë të përcaktuara si në Figura 3-28.




Figura 3-28 VKE-të për TC Kosova A dhe TC Kosova B për vitin 2018

Siç është paraqitur në figurën e mësipërme, nxehtësia hyrëse për të dy IDM-të është më e lartë se 500MW, dhe bazuar në këtë VKE-të ndryshojnë për çdo vit siç është përshkruar në Figura 3-29.

Siç është paraqitur në figurë, vlerat e VKE-ve ndryshojnë dhe Palët Kontraktuese të cilat zgjedhin PKZE-në duhet të jenë në pajtueshmëri me këto vlera.




Figura 3-29 Ndryshimi i VKE-ve sipas direktivës së BE

Në Aktivitetin Paraprak, MMPHI/MMPH, KEK dhe pala japoneze kanë diskutuar dhe kanë ardhur në përfundim se është praktikisht e pamundur që të fillohet me PKZE nga viti 2018. Për këtë arsye qeveria e Kosovës vendosi të negociojë me KEn duke shpjeguar se Kosova do të fillojë me PKZE nga viti 2022, me katër vite vonesë. Bazuar në këtë vendim qeveria rishikoi planin e zbatimit të PKZE-së siç është paraqitur në Figura 3-30, dhe iu përgjigj KEn.

Viti	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Plan-programi	A, B F/S Prokurimi													
Kosova A														
A3	Pluhuri					50mg/Nm3								20mg/Nm3
	SO2					400mg/Nm3								200mg/Nm3
	NOX					500mg/Nm3					200mg/Nm3			
A4	Pluhuri					50mg/Nm3								20mg/Nm3
	SO2					400mg/Nm3								200mg/Nm3
	NOX					500mg/Nm3					200mg/Nm3			
A5	Pluhuri					50mg/Nm3								20mg/Nm3
	SO2					400mg/Nm3								200mg/Nm3
	NOX					500mg/Nm3					200mg/Nm3			
Kosova B														
B1	Pluhuri					50mg/Nm3								20mg/Nm3
	SO2					400mg/Nm3								200mg/Nm3
	NOX					500mg/Nm3					200mg/Nm3			
B2	Pluhuri					50mg/Nm3								20mg/Nm3
	SO2					400mg/Nm3								200mg/Nm3
	NOX					500mg/Nm3					200mg/Nm3			
Termocentrali i ri														
N1											NOx, SO2;200mg/Nm3			
N2											Pluhuri;10mg/Nm3 për ShLQ			

Figura 3-30 Plani i rishikuar i zbatimit të PKZE

Mirëpo, KEn nuk e pranoi këtë plan, dhe për këtë arsye Kosovës duhej ta rishikonte planin për të filluar me PKZE në vitin 2018, dhe pas rishikimit Kosova e dorëzoi planin final të PKZE-së tek KEn në muajin maj 2018.

2) Studimi i masave për zvogëlimin e emisioneve në TC Kosova A

Si referencë, Tabela 3-101 paraqet specifikimet e TC Kosova A dhe TC Kosova B. Specifikimi më i detajuar i TC Kosova A është paraqitur në Tabela 3-113 dhe Tabela 3-114.

Tabela 3-101 Specifikacioni i TC Kosova A dhe TC Kosova B

1/2: TC Kosova A

Pika	Njësia	Përshkrimi
Viti i operimit		A ₃ – 1970, A ₄ – 1971, A ₅ – 1975.
Lloji i kaldajës		Qarkullim natyror
Sistemi i ndezjes		Thëngjilli i pluhurizuar i ndihmuar me mazut me fryrje të vazhdueshme të ajrit.
Rrjedha e avullit	t/h	614 për 200 MW(A-3, A-4) 645 për 210 MW (A-5)
Temperatura e avullit	°C	535
Presioni i avullit	bar.	162 (FW), 152 (Tamburi) 138 (SH Jashtë)
Rezultati	MW	200 MW (A-3, A-4), 210 MW (A-5)
Lloji i filtrit		Filtri Elektro Statik Ndërtuar në vitin 2012 3 FES për kaldajë

		Secili FES ka katër fusha
Përmbajtja e pluhurit (në hyrje të Filtrit)	mg/Nm ³	41110
Përmbajtja e pluhurit (në hyrje të Oxhakut)	mg/Nm ³	50
Madhësia e oxhakut (Lartësia, Diametri)	m	A ₃ dhe A ₄ , H=100.2 D _{mb} = 8.50/5.20 m A ₅ , H = 120.0 m D _{mb} = 9.64/6.00 m

2/2: TC Kosova B

Pika	Njësia	Përshkrimi
Viti i operimit		1983/1984
Lloji i kaldajës		Qarkullim i detyruar
Sistemi i ndezjes		Thëngjilli i pluhurizuar i ndihmuar me mazut me fryrje të vazhdueshme të ajrit.
Rrjedha e avullit	t/h	1000t/h për 339MW
Temperatura e avullit	°C	540 ⁰ C
Presioni i avullit	bar.	174bar. (për 339MW)
Rezultati	MW	339MW
Lloji i filtrit		Filtri Elektro Statik 1983 2 FES për kaldajë Secili FES ka tetë seksione
Përmbajtja e pluhurit (në hyrje të Filtrit)	mg/Nm ³	30.000
Përmbajtja e pluhurit (në hyrje të Oxhakut)	mg/Nm ³	150 (B-1), 260 (B-2)
Madhësia e oxhakut (Lartësia, Diametri)	m	210

Tri njësi në TC Kosova A filluan operimin nga viti 1970 deri në vitin 1975. FES është rinovuar në vitin 2012 si masë për zvogëlimin e pluhurit, por impiantet nuk kanë njësi për de-sulfurim dhe njësi për de-nitrim. Në anën tjetër, TC Kosova B filloi operimin nga viti 1983 deri në vitin 1984. TC Kosova B i ka FES-ët si masë për zvogëlimin e pluhurit që nga fillimi i punës, por nuk ka njësi për de-sulfurim e as njësi për de-nitrim. Turbinat me avull janë rinovuar rreth dhjetë vite më parë. Të dy TC-të janë të vjetërsuara.

Siç është cekur më parë, Projekti ka bërë studimin dhe propozimin e masave për zvogëlimin e emisioneve vetëm për TC Kosova A.

Synim i masave për zvogëlimin e emisioneve janë Pluhuri, SO₂ dhe NO_x. Të gjitha rezultatet e matjes së gazit të shkarkuar të cilat i ka bërë Projekti tashmë janë paraqitur në Figura 3-12 (Asnjë nga pajisjet nuk është rinovuar gjatë periudhës së matjes). Vlerat e NO_x janë pak a shumë stabile, por vlerat e Pluhurit dhe SO₂ luhat shumë gjatë secilës matje. Asnjë nga komponentët nuk i përmbushë VKE-të për IDM.

PKZE filloi në vitin 2018 dhe ishte e nevojshme që të studiohen masat sa më parë që është e mundur, prandaj aktivitetet u kryen në bazë të prioritetit. Është planifikuar që TC Kosova A të ndalë punën pas fillimit të punës të TC Kosova e Re. Në këtë situatë, është shumë e vështirë që të bëhen investime të mëdha për TC Kosova A, prandaj projekti u përqendrua në studimin e masave të përballeshme dhe të arsyeshme.

Përmbledhja e hulumtimit dhe studimit në TC Kosova A është paraqitur siç vijon (detajet janë përshkruar në 3.8.1).

i) Masat për zvogëlimin e pluhurit

Gjatë secilës matje përmbajtja e pluhurit ndryshon nga 100 deri 1,000mg/Nm³. Specifikacioni i FES-së është 50 g/Nm³, por përmbajtja e pluhurit është më e lartë se specifikacioni dhe FES nuk përmbush specifikacionin e tij.

Përmes aktiviteteve të kryera në Rezultatin 2 dhe Rezultatin 7 për matjen e gazit të shkarkuar dhe inspektimin e operimit, Projekti ka propozuar ekzekutimin e njëkohshëm të tri masave si masë për zvogëlimin e emisioneve, e të cilat janë përmirësimi i shpërndarjes së rrjedhës së gazit brenda FES-it, aplikimi i kontrollit të energjizimit me ndërprerje për FES-in dhe zvogëlimi i shkallës së rrjedhës së gazit të shkarkuar përmes përmirësimit të operimit. Përmirësimi i shpërndarjes së rrjedhës së gazit dhe aplikimi i kontrollit të energjizimit me ndërprerje kërkojnë modifikim të harduerit dhe softuerit, dhe megjithëse buxheti i nevojitur është i ulët TC Kosova A pranoi propozimet. TC Kosova A fillimisht aplikoi modifikimi për përmirësimin e shpërndarjes së rrjedhës së gazit në një FES (Kanali-C i kaldajës Nr.5) në muajin mars 2019 dhe është vlerësimi i efektivitetit të modifikimit nga ana e Projektit. Rezultati i përmbajtjes së pluhurit është paraqitur në Tabela 3-102. Aplikimi i njëkohshëm i përmirësimit të shpërndarjes së rrjedhës së gazit dhe i zvogëlimit të shkallës së rrjedhës së gazit të shkarkuar bënë që përmbajtja e Pluhurit pothuajse t'i arrijë VEK-të për vitin 2018.

Tabela 3-102 Rezultatet e testeve për zvogëlimin e Pluhurit

Përmbajtja e pluhurit (mg/Nm³) (Kanali-C i kaldajës Nr.5) (VKE 50 mg/Nm³: 2018)	
Operimit konvencional	Zvogëlimi i shkallës së rrjedhës së gazit të shkarkuar
534, 97, 263, 632 <u>mg/Nm³</u>	51, 50, 48 <u>mg/Nm³</u>

Për sa i përket përmirësimit të shpërndarjes së gazit brenda FES-it, KEK, UP dhe JET bashkëpunuan në punën për ta bërë matjen e shpërndarjes së rrjedhës brenda FES-it, për ta kryer CFD dhe për t'i studiuar masat për përmirësim bazuar në rezultatet e studimit. Në fund, është propozuar plani për modifikimin e pllakës drejtuese (pllaka drejtuese të cilat e kontrollojnë rrjedhën brenda FES-it) në hyrje dhe plani është zbatuar bazuar në propozimin.

Mirëpo, për sa i përket kontrollit të energjizimit me ndërprerje për FES-in, kjo ende nuk është zbatuar për shkak të mos përgjigjes nga prodhuesi i FES-it përkundër kërkesave të shumta nga TC Kosova A. Mirëpo, në periudhën e tretë pasi që për rehabilitimin e TC Kosova B u vendos që për FES të zgjedhet prodhuesi i njëjtë, TC Kosova A pati mundësi që të ketë takim me prodhuesin dhe negociatat me prodhuesin janë në vazhdim e sipër.

Është konfirmuar efektiviteti i përmirësimit të shpërndarjes së rrjedhës së gazit brenda FES-it dhe ky modifikim i aplikuar FES-ve të tjerë. Aktualisht, janë modifikuar FES-ët e kanalit-C të kaldajës Nr.5 dhe të gjithë FES-ët e kaldajës Nr.4.

Aplikimi i kontrollit të energjizimit me ndërprerje tani është nën negociim dhe krijimi i operimit për zvogëlim të shkallës së rrjedhës së gazit të shkarkuar mbetet çështje për të ardhmen. Përmirësimi i shpërndarjes së rrjedhës së gazit brenda FES-it, aplikimi i kontrollit të energjizimit me ndërprerje dhe zvogëlimi i shkallës së rrjedhës së gazit të shkarkuar do të kontribuojnë në zvogëlimin e Pluhurit në të ardhmen.

ii) Masat për zvogëlimin e SO₂

Vlerat e SO₂ luhaten nga 0 deri 2,000 mg/Nm³. Për de-sulfurim të përhershëm është e nevojshme të instalohet njësia e de-sulfurimit, por instalimi i kësaj njësie është e pamundshme për TC Kosova A për shkak se kërkohet investim i madh.

Në anën tjetër, vlera e SO₂ nganjëherë ka rënë në 0 mg/Nm³, dhe Projekti ka vazhduar ta studiojë këtë dukuri. Kjo dukuri shkaktohet nga de-sulfurimi në vatër dhe varet nga kushte brenda vatrës (temperatura e gazit dhe shpërndarja e tij, etj.), përbërja e linjitit (përmbajtja e Kalciumit (këtu e tutje "Ca"), përmbajtja e Sulfurit (këtu e tutje "S")), etj. dhe kur përmbushen kushtet e caktuara ndodhë de-sulfurimi në vatër. Mirëpo, përbërja e linjitit si vlera e nxehtësisë, përmbajtja e lagështisë, përmbajtja e S, përmbajtja e Ca, etj. gjithmonë ndryshojnë, dhe përveç kësaj faktorët e operimit si kontrolli i shpërndarjes së sasisë së linjitit tek flakadanët, kontrolli i furnizimit të ajrit të djegies, etj. janë të pamjaftueshëm. Për këtë arsye, është e vështirë që të kontrollohen kushtet e vatrës që të jenë të përshtatshme për de-sulfurim në vatër. Është e pamundur për TC Kosova A ta bëjë përzgjedhjen e linjiti dhe ta kontrollojë cilësinë, si dhe të krijohen kushtet e përshtatshme për de-sulfurim për shkak të shtrirjes së pamjaftueshme të kontrollit të vatrës. Mirëpo,

Projekti dha udhëzime se si të kontrollohen faktorët e operimit të kaldajës në mënyrë që de-sulfurim të përmirësohet sado pak. Detajet janë përshkruar në 3.8.1.

iii) Masat e zvogëlimit të NO_x

Është konfirmuar së paku 15% të zvogëlimit të NO_x kur ajri i djegies është zvogëluar (zvogëlimi i O₂ në gazin e shkarkuar). Mirëpo, nuk është i mjaftueshëm për ta arritur VKE-në (200mg/Nm³) në vitin 2023 në përputhje me Direktivën e BE-së. Është e vështirë që të krijohen kushtet e operimit për zvogëlimin e ajrit të djegies.

Këto studime për masat e zvogëlimit të emisioneve janë kryer përmes bashkëpunimit ndërmjet DMNU/DMNI, IHMK-së dhe KEK-ut, dhe për më tepër, UP morri pjesë në studimin e përmirësimit të shpërndarjes së rrjedhës së gazit brenda FES-it, që është zhvilluar përmes bashkëpunimit industri-akademi-qeveri. Planifikohet që Kosova A të ndal së punuari në të ardhmen e afërt dhe investimet janë të kufizuara. Në këtë situatë ka qenë rezultat i mirë për Projektin të jetë në gjendje të propozojë dhe zbatojë përmirësime.

Përmes këtyre aktiviteteve janë arritur rezultatet në vijim.

- H/L (veçanërisht KEK-u) kanë mësuar procedurat për studimin e masave për zvogëlimin e emisioneve për të cilat u nevojiti të ndërmerren hapat e matjes dhe inspektimit, analizës, studimit të masave dhe aplikimit të tyre. Deri më tani, operacionet iu janë lënë prodhuesve dhe fabrikave, por H/L kanë mësuar se mund t'i studiojnë masat për zvogëlimin e emisioneve duke bërë vetë ekzaminimin dhe analizën e operacioneve. Stafit i TC Kosova A është i gatshëm t'i studiojë dhe zbatojë masat për zvogëlimin e emisioneve përmes inspektimit të cilin e bëjnë vetë.
- Për sa i përket përmirësimit të shpërndarjes së rrjedhës së gazit brenda FES-it, MMPHI/MMPH, JET-i, KEK-u dhe bashkëpunuan në matjen e shpërndarjes aktuale të rrjedhës brenda FES-it, analizën e shpërndarjes së rrjedhës me përdorimin e CFD, studimin e masave për përmirësime dhe propozimin final për përmirësime. Pritet që ky shembull të bëhet praktikë e mirë dhe aktivitete të njëjta të priten në të ardhmen.

(2) Aktivitetet për sa i përket burimeve të tjera të palëvizshme

Projekti ka kryer matje të gazit të shkarkuar dhe ka bërë inspektimin e proceseve dhe lëndëve djegëse të konsumuara në mënyrë që ta kuptojë gjendjen aktuale të emisioneve nga burimet e tjera të palëvizshme. Bazuar në rezultatet e matjes dhe inspektimit, janë studiuar gjendja aktuale e emisioneve dhe masat për zvogëlimin e emisioneve.

Fabrikat të cilat kanë qenë synim i studimit dhe ku është bërë matja e gazit të shkarkuar janë këto katër fabrika në vijim.

- 1) Fabrika e Ferronikelit
- 2) Fabrika e blloqeve
- 3) Fabrika e asfaltit

4) Fabrika e vajrave të përdorura

Siç është cekur në 3.3.1, VKE-të për burimet e tjera të palëvizshme janë të rregulluara me dy ligje. Njëri i aplikohet fabrikave shumë të mëdha të përcaktuara në ligjin për PKIN, dhe në këtë ligj VKE-të jepen përmes lejes PKIN¹⁹ për të cilin fabrikat aplikojnë tek qeveria dhe më pas qeveria e bën ekzaminimin e detajuar të aplikimit. Tjetri i aplikohet fabrikave të tjera varësisht nga lloji i përcaktuar në Udhëzimin Administrativ Nr./2007. Nga katër fabrikat, fabrika e Ferronikelit dhe fabrika e riciklimit të vajrave janë të rregulluara me lejen PKIN, dhe fabrika e blloqeve dhe fabrika e asfaltit janë të rregulluara me UA.

Rezultatet e inspektimit janë përshkruar siç vijon.

1) Fabrika e Ferronikelit

Rrjedha e procesit të fabrikës së Ferronikelit është paraqitur në Figura 3-31. Objektet e fabrikës janë i) Furra rrotulluese, ii) Furra elektrike dhe iii) Konvertori. Pasi që secili nga objektet e ka oxhakun e vetë, VKE-të janë të përcaktuara për secilin objekt, dhe për këtë arsye matja e gazit të shkarkuar duhet të bëhet për secilin objekt.




Figura 3-31 Rrjedha e procesit në fabrikën e Ferronikelit

IHMK, DMMU/DMNI dhe JET-i kanë kryer dy herë matjet për secilin objekt. Rezultatet e matjes tashmë janë paraqitur në Tabela 3-61. Rezultatet e matjes tregojnë se SO₂ në Furrën rrotulluese dhe Pluhuri në Furrën elektrike dhe Konvertor tejkalojnë VKE-të.

Secili proces është përshkruar në vijim.

i) Furra Rrotulluese

Xehja e nikelit e cila është lëndë e parë i furnizohet furrës Rrotulluese bashkë me linjit dhe gur gëlqeror. Në furrën Rrotulluese, xehja e nikelit piqet në temperaturë prej afërsisht 850 °C përmes lëndëve djegëse (mazut dhe/ose petrol-koks) dhe i furnizohet Furrës elektrike. Pluhuri në gazin e shkarkuar mënjanohet përmes FES-it dhe gazi i shkarkuar nxirret nga oxhaku në lartësi prej 100 m. Objekti nuk ka njësi të de-sulfurimit dhe njësi të de-nitritimit. Këtu është vëllimi më i madh i gazit në fabrikën e Ferronikelit.

ii) Furra Elektrike

Xehja e nikelit e pjekur në furrën Rrotulluese furnizohet dhe më pas reduktohet përmes karbonit në Furrën elektrike dhe shkrihet përmes energjisë elektrike, dhe prodhohet ferro-nikeli i shkrirë i papërpunuar.

Gazi i shkarkuar lahet përmes skruherit venturi me dy-faza dhe dërgohet në kulm të ndërtesës. Gazi djegie përdoritur është duke u shkarkuar.

iii) Konvertori

Konvertori e furnizon ferro-nikelin e shkrirë të papërpunuar me oksigjen dhe rregullon përqendrimin e nikelit në produktin final duke kryer oksidimin dhe duke larguar hekurin. Në fund, hidhet në kallëp si ferro-nikel dhe bëhet produkt.

Gazi i shkarkuar nxirret pasi që të lahet me anë të skruherit venturi me dy-faza.

Nga rezultatet e matjes së gazit të shkarkuar dhe procesi supozohen çështjet në vijim

i) Furra Rrotulluese

Pasi që furra rrotulluese konsumon petrol-koks që si lëndë djegëse përmban nivel të lartë të S vlera e SO₂ është shumë e lartë, që është problem i madh. Zakonisht petrol-koksi i konsumuar në Kosovë përmban 4 deri 6% S. Kur përdoret llogaritja e djegies, petrol-koksi që përmban 6% S prodhon rreth 2,050mg/Nm³ të SO₂ në O₂ =18% në gazin e shkarkuar (12,320mg/Nm³ të SO₂ në O₂ =3% në gazin e shkarkuar), e cila është vlerë shumë e madhe. Duke vlerësuar nga rezultatet e matjes, S në petrol-koks shkarkohet pas djegies ashtu si është. Në anën tjetër, niveli i NO_x është i ulët sepse temperatura e vatrës është e ulët dhe Pluhuri mënjanohet në nivel të mjaftueshme përmes FES-it.

Vlera e lartë e SO₂ shkaktohet nga petrol-koksi, dhe është e domosdoshme që të kalohet në përdorimin e lëndës së parë me nivel të ulët të S sa më parë që është e mundur.



Foto 3-28 Matja në Furrën Rrotulluese

ii) Furra Elektrike

Pluhuri në gazin e shkarkuar nga Furra Elektrike tejkalon VKE-në, por niveli i SO_2 është pothuajse 0 mg/Nm^3 . Gazi i shkarkuar është gaz reduktues dhe O_2 tregon 0%. Për këtë arsye gazi digjet pas shkarkimit në ajër. Për ta vlerësuar efektin në ajër duhet të matet gazi pas djegies, por leja PKIN jepet bazuar në gazin para djegies për shkak të kufizimeve të objektit. Prandaj, VKE-të janë dhënë vetëm për Pluhur. Mirëpo, pluhuri shkon kah ngjyra e zezë në të cilin supozohet se përfshihet karboni, prandaj përmbajtja e Pluhurit mund të jetë më e ulët pas djegies.

S në gazin e shkarkuar nuk mund të ekzistojë si SO_2 në mjedis reduktues, dhe supozohet se ekziston në gjendje të sulfidit të hidrogjenit (këtu e tutje " H_2S "). Në anën tjetër, meqenëse në këtë proces pjesa më e madhe e S mund të merret në zgjyrë, pritet përmbajtja e ulët e S në gaz. Për sa i përket NO_x , NO_x nuk krijohet në mjedis reduktues, por NO_x i krijuar pas djegies supozohet të jetë ende në nivel të ulët për shkak të temperaturës së ulët të djegies. Është e arsyeshme që leja PKIN nuk përcakton SO_2 dhe NO_x , por së paku duhet të bëhet matja e H_2S . (Gazi ka kundërmimin e H_2S)



Foto 3-29 Matja në Furrën Elektrike

Për sa i përket Pluhurit, fabrika ka adoptuar Teknologjinë më të mirë në dispozicion (këtu e tutje "BAT") që është skruberi venturi me tri-faza, por është e nevojshme që të rritet kapaciteti larës për pastrimin e gazit.

iii) Konvertori

Në Konvertor Pluhuri tejkalon VKE-të. Niveli i SO₂ dhe NO_x janë mjaftueshëm të ulët. Duke marrë parasysh procesin, S nuk ekziston nikelin e shkrirë të papërpunuar dhe niveli i NOX është gjithashtu i ulët, dhe këto vlera janë shumë të arsyeshme. Për sa i përket Pluhurit, sistemi i pastrimit të gazit të shkarkuar adopton teknologjinë BAT të ashtuquajtur skruberi venturi me dy-faza, por është e nevojshme që të rritet kapaciteti larës për pastrimin e gazit.




Foto 3-30 Matja në konvertor

Projekti ka kryer matjet dhe ka studiuar masat për zvogëlimin e emisioneve për tri objekte në fabrikën e Ferronikelit. Problemi më i madh është niveli i lartë i SO₂ në gazin e shkarkuar nga furra Rrotulluese. Kërkohe konvertimi i menjëhershëm në lëndë djegëse me nivel të ulët të S. Për zvogëlimin e Pluhurit nga Furra Elektrike dhe Konvertori është e nevojshme që të ketë më shumë rënie të presionit për skruberat venturi dhe të përmirësohet efikasiteti i mënjanimin të pluhurit.

2) Fabrika e blloqeve

Rrjedha e procesit të fabrikës së Blloqeve është paraqitur në Figura 3-32. Objekti qendror është furra tunel.

Blloqet e formësuar të renditura në trakë lëvizëse thahen dhe para-nxehen me ajër të nxehtë nga furra tunel dhe më pas futen brenda furrës tunel. Në zonën e sinterimit në furrën tunel temperatura mbahet në vlerën e përcaktuar përmes gazit të djegies nga flakadanët. Gazi i djegies rrjedh në zonën e para-nxehjes, para-nxeh blloqet dhe shkarkohet nga oxhaku. Blloqet e formësuar hyjnë përmes hyrjes së furrës, para-nxehen në zonën e para-nxehjes, piqen në temperaturën e përcaktuar për kohën e përcaktuar në zonën e sinterimit, ftohen në zonën e ftohjes dhe nxirren nga furra. Ftohja e përdorur për ftohjen e blloqeve përdoret si ajër i nxehtë për para-nxehje të blloqeve. Blloqet piqen gjatë lëvizjes nga hyrja deri tek dalja dhe dalin si produkt.




Figura 3-32 Rrjedha e procesit të së fabrikës së Biloqeve

IHMK dhe JET-i kryen matjet dy herë. Rezultatet tashmë janë paraqitur në Tabela 3-61. Rezultatet tregojnë se Pluhuri dhe SO₂ në mënyrë drastike tejkalojnë VKE-të.



Foto 3-31 Matja në fabrikën e Biloqeve

Kjo fabrikë përdor petrol-koksin njëjtë si lëndë djegëse e përdorur në fabrikën e Ferronikelit, por në të njëjtën kohë, fabrika ka futur në përdorim tankerin për furnizimin me Gaz të lëngëzuar të naftës (këtu e tutje “LPG”) si masë të kontrollit të ndotjes së ajrit. Mirëpo, shkalla e furnizimit me LPG është rreth dhjetë për qind, dhe për këtë arsye gazi i shkarkuar ka nivel të lartë të SO₂ të ndikuar nga petrol-koksi. Vlera e Pluhurit është gjithashtu e lartë dhe Pluhuri është tepër i zi siç është paraqitur në Foto 3-32. Kjo supozohet se shkaktohet nga karboni i padjegur në petrol-koks.

Pasi që furra tunel në fabrikën e Biloqeve konsumon petrol-koks si lëndën kryesore djegëse nivelet e Pluhurit dhe SO₂ janë shumë të larta, dhe kërkohet konvertimi i menjëhershëm në lëndë djegëse me nivel të ulët të S. Është e mundshme që të zvogëlohen nivelet e Pluhurit dhe SO₂ duke rritur shkallën e furnizimit të LPG.

Tabela 3-103 paraqet vlerën e llogaritur të SO₂ në përputhje me rritjen e shkallës së furnizimit të LPG kur nxehtësia hyrëse totale mbahet e njëjtë.



Foto 3-32 tankeri për furnizim të LPG



Foto 3-33 Pluhuri i mbledhur

Tabela 3-103 Rezultatet e llogaritura të SO₂ në gazin e shkarkuar

	Shkalla e furnizimit të lëndës djegëse (kg/hr)		Përqendrimi i SO ₂ në gazin e shkarkuar (mg/Nm ³)	
	Petrol-koksi ^{*1)}	LPG	Gazi i shkarkuar O ₂ =18% ^{*2)}	Gazi i shkarkuar O ₂ =3% ^{*2)}
Gjendja aktuale	450	45,6	1643	9858
Për t'i përmbushur VKE-të aktuale	147	265	500	3000
Për t'i përmbushur VKE-të në të ardhmen	43	341	142	850

*1): Përmbajtja e supozuar e përmbajtjes së S në petrol-koks për llogaritjen e SO₂ është 6.22 %. LPG nuk përmban S.

*2) Referencë O₂ në gazin e shkarkuar është 18 % në rregulloren aktuale (ELV = 500 mg/Nm³) dhe 3% për rregulloren në të ardhmen (ELV = 850 mg/Nm³)

Siç është paraqitur në tabelë, për ta përmbushur VKE-në e rregullores aktuale shkalla e LPG duhet të rritet në 65% dhe për ta përmbushur VKE-në e rregullores në të ardhmen shkalla e LPG duhet të rritet në 89%. Është e nevojshme që menjëherë të rritet shkalla e LPG dhe të zvogëlohet vlera e SO₂. Për sa i përket pluhurit, për shkak të performancës së lartë të djegies të LPG, karboni i padjegshëm do të zvogëlohet dhe supozohet se edhe përmbajtja e Pluhurit gjithashtu do të zvogëlohet.

3) Fabrika e asfaltit

Rrjedha e procesit të fabrikës së Asfaltit është paraqitur në Figura 3-33. Objekti i djegies është Furra Rrotulluese që përdoret për tharjen e lëndës së parë.

Zhavorri si lëndë e parë (kryesisht përbëhet nga guri gëlqeror (CaCO₃)) furnizohet në furrën Rrotulluese dhe thahet në rreth 200 °C. Pas tharjes zhavorri sitet, përzihet me asfalt (Bitum) me kontroll të temperaturës, vendoset në kontejner dhe transportohet.

Gazi i shkarkuar del nga oxhaku pas mënjanimit të Pluhurit me anë të Filtrave me thasë.






Figura 3-33 Rrjedha e procesit të së fabrikës së Asfaltit

IHMK dhe JET-i i kryen matjet e gazit të shkarkuar. Rezultatet e matjeve janë paraqitur në Tabela 3-61. Rezultatet e matjes tregojnë se përmbajtja e Pluhurit tejkalon mjaft shumë VKE-në.



Foto 3-34 Matja në fabrikën e Asfaltit

Edhe pse fabrika e Asfaltit përdor naftë me S=0.76% që është shumë më i ulët se ai në petrol-koks, përmbajtja e SO₂ në O₂ Referente = 10% e llogaritur nga përbërja e lëndës djegëse është 842 mg/Nm³, dhe kjo vlerë tejkalon VKE-në. Mirëpo rezultati i matjes është 212 mg/Nm³ dhe është mjaftueshëm i ulët në krahasim me VKE-në. Kjo supozohet se shkaktohet nga reaksioni i de-sulfurimit në vijim.



Në përgjithësi, njëra nga metodat për mënjanimin e SO₂ nga gazi i shkarkuar është që hidrati i gëlqeres (Ca(OH)₂) të injektohet para filtrit me thasë dhe SO₂ të mënjanohet përmes reaksionit me gëlqere të kalcinuar (CaO). Në këtë proces, lënda e parë e gurit gëlqeror zëvendësohet me hidratin e gëlqeres dhe është parë se procesi ka kapacitet të mjaftueshëm të de-sulfurimit.

Në anën tjetër, pluhuri në përgjithësi zvogëlohet në 20 deri 30 mg/Nm³ në rast se trajtohet me filtër me thasë, por rezultatet e matjes tregojnë vlerë të madhe. Supozohet se filtrat me thasë kanë ndonjë problem siç janë vrimat, etj.

Është gjë që dihet se nëse procesi ka filtra me thasë Pluhuri mënjanohej mjaftueshëm. Mirëpo, ky rast tregon se menaxhimi i operimit është shumë i rëndësishëm si konfirmimi i performancës së pajisjeve përmes matjes së gazit të shkarkuar, etj. Në të njëjtën kohë, përmes matjes u konfirmua se ndodhë de-sulfurimi dhe efikasiteti i de-sulfurimit në këtë proces u mësua për herë të parë kur u krye matja e gazit të shkarkuar. Siç është përmendur këtu, është shumë e rëndësishme që të bëhet konfirmimi i emisioneve përmes matjes së gazit të shkarkuar.

4) Fabrika e vajrave të përdorura

Rrjedha e procesit të fabrikës së Riciklimit të Vajrave është paraqitur në Figura 3-34. Kjo fabrikë bënë ndarjen e vajrave të përdorura në komponentë duke shfrytëzuar diferencën e temperaturës së avullimit dhe temperaturën e kondensimit. Vaji i avulluar kondensohet dhe rikuperohet përmes kondensatorit, por gasi i lëshuar i pa kondensuar shkarkohet në fund. Shtrirja e rregullores për këtë fabrikë aplikohet për këtë gaz të shkarkuar. Ky gaz digjet nga flakadani pilot, ftohet me spërkatje me ujë dhe shkarkohet në ajër përmes oxhakut. Leja PKIN e kësaj fabrike rregullon komponentët e këtij gasi të shkarkuar.

Përmes matjes Projekti nuk mund t'i analizojë këta komponentë të gazit, dhe për këtë arsye si zakonisht u bë vetëm matja e Pluhurit, SO₂ dhe NO_x. Stafi i fabrikës thanë se ka ankesa nga njerëzit të cilët jetojnë në afërsi për kundërmimin.




Figura 3-34 Rrjedha e procesit të së fabrikës për Riciklimin e Vajrave

IHMK dhe JET-i i kryen matjet e gazit të shkarkuar. Rezultatet e matjeve janë paraqitur në Tabela 3-61. Rezultatet e matjes tregojnë se pothuajse i gjithë gasi i shkarkuar është ajër, dhe Pluhuri, SO₂ dhe NO_x janë vërejtur shumë pak. Sipas stafit të fabrikës riciklimi i vajrave merr shumë kohë dhe sasia e gazit të gjeneruar varet shumë nga lloji i vajit të përdorur që riciklohet. Në ditën e matjes sasia e gazit të gjeneruar ka

qenë e vogël dhe gazi i rikuperuar ka qenë pothuajse i tëri ajër. Gazrat e gjeneruara nga fabrika janë gaz i avulluar dhe i pa kontaminuar. Problemi është nëse Komponentet Organike të Avullueshme (këtu e tutje “VOC”) dhe/ose Hidrokarburi Aromatik Policiklik (këtu e tutje “PAH”) sigurisht mund të digjen apo jo. Ky problem supozohet se është shkaku pse ka ankesa nga njerëzit që jetojnë në afërsi. Kundërmimi nuk mund të mënjanohet nëse VOC, etj. nuk digjen (treden). Përmes matjes nuk është vërejtur asnjë sasi e SO₂ dhe NO_x.

Foto 3-36 paraqet kabinën e djegies së gazit të shkarkuar. Vetëm flakadani pilot është i instaluar me lëndë djegës LPG dhe është vështirë të thuhet se gazi i shkarkuar sigurisht digjet.



Foto 3-35 Matja në fabrikën e Riciklimit të Vajrave



Foto 3-36 Kabina e djegies së gazit të shkarkuar

Bazuar në përvojën, JET-i propozoi që të instalohet objekti për djegie që gazi sigurisht të digjet. Propozimi është paraqitur në Figura 3-35.




Figura 3-35 Sistemi për objektin e djegies

Metodat për mënjanimin e VOC dhe/ose PAH janë djegia ose absorbimi përmes koksit aktiv. Mirëpo, për metodën e absorbimit, karboni aktiv duhet të trajtohet pas përdorimit dhe për këtë arsye mendohet se metoda e djegies është më reale.

Në përgjithësi thuhet se nevojitet kushti i temperaturës prej 850 °C ose më lartë dhe 2 sekonda ose më gjatë të kohës së qëndrimit për t'i djegur (dekompozuar) VOC dhe/ose PAH. Prandaj, fabrika e Riciklimit të Vajrave duhet ta instalojë objektin për djegie siç është paraqitur në figurë, e cila ka vëllim të mbajë gazin e djegur për dy sekonda ose më gjatë. Në të njëjtën kohë, në objektin e djegies duhet të instalohet një termometër i cili rregullon temperaturën e djegies në 850 °C ose më lartë duke e kontrolluar shkallën e rrjedhës së LPG, dhe pastaj gasi i djegur ftohet përmes spërkatjes me ujë.

Instalimi i objektit të lartpërmendur për djegie do ta mënjanojë kundërmimin dhe O₂ dhe NO_x do të detektohen.

Projekti ka kryer matje të gazit të shkarkuar për katër burime tjera të palëvizshme dhe në të njëjtën kohë ka bërë vlerësimin e masave për zvogëlimin e emisioneve. Si rezultat janë identifikuar çështjet në vijim.

- Shumë fabrika private nuk kryejnë matje të duhur të gazit të shkarkuar dhe nuk dorëzojnë raporte të sakta të matjes.
- MMPHI/MMPH (Inspektorati dhe DMMU/DMNI) nuk ka njohuri të mjaftueshme për masat e zvogëlimit të emisioneve dhe nuk mund t'i japë udhëzimet e përshtatshme për fabrikat private.
- Personat përgjegjës për menaxhimin e fabrikave private nuk kanë njohuri të mjaftueshme për masat e zvogëlimit të emisioneve, e madje edhe fabrikat që kanë pajisje për trajtimin e gazit të shkarkuar nuk mund t'i menaxhojnë ato në mënyrë të duhur.

Rezultatet e matjes dhe masat për burimet e tjera të palëvizshme i janë dorëzuar stafit përgjegjës në MMPHI/MMPH pasi që JET-i bëri shpjegimin e përmbajtjes dhe pati pyetje dhe përgjigje, dhe JET-i kërkoi nga ta që t'i udhëzojnë fabrikat.

Mendohet se është element shumë i rëndësishëm që MMPHI/MMPH që është autoriteti kompetent fiton njohuri për t'i udhëzuar fabrikat private. Për ta realizuar këtë është e domosdoshme që të zgjerohet njohuria e personave përgjegjës në MMPHI/MMPH dhe të sigurohen rezultate të sakta të matjes së emisioneve. Kjo do t'iu mundësojë personave përgjegjës në MMPHI/MMPH që ta gjykojnë situatën e emisioneve nga fabrikat private bazuar në rezultatet e matjes së gazit të shkarkuar dhe t'i japin udhëzime këtyre fabrikave. Pasi që IHMK ka zhvilluar kapacitetin për matje të gazit të shkarkuar, MMPHI/MMPH mund ta shfrytëzojnë këtë kapacitet. Nëse MMPHI/MMPH i udhëzon tërë kohën fabrikat private duke përdorur kapacitetin e IHMK-së, matja e gazit të shkarkuar do të ketë perspektivë si biznes dhe pritet që do t'i nxisë biznesin privat për matje.

Qëllimi përfundimtar i dëshiruar është që të gjitha fabrikat të kryejnë matje të duhura dhe t'i raportojnë rezultatet tek agjencia kompetente.

Si çështje tjetër, në Kosovë importohet petrol-koksi si lëndë djegëse e lirë, dhe prandaj konsumohet shumë. Pasi që petrol-koksi ka përmbajtje të lartë të S, është e sigurt se SO₂ tejkalon VKE-në pa njësi të de-sulfurimit. Prandaj, është e pamundur që të përdoret petrol-koksi si lëndë djegëse pa njësi të de-sulfurimit. Mirëpo, është realitet se petrol-koksi

ende përdoret si lëndë djegëse dhe nga kjo pikëpamje është e dëshirueshme që të forcohet zbatimi i ligjit për rregulloret për gazin e shkarkuar. Nëse aplikohet si duhet rregullorja për gazin e shkarkuar, pashmangshëm do të zvogëlohet përdorimi i petrol-koksit. Në Japoni, në rast se petrol-koksi digjet, ana furnizuese i paguan para anës së kërkesës pasi që djegia e petrol-koksit ngarkon kosto të madhe për trajtimin e gazit të shkarkuar. Kur çmimi i koksit të naftës është minus trajtohet si “mbeturinë” në Japoni.

(3) Rritja e njohurisë për sa i përket masave për zvogëlimin e emisioneve

Projekti kuptoi s kërkohe rritja e njohurisë së MMPHI/MMPH (Inspektorati dhe DMMU/DMNI) për studimin e masave për zvogëlimin e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera të palëvizshme.

Në mënyrë që H/L të fitojnë njohuritë e lartpërmendura, bashkë me njohuritë për masat e zvogëlimit të emisioneve, kërkohen aktivitete në vijim: inspektimi i rrjedhës së procesit, lloji i lëndës djegëse të konsumuar, shkalla e konsumit të lëndëve djegëse dhe operimi aktual, si dhe pjesëmarrja në matje aktuale. Pastaj duke marrë parasysh të gjitha gjetjet duhet të studiohen masat efektive. TNP mendohet të jetë mënyra më efektive për këtë aktivitet. Mirëpo, Projekti nuk e ka kryer këtë aktivitet. Prandaj, projekti mbajti ligjëratat për njohuritë themelore të nevojshme për studimin e masave për zvogëlimin e emisioneve.

Qëllimi i ligjëratave është që të rritet njohuria. Ligjëratat janë mbajtur katër herë dhe kanë marrë pjesë të gjithë personat përkatës nga Inspektorati, DMMU/DMNI, IHMK, etj. Përmbajtja është paraqitur në Tabela 3-104.

Tabela 3-104 Përmbajtja e ligjëratave për rritjen e njohurisë

Periudha e tretë (2020)		
Data	Aktivitetet	Vërejtjet
30 janar 2020 (e enjte)	Ligjëratat për rregullimin e emisioneve për sa i përket objekteve industriale (efekti në ajër nga ndotësit nga oxhaqet si dhe analiza elementare dhe analiza industriale e lëndëve djegëse)	H/L: 12 JET: 1
31 janar 2020 (e premte)	Llogaritja e vëllimit të gazit të shkarkuar për peshë të njësisë së lëndës djegëse dhe vlerësimi i përmbajtjes së SO ₂ bazuar në rezultatet e analizës elementare dhe të analizës industriale	H/L: 6 JET: 1
3 shkurt 2020 (e hënë)	Krahasimi ndërmjet llogaritjes dhe rezultateve të matjes aktuale për gazin e shkarkuar, dhe metoda e matjes	H/L: 9 JET: 1
5 shkurt 2020 (e mërkure)	Metodat e matjes së gazit të shkarkuar dhe masat për zvogëlimin e emisioneve	H/L: 9 JET: 1



Foto 3-37 Ligjëratat për rritjen e njohurisë

Në ligjëratën e parë u ligjërua për efektin në ajër nga ndotësit nga oxhaqet (llogaritja e difuzionit të ndotësve nga oxhaqet) dhe njohurinë themelore për lëndët djegëse (analiza elementare dhe analiza industriale e lëndëve djegëse). Në ligjëratën e dytë u ligjërua për llogaritjen e vëllimit të gazit të shkarkuar për peshë të njësisë së lëndës djegësen vlerësimin e përmbajtjes së SO₂ bazuar në rezultatet e analizës elementare dhe të analizës industriale, dhe në të njëjtën kohë u theksua rëndësia e matjeve. Në ligjëratën e tretë, bazuar në raportet e rezultateve të matjes dhe rezultateve të inspektimit për lëndën e konsumuar djegëse dhe proceset, u ligjërua për rezultatet e matjes dhe masat për zvogëlimin e emisioneve. Në ligjëratën e katërt u ligjërua për metodën e matjes së gazit të shkarkuar dhe masat e zakonshme për zvogëlimin e emisioneve.

Përmes këtyre katër ligjëratave, Projekti ka këshilluar siç vijon. Një është se është e mundshme të vlerësohet niveli i SO₂ nga komponentët e lëndës djegëse. Tjetër është se në rast se është instaluar pajisja për zvogëlimin e emisioneve, është e rëndësishme të bëhen matjet dhe të konfirmohet nëse emisionet janë zvogëluar përmes pajisjes për zvogëlimin e emisioneve. Raportet për burimet e tjera të palëvizshme i janë dorëzuar MMPHI/MMPH pas shpjegimit dhe pyetjeve. JET ka kërkuar nga MMPHI/MMPH që t'i japë udhëzime këtyre fabrikave private.

Një pjesë e këtyre ligjëratave është mbajtur si seminar për kompanitë dhe Universitetin, etj.

H/L ishin shumë të interesuar që t'i dëgjojnë këto ligjërata. Mirëpo, për shkak të mungesës së njohurive dhe përvojave, është e diskutueshme nëse H/L do të jenë në gjendje ta përdorin njohurinë që kanë fituar. Ky do të jetë faktori kryesor nëse MMPHI/MMPH do të mund ta zbatojë ligjin apo jo nga tani e tutje.

Zgjerimi i njohurisë dhe përvojës e MMPHI/MMPH është aktivitet i rëndësishëm, dhe mendohet se çon drejt krijimit të kornizës institucionale për matjen e gazit të shkarkuar.

Në Ligjet e Kosovës, matja e gazit të shkarkuar dhe raportimi nga fabrikat private është i detyrueshëm. Mirëpo, në të vërtetë është vështirë të thuhet se ligji zbatohet. Ekziston një situatë ku mendohet se matja e gazit të shkarkuar nuk është pranuar mjaftueshëm.

Në 3.3.1 (3), janë paraqitur hapat drejt përhapjes së matjes së gazit të shkarkuar, por si premisë, për t'i avancuar hapat kërkohet siç vijon.

- 1) Zyrtarët në MMPHI/MMPH fitojnë njohuri dhe përvojë të mjaftueshme për matjen e gazit të shkarkuar dhe masat për zvogëlimin e emisioneve.
- 2) Zyrtarët në MMPHI/MMPH i japin udhëzime fabrikave private bazuar në njohurinë dhe përvojën e tyre.

Fabrikat private janë të detyruara me ligj që ta dorëzojnë raportin për gazin e shkarkuar, por aktualisht raportet e matjes nuk dorëzohen ose nuk janë adekuate edhe nëse dorëzohen. Pritet se matja e gazit të shkarkuar do të pranohet dhe do të shpërndahet përmes udhëzimit të fabrikave private nga zyrtarët e MMPHI/MMPH.

Ekziston vetëm një agjenci private e mundshme në Kosovë që mund të kryejë matje të gazit të shkarkuar. Mirëpo, MMPHI/MMPH beson se është e vështirë për MMPHI/MMPH ta mbështesë kompaninë private specifike si me mbështetje teknike dhe/ose furnizim me pajisje të matjes. Prandaj, është e vështirë që të arrihet konsensusi ndërmjet MMPHI/MMPH dhe agjencisë private. Në të njëjtën kohë, duhet që matja e gazit të shkarkuar të krijohet si biznes duke marrë parasysh vazhdimësinë e matjeve. Aktualisht, janë të nevojshme zhvillimi i kapaciteteve të zyrtarëve të MMPHI/MMPH dhe forcimi i aftësisë për t'i udhëzuar kompanitë private. Këto masa do ta bëjnë më të sigurt realizimin e zbatimit të ligjit.

3.7.2 Vlerësimi i Treguesve objektivisht të verifikueshëm në MDP

Treguesit objektivisht të verifikueshëm në MDP janë “Rekomandimet për kontrollin e ndotjes së ajrit bëhen të paktën një herë në dobi të proceseve të bërjes së politikave relevante nga pala kosovare” dhe “Publikimi dhe buletini informues për kontrollin e ndotjes së ajrit shpërndahen të paktën katër herë”.

Masat për zvogëlimin e emisioneve janë propozuar për IDM dhe burimet e tjera të palëvizshme. Masat për zvogëlimin e pluhurit për TC Kosova A janë në proces e sipër. Megjithëse janë propozuar masat për zvogëlimin e SO₂ dhe NO_x për TC Kosova A, ato mbesin si propozime për shkak të vjetërsisë së objekteve dhe investimeve të kufizuara për përmirësime. Për sa i përket burimeve të tjera të palëvizshme, janë studiuar dhe propozuar masat për katër burime të palëvizshme.

Siç është cekur në 3.9.1 (Rezultati 8) gjithashtu janë propozuar shumë masa për kontrollin e ndotjes së ajrit dhe disa masa janë vlerësuar për së afërmi. Buletinet informative janë publikuar katër herë. Ato janë të bashkëngjitura në Shtojcën-3 dhe përmbajtjet janë treguar në 3.12.2.

Siç është përmendur më lartë Treguesit Objektivisht të Verifikueshëm për Rezultatit 6 janë përmbyshur.

3.7.3 Zhvillimi i kapaciteteve përmes aktiviteteve

Stafi i TC Kosova A ka mësuar hapat ku ata kanë mbledhur të dhëna si të dhënat e matjes, të dhënat e operimit, rezultatet e analizës së linjtit dhe hirit fluturues, etj., kanë analizuar operimet dhe kanë bërë studimin e masave për përmirësim. Në të njëjtën kohë, stafi i TC Kosova A

gjithashtu ka mësuar teknologjinë e matjes dhe metodat e menaxhimit të emisioneve. Është e dëshirueshme që TC Kosova A ta shfrytëzojë këtë njohuri dhe këto teknologji për përmirësimin e operimit.

Në anën tjetër, për sa i përket burimeve të tjera të palëvizshme, është bërë e qartë se ligjet dhe rregulloret nuk respektohen. Projekti ka mbajtur ligjërata për përmirësimin e njohurisë, por kërkojnë më shumë njohuri dhe përvojë. Kjo është një sfidë e madhe për të ardhmen.

3.8 Rezultati 7: Zhvillohen masat e kontrollit të emisioneve në IDM.

3.8.1 Aktivitetet

Studimi i masave për zvogëlimin e emisioneve për IDM ka pasur për synim vetëm TC Kosova A. Aktiviteti i kryer ka qenë kryesisht studimi i efektit të de-sulfurimit në vatër përmes analizës së sjelljes së SO₂, përmirësimi i efikasitetit të performancës së FES-ve dhe zvogëlimi i NOx duke përmirësuar operimin e kaldajave.

(1) Periudha e parë

Në periudhën e parë janë zbatuar aktivitetet e paraqitura në Tabela 3-105. Janë matur dhe regjistruar SO₂, NOx dhe Pluhuri bazuar në “matja e gazit të shkarkuar e Rezultatit 2”, janë mbajtur regjistrat e detajuar të operimit të kaldajës, dhe është mostruar dhe analizuar linjiti dhe hiri fluturues. Këto të dhëna janë shfrytëzuar si të dhëna për analizën e sjelljes së SO₂, NOx dhe Pluhurit.

Tabela 3-105 Aktivitetet e Masave për Kontrollin e Emisioneve për IDM

Data	Aktiviteti	Pjesëmarrës
1 dhjetor 2017 (e premtë)	Takimi i Parë i Rregullt Zvogëlimi i Emisioneve të IDM-ve	H/L: 7
4 dhjetor 2017 (e hënë)	Shpjegimi për Hulumtimin e FES	H/L: 5
7 dhjetor (e enjte) ~ 8 dhjetor (e premtë) 2017	Mbledhja e të dhënave të dizajnit të FES-së së TC Kosova A Hulumtimi i brendshëm i FES-it të Kaldajës A-5	H/L: 12
13 Dhjetor 2017 (e mërkurë)	Mbledhja e të dhënave të rezultateve të matjes së vazhdueshme të SO ₂	H/L: 8
15 dhjetor 2017 (e premtë)	Takimi i Dytë i Rregullt Ligjëratë mbi njohurit bazike për FES	H/L: 12
18 dhjetor 2017 (e hënë)	Diskutimi me KEK-un për politikën dhe planin e zbatimit të aktivitetit të ardhshëm	H/L: 3
6 prill 2108 (e shtunë)	Takimi i Grupit për Kaldaja (Përshkrimi i planit të zbatimit)	H/L: 7
11 prill 2018 (e mërkurë)	Seminar për Matjen në terren e gazit nga oxhaku	H/L: 13
12 prill 2018 (e enjte)	Diskutim për Procedurën e Testimit të FES-it	H/L: 10
13 prill 2018 (e premtë)	Takimi për simulimin e rrjedhës së gazit në FES me UP	H/L: 3

16 prill (e hënë) deri 17 prill (e martë) 2018	Hulumtimi i brendësisë së FES të TC Kosova A (kaldaja A-5)	H/L: 5
18 prill (e mërkurë) deri 19 prill (e enjte) 2018	Përgatitja e matjes së shpërndarjes së Rrjedhës në FES të TC Kosova A (kaldaja A-5)	H/L: 5
18 Prill 2018 (e mërkurë)	Fillimi i matjes në terren të gazit në oxhak në TC Kosova A (kaldaja A-4)	H/L: 6
20 prill 2018 (e premte) 24 (E martë)	Matja e shpërndarjes së Rrjedhës në FES të TC Kosova A (kaldaja A-5)	H/L: 8
25 Prill 2018 (e mërkurë)	Procedura e testit të ndryshimit të shkallës së rrjedhës së gazit në FES/temperaturës	H/L: 5
27 prill 2018 (e premte)	Matja e shpërndarjes së Rrjedhës në FES të TC Kosova A (kaldaja A-5) (Matje shtesë)	H/L: 8
30 prill 2018 (e hënë)	Testi i ndryshimit të shkallës së rrjedhës së gazit në FES Monitorimi i energjizimit elektrik të kontrollit të FES-së	H/L: 8
2 maj (e mërkurë) deri 7 maj (e hënë) 2018	Matja në terren të gazit në oxhak në TC Kosova A (kaldaja A-3)	H/L: 5
2 maj 2018 (e mërkurë)	Testi i sjelljes së SO ₂ përmes ndryshimit të O ₂ të kaldajës në TC Kosova A (kaldaja A-3)	H/L: 2
3 maj 2018 (e enjte)	Testi i sjelljes së SO ₂ përmes ndryshimit të temperaturës në dalje të mullirit në TC Kosova A (kaldaja A-3)	H/L: 4
7 maj 2018 (e hënë)	Testi i sjelljes së SO ₂ përmes ndryshimit të numrit të mullinjve në operim në TC Kosova A (kaldaja A-3)	H/L: 4
7 maj 2018 (e hënë)	Takimi për simulimin e rrjedhës së gazit në FES me UP	H/L: 5
8 Maj 2018 (e martë)	Seminar (Për rezultatet e hulumtimit të FES-it dhe masat për përmirësimin e performancës)	H/L: 7
17 maj 2018 (e enjte)	Hulumtimi i metodës së analizës së Linjtit (në INKOS) Hulumtimi i objektit të kaldajës së TC Kosova A	INKOS: 1 H/L: 4
18 maj 2018 (e premte)	Takimi për simulimin e rrjedhës së gazit në FES me UP	H/L: 3
25 maj 2018 (e premte)	Takimi i raportimit për grupin për kaldaja	H/L: 7
28 Maj 2018 (e hënë)	Takimi për simulimin e rrjedhës së gazit në FES me UP	H/L: 2
29 Maj 2018 (e martë)	Seminar (Masat mjedisore për IDM-të)	H/L: 10

1) Masat për zvogëlimin e Pluhurit

FES-të në TPP Kosova A (A-3, A-4 dhe A-5), të cilat janë të projektuara të kenë përmbajtje të Pluhurit në dalje jo më tepër se 50 mg/Nm³, janë ripërtërirë në vitin 2012 (të prodhuara nga Hamon Thermal Germany GmbH në Gjermani). Megjithëse matësit e pluhurit të instaluar në dalje të FES-ve kanë treguar vlerë më të vogël se 50 mg/Nm³, bazuar në ngjyrën e tymit nga oxhaku ishte dukshëm më i lartë se 50 mg/Nm³, dhe vlerat e matura në Aktivitetet Paraprake treguan vlera të larta prej 200~600mg/Nm³. Për


këtë arsye, këta FES kanë mundësinë që ta përmbushin VKE-në ($50\text{mg}/\text{Nm}^3$) nëse sqarohen dhe zgjidhen shkaqet e performancës së dobët.

JET-i ka bërë inspektimin e FES-ve në TC Kosova A në dhjetor të vitit 2017. Zvogëlimi në performancë supozohet se shkaktohet nga caktimi i papërshtatshëm i kontrollit të energjizimit elektrik të FES-it, mirëmbajtja jo e duhur e elektrodave dhe mos-uniformiteti i shpërndarjes së rrjedhës së gazit brenda FES-it.

Bazuar në gjetje të këtyre fakteve në prill të viti 2018, Projekti u përqendruar në përmirësimin e uniformitetit të rrjedhës së gazit, dhe siç është paraqitur në Figura 3-36, ka kryer matjen e shpërndarjes së rrjedhës së ajrit brenda FES-it të kaldajës A-5 dhe siç është paraqitur në Figura 3-37, është gjetur se kishte shumë pak rrjedhë në pjesën e fundme të FES-it, dhe matja konfirmoi domosdoshmërinë për përmirësimin e rrjedhës së gazit.



Takimi për Procedurën e Testit të FES-it



Shtylla Mbështetëse e Pllakës Mbledhëse




Grilat (pjesa e sipërme)



Anemometri me tel-të-nxehtë

Pamja poshtë nga maja e FES-it



Çikriku i varur për pajisjen për matjen e rrjedhës



Kontrulli i operimit të pajisjes për matjen e rrjedhës

Pajisja për varjen e instrumentit për matjen e shpejtësisë Kontrolli i operimit në pjesën e poshtme të FES-it

Figura 3-36 Pasqyra e brendësisë së FES-it dhe situata e aktivitetit




Figura 3-37 Rezultati i matjes së shpërndarjes së shpejtësisë brenda FES-it

Nga maji i vitit 2018, në bashkëpunim me UP filluan studimet për të krijuar rrjedhë uniforme të gazit brenda FES-it duke përdorur modelin kompjuterik CFD duke reflektuar rezultatet e matjes.

Për më tepër, përmes monitorimit të gjendjes së ngarkimit elektrik në pajisjen e kontrollit të FES-it në kaldajën A-4, u konfirmua se shpesh ndodhte dukuria e ashtuquajtur "Korona Kthyesë" (jonizimi i kundërt) i shkaktuar nga përbërja e hirit të linjtit, që përkeqëson performancën e FES-it, dhe Projekti rekomandoi futjen në funksion të "Kontrollit të Energjizimit me Ndërprerje" në mënyrë që të zvogëlohet kjo dukuri. Kjo është metoda më ekonomike pa investim të madh, por për t'u aplikuar ky sistem i përmirësuar i kontrollit është e nevojshme që të konfirmohet nëse ky sistem i kontrollit është i aplikueshëm në sistemin ekzistues apo jo. Nëse konfirmohet se është e aplikueshme, është e lehtë të programohet nga inxhinieri i prodhuesit. Projekti kërkoi nga TC Kosova A që ta pyesë prodhuesin për mundësinë e aplikimit të këtij kontrolli, dhe vlerësimin e kostos nëse është i zbatueshëm.

Në anën tjetër, si rezultat i testeve të ndryshme përmes ndryshimit të kushteve të operimit të kaldajës u konfirmua se djegia me shkallë të ulët të ajrit tepricë (operimi me nivel të ulët të O_2 në gazin e shkarkuar) kontribuoi jo vetëm në zvogëlimin e emisioneve të NO_x por gjithashtu në përmirësimin e efikasitetit të mbledhjes së Pluhurit të FES-it. Mirëpo, gjetur se SO_2 është rritur.

2) Masat për zvogëlimin e SO_2

Në Aktivitetet Paraprake SO_2 në gazin e shkarkuar zakonisht ka treguar vlerë relativisht të lartë prej 600-800 mg/Nm^3 , por nganjëherë është parë që niveli i SO_2 bie në pothuajse 0 mg/Nm^3 . Kjo dukuri supozohet se shkaktohet nga reaksioni i de-sulfurimit në vatër për shkak të ekzistencës së CA në linjit. Nëse faktorët të cilët gjenerojnë këtë dukuri bëhen të qartë mendohet se është e mundshme të mbahet niveli i ulët i SO_2 duke përmirësuar operimet e kaldajës dhe/ose duke kontrolluar përbërjen e

linjtit të furnizuar.

Për sa i përket hulumtimit të sjelljes së SO₂ në gazin e shkarkuar në TC Kosova A, rezultatet e matjes së gazit të shkarkuar në kaldajën A-4 që u kryen në muajin prill janë paraqitur në Figura 3-38. Trendët e SO₂ tregojnë vlerë të ulët të ndikuar nga de-sulfurimi në vatër njëjtë si në Aktivitetet Paraprake. Në muajin maj u planifikuan testet për të sqaruar se çfarë parametra të operimit të kaldajës do të kontribuonin në zvogëlimin e nivelit të SO₂ me ndryshimin kushteve të djegies në vatrën e kaldajës A-4.

Pasi që kaldaja A-4 u ndal për shkak të rrjedhjes në tubin e kaldajës, testet u kryen në kaldajën A-3. Mirëpo, në kaldajën A-3 SO₂ asnjëherë nuk tregoi vlerë të ulët dhe vazhdoi të gjenerohet nivel i lartë e SO₂, gjë që nuk ishte matur kurrë më parë, siç është paraqitur në Figura 3-39.

Ky nivel i lartë i SO₂ ishte pothuajse i barasvlershëm me konvertimin e të gjithë sulfurit (Sulfuri total) në linjit në SO₂ gjatë procesit të djegies. Kjo ishte kontradiktore me pikëpamjen të cilën e kishte inxhinieri i KEK-ut, se vetëm sulfuri i djegshëm (organik) në linjit konvertohet në SO₂.

Për ta hetuar shkakun e kësaj dukurie, JET-i konfirmoi strukturën e sistemit të djegies së kaldajës nga departamenti teknik i termocentralit. Në takimin e Grupit për kaldaja më 25 maj 2018, JET-i shpjegoi për shkaqet e supozuara të cilat aktualisht ishin duke u marrë parasysh. Meqenëse është e nevojshme të sqarohet nëse kjo dukuri është specifike për kaldajën A-3 ose e mundshme për kaldajat e tjera nën kushte të caktuara, JET-i kërkoi nga KEK-u që vatë ta bëjnë matjen e gazit të shkarkuar dhe ta bëjnë krahasimin e rezultateve kur kaldaja A-4 të fillojë operimin.

Rezultatet e matjes së kësaj here treguan vazhdimisht vlerë të lartë të SO₂. Dukuri e vlerës së SO₂ afër zeros supozohet se kërkon kushte dhe arsye specifike. Për t'i gjetur kushtet, është e nevojshme që të identifikohen kushtet dhe të studiohet arsyeshmëria e krijimit të tyre. Kushtet nuk janë specifikuar ende dhe supozohet se nuk është e lehtë që kushtet të krijohen gjatë gjithë kohës. Për këtë arsye, është e vështirë që të përmbushte VKE prej mg/Nm³ vetëm me de-sulfurim në vatër deri në vitin 2023.




Figura 3-38 Rezultatet e matjes së gazit të shkarkuar në TC Kosova A Kaldaja A-4




Figura 3-39 Rezultatet e matjes së gazit të shkarkuar në TC Kosova A Kaldaja A-3

3) Masat për zvogëlimin e NO_x

Në Aktivitetet Paraprake dhe në periudhën e Projektit, niveli i NO_x në gazin e shkarkuar zakonisht qëndronte në 400~800 mg/Nm³ i ndikuar nga përmbajtja e azoti në linjit dhe pothuajse vlerë e njëjtë pritet përdërisa përmbajtja e azotit në linjit nuk ndryshon shumë. VKE prej 500 mg/Nm³ në vitin 2018 mund të jetë e arritshme duke aplikuar kufizime të azotit në linjit ose përmirësime të operimit të flakadanit të kaldajës. Mirëpo, për ta arritur VKE-në prej 200 mg/Nm³ në vitin 2023, së paku duhet të instalohet flakadani me nivel të ulët të NO_x. Edhe nëse instalohet flakadani me nivel të ulët të NO_x, ende kërkohet të bëhet studimi i efektit të ajrit të furnizuar jo nga flakadanë por nga pjesë të tjera të kaldajës.

(2) Periudha e dytë dhe aktivitetet shtesë në periudhën e tretë

Studimi i masave për zvogëlimin e emisioneve për IDM-të ka qenë synim vetëm për TC Kosova A. Në TC Kosova A asnjë ndotës nuk është në pajtueshmëri me VKE-të, prandaj aktiviteti i kryer ishte kryesisht studimi për përmirësimin e performancës së FES-it dhe efektit të de-sulfurimit në vatër përmes analizës së sjelljes së SO₂.

Në periudhën e dytë, për sa i përket përmirësimit të performancës së FES-it për t'i zvogëluar emisionet e Pluhurit, JET-i ia ka shpjeguar GP-H/L masat konkrete (përmirësimi i shpërndarjes së rrjedhës së gazit brenda FES-it, aplikimi i kontrollit të energjizimit me ndërprerje dhe zvogëlimi i shkallës së rrjedhës së gazit të shkarkuar), dhe më pastaj i ka propozuar ato tek personeli i TC Kosova A duke përfshirë drejtorët ekzekutivë të KEK-ut. Si rezultat, TC Kosova A ka pranuar propozimin dhe në mënyrë aktive do t'i promovojnë vetë këto përmirësime. Për sa i përket çështjes së përmirësimit të shpërndarjes së rrjedhës së gazit brenda FES-it, u propozua masa konkrete të cilën JET-i dhe UP e studiuuan dhe finalizuan bazuar në rezultatet e llogaritjes të kryera në periudhën e parë. Përmirësimi i

shpërndarjes së rrjedhës së gazit në FES do të zbatohet nga stafi i TC Kosova A.

Për sa i përket futjes në funksion të Kontrollit të Energjizimit me Ndërprerje, mundësia e aplikimit është konfirmuar nga prodhuesi. Mirëpo, ishte e nevojshme të thërritej inxhinieri nga prodhuesi, dhe për këtë arsye TC Kosova A i ofroi sqarimet e nevojshme për menaxhmentin e lartë të KEK-ut duke përfshirë kërkesën për alokimin e buxhetit. Pasi që TC Kosova A po planifikonte ta mësonte jo vetëm futjen në funksion të kontrollit të energjizimit me ndërprerje, por gjithashtu përvetësimin e njohurisë për tërë sistemin e kontrollit, JET përpiloi kërkesën me specifikime për prodhuesin e FES-it dhe ia dorëzoi atë KEK-ut. Për sa i përket punës së modifikimit për ta përmirësuar shpërndarjen e rrjedhës së gazit brenda FES-it, JET-i ka përpiluar manualin e punës i cili është përgatitur bazuar në skicat e detajuara të FES-it dhe ia ka shpjeguar këtë stafit të TC Kosova A.

Studimi për përmirësimin e shpërndarjes së rrjedhës së gazit është kryer përmes bashkëpunimit industri- akademi duke përfshirë UP, KEK-un dhe JET-in, dhe ky është rasti i parë i këtij lloji të bashkëpunimi në Kosovë, i cili konsiderohet si një ndër arritjet e mëdha të këtij projekti.

Ndërkohë, në periudhën e zgjatur të periudhës së tretë, Projekti studioi efektin e zvogëlimit të ngarkesës. Paralelisht, Projekti ka kryer testin për dallimin ndërmjet rezultateve të matjes midis analizatorit automatik të gazit dhe analizës me Metodën Standarde Referente, dhe kjo është përshkruar në 3-5-1 (2) 2).

Puna e modifikimit në hyrjen e FES-it duke përfshirë modifikimin e pllakave udhëzuese (pllakat për rregullimin e drejtimit të rrjedhës brenda FES-it) u krye në mars 2019 në kanal-in-C të kaldajës No.5 në TC Kosova A, rezultati i modifikimit u kontrollua nga JET-i. JET-i ka kontrolluar rezultatet e modifikimit dhe ka matur shpërndarjen e shpejtësisë së rrjedhës brenda FES-it para startimit të kaldajës dhe është konfirmuar përmirësimi i shpërndarjes së rrjedhës së gazit. Pas startimit të kaldajës Projekti ka matur përmbajtjen e Pluhurit si test të performancës dhe ka konfirmuar performancën e përmirësuar përmes modifikimit për përmirësimin e shpërndarjes së rrjedhës së gazit dhe zvogëlimit të shkallës së rrjedhës së gazit të shkarkuar.

Në anën tjetër, për sa i përket kontrollit të energjizimit me ndërprerje për FES, nga prodhuesi i FES-it ishte kërkuar ta dërgonte një inxhinier, por nuk kishte përgjigje ndaj kërkesave të panumërta nga KEK-u. Punëtorja u mbajt në mënyrë që inxhinierët në TC Kosova t'i përmirësojnë njohuritë e tyre, në mënyrë që ta kuptojnë kontrollin e energjizimit me ndërprerje dhe të përgatiten për të ardhmen kur të dërgohet inxhinieri nga prodhuesi.

Për sa i përket SO₂, në fillim shpesh është matur vlerë e ulët e cila ishte afër zeros, por me përsëritjen e matjeve shpesh gjithashtu është parë vlerë shumë e lartë e SO₂. Në të kaluarën, KEK-u ka menduar se vetëm sulfuri i djegshëm²⁸ (sulfuri organik) në linjit konvertohet në SO₂ dhe de-sulfurimi në vatër nganjëherë çonte kah vlerat afër zeros. Mirëpo, është e vështirë të shpjegohet përmes këtij supozimi përse vërehet shpesh vlerë kaq e lartë e SO₂.

²⁸ Sulfuri i zbritur nga sulfuri total mbetet pas nxehjes për dy orë në furrë elektrike në temperaturë prej 815±10°C. dhe gjithashtu quhet "Sulfur Organik"

Për më tepër, megjithëse kushtet e operimit të kaldajës janë të njëjta, ka luhatje të mëdha të SO₂ gjatë ditës së njëjtë. Dukuria si duket ndikohet nga luhatja e përbërjes së linjtit.

Prandaj, për t'i hetuar shkaqet, u krye analiza në bazë të dhënave të matjeve për katër vitet e fundit, duke përfshirë të dhënat nga aktiviteti paraprak, dhe u bë analiza e faktorëve të cilët ndikojnë në de-sulfurimin në vatër. Si rezultat, ka dalë në pah se janë të rëndësishme tri elemente (Temperatura e gazit, Përqendrimi i oksigjenit në gazin e shkarkuar dhe Koha e qëndrimit në shtrirjen e zonës së reaksionit për de-sulfurim. Për t'i konfirmuar këto hipoteza dhe përmes diskutimeve me H/L në lidhje me masat e mundshme që mund të zbatoheshin në operacionin aktual të kaldajës, janë kryer testet e mëposhtme.

- Operimi me nivel të ulët të O₂ në gazin e shkarkuar për ta zvogëluar sasinë e ajrit të djegies
- Rritja e vlerës së përcaktuar të temperaturës në dalje të mullirit brenda zonës së lejuar
- Ndryshimi i sasisë së ajrit të furnizuar tek skara (skarë në formë të zinxhirëve të hekurit për djegien e grimcave të mëdha të linjtit që bien në fund) e cila është e instaluar në fund të vatrës

Duhet të ceket se testi për ta konfirmuar sjelljen e SO₂ përmes ndryshimit të hapjes së flegres së flakadani gjatë djegies dhe testi me ngarkesë më të ulët të kaldajës nuk janë bërë pasi që kanë qenë shumë të papërshtatshme për stafin e TC-së.

Kur është aplikuar djegia me nivel të ulët të O₂ tepricë (zvogëlimi i sasisë së ajrit për djegie), NO_x mund të zvogëlohej, por SO₂ rritej shumë.

Në operimin me rritje të vlerës së përcaktuar të temperaturës në dalje të mullirit dhe ndryshimit të sasisë së rrjedhës së ajrit të furnizuar tek skara në pjesën e poshtme të vatrës, është konfirmuar se NO_x nuk ndryshon shumë, por SO₂ ndryshon ndjeshëm.

Gjithashtu është e mundshme të aplikohet djegia e simuluar me dy faza²⁹ dhe lënda djegëse me përparësi³⁰ si masa të zvogëlimit të NO_x, të cilat mund të aplikohen në kaldajat ekzistuese. Mirëpo, nga inspektimi i hapjes aktuale të flegres së kaldajës (flegra e sipërme është plotësisht e hapur dhe flegra e poshtme është e hapur 50%), pasi që janë të caktuara afër djegies së simuluar me dy faza, nuk mund të pritët zvogëlimi i NO_x. Ekziston edhe një metodë për ta rritur sasinë e lëndës djegëse hyrës nga flakadani i nivelit më të ulët për të arritur djegien e ngadaltë, por për ta rritur sasinë e lëndës djegëse hyrëse nga flakadani më i ulët. Kërkohet operimi më i ndërlikuar dhe rritet sasia e grimcave të padjegura që bien në pjesën e fundme të vatrës. Prandaj, duket se është vështirë për ta ndryshuar shpërndarjen aktuale të caktuar të lëndës djegëse hyrëse.

²⁹ Ajri i djegies furnizohet nga dy faza. Ajri i fazës së parë furnizohet nga flakadani bashkë me lëndën djegëse dhe ajri i fazës së dytë furnizohet nga pjesa e sipërme e flakadani. NO_x zvogëlohet duke e bërë djegien më të ngadaltë.

³⁰ Kur flakadanët janë të vendosur në drejtimin e lartësisë, përgjatë drejtimit të lartësisë furnizohet sasi e ndryshme e lëndës djegëse. Në këtë rast, flakadanët me ajër të pamjaftueshëm të djegies formojnë mjedisin e zvogëlimit ku NO_x pothuajse nuk prodhohet.

Tabela 3-106 Aktivitetet për masat për zvogëlimin e pluhurit në TC Kosova A (Periudha e dytë dhe aktivitetet shtesë në periudhën e tretë)

Data	Aktiviteti	Pjesëmarrës
19 tetor 2018 (e premte)	Lart Takimi për rezultatet e simulimit të rrjedhës së gazit në FES	H/L dhe UP: 5
22 tetor 2018 (e hënë)	Diskutimi për çështjet dhe Plani i punës në periudhën e dytë	H/L: 7
22 tetor 2018 (e hënë)	UP, Konfirmimi i materialeve të prezantimit për simulimin	H/L dhe UP: 4
23 tetor 2018 (e martë)	Prezantimi për përmirësimin e performancës së FES-së të TC Kosova A	H/L dhe KEK-u: 13
24 tetor 2018 (e mërkure)	Takimi për zbatimin e përmirësimit të performancës së FES-së	H/L dhe KEK-u: 6
25 tetor 2018 (e enjte)	Prezantimi i përmirësimit të performancës së FES-së për Drejtorët e KEK-ut	H/L dhe KEK-u: 5
30 tetor 2018 (e martë)	Zvogëlimi i tymit të zi gjatë startimit të kaldajës në TC Kosova A Përmirësimi i kontrollit të energjizimit elektrik të FES-së	H/L dhe KEK-u: 6
31 tetor 2018 (e mërkure)	Plani i testit për zvogëlimin e NOx në TC Kosova A	H/L dhe KEK-u: 3
1 nëntor 2018 (e enjte)	Punëtorja për FES	H/L dhe KEK-u: 8
5 nëntor 2018 (e hënë)	Procedura e testit për zvogëlimin e NOx në TC Kosova A	H/L dhe KEK-u: 8
6 nëntor 2018 (e martë)	Testi për zvogëlimin e NOx në TC Kosova A	H/L dhe KEK-u: 5
6 nëntor 2018 (e martë)	Udhëzimet për modifikimin e FES-së	H/L dhe KEK-u: 6
8 nëntor 2018 (e enjte)	Diskutimi për PKZE	H/L dhe KEK-u: 3
9 nëntor 2018 (e premte)	Punëtorja për masat mjedisore për IDM	H/L dhe KEK-u: 7
21 mars 2019 (e enjte)	Konfirmimi i situatës së KEK-ut për sa i përket përmirësimit të FES-së	H/L dhe KEK-u: 2
22 mars 2019 (e premte)	Procedura e matjes së shpërndarjes së rrjedhës së ajrit në TC Kosova A	H/L dhe KEK-u: 2
25 mars 2019 (e hënë)	Procedura e matjes së shpërndarjes së rrjedhës së ajrit në TC Kosova A	H/L dhe KEK-u: 4
28 mars 2019 (e enjte)	Punëtorja për zvogëlimin e SO ₂ të TC Kosova A	H/L dhe KEK-u: 8
29 mars 2019 (e premte)	Punëtorja për kontrollin e energjizimit elektrik të FES-së së TC Kosova A	H/L dhe KEK-u: 5
1 prill 2019 (e hënë) deri 4 prill (e enjte) 2019	Matja e gazit të shkarkuar për verifikimin e përmirësimit të performancës së FES-së në TC Kosova A (Pluhuri, SO ₂ , NOx)	H/L dhe KEK-u: 4

8 prill 2019 (e hënë)	Punëtorja për zvogëlimin e SO ₂ NO _x përmes përmirësimit të operimit të kaldajës	H/L dhe KEK-u: 3
10 prill 2019 (mërkure) deri 11 prill (e enjte) 2019	Testi për zvogëlimin e SO ₂ dhe NO _x në TC Kosova A	H/L dhe KEK-u: 4
12 prill 2019 (e premte)	Punëtorja për përmirësimin e performancës së FES-së	H/L dhe KEK-u: 9
15 prill (e hënë) deri 18 prill (e enjte) 2019	Testi për zvogëlimin e SO ₂ dhe NO _x në TC Kosova A	H/L dhe KEK-u: 3
24 prill 2019 (e mërkure)	Punëtorja për zvogëlimin e misioneve të IDM-ve	H/L dhe KEK-u: 10
Aktivitetet shitesë në periudhën e tretë		
19 nëntor 2020 (e premte)	Diskutimi për rezultatet e matjes së gazit të shkarkuar në TC Kosova A	H/L: 2
19 nëntor 2020 (e enjte)	Diskutimi për rezultatet e matjes në TC Kosova A	H/L: 2
19 mars 2021 (e premte)	Diskutimi për rezultatet e matjes në TC Kosova A	H/L: 3

1) Masat për Zvogëlimin e Pluhurit

Si masa për përmirësimin e performancës së FES-it për zvogëlimin e Pluhurit u propozuan tri pikat e mëposhtme, dhe u bë zbatimi dhe verifikimi i tyre.

i) Barazimi i shpërndarjes së rrjedhës së gazit

Bazuar në rezultatet e llogaritjes së shpërndarjes së rrjedhës duke përdorur analizën kompjuterike, është bërë ndryshimi i formës së një pjese të pllakës udhëzuese, dhe heqja e pjeseshme e njërës pllakë kufizuese në hyrje FES-it të kanalit-C të kaldajës Nr.5. Siç tregohet në krahasimin e rezultateve të analizës, ky modifikim synon të mundësojë rrjedhën e gazit në pjesën e fundme të FES-it ku nuk është vërejtur rrjedhë, dhe të krijojë rrjedhë uniforme përgjatë gjithë prerjes tërthore të FES-it. Kjo është kryer në bazë të planit të modifikimit të paraqitur në Figura 3-40.




Figura 3-40 Plani i punës së modifikimit të hyrjes së FES-it

Matja e shpërndarjes së shpejtësisë së rrjedhës në FES pas modifikimit është kryer brenda një periudhe kohore shumë të kufizuar për shkak se kaldaja duhej të fillonte punën shumë shpejt, prandaj mund të matej vetëm pjesa e poshtme në hyrje të FES-it.

Siç është paraqitur në Figura 3-41, rrjedha e gazit në këtë pjesë është përmirësuar ashtu siç pritej.

Përmirësimi i shpërndarjes së rrjedhës me anë të Simulimit kompjuterik




Figura 3-41 Rezultatet e matjes së rrjedhës në hyrje të FES-it (Para dhe pas modifikimit)

Për ta vlerësuar performancën e FES-it pas modifikimit është bërë krahasimi i përmbajtjes së Pluhurit gjatë operimit të kaldajës ndërmjet asaj në FES të kanalit-C dhe asaj në kanalit-A të kaldajës A-5.




Figura 3-42 Aranzhimet e Kaldajës dhe FES-it në TC Kosova A

Testi i vlerësimit të performancës është kryer bashkë me testin e ndryshimit të shkallës së rrjedhës së gazit.

Bazuar në rezultatet e testit më 2 prill 2019, kur u konsiderua se përbërja e linjtit të djegur ishte e qëndrueshme gjatë periudhës së testimit, u konfirmua se FES i kanalit C që ishte modifikuar kishte performancë më të mirë se FES i kanalit A që nuk ishte modifikuar.

Për më tepër, meqenëse performanca e FES-it ndikohet nga përbërja e hirit të linjtit, edhe në këtë test është konfirmuar se performanca e FES-it ka ndryshuar

gjatë kohës. Ndryshimi i performancës është supozuar të jetë ndikuar nga "Dukuria e koronës kthyese" për shkak të rezistencës së lartë elektrike të Pluhurit. Kontrolli i Energjizimit me Ndërprerje është efektiv për këtë lloj të dukurisë, por Projekti nuk ka mundur ta vlerësojë efektivitetin pasi që Kontrolli i Energjizimit me Ndërprerje ende nuk është futur në funksion.

ii) Zvogëlimi i rrjedhës së gazit

Kaldajat e TC Kosova A janë duke operuar nën sasi të madhe rrjedhës së gazit në krahasim me kaldajat që kanë prodhim të njëjtë, dhe në të njëjtën kohë, temperatura e gazit në hyrje të FES-it është më e lartë se temperatura e projektuar. Prandaj, FES është duke operuar nën shkallë më të lartë të rrjedhës së gazit se sa vlera e projektuar.

Për këtë arsye, zvogëlimi i shkallës së rrjedhës së gazit do të jetë i dobishëm në terme të performancës së FES-it, dhe për këtë arsye është kryer testi i lartpërmendur i performancës duke zvogëluar rrjedhën e gazit bashkë me konfirmimin e modifikimit të lartpërmendur në hyrje të FES-it. Si rezultat, performanca e FES-it është konfirmuar të jetë përmirësuar me zvogëlimin e shkallës së rrjedhës së gazit dhe rezultatet pothuajse përbushin VKE-të për vitin 2018. Përveç efektit të zvogëlimit të sasisë së gazit, kjo është konsideruar se ndodh për shkak të faktit se temperatura e operimit gjithashtu zvogëlohet dhe gjendja e energjizimit elektrike të FES-it është përmirësuar.

Metodat në vijim mund të përmenden si metoda për ta zvogëluar shkallën e rrjedhës së gazit të shkarkuar nga kaldaja.

- (a) Zvogëloni shkallën e rrjedhës së ajrit të djegies përmes djegies me nivel të ulët të O₂ në gazin e shkarkuar
- (b) Zvogëlimi rrjedhjes së ajrit nga ana e ajrit në anën e gazit në para-nxehës të ajrit
- (c) Zvogëloni shkallën e rrjedhës së ajrit tek Skara në pjesën e fundme e vatrës
- (d) Zvogëloni ajrin ftohës të dizat e flakadanit i cili nuk është në operim
- (e) Zvogëloni infiltrimin e ajrit në kaldajë përmes hapësirës ndërmjet murit të kaldajës dhe tubacionit hyrës në vatër, etj.

Si rezultat i testeve të kryera në (a), u konfirmua përmirësimi i performancës së mbledhjes së Pluhurit të FES-it dhe CO nuk u rrit për shkak të djegies së paplotë, por SO₂ u rrit ndjeshëm. Prandaj, është e vështirë të zbatohet kjo metodë në objektet aktuale.

Sasia e rrjedhjes së ajrit në para-nxehësin e ajrit u llogarit në bazë të përmbajtjes së O₂ në gazin e shkarkuar në hyrje dhe dalje të para-nxehësit të ajrit. Si rezultat, u konstatua se ka rrjedhje të rreth 50% të ajrit teorik të nevojshëm për djegie. Rrjedhja e ajrit në para-nxehësin e ajrit mund të jetë shkaktuar nga

rregullimi joadekuat ose përkeqësimit të mekanizmit mbyllës që ndan anën e ajrit nga ana e gazit të para-nxehësit të ajrit. JET-i shpjegoi procedurën e rregullimit të mekanizmit mbyllës dhe rekomandoi të kryhej rregullimi.

Për sa i përket (c), (d) dhe (e), mendohet se zbatimi është i vështirë për shkak se është e nevojshme të ndryshohet struktura e kaldajës dhe/ose kaldaja e vjetër të rinovohet plotësisht.

2) Masat për zvogëlimin e SO₂

Kur u bë matja e SO₂ fillimisht në Aktivitetet Paraprake, u vërejt vlerë e ulët dhe nganjëherë tregoi vlerë afër zeros. Prandaj, mendohet se në kaldajën me djegie të linjtit vetëm sulfuri i djegshëm (organik) në linjit shndërrohet në SO₂. Megjithatë, pasi u përsërit matja është gjetur se vlera shpesh tejkalon 1,000 mg/Nm³ dhe nganjëherë rritet deri në 2000 mg/Nm³ ose më shumë. Përveç kësaj, u zbulua gjithashtu se SO₂ luhatet shumë edhe pa ndryshime në kushtet e operimit të kaldajës dhe gjithashtu është shumë e vështirë të tregojë vlera të qëndrueshme dhe konstante brenda një dite siç është paraqitur në Figura 3-43. Mendohet se efekti i de-sulfurimit në vatër luhatet për shkak të ndryshimit të kushteve të djegies të shkaktuar nga ndryshimi i përbërjes së linjtit.

Pasi që linjiti furnizohet në mënyrë të drejtpërdrejt nga miniera e thëngjillit, është e vështirë që gjithmonë të furnizohet linjiti me përbërje të qëndrueshme. Prandaj, është e nevojshme të hulumtohen faktorët për arritjen e efikasitetit të lartë të de-sulfurimit në vatër dhe të konsiderohet mundësia e përballimit të ndryshimeve gjatë operimit të kaldajës.

Prandaj, është kryer analiza e të dhënave të mbledhura nga projekti, dhe në bazë të rezultateve janë hulumtuar masat e mundshme përmes ndryshimit të metodës së operimit të kaldajës.




Figura 3-43 Sjellja e Përqendrimit të SO₂

i) Rezultatet e analizës së sjelljes së SO₂

Për sa i përket të dhënave të mbledhura nga viti 2017 deri 2018 të paraqitura në Tabela 3-107, është bërë analiza lidhur me marrëdhënien midis kushteve të operimit të kaldajës dhe përbërjes së gazit të shkarkuar. Analiza e linjtit ishte në dispozicion vetëm për datat e shënuara me ngjyrë të gjelbër në tabelë, por gjithashtu janë analizuar të dhënat pa analiza të linjtit nga pikëpamja e de-sulfurimit në vatër.

Tabela 3-107 Të dhënat e regjistruara

Nr.	Data	Kaldaja	Kanali	Nr.	Data	Kaldaja	Kanali
1	20 Mars 2017	A-4	A, B	8	2 maj 2018	A-3	B
2	11 prill 2017	A-4	B	9	3, 7 maj 2018	A-3	B
3	11 prill 2017	A-4	A	10	21 shtator 2018	A-4	A, B
4	12 prill 2017	A-4	B	11	25 shtator 2018	A-3	B, C
5	13 prill 2017	A-4	B, C	12	26 shtator 2018	A-5	B
6	18, 19, 20, 23 prill 2018	A-4	B	13	5 nëntor 2018	A-3	B
7	30 prill 2018	A-3	A	14	6 nëntor 2018	A-3	B

; Ekzistojnë rezultatet e analizës së linjtit

Në analiza, të dhënat për operimin e kaldajës, të dhënat e matjes së gazit të shkarkuar dhe analizat e linjtit janë krahasuar në periudha kohore, dhe është kryer analiza e marrëdhënies ndërmjet elementeve (Ca, S, O₂, Temperatura e gazit, dhe Ngarkesa e kaldajës) dhe SO₂ në mënyrë që të kryhet në mënyrë efikase de-sulfurimi në vatër. Rezultatet e analizës janë paraqitur në Figura 3-44~Figura 3-49.




Figura 3-44 Ndryshimi i SO₂ për kanal




Figura 3-45 O₂ kundrejt. SO₂, NOx




Figura 3-46 Temperatura e gazit kundrejt SO₂




Figura 3-47 S Organik kundrejt SO₂




Figura 3-48 Materia e avullueshme kundrejt SO₂




Figura 3-49 Ca, S në Linjit

Rezultatet e analizës janë përmbledhur në Tabela 3-108.

Tabela 3-108 Përmbledhja e rezultateve të analizës


Pika	Rezultatet e analizës së të dhënave
1 Përqendrimi i SO ₂ dhe NO _x	<ul style="list-style-type: none"> • Ka luhatje të madhe të nivelit të SO₂ gjatë ditës. (0 deri 2500 mg / Nm³) • Megjithëse nuk ka luhatje të madhe të nivelit të NO_x gjatë një dite, megjithatë ka ndryshime deri në një shkallë. • Ka ndryshime të përqendrimit të SO₂ dhe NO_x ndërmjet Kanaleve.
2 Ndikimi i O ₂	<ul style="list-style-type: none"> • Kur niveli i O₂ është i ulët, me zvogëlimin e O₂ rritet SO₂. • Kur niveli i O₂ është i lartë, me rritjen e O₂ rritet SO₂.
3 Temperatura e Gazit në Vatër	<ul style="list-style-type: none"> • Dallimi i temperaturës ndërmjet anës së majtë dhe anës së djathtë shpesh është i madh. • Nuk tregon domosdoshmëri temperaturën e zonës së reaksionit të desulfurizimit. • Për secilën flakë nga flakadani ka shkallë të lartë/ulët të de-sulfurimit. • Kur temperatura është më e ulët se 800 °C ose më e lartë se 900°C përqendrimi i SO₂ është i lartë. • Megjithatë kur ngarkesa është e ulët, në temperaturë nën 700 °C përqendrimi i SO₂ është i ulët.

4	Analiza e Linjtit	<ul style="list-style-type: none"> • Megjithëse ka variacione në vlerën kalorike, komponenti S, etj., marrëdhënia me përqendrimin e SO₂ nuk mund të specifikohet. • Nëse i tërë S shndërrohet në SO₂ kur S në linjit është 1% (Bazë e Thatë), është 3000 mg/Nm³, që do të thotë se gjithmonë ndodhë reaksioni i de-sulfurimit. • Sa më i lartë të jetë raporti KF/MA aq më i lartë duket të jetë përqendrimi i SO₂. • Përbërja e Ca në linjit është 4 ose më shumë e raportit Ca/S.
5	Lokacioni i Mullirit i cili nuk është në Operim	<ul style="list-style-type: none"> • Si duket nuk ka marrëdhënie ndërmjet përqendrimit të SO₂ dhe cili mulli është ndalur. • Mirëpo, ekziston marrëdhënia ndërmjet temperaturës së gazit në dalje të vatrës dhe çekuilibrit të O₂ në dalje të kaldajës.
6	Ngarkesa e Kaldajës	<ul style="list-style-type: none"> • Me zvogëlimin e ngarkesës së kaldajës, përqendrimi i SO₂ dhe NO_x zvogëlohet. • Gjatë ndryshimit të vogël në ngarkesë nuk është e qartë për shkak të ndikimit të faktorëve të tjerë siç është O₂.

FC/VM: Karboni i fiksuar/Materia e avullueshme

Në reaksionin e de-sulfurimit në vatër, Kalciumi (Ca) që përmbahet në linjit dhe Ca në gëlqere (CaCO₃) ose treten në temperaturë të lartë për t'u shndërruar në CaO në vatër dhe de-sulfurimi kryhet përmes reaksionit të CaO të gjeneruar dhe SO₂ në gazin e djegies siç është paraqitur më poshtë. Performanca e reaksionit të de-sulfurimit në vatër ndryshon për shkak të raporti molar të Ca/S dhe temperaturës së gazit siç është paraqitur në Figura 3-50 dhe

Figura 3-51.



Duhet të plotësohen kushtet e paraqitura në Tabela 3-109, në mënyrë që të kryhet në mënyrë efikase reaksioni i de-sulfurimit në vatër.




Figura 3-50 Ca/S kundrejt efikasitetit të de-SO₂




Figura 3-51 Temperatura e gazit kundrejt efikasitetit të de-SO₂

Tabela 3-109 Kushtet e nevojshme për de-sulfurimin në vatër

Pika	Ndikimi në desulfurizim	Koment
1. Raporti Ca/S	Efekti në Efikasitetin e De-SO ₂	Raporti Ca/S mund të sigurohet përmes rezultateve të analizës së Linjtit
2. Temperatura	Temperaturë e përshtatshme është 825°C±25°C	Është e domosdoshme të sigurohet shtrirja e temperaturës në zonën e reaksionit.
3. Dendësia e O ₂	Reaksioni i De-SO ₂ ndodh me Atmosferë Oksiduese	Është e domosdoshme të sigurohet O ₂ në zonën e reaksionit.
4. Përzierja e Gëlqeres me Gazin nga Djegia	Nevojitet një përzierje e mirë	Përzierja duket të jetë e mirë për shkak se Linjiti përmban Ca
5. Madhësia e grimcës qarkulluese	Është e nevojshme të ketë reaksion në qendër të grimcës së CaO	Mirë pasi që nganjëherë SO ₂ bëhet Zero
6. Koha e Qëndrimit për Reaksion	Kërkohet kohë e mjaftueshme në zonën e temperaturës së përshtatshme të gazit	Djegia duhet të bëhet e plotë në zonën e reaksionit.

Nga rezultatet e mësipërme, pasi që linjiti i përdorur në TC Kosova A përmban sasi të madhe të Ca, injektimi shtesë i gurit gëlqeror nuk është i nevojshëm dhe për ta kryer në mënyrë efikase de-sulfurimin në vatër është e rëndësishme të krijohen kushtet siç vijon.

- a) Të krijohet temperatura e përshtatshme për reaksionin e de-sulfurimit në vatër
- b) Të sigurohet përqendrimi i O₂ në zonën e reaksionit të de-sulfurimit në vatër
- c) Të sigurohet koha e qëndrimit në zonën e reaksionit të de-sulfurimit në vatër

ii) Ekzaminimi i masave të përmirësimit për de-sulfurimin në vatër duke ndryshuar metodën e operimit të kaldajës

Si metodë e rregullimit të temperaturës së gazit në dalje të vatrës konsiderohen metodat e paraqitura në Tabela 3-110.

Mirëpo, pajisjet e TC Kosova A janë të vjetra dhe të degraduara, dhe rregullimi i tyre momentalisht është i vështirë, dhe për këtë arsye, parakusht është investimi në përmirësimin e pajisjeve.

Pasi që linjiti furnizohet në mënyrë të drejtpërdrejt nga miniera dhe është e vështirë që të deponohet në termocentral për kohë më të gjatë për shkak të vetive të tij ndezëse, dhe nuk është e mundur që të aplikohen metoda siç është rregullimi i cilësisë përmes përzierjes së linjtit me cilësi të dobët me linjtin me cilësi të lartë. Gjithashtu ekziston problemi se cilësia e linjtit e cila i furnizohet TC Kosova A nuk

është e qëndrueshme, pasi që linjiti i cilësisë relativisht të mirë në mënyrë favorizuese i furnizohet TC Kosova B

Kur përbërja e linjiti ndryshon është ideale të reagohet shpejt përmes operimit të kaldajës. Mirëpo, aplikimi është shumë i vështirë për shkak të investimit të madh të nevojitur si p.sh. për futjen në përdorim të kontrollit automatik.

Tabela 3-110 Metoda e rregullimit të temperaturës në dalje të vatrës

Parametri	Efekti	Masat
1 Absorbimi i nxehtësisë në vatër	Temperatura e gazit lëkundet në baza periodike me depozitim dhe rënien e Skories. Pas pastrimit të vatrës sasia e nxehtësisë e absorbuar nga muri i vatrës rritet dhe temperatura e gazit në dalje të vatrës zvogëlohet.	Pastrimi i rregullt
2 O ₂ tepricë	Kur rritet sasia e O ₂ tepricë shkalla e djegies rritet dhe temperatura e gazit në dalje të vatrës zvogëlohet, por NOx rritet. Për më tepër edhe sasia e gazit nga djegia rritet.	Rregullimi i rrjedhës së ajrit
3 Përbërja e linjtit	Temperatura e gazit në vatër lëkundet për shkak të ndikimit të shpejtësisë së djegies dhe shkëlqimit të flakës.	Zgjedhja e përbërjes së linjtit (vështirësitë e zbatimit)
4 Ajri nga Flakadani në operim	Temperatura e gazit në dalje të vatrës ndryshon varësisht nga shpërndarja e ajrit sekondar dhe terciar në nivelin e epërm, mesëm dhe poshtëm të flakadani. Temperatura e gazit në dalje të vatrës rritet nëse sasia e ajrit nga niveli i poshtëm zvogëlohet.	Rregullimi i hapjes së flegres
5 Ajri nga flakadanët e ndalur	Sasia e ajrit që rrjedhë për ftohje të flakadani i cili nuk është në operim nuk kontribuon aq në djegie, që rezulton në rritje të sasisë së gazit të djegies.	Zvogëlimi i ajrit për ftohje (E vështirë për shkak të djegies së Flakadani)
6 Ajri nga Fundi i Vatrës	Ajrit nga fundi i vatrës rrit sasinë e ajrit tek niveli i poshtëm i flakadani. Si rezultat flaka zhvendoset poshtë dhe temperatura e gazit në dalje të vatrës bie.	Zvogëlimi i ajrit tek Skara (E vështirë për shkak të djegies së Skarës)
7 Ngarkesa e Kaldajës	Kur zvogëlohet ngarkesa e kaldajës, sasia e nxehtësisë hyrëse në vatër zvogëlohet dhe sasia e gazit të djegies gjithashtu zvogëlohet. Efekti i zvogëlimit të Pluhurit, SO ₂ dhe NOx është i madh.	Deratizimi i ngarkesës së kaldajës (vështirësia?)
8 Vlera e përcaktuar e Temperaturës në dalje të mullirit	Kur vlera e përcaktuar rritet, sasia e gazit nga vatra e sjellë në mulli rritet, atmosfera inerte rritet në zonën e flakadani, shpejtësia e djegies ulët dhe temperatura e gazit në dalje të vatrës rritet.	Rritja e temperaturës së përcaktuar
9 Numrit i mullinjve në operim	Kur ngarkesa e mullirit rritet, sasia e gazit nga vatra e sjellë në mulli rritet për terjen e lagështisë së linjtit. Rezultati është i njëjtë si në 8.	Me numër më të vogël të Mullinjve në operim (e kufizuar nga kapaciteti i mullirit)
10 Fryrësi i Blozës	Temperatura e gazit në dalje të vatrës mund të mbahet e qëndrueshme duke kufizuar sasinë e Skories e cila ngjitet në murin e vatrës dhe duke stabilizuar absorbimin e nxehtësisë të mureve të vatrës.	Kërkohet investim kapital

Figura 3-52 tregon ajrin e furnizuar në vatër të kaldajës. Hapja e flegrave të flakadanëve që operohen në mënyrë manuale mbahet në të njëjtin pozicion, ndërsa vetëm flegrat të cilat operohen me motor mund të hapen dhe mbyllen

ndërsa mulliri funksionon ose ndalet.

Figura 3-53 tregon prerjen e tërthortë të vatrës dhe rregullimin e mullirit. Meqenëse ajri për ftohjen e dizës së flakadanit i furnizohet flakadanit i cili nuk është në operim, shkakton mos-baraspeshë të temperaturës së gazit dhe O₂ brenda vatrës.




Figura 3-52 Furnizimi i ajrit në vatër




Figura 3-53 Organizimi i mullirit dhe atmosfera e vatrës

iii) Testi i konfirmimit të ndikimit në de-sulfurim në vatër

Për ta konfirmuar sjelljen e SO₂ përmes ndryshimit të metodës së operimit të kaldajës janë kryer testet në vijim.

- Djegia me nivel të ulët të O₂ në gazin e shkarkuar
- Ndryshimi i vlerës së caktuar të temperaturës në dalje të mullirit
- Ndryshimi i rrjedhës së ajrit nga pjesa e fundme e vatrës

Testi me ngarkesë të ulur të kaldajës është kryer ndaras në aktivitetet shtesë në periudhën e tretë.

(Rezultatet e testit)

Në operimin me djegie me nivel të ulët të O₂ në gazin e shkarkuar, është vërejtur se SO₂ është rritur me zvogëlimin e O₂ në gazin e shkarkuar. Kjo ka gjasë se ndodhë për shkak të mungesës së O₂ në zonën e reaksionit të de-sulfurimit.

Si rezultat i ndryshimit të vlerës së caktuar të temperaturës në dalje të mullirit, është konfirmuar që temperatura e gazit në dalje të vatrës është rritur kur vlera e caktuar rritet. Mendohet se kur rritet vlera e caktuar, raporti i përzierjes së gazit të shkarkuar me ajrin primar rritet dhe raporti i ajrit që përmbahet në ajrin primar zvogëlohet, kështu që djegia në afërsi të pikës së ndezjes së flakadanit bëhet e ngadaltë dhe pozicioni i flakës zhvendoset lart.

Kur temperatura e gazit në dalje të vatrës është më e ulët se temperatura e përshtatshme për de-sulfurim në vatër, efikasiteti i de-sulfurimit përmirësohet dhe SO₂ zvogëlohet për shkak të rritjes së temperaturës së gazit, por efikasiteti i de-sulfurimit zvogëlohet nëse temperatura ngrihet më tej dhe tejkalon temperaturën e përshtatshme për de-sulfurim dhe SO₂ rritet.

Kur temperatura e gazit në dalje të vatrës është më e lartë se temperatura e përshtatshme për de-sulfurim në vatër, SO₂ rritet me shpejtësi me ngritjen e mëtejme të temperaturës së gazit.

Kur temperatura e gazit në dalje të vatrës është e lartë, nëse sasia e ajrit nga pjesa e fundme e vatrës³¹ rritet, sasia e ajrit të furnizuar tek niveli më i ulët i flakadanit rritet. Atëherë pozita e flakës zhvendose poshtë dhe temperatura e gazit në dalje të vatrës zvogëlohet. Është konfirmuar se kur temperatura e gazit të vatrës ishte më e lartë se temperatura e përshtatshme për de-sulfurim, zvogëlimi i temperaturës së gazit shkaktoi ulje të nivelit të SO₂.

Gjithashtu është konfirmuar se SO₂ ndryshon ndjeshëm edhe në qoftë se temperatura e gazit në dalje të vatrës ndryshon vetëm pak.

Nëse përbërja e linjtit është e qëndrueshme, shtrirja e ndryshimit të SO₂ është e vogël, dhe mund të jetë e mundur të kontrollohet SO₂ përmes rregullimit në mënyrë manuale të parametrave të operimit të kaldajës bazuar në SO₂ dhe kushtet e operimit të kaldajës në atë kohë.

Mirëpo, kur përbërja e linjtit nuk është e qëndrueshme dhe ndryshon shumë me kalimin e kohës, është e vështirë të përcillet përmes ndryshimit të metodës së operimit të kaldajës.

Në mënyrë që të jetë e mundur për t'u marrë me një rast të tillë, është e

³¹ Ajri i ftohtë drejtpërdrejt nga ventilatori i ajrit të djegies dhe ajri i nxehtë nga shkëmbyesi i nxehtësisë i furnizohen skarës në pjesën e fundme të kaldajës. Meqenëse sasia e ajrit të ftohtë është konstante, sasia e ajrit të nxehtë tek skara rritet kur sasia totale e ajrit rritet. Prandaj, temperatura e ajrit të furnizuar tek skara rritet dhe kjo temperaturë bëhet tregues i sasisë totale të ajrit të furnizuar tek kaldaja.

nevojshme të instalohet pajisja e monitorimit të kushteve të operimit të kaldajës, të dhënave të emisioneve në gazin e shkarkuar dhe kontrolli nga largësia i flegërës së flakadani i cili zakonisht është pjesë e integruar e kaldajave moderne, dhe pastaj duhet të futet në përdorim sistemi i avancuar i kontrollit, që përdor sistemin kompjuterik i cili në mënyrë automatike mund t'i rregullojë parametrat e operimit të kaldajës për ta arritur në mënyrë efektive de-sulfurimin në vatër bazuar në monitorimin e të dhënave.

3) Masat për zvogëlimin e NO_x

Megjithëse, është konfirmuar se NO_x mund të zvogëlohet për rreth 15% me anë të djegies me nivel të ulët të O₂ në gazin e shkarkuar, por SO₂ rritet shpejtë.

Kjo konsiderohet se ndodhë për shkak të mungesës së O₂ në zonën e reaksionit të de-sulfurimit në vatër. Efikasiteti i de-sulfurimit zvogëlohet kur bëhet djegia me nivel të ulët të O₂ në gazin e shkarkuar. Prandaj, në kaldajën ekzistuese është e vështirë të arrihet zvogëlimi i SO₂ dhe zvogëlimi i NO_x në të njëjtën kohë.

Përveç kësaj, megjithëse metoda që përdorë djegien e simuluar me dy faza dhe përparësinë e lëndës djegëse mund të konsiderohen si masa për zvogëlimin e NO_x, por duke marrë parasysh hapjen aktuale të flegërës së kaldajës, caktimi i hapjes veç është i ngjashëm me djegien e simuluar me dy faza, kështu që nuk mund të pritët zvogëlimi i mëtejshëm e NO_x

Ekziston edhe metoda për ta rritur sasinë e lëndës djegëse hyrës nga flakadani i nivelit më të ulët për të arritur djegien e ngadaltë, por rritja e sasisë së lëndës djegëse hyrëse nga flakadani më i ulët gjithashtu rrit sasinë e grimcave të padjegura që bien në pjesën e fundme të vatrës. Duket se është vështirë të ndryshohet shpërndarja aktuale e lëndës djegëse hyrëse.

Si veçori e kaldajës së TC Kosova A, ajrit furnizohet nga Skara e cila është e instaluar në pjesën e poshtme të vatrës dhe nga flakadani që nuk është në operim për ftohjen e dizave të flakadani.

Ajri i furnizuar nga flakadani në operim mund të rregullohet në mënyrë që lënda djegëse të mund të përzihet siç duhet me ajrin dhe të mund të arrihet djegie e mirë, por ajri i furnizuar nga pjesë të tjera përveç flakadanëve nuk kontribuon domosdo në djegie.

Madje edhe gjatë përpjekjes së kryerjes së djegies me nivel të ulët të O₂ në gazin e shkarkuar, ajri nga pjesë të tjera përveç flakadanëve ndërhyt ose sjell mos-baraspeshë të O₂ në vatër dhe ky ajër është pengesë për zvogëlimin e NO_x dhe në përmirësimin e metodës së djegies. Ajri ndërhyt në operimin për zvogëlimin e NO_x dhe është pothuajse kufiri i zvogëlimit të NO_x me objektet ekzistuese, dhe është i domosdoshëm futja në funksion e djegies me dy faza + flakadani me nivel të ulët të NO_x.

4) Ndikimi i ngarkesës së kaldajës në ndotës

Në periudhën e tretë, si një nga aktivitetet shtesë, Projekti ka bërë inspektimin e efektit të zvogëlimit të ngarkesës së kaldajës në pluhur, SO₂ dhe NO_x, megjithëse koha e operimit me ngarkesë të ulët ka qenë e shkurtër. Paralelisht, Projekti ka studiuar dallimin ndërmjet rezultateve me analizator automatik të gazit dhe rezultateve të analizës me Metodën Standarde Referente, dhe kjo është përshkruar në 3-5-1 (2) 2).

Efekti i zvogëlimit të ngarkesës së kaldajës është siç vijon.

Zvogëlimi i ngarkesës së kaldajës ka efektet siç janë paraqitur në tabelë, të cilat mendohet se ndikojnë në vlerat e SO₂ dhe NO_x.

Tabela 3-111 Efekti i ngarkesës së zvogëluar të kaldajës në SO₂ dhe NO_x

Parametri		Efektet	
1 Nxehtësia Hyrëse	↓	Temperatura e gazit në vatër	↓
2 Rrjedha e gazit	↓	Koha e qëndrimit	↑
3 Ngarkesa e flakadanit	↓	Ajri primar/Linjiti	↑

Testi është kryer nga H/L më 4 nëntor 2020, me metodën e zbritjes së përkohshme të ngarkesës së kaldajës nga 137 MW në 118 MW

(14% zvogëlim të ngarkesës). Rezultatet e testit janë paraqitur në vijim.

SO₂ është zvogëluar ndjeshëm me zvogëlimin e ngarkesës së kaldajës. Në anën tjetër, NO_x nuk ka ndryshuar shumë edhe kur është zvogëluar ngarkesa e kaldajës.

Arsyet për këtë konsiderohet se janë se zvogëlimi i ngarkesës së mullirit rrit sasinë e O₂ në ajrin primar në flakadan, nxit djegien dhe rrit NO_x, ndërsa NO_x zvogëlohet për shkak të zvogëlimit të ngarkesës në vatër. Është e mundshme që efektet ta anulojnë njëra-tjetrën dhe NO_x nuk ka ndryshuar shumë.




Figura 3-54 Rezultati i testit të zvogëlimit të ngarkesës së kaldajës

(Për detaje shihni Shtojcën -1 Materialet e Rezultatit: "7-2)-4 Ndryshimi i Ngarkesës së Kaldajës Kosova A-5", "7-2)-5 Kontrolli i Rrjedhës së Lëndës Djegëse për Kaldajën e Llojit me Tambur" dhe "7-2)-6 Ndikimi i zvogëlimit të Ngarkesës së Kaldajës në NO_x ")

Dukuria ku NO_x nuk zvogëlohet edhe nëse ngarkesa e kaldajës zvogëlohet ka shumë të ngjarë që ka ndodh për shkak se numri i mullinjve në operim nuk është zvogëluar kur është zvogëluar ngarkesa e kaldajës. Në rastin e zvogëlimit të ngarkesës së kaldajës, nëse zvogëlohet numri i mullinjve në operim sasia e O_2 në ajrin primar në flakadan zvogëlohet. Në këto kushte NO_x pritet të zvogëlohet.

Për më tepër, pasi që efekti i zvogëlimit të SO_2 është i madh, nëse kryhet djegia me nivel të ulët të O_2 tepëricë, SO_2 mund të rritet pak, por NO_x mund të zvogëlohet.

Në mënyrë që të bëhet e qartë në mënyrë të detajuar arsyeja pse SO_2 dhe NO_x zvogëlohen me zvogëlimin e ngarkesës së kaldajës, JET-i ka rekomanduar se H/L duhet t'i konfirmojnë pikat në vijim.

- a. Ashtu si në testin e mëparshëm, është zbuluar se nuk ka shumë ndryshim në NO_x ndërmjet secilit kanal, por ndryshimi në SO_2 është i madh dhe për këtë arsye është e nevojshme të matet dhe konfirmohet SO_2 në secilin kanal për t'i sqaruar efektet.
- b. Gjithashtu është e nevojshme që të mblidhen të dhënat për një orë para dhe pas zvogëlimit të ngarkesës së kaldajës për ta konfirmuar stabilitetin e kaldajës. Të gjitha të dhënat e ngarkesës së kaldajës, temperatura e gazit, SO_2 , NO_x dhe O_2 duhet të mblidhen për çdo 15 deri në 20 minuta gjatë testit.
- c. Gjithashtu është e nevojshme të konfirmohet efekti i djegies me nivel të ulët të O_2 tepëricë në mënyrë që të konfirmohet efektin në gazin e shkarkuar kur bëhet zvogëlimi i ngarkesës së kaldajës,
- d. Konsiderohet se mbajtja e temperaturës së gazit në dalje të vatrës në temperaturë të përshtatshme për reaksionin e de-sulfurimit është faktori më i rëndësishëm për de-sulfurim efektiv në vatër të kaldajës. Ekziston dallim në temperaturën e gazit në dalje të vatrës ndërmjet kanaleve, dhe është e paqartë se cili faktor ndikon në zvogëlimin e SO_2 si rezultat i de-sulfurimit në vatër. Prandaj, është propozuar që të rregullohen hapjet e flegrave për secilin flakadan ose të rregullohet sasia e hyrjes së linjimit nëpër secilën mulli në mënyrë që të mos ketë ndryshim midis kanaleve në temperaturën e gazit në dalje të vatrës.
- e. Në mënyrë që shpërndarja e temperaturës së gazit në dalje të vatrës të bëhet uniforme, rekomandohet instalimi i edhe dy termometrave për kontrollin e temperaturave, dhe më pas bazuar në këto temperatura, të kontrollohet djegia në mënyrë manuale ose përmes rregullimit të rrjedhës së linjimit ose rregullimit të hapjes së flegrës.

5) Masat për zvogëlimin e emisioneve për IDM-të

Kosova ka përpiluar PKZE-në bazuar në PKZE-në e dorëzuar në EnC në maj të vitit 2018 në përputhje me Direktivën e BE-së për Impiantet me Djegie të Mëdha (IDM-të). Është e domosdoshme që të arrihen VKE-të në përputhje me direktivën e BE për IDM të paraqitur në Tabela 3-112 për Pluhur, SO₂ dhe NO_x.

Tabela 3-112 Vlerat Kufitare të Emisioneve për IDM

Ndotësi/Viti	2018	2023	2026
SO ₂ (mg/Nm ³)	400	400	200
NO _x (mg/Nm ³) as NO ₂	500	200	200
Pluhuri (mg/Nm ³)	50	50	20

Në TC Kosova A, tri kaldaja: A-3, A-4 dhe A-5 janë në operim. Specifikacionet e kaldajës dhe FES-it janë siç janë paraqitur në Tabela 3-113 dhe Tabela 3-114. Kaldajat A-3 dhe A-4 janë kaldaja të dizajnit të njëjtë dhe kaldaja A-5 ka kapacitet pak më të ndryshëm, por megjithatë mund të konsiderohet se ka kapacitet të njëjtë.

Tabela 3-113 Specifikacionet e kaldajave A-3, 4 dhe 5 të TC Kosova

	Pika	Njësia	Përshkrimi
1	Prodhuesi Lloji		“RAFAKO” Poloni OP – 650 –b
2	Viti i operimit		A-3; 1970、 A-4;1971、 A-5;1975.
3	Lartësia e kaldajës	m	60
4	Madhësia e vatrës (Gjerësia x Thellësia)	m	12.5 x 15.24
5	Lloji i kaldajës		Qarkullim natyror Kaldajë me konstruksion të varur gjysmë të lirë, me dy tambura, me qarkullim natyror të skemës avull-ujë dhe me largim të zgjyrës në gjendje të ngurtë.
6	Sistemi i ndezjes		Thëngjill i bluar i asistuar me naftë
7	Sistemi i ajrosjes		Ajrim i balancuar
8	Muri i vatrës		Membranë
9	Pjesa e fundme e vatrës		Bartës gërryes me mbulesë uji
10	Avullimi	T/h	650
11	Temperatura e avullit	°C	540
12	Presioni i avullit	bar.	162 (FW), 152 (Tamburi) 138 (SH Jashtë)
13	Thëngjilli i projektuar i kaldajës		Linjiti
14	Konsumi i thëngjillit	T/h	316
15	Flakadani		3 Nivele x 8 Kënde
16	Norma e Ajrit Tepricë	%	30 - 50
17	Vlera e rrjedhës së ajrit të nevojshëm për djegie	Nm ³ /h	855 000 Nm ³ /h
18	Temperatura e ajrit në hyrje të flakadanit	°C	270

19	Presioni në Vatër	mmH2O	-3 deri në -5
20	Temperatura e gazit në dalje të kaldajës	°C	160 - 200

Tabela 3-114 Specifikacionet e FES-ve të TC Kosova A-3, 4 dhe 5

	Pika	Njësia	Përshkrimi
1	Prodhuesi Lloji		HAMON ENVIRONMENTAL GmbH “KOMPAKT PLUS”
2	Viti i operimit		2012
3	Numri për kaldajë		3 FES/Kaldajë
4	Numri i Fushave		4 Fusha
5	Sipërfaqja për elektodat grumbulluese	m ²	9728/FES (1F : 2816 2~4F : 6912)
6	Lartësia	m	16
7	Rrjedha e gazit në hyrje të FES-it	m ³ /h	716,784/FES
8	Temperatura e gazit në hyrje të FES-it	°C	150 - 210
9	Shpejtësia e Gazit	m/s	1.41
10	Humbjet në ajrimin të FES	mbar	(-30)
11	Përmbajtja e pluhurit në hyrje të FES-it	g/Nm ³	41.110
12	Përmbajtja e gazit në dalje të FES-it	mg/Nm ³	50
13	Efikasiteti i mbledhjes së pluhurit	%	99,88

Figura 3-55 dhe Figura 3-56 bëjnë përmbledhjen e të gjitha të dhënave për përmbajtjen e NO_x dhe SO₂ (mg/Nm³; O₂=6% bazë) të matura në TC Kosova A nga viti 2017 deri më tani dhe këto Vlera janë tepër të shpërndara.




Figura 3-55 Shpërndarja e vlerës së SO₂




Figura 3-56 Shpërndarja e vlerës së NO_x

Këto të dhëna përfshijnë të dhëna për të cilat nuk është aplikuar asnjë përmirësim me metodën e operimit të kaldajës, kështu që kur merret parasysh përmirësimi i pajisjeve për t'i përmbushur VKE-të, përdorimi i vlerës maksimale për t'i përmbushur VKE-të nuk është i përshtatshëm për t'i konsideruar masat.

Prandaj, është praktike të studiohen masat bazuar në vlerën maksimale të të dhënave

që përmbledhin 20% e sipërm të të gjitha të dhënave (Tabela 3-115). Nëse rast se ndodh tejkalimi i këtyre vlerave në operimin aktual, konsiderohet se mund të trajtohet përmes operimit të kaldajës të kryer në testet e mëhershme dhe përmes uljes së ngarkesës së kaldajës.

Tabela 3-115 Kufiri i 20% të sipërm të të gjitha të dhënave

SO ₂	Më shumë se 1500 mg/Nm ³
NO _x	Më shumë se 670 mg/Nm ³

i) Masat për Zvogëlimin e Pluhurit

Siç është thënë gjatë aktiviteteve, FES-i aktual është projektuar për përqendrim të Pluhurit të shkarkuar prej 50mg/Nm³, dhe nëse masat e paraqitura në Tabela 3-116 aplikohen bazuar në rezultatet e testeve të bëra deri më tani, konsiderohet se VKE-të në vitin 2023 mund të përmbushen. Për t'i përmbushur VKE-të në vitin 2026, është e nevojshme të rritet më tej kapaciteti i mbledhjes së Pluhurit, por mund të jetë e mundur të arrihet kjo duke e instaluar njësinë e de-sulfurimit (* 1) sepse Pluhuri gjithashtu mënjanohet përmes njësisë së de-sulfurimit.

Tabela 3-116 Masat e zvogëlimit të pluhurit

	Masat	Çka të bëhet
1	Rrjedha e gazit në FES Homogjenizimi	Përmirësimi i pllakës drejtuese në hyrje të kanalit të FES-së për rrjedhë uniforme të gazit bazuar në rezultatet e analizës së rrjedhës në FES (pjesërisht e zbatuar)
2	Ndryshimi i metodës së kontrollit të energjizimit të FES-it	Në diskutim e sipër me prodhuesin e FES-së për përmirësimin e kontrollit të energjizimit të FES-së
3	Zvogëlimi i vëllimit të gazit të shkarkuar	Është e nevojshme që të zbatohet në anën e kaldajës. (*2)
4	Zvogëlimi i temperaturës së gazit të shkarkuar	Është e nevojshme që të zbatohet në anën e kaldajës. (*2)

* 1: Përveç efektit të mënjanimin të Pluhurit të njësisë së de-sulfurimit, nëse Nxehtësi Gaz-Gaz (GGH) për ri-nxehjen e gazit të shkarkuar e instaluar në njësinë e de-sulfurimit instalohet në rrjedhën e sipërme të FES-it ekzistuese, temperatura e gazit të shkarkuar në hyrje të FES-it do të ulet deri rreth 90 °C. Si rezultat, shkalla e vëllimit të rrjedhës së gazit të shkarkuar do të zvogëlohet për rreth 20% dhe gjithashtu do të përmirësohet performanca e mbledhjes së pluhurit të FES-it. Në të njëjtën kohë, me uljen e temperaturës së gazit do të përmirësohen karakteristikat e ngarkesës së FES-it. (Figura 3-57)




Figura 3-57 Sistemi i FES-it me temperaturë të ulët-ulët (Sistemi i ri)

- * 2: Metodatat për zvogëlimin e sasisë së gazit të shkarkuar drejt FES-it janë (1) zvogëlimin e sasisë së ajrit që rrjedhë në para-nxehës të ajrit, (2) djegien me nivel të ulët të O₂ të flakadanit dhe (3) zvogëlimin e sasisë së ajrit që rrjedhë në kaldajë.

Sipas rezultateve të matjes, vëllimi i ajrit i cili rrjedhë në para-nxehësin aktual është rreth 50% e vëllimit të ajrit teorik të ajrit të djegies dhe është e nevojshme të zvogëlohet në 10% njëjtë me nivelin në kohën e ndërtimit duke rregulluar dhe riparuar mbyllësin e para-nxehësit të ajrit.

Meqenëse temperatura e gazit të shkarkuar në dalje të para-nxehësit të ajrit ulët duke përzier ajrin me gazin e shkarkuar pas shkëmbimit të nxehtësisë në para-nxehës të ajrit, nëse sasia e ajrit që rrjedhë në para-nxehës të ajrit zvogëlohet temperatura e gazit në dalje të para-nxehësit të ajrit rritet. Prandaj, gjatë ndërmarrjes së masave për ta zvogëluar sasinë e ajrit që rrjedhë në para-nxehës të ajrit është e nevojshme që të ndërmerren njëkohësisht masat e përmendura më poshtë për zvogëlimin e temperaturës së gazit të shkarkuar.

Meqenëse flakadanët me nivel të ulët të NO_x si masë për zvogëlimin e NO_x mund të bëjë djegien me nivel të ulët të O₂ në gazin e shkarkuar, zëvendësimi me flakadan me nivel të ulët të NO_x gjithashtu kontribuon në përmirësimin e performancës së FES-it.

Mirëmbajtja rutinore është e rëndësishme për zvogëlimin e sasisë së ajrit që hyn nga vatra e kaldajës.

- * 3: Zvogëlimi i temperaturës së gazit në hyrje të FES-it

Shkaqet për rritjen e temperaturës së gazit të shkarkuar të kaldajës janë: (1) Kontaminimin e sipërfaqes së transferimit të nxehtësisë si ekonomajzerat, tej-nxehësit dhe ri-nxehësit, ose rrjedhën o të barabartë të gazit në vatër të kaldajës për shkak të akumulimit të hirit, dhe (2) Përkeqësimin e transferimit të nxehtësisë së para-nxehësit të ajrit për shkak të zvogëlimin të trashësisë së elementit për transferimin e nxehtësisë.

Kur kaldaja të ndalet, është e nevojshme që të kontrollohet për ndotjes dhe

bllokim nga hiri në sipërfaqet për transferimin e nxehtësisë të ekonomajzerit, tej-nxehësit dhe ri-nxehësit. Për të kontrolluar për përkeqësim të elementit të transferimit të nxehtësisë së para-nxehësit të ajrit, është e nevojshme që të nxirret elementi i transferimit të nxehtësisë dhe të kontrollohet në mënyrë vizuale, dhe të kontrollohet përmes peshimit nëse elementi i transferimit të nxehtësisë ka humbur peshë.

Nëse në sipërfaqet e transferimit të nxehtësisë së ekonomajzerit, tej-nxehësit dhe ri-nxehësit gjetet ndotje ose bllokim nga hiri pastrojini ato dhe instaloni fryrës të blozës në vendet ku hiri ngjitet së tepërmi për t'u siguruar se transferimi i nxehtësisë tek avulli dhe uji është duke u kryer si duhet.

Nëse shihet se elementi i transferimit të nxehtësisë i para-nxehësit të ajrit është përkeqësuar, ai duhet të zëvendësohet me element të ri.

ii) Masat për zvogëlimin e NO_x

Për ta zvogëluar nivelin e NO_x nga 670 mg/Nm³ në 200 mg/Nm³, është e domosdoshme që flakadani ekzistues të zëvendësohet me Ajrin mbi flakë në dy-faza (OFA) + flakadan me nivel të ulët të NO_x. Mirëpo, konsiderohet se është mjaft e vështirë që gjithmonë të përmbushet 200 mg/Nm³ meqenëse niveli i NO_x është shumë i lartë dhe flakadanët me nivel të ulët të NO_x mund të mos punojnë mirë për shkak të rrjedhjes së ajrit në vatër nga një pjesë tjetër e jo nga flakadani.

Për sa i përket lartësisë së kërkuar të vatrës për djegie me nivel të ulët të NO_x, kaldaja e TC Kosova A operohet në rreth 25% më ulët se specifikimi i projektuar, prandaj koha e qëndrimit të gazit të djegies në vatër është 25% më e gjatë se ajo e projektuar. Prandaj, konsiderohet se koha e qëndrimit të djegies në vatër mund të sigurohet edhe nëse bëhet konvertimi në djegie me dy-faza dhe flakadan me nivel të ulët të NO_x. Konsiderohet se flakadani me nivel të ultë të NO_x mund të aplikohet pa rritje të lartësisë së vatrës.

Në kohën e rimodelimit të flakadanit është e nevojshme që të zëvendësohet flakadani startues me naftë i cili gjeneron tym të zi kur startohet kaldaja.

Nëse nuk mund të përmbushet 200 mg/Nm³ të NO_x me djegie në dy-faza + flakadan me nivel të ulët të NO_x, është e nevojshme të instalohet pajisja e de-NO_x, mirëpo meqenëse shkalla e zvogëlimin të NO_x e kërkuar për pajisje të de-NO_x është e vogël, konsiderohet se kërkesa mund të përmbushet me aplikimin e sistemit jo-katalitik të de-nitritit ³² (SNCR). Nëse aplikohet sistemi katalitik i de-nitritit (SCR), hiri i gjeneruar nga djegia e linjtit përmban sasi të madhe të komponentëve alkalik kështu që duhet pasur kujdes në përzgjedhjen e katalizatorëve të cilët nuk

³² Duke furnizuar një agjent reduktues siç është amoniaku ose urea në zonën e temperaturës së lartë të gazit në vatrën e kaldajës (pothuajse të njëjtën zonë të temperaturës si de-sulfurimi në vatër), mund të arrihet 30% deri 50% të zvogëlimin të NO_x pa katalizator.

përkeqësohen për shkak të komponentëve alkaline.

Flakadani me nivel të ulët të NO_x mund të operohet me shkallë të ajrit tepriçë prej rreth 20% të sasisë së ajrit teorik për djegie. Nëse rrjedha e gazit zvogëlohet dhe temperatura e gazit të shkarkuar mbahet në nivelin aktual prej rreth 180 °C, efikasiteti i kaldajës (bazuar në vlerën më të lartë të nxehtësisë) do të rritet për rreth 7% si vlerë relative në krahasim me nivelin aktual. Masat janë gjithashtu efektive për përmirësimin e efikasitetit të kaldajës.

iii) Masat për zvogëlimin e SO_2

Është konfirmuar se SO_2 ndryshon tej mase nga 0 mg/Nm³ deri në 2000 mg/Nm³, por kjo është për shkak të de-sulfurimit në vatër si rezultat i Ca të përmbajtur në linjit. Në mënyrë që de-sulfurimi në vatër të kryhet në mënyrë efektive, është e nevojshme të krijohet shtrirja e temperaturës e përshtatshme për reaksionin e de-sulfurimit në vatër të kaldajës. Në kaldajat ekzistuese, mundësia e rregullimit të temperaturës së gazit brenda vatrës së kaldajës në shtrirje të temperaturës të përshtatshme për reaksion të de-sulfurimit është e kufizuar, mirëpo është konfirmuar se SO_2 mund të zvogëlohet duke ndryshuar disa parametra të operimit.

Gjatë zëvendësimit me djegie në dy-faza + flakadan me nivel të ulët të NO_x , parametrat e operimit në vijim i shtohen parametrave të operimit të cilat mund të aplikohen me kaldajën ekzistuese si mënyrë për rregullimin e temperaturës së gazit në vatër dhe pritet që efikasiteti i de-sulfurimit në vatër të përmirësohet përmes operimit të përshkruar më poshtë.

- Ndryshimi i kushteve të djegies së linjiti përmes rregullimit të hapjes së flegrës së flakadanit
- Rregullimi i temperaturës së gazit në vatër duke rritur ose zvogëluar sasinë e ajrit nga porti i ajrit mbi flakë.

Prandaj, pas instalimit të djegies në dy-faza + flakadanit me nivel të ulët të NO_x , është e nevojshme që të kryhet testi për përmirësimin e de-sulfurimit në vatër dhe të konfirmohet se deri në çfarë niveli mund të zvogëlohet SO_2 para se të konsiderohen masat për zvogëlimin e SO_2 .

Temperatura e gazit në vatër ndryshon për shkak se sasia e nxehtësisë e absorbuar nga tubi i murit të vatrës ndryshon varësisht nga trashësia e hirit që ngjitet në sipërfaqen e murit të vatrës. Prandaj, fryrësit e blozës të instaluar në mur të vatrës janë mënyrë efektive për rregullimin e temperaturës së gazit të vatrës. Ekziston dallim i temperaturës së gazit ndërmjet anës së majtë dhe anës së djathtë të vatrës. Është e rëndësishme që të barazohet temperatura e gazit në prerjen tërthore të vatrës, dhe kjo mund të rregullohet përmes sasisë së linjtit të furnizuar nga mulliri dhe sasisë së ajrit të furnizuar nga secili flakadan. Për këtë qëllim, është e nevojshme të shtohen së paku dy komplete të termometrave të gazit në dalje të vatrës, të monitorohet temperatura e gazit në vatër dhe të bëhet rregullimi

në mënyrë që të minimizohet diferenca e temperaturës së gazit.

Nëse vlera e rregullores për SO₂ nuk mund të përmbushte edhe pas ndërmarrjes së këtyre masave, është e nevojshme të konsiderohet instalimi i njësive së de-sulfurimit.

6) Vlerësimi i Kostos së Masave

Kosto masave për ndotës që duhet zbatuar në tri kaldaja të TC Kosova A është vlerësuar bazuar në koston e përgjithshme të pajisjeve. Meqenëse ekzistojnë faktorë të pasigurisë në secilin impiant, gjatë zbatimit të masave është e nevojshme të sqarohen kushtet dhe të konsultohet prodhuesi. Kjo nuk përfshinë koston e masave për degradimin e si rezultat i vjetërsisë së kaldajave

i) Kushtet lokale të vendit të instalimit;

- Kushtet klimatike (temperatura, lagështia, shpejtësia e erës, të reshurat e shiut, të reshurat e borës), Koeficienti sizmik, dhe Vlera e rregullimit të zhurmës
- Performanca e pajisjeve të kaldajës ekzistuese (gjendja e mullirit, temperatura e ajrit të djegies, etj.)
- Gjendja e furnizimit e burimit të shërbimeve (ujit, energjisë elektrike)
- Nevoja për transportim të brendshëm
- Nëse është e mundshme blerja e materialeve kryesore dhe materialeve ndihmëse për ndërtim
- Kosto fuqisë punëtore lokale - Llojet
- Kapaciteti dhe numri i pajisjeve të rënda të cilat mund të blihen dhe kosto e tyre
- Periudha e mundshme e ndaljes së impiantit
- Masat e kërkuara mjedisore gjatë ndërtimit
- Shpenzimet për përpunimin e materialeve mbeturina të gjeneruara gjatë ndërtimit

Etj.

ii) Puna e ndihmëse

- Nuk përfshinë punët e ndërtimtarisë deri në ndërtimin e bazës
- Rimodelimi i dyshemeve, kornizat e çeliktat, skelet (të cilat mbajnë nga prapa), etj. për shkak të rimodelimit të flakadanëve, etj.
- Rimodelimi i automatizuar i pjesëve ekzistuese të panelit të kontrollit qendror
- Kufizimet e lokacionit të instalimit dhe ndërrimi i rutës siç janë kanalet e pranuar nga plani ekzistues i pajisjeve të impiantit.
- Rregullimi i pajisjeve ekzistuese për ndërtim, largimi dhe zhvendosja e pajisjeve ekzistuese.
- Largimi i përkohshëm dhe restaurimi i pajisjeve të cilat ndikojnë në vendosjen e pajisjeve të ndërtimit

- Kufizimet për pajisje të rënda të cilat mund të përdoren të terme të vendosjes së pajisjeve në impiant dhe kufizimi për instalimin e objekteve të përkohshme për ndërtim

Në veçanti për shkak se kaldaja është e degraduar, ka mundësi që shtrirja e ndërtimit do të zgjerohet në raport me përkeqësimin.

iii) Kontraktori;

- Numër i kufizuar i kontraktorëve është në dispozicion
- A janë të kompletuara vizatimet etj. të cilat mund t'i ofrohen Kontraktorit?

iv) Mjedisi Ekonomik

- Koha e zbatimit dhe mjedisi ekonomik global në atë kohë do të ndikojnë në kostot e zbatimit

a) Kosto e Zvogëlimit të Pluhurit (përfshijë shpenzimet e renovimit)

Pika	Kosto
• Renovimi i mbyllësve të para-nxehësve të ajrit dhe elementeve të transferimit të nxehësive (3 komplete/kaldajë x 3 kaldaja)	1.2 milion €
• Instalimi i fryrësve të blozës shtesë (34 komplete/kaldajë x 3 kaldaja)	7.5million €

Kosto e lartpërmendur është kosto shtesë për sigurimin e masave të zvogëlimit të pluhurit. Nuk janë përfshirë përmirësimi i vazhdueshëm siç është përmirësimi i shpërndarjes së rrjedhës së gazit brenda FES-it dhe aplikimi i kontrollit të energjizimit me ndërprerje. Është vështirë të bëhet vlerësimi i përmirësimit të shpërndarjes së rrjedhës së gazit pasi që është punë e kryer nga punonjësit e TC Kosova A. Aplikimi i kontrollit të energjizimit me ndërprerje ende nuk është përcaktuar për shkak se është në negociata e sipër. Mirëpo, investimi për këto dy masa supozohet të jetë i vogël në krahasim me investimet e lartpërmendura, prandaj këto kosto nuk merren parasysh.

b) Kosto e Zvogëlimit të NOx (përfshijë shpenzimet e renovimit)

Pika	Kosto
• OFA në dy-faza + flakadanë me nivel të ulët të NOx (8 kënde/kaldajë x 3 kaldaja)	33 milion €

c) Kosto e Zvogëlimit të SO₂ (përfshijë shpenzimet e renovimit për pajisjet ekzistuese)

Pika	Kosto
• De-sulfurimi (DGQ) (2 komplete/kaldajë x 3 kaldaja)	88 milion €

3.8.2 Vlerësimi i Treguesve objektivisht të verifikueshëm në MDP

Treguesi objektivisht i verifikueshëm në MDP është “Kryhen diagnostikimet për emisionet e NO_x, SO₂ dhe të pluhurit për IDM”. Për TC Kosova A do të shtjellohen tri masa të kontrollit të ndotjes së ajrit për secilin ndotës”.

Projekti i ka propozuar TC Kosova A tri masa për zvogëlimin e pluhurit, një për zvogëlimin e NO_x dhe një për zvogëlimin e SO₂. Në total janë propozuar pesë masa dhe treguesi është përmbushur. Mirëpo, vetëm dy nga tri masat për pluhur janë aplikuar ose janë në aplikim e sipër. Masat e tjera kërkojnë investime mjaft të mëdha dhe kjo mund të ndikojë në vendimin e qeverisë nëse do ta bëjë rehabilitimin e TC Kosova A ose të vendosë për de-komisionimin e saj.

Për sa i përket zvogëlimit të pluhurit, janë propozuar tri masat e lartpërmendura (përmirësimi i shpërndarjes së rrjedhës së gazit brenda FES-it, aplikimi i kontrollit të energjizimit me ndërprerje për FES-ët dhe zvogëlimi i shkallës së rrjedhës së gazit të shkarkuar). Përmirësimi i shpërndarjes së rrjedhës së gazit brenda FES-it i është aplikuar secilës kaldajë një nga një dhe aplikimi i sistemit të kontrollit të energjizimit me ndërprerje për FES-ët është tani nën negociatë me prodhuesin. Zvogëlimi i shkallës së rrjedhës së gazit të shkarkuar ka nevojë për investime jo aq të vogla dhe është çështje për të ardhmen. Nëse aplikohen këto masa do të përmbushen VKE-të. Për sa i përket NO_x, është propozuar futja në përdorim e flakadanit me nivel të ulët të NO_x dhe djegia me dy faza, dhe për sa i përket SO₂ është propozuar kontrolli i temperaturës si futja në përdorim e kontrollit të ajrit të djegies, parandalimi i infiltrimit të ajrit, etj. por këto nuk janë realizuar për shkak të kufizimit të buxhetit.

Për sa i përket NO_x, pasi që kaldajat e TC janë të vjetra dhe pajisjet e flakadanit për kontrollimin e djegies nuk janë të mjaftueshme, metoda që mund të zvogëlojë NO_x duke ndryshuar metodën e operimit të flakadanit është e kufizuar në operimin me raport të ulët të ajrit tepricë (O₂ e ulët) dhe efekti i kësaj është konfirmuar. Mirëpo, kur është bërë operimi me raport të ulët të ajrit tepricë, temperatura e gazit në vatër ka ndryshuar dhe si rezultat niveli i SO₂ është rritur. Për t'i përmbushur VKE-të, është propozuar të paktën zëvendësimi i flakadanit ekzistues me "Djegje me dy faza + Flakadan me nivel të ulët të NO_x", pasi që ekziston kufiri për zvogëlimin e NO_x me përmirësimin e operimit të flakadanit ekzistues.

Për sa i përket SO₂, është zbuluar se përqendrimi i SO₂ luhetet për shkak të reaksionit të de-sulfurimit në vatër përmes Ca të përmbajtur në linjit (kjo quhet "De-sulfurimi në vatër"). Për ta zvogëluar SO₂ nevojitet që të kryhet de-sulfurimi në vatër në mënyrë efektive. Sjellja e SO₂ është hulumtuar kur temperatura e gazit në vatër është ndryshuar duke ndryshuar metodën e operimit të kaldajës. Si rezultat, u bë e qartë se mbajtja e temperaturës së përshtatshme në vatër është efektive për de-sulfurim në vatër. Mirëpo, me pajisjet ekzistuese temperatura e gazit brenda vatrës mund të ndryshohet vetëm pak, dhe SO₂ nuk mund të zvogëlohet dukshëm, prandaj aktualisht VKE-të nuk mund të përmbushen.

Për ta arritur zvogëlimin e SO₂, në vend se të vendoset që të instalohet menjëherë pajisja e kushtueshme e de-sulfurimit, është sugjeruar që të bëhet testi i zvogëlimin të SO₂ bazuar në testet që i ka bërë projekti deri më tani, pasi që temperatura e gazit në vatër mund të zvogëlohet edhe pak më shumë pas zëvendësimit të flakadanit ekzistues me "Djegje me dy faza + Flakadan me nivel të ulët të NO_x".

Kur VKE-të të bëhen më të rrepta në të ardhmen, do të jetë e nevojshme që të futen në funksion pajisjet me performancë të lartë të zvogëlimin të emisioneve (për shembull FES i lagësht, njësia e de-sulfurimit, njësia e de-nitritit, etj.). Prandaj, njohuria themelore e pajisjeve për zvogëlimin e emisioneve e adoptuar në përgjithësi në IDM dhe pikat të cilave duhet kushtuar vëmendja gjatë adoptimit të tyre janë shpjeguar në mënyrë të përsëritshme përmes punëtorive, në mënyrë që të thellohet të kuptuarit e tyre.

3.8.3 Zhvillimi i kapaciteteve përmes aktiviteteve

Qëllimi i Rezultati 7 është të "Zhvillohen masat e kontrollit të emisioneve në IDM". Aktivitetet aktuale përfshijnë sqarimin e sjelljes së ndotësve në IDM, planifikimin e masave për zvogëlimin e emisioneve, përmirësimin e metodave të operimit të cilat mund të zbatohen menjëherë dhe aplikimin e masave të cilat mund të zbatohen me investime relativisht të vogla. Përmes këtyre aktiviteteve është menduar të përmirësohet kapaciteti i H/L.

- Për ta zvogëluar SO₂, Pluhurin dhe NO_x si masa mjedisore për IDM, është e rëndësishme që të kuptohet gjendja aktuale e përbërësve të gazit të shkarkuar. Përmes TNP H/L ka përvetësuar teknologjinë e matjes si caktimin e porteve të mostrimit për mbledhjen e gazit të shkarkuar, përgatitjen e pajisjeve të matjes në terren, bashkëpunimin me palët e ndërlidhura gjatë kohës së matjes, pastrimin e pajisjeve pas matjes, përpunimin e të dhënave të mbledhura, etj. Përmes një sërë aktiviteteve janë përgatitur manualët e operimit dhe H/L kanë arritur nivelin e aftësisë ku ata vetë mund ta kryejnë tërë procesin e matjes pa mbështetjen e JET-it. Mirëpo, numri i anëtarëve për matje është i vogël dhe është e nevojshme që të rritet numri i anëtarëve të grupit për matje.
- Kaldajat janë të vjetra meqenëse janë ndërtuar afër 50 vite më parë, përbërja e linjtit nuk është e qëndrueshme dhe përbërja e gazit të shkarkuar nga kaldaja mund të ndryshojë dukshëm. Është shumë e vështirë që të gjeten mënyra për ta përmirësuar përbërjen e gazit të shkarkuar përmes ndryshimit të metodës së operimit të kaldajës, por është përvetësuar metoda për të gjetur mënyra dhe/ose procese për të bërë përmirësime.
- Për ta përmirësuar performancën e FES-it, përmes bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve të TC, UP dhe JET-it janë kryer një sërë detyrash duke përfshirë matjen e shpërndarjes së rrjedhës brenda FES-it, analizën e shpërndarjes së rrjedhës duke përdorur modelin CFD bazuar në rezultatet e matjes dhe masat për ta barazuar rrjedhën e gazit në hyrje të FES-it bazuar në rezultatet e analizës. Përmes kësaj pune, palës kosovare i janë transferuar një sërë qasjesh për zgjidhjen e problemit.

- Masat mjedisore për IDM janë shpjeguar shumë herë gjatë seminareve dhe H/L kanë kuptuar parimet e pajisjeve për zvogëlimin e emisioneve dhe pikat që duhet të merren parasysh për rastin kur ato të adoptohen.

3.9 Rezultati 8: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit.

3.9.1 Aktivitetet

- (1) Aktivitetet për vlerësimin e masave ndaj ndotjes së ajrit

Janë kryera aktivitetet e paraqitura në Tabela 3-117 për zhvillimin e kapaciteteve të palës kosovare për vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit (këtu e tutje “Masat”).

Tabela 3-117 Seminaret, Ligjëratat, TNP për Rezultatit 8

Data	Përmbajtja	Pjesëmarrës
<u>Periudha e parë</u>		
20 prill 2018 9:00~12:00	Seminari: Historia e masave për ndotjen e ajrit në Japoni	18 H/L
<u>Periudha e dytë</u>		
22 janar 2019 13:30~14:30	Diskutimi për studimin e metodës së vlerësimit cilësor të Masave	1 H/L
28 janar 2019 9:00~12:00	Diskutimi për rishikimin e Masave në Kosovë	1 H/L
29 janar 2019 9:00~12:00	Seminari për metodën e vlerësimit të Masave në Kosovë	8 H/L
29 janar 2019 13:30~16:00	Diskutimi për rishikimin e Masave në Kosovë	1 H/L
19 prill 2019 13:30~15:30	Diskutimi për rishikimin e Masave në një shtet tjetër	1 H/L
24 qershor 2019	Diskutimi për Masat për pajisjet në amvisëri	1 H/L
25 qershor 2019	Diskutimi për Masat për gazin e shkarkuar të automjeteve	1 H/L
2 korrik 2019 09:30~11:00	Diskutimi për rezultatet e shqyrtimit të Masave në një shtet tjetër dhe Plani i Veprimit për Cilësi të Ajrit në Kosovë	3 H/L
<u>Periudha e tretë</u>		
1 nëntor 2019 09:30~11:50	Diskutimi për Aktivitetet në periudhën e tretë dhe intervistat përmes vizitës për Masat	2 H/L
5 nëntor 2019 13:30~15:30	Diskutimi për përmbajtjen e intervistave përmes vizitës për Masat	2 H/L
6 nëntor 2019 13:30~15:30	Diskutimi për përmbajtjen e intervistave përmes vizitës për Masat dhe përshtatja e orarit	2 H/L
11 nëntor 2019 10:00~11:50	Diskutimi për metodën e studimit të Masave bazuar në Planin e Veprimit për Cilësi të Ajrit	2 H/L
12 nëntor 2019 09:30~10:15	Takimi me Termokosin për planin e zgjerimit të ngrohjes qendrore publike në të ardhmen	3 H/L
12 nëntor 2019 13:30~14:30	Takimi me MCC/MFK për aktivitetet mbështetëse për planin e konservimit të energjisë nga MCC/MFK	2 H/L

14 nëntor 2019 09:30~10:45	Takimi me GIZ për aktivitetet mbështetëse për planin e konservimit të energjisë nga GIZ	2 H/L
15 nëntor 2019 09:00~12:00	Diskutimi për Masat për automjetet	3 H/L
18 nëntor 2019 09:00~15:30	Përgatitja e materialeve mbi Masat për automjete për takimin ndërmjet H/L dhe organizatave relevante	2 H/L
20 nëntor 2019 13:00~15:30	Studimi me H/L për Masat për ngrohjen në amvisëri	2 H/L
22 nëntor 2019 10:15~11:30	Konsultimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme: (MPBAP/MPB: Policia e Trafikut) për Masat për automjetet	2 H/L
22 nëntor 2019 13:00~15:30	Përgatitja për seminarin e 25 nëntorit për Masat për ngrohjen në amvisëri	1 H/L
25 nëntor 2019 09:00~11:50	Seminari i Përbashkët Konsultues nga H/L për Masat për ngrohjen në amvisëri	6 H/L
3 dhjetor 2019 13:30~15:00	Diskutimi për zhvillimin e skenarëve për vlerësimin e masave për ngrohjen në amvisëri	2 H/L
5 dhjetor 2019 10:00~15:00	Diskutimi për zhvillimin e skenarëve për vlerësimin e masave për automjete	2 H/L
22 janar 2020 13:30~15:00	Prezantimi i Fletës së Vlerësimit të Masave dhe diskutimi për përmbajtjen e aktiviteve	2 H/L
24 janar 2020 13:30~15:00	Diskutimi për përmbajtjen a aktiviteve për finalizimin e vlerësimit të Masave	2 H/L
31 janar 2020 11:00~12:00	Intervista përmes vizitës me Termokosin për planin e zgjerimit të ngrohjes qendrore publike në të ardhmen	2 H/L
4 shkurt 2020 13:30~15:30	Diskutimi për metodën e llogaritjes së kostos së Masave	6 H/L
5 shkurt 2020 9:15~11:45, 13:45~14:45	TNP nga H/L për llogaritjen e zvogëlimit të emisioneve për Masat për ngrohje në amvisëri	6 H/L
7 shkurt 2020 09:30~11:30	Diskutimi për përmbajtjen e Fletës së Vlerësimit për Masat	2 H/L
10 shkurt 2020 09:30~11:30	Diskutimi për rezultatet e llogaritjes së zvogëlimit të emisioneve për Masat	2 H/L
11 shkurt 2020 09:30~11:50	Ligjërimi për Fletën e Vlerësimit për Masat	8 H/L
12 shkurt 2020 13:30~15:30	Aranzhimi i çështjeve bazuar në ligjërata dhe Diskutimi për metodën e llogaritjes së kostos së Masave për emisionet nga automjetet	3 H/L
13 shkurt 2020 09:15~11:45	Studimi për metodën e llogaritjes së kostos së Masave për emisionet nga automjetet dhe konservimi i energjisë me futjen në përdorim të materialit izolues	3 H/L
18 shkurt 2020 13:30~15:00	Përmbledhja e vlerësimit të Masave	3 H/L
21 shkurt 2020 9:30~11:30	TNP për llogaritjen e zvogëlimit të emisioneve për Masat	4 H/L
26 shkurt 2020 10:45~11:45	TNP për llogaritjen e zvogëlimit të emisioneve për Masat	3 H/L

28 shkurt 2020 9:30 – 11:30	Diskutimi për finalizimin e Fletës së Vlerësimit për Masat	2 H/L
4 mars 2020 9:30 – 11:30	Ligjërata me grupet e tjera për Fletën e Vlerësimit për Masat	9 H/L
16 prill 2021 9:00 – 11:00	Diskutimi për Raportin Përfundimtar	3 H/L
07 Maj 2021 9:00 – 11:00	Diskutimi për Raportin Përfundimtar dhe Përgatitja e materialit të prezantimit për Seminarin Përfundimtar	3 H/L
13 maj 2021 9:00 – 11:00	Diskutimi për Raportin Përfundimtar dhe Përgatitja e materialit të prezantimit për Seminarin Përfundimtar	3 H/L
21 maj 2021 9:00 – 11:00	Përgatitja e materialit të prezantimit për Seminarin Përfundimtar	3 H/L
28 maj 2021 9:00 – 11:00	Përgatitja e materialit të prezantimit për Seminarin Përfundimtar	3 H/L
<u>Aktivitetet shitesë në periudhën e tretë</u>		
12 nëntor 2020 09:00 - 11:00	Diskutimi për aktivitetet shitesë nga distanca për vlerësimin e Masave	2 H/L
20 nëntor 2020 09:00 - 11:00	Përgatitja e Fletës së Vlerësimit për Masat për Amvisëri të cilat kalojnë në Ngrohës me Pelet, Ngrohës me LPG dhe Ngrohës elektrik	3 H/L
26 nëntor 2020 09:00 - 11:00	Përgatitja e Fletës së Vlerësimit për Masat për Amvisëri të cilat kalojnë në Ngrohës me Pelet, Ngrohës me LPG dhe Ngrohës elektrik	3 H/L
2 dhjetor 2020 09:00 - 11:00	Llogaritja e Simulimit për masat shitesë të kontrollit të ndotjes së ajrit	7 H/L
9 dhjetor 2020 09:00 - 11:00	Ri-konsiderimi i Fletës së Vlerësimit të Masave për Zgjerimin e Ngrohje Qendrore Publike	3 H/L
14 dhjetor 2020 09:00 - 11:00	Ri-konsiderimi i Fletës së Vlerësimit të Masave për Zgjerimin e Ngrohje Qendrore Publike	3 H/L
15 dhjetor 2020 09:00 - 11:00	Llogaritja e Simulimit për masat shitesë të kontrollit të ndotjes së ajrit	6 H/L
22 janar 2021 09:00 - 11:00	Diskutimi për Masat për Automjetet	3 H/L
28 janar 2021 09:00 - 11:00	Diskutimi dhe Konfirmimi i skenarit dhe kosto - efektivitetit për Masat për automjete	3 H/L
03 shkurt 2021 09:00 - 11:00	Përgatitja e Fletës së Vlerësimit për Masat për Automjete me Rregullore Euro për Emisione	3 H/L
16 shkurt 2021 09:00 - 11:00	Përgatitja e Fletës së Vlerësimit për Masat e Kufizimit të Hyrjes së Automjeteve sipas Numrit të Targës së Automjetit	3 H/L
26 shkurt 2021 09:00 - 11:00	Diskutimi për Përmirësimin e Procedurës së Llogaritjes së Kostos dhe Diskutimi për Informacionin e Taksës mbi Lëndë Djegëse	3 H/L
09:15 ~ 09:20	Fjalimi përshëndetës	Z. OGASAWARA Mitsunori I ngarkuari në detyrë, Ambasada e Japonisë në Kosovë
09:20~ 09:30	Fjalët hyrëse	Zyra Qendrore e JICA-s (Znj. Chie SHIMODAIRA, Drejtoreshë, Departamenti për Mjedis Global, JICA)
09:30 ~ 09:55	Çështjet në menaxhimin e cilësisë së ajrit në Kosovë dhe Prezantimi i	Znj. Visare Hoxha: DMNI/MMPHI

	Projektit “Zhvillimi i kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit”	
09:55~ 10:25	Aktivitetet e përmirësimit të monitorimit të cilësisë së ajrit	Z. Shkumbin SHALA: IHMK/MMPHI
10:25~10:40	Pauza për Kafe	
10:40~11:00	Plani Kombëtarë për Zvogëlimin e Emisioneve në Kosovë dhe situata aktuale	Z. Lulzim KORENICA: Ministria e Ekonomisë
10:55~ 11:25	Matjet e emisioneve dhe Masat për zvogëlimin e emisioneve në TC Kosova A	Z. Agron Shala: IHMK/MMPHI Z. Sabri Simnica: KEK
11:25 ~ 11:55	Përgatitja e Inventarit të Emisioneve për Zonën e Prishtinës	Z. Afrim Berisha: AMMK/MMPHI
11:55~ 12:50	Dreka	
12:50 ~ 13:20	Simulimi i gjendjes së cilësisë së ajrit në Zonën e Prishtinës	Znj. Letafete Latifi, MMPHI/AMMK/IHMK
13:20~ 13:50	Vlerësimi i masave të mundshme për kontrollin e ndotjes së ajrit	Znj. Albana Kashtanjeva DMNI/MMPHI
13:50~ 14:05	Pauza për Kafe	
14:05~14:25	Gjendja e cilësisë së ajrit në Kroaci	Z. Gordan Dosen Ministria e Ekonomisë dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm Republika e Kroacisë
14:45~15:05	Gjendja e cilësisë së ajrit në Maqedoninë Veriore	Aleksandra Krsetska Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Republika e Maqedonisë Veriore
15:05~15:25	Diskutim	
15:25~ 15:35	Komentet përfundimtare	Drejtori i Zyrës së JICA-s për Ballkanin (Z. Jiro Takeichi)

Pjesëmarrës në vendngjarje (renditje e rastësishme)

	EMRI	Organizata
1	Liburn Aliu	Ministër i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
2	Gent Zeqiri	Këshilltare e Ministrit
3	Znj. Rineta Jashari	Këshilltare e Ministrit
4	Mitsunori Ogasawara	Ambasada Japoneze
5	Kay Kurimoto	Ambasada Japoneze
6	Z. Jiro TAKEICHI	Përfaqësues kryesor, Zyra e JICA-s për

		Ballkanin
7	Muhamet Malsiu	MMPHI
8	Valerie Tucker	Ambasada e SHBA-ve
9	Yllka Binaj	Ambasada e SHBA-ve
10	Florije Kika	MMPHI
11	Hana Imeri	MMPHI
12	Nijazi Miftari	MPBAP/MPB
13	Armend Agushi	MMPHI
14	Nexhat Jashari	GIZ
15	Mentor Shala	MMPHI
16	Naim Alidema	MMPHI
17	Përparim Terziu	MMPHI
18	Përparim Gashi	MMPHI
19	Albana Kashtanjeva	MMPHI
20	Xhelal Gashi	JICA
21	Visare Hoxha	MMPHI
22	Rron Gjyshinca	PR Solutions
23	Erdonite Hebibi	Gazetare/Ekonomia Online
24	Seniha Bajraktari	Komuna e Prishtinës
25	Murlan Jasiqi	Përkthyes
26	Lulzim Korenica	ME
27	Shkumbin Shala	MMPHI
28	Agron Shala	MMPHI
29	Sabri Simnica	KEK
30	Arsim Mulaku	MMPHI
31	Donika Peja	IHMK
32	Letafete Latifi	MMPHI
33	Musli Kozhani	MMPHI
34	Bujar Rexhepi	OBSH-ja
35	Enisa Serhati	UNDP
36	Afrim Berisha	MMPHI
37	Vlora Spanca	MMPHI
38	Ajet Mahmuti	MMPHI
39	Florent Tahiri	KEK
40	Nehat Bojaxhiu	PROJEKTI i JICA-s
41	Nezakete Hakaj	JET/JICA
42	Kastriot Maxhuni	JET/JICA
43	Ardi Rexhepi	JET/JICA
44	Feriz Teliqi	Përkthyes
45	Ilir Jakupi	Përkthyes
46	Bruno Neziraj	Përkthyes

Pjesëmarrës përmes internetit (renditje e rastësishme)

	EMRI	Organizata
Pjesëmarrja nga shtetet fqinje		

1	Aleksandra Krsetska	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Republika e Maqedonisë Veriore
2	Gordan Dosen	Udhëheqës i Shërbimit për ajër, tokë dhe ndotje të vogla dhe punët strategjike në Ministrinë e Ekonomisë dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm Republika e Kroacisë
Pala kosovare		
1	Katrin Zimmer	SEPA
2	Kristian Silver	SEPA
3	Liridon Hajzeri	
Pala japoneze		
1	Z. Taizo YAMADA	Zyra qendrore e JICA-s
2	Z. Keita HARADA	Zyra qendrore e JICA-s
3	Z. Chie SHIMODAIRA	Zyra qendrore e JICA-s
4	Z. Jun Hirashima	Zyra e JICA-s për Ballkanin
5	Z. Masuto SHIMIZU	Ekipi i Ekspertëve të JICA-s
6	Z. Fumihiko KUWAHARA	Ekipi i Ekspertëve të JICA-s
7	Z. Ei EDO	Ekipi i Ekspertëve të JICA-s
8	Z. Toru TABATA	Ekipi i Ekspertëve të JICA-s
9	Z. Yasufumi NAKAJIMA	Ekipi i Ekspertëve të JICA-s
10	Z. Keiichi TAKAHASHI	Ekipi i Ekspertëve të JICA-s
11	Z. Kyoichi KAMEYAMA	Ekipi i Ekspertëve të JICA-s

3.11 Vlerësimi i Kapaciteteve

Projekti ka kryer Vlerësimin e Kapaciteteve nga periudha e parë deri në periudhën e tretë për ta studiuar ndryshimin në kapacitetet e palës kosovare (H/L dhe GP-H/L).

Vlerësimi i kapaciteteve ka për qëllim ofrimin e treguesve për siç vijon. Tregues të verifikueshëm duhet të jenë ata tregues përmes të cilëve mund të vlerësohet kapaciteti i nivelit individual, nivelit organizativ dhe nivelit shoqëror ndërlidhur në mënyrë sistematike për sa i përket qëllimit të përgjithshëm dhe qëllimit të projektit përmes zbatimit të Projektit. Për më tepër, treguesit e verifikueshëm janë ata tregues përmes të cilëve mund të kuptohet zhvillimi i kapaciteteve të palës kosovare nga pikëpamja e formimit të sistemit të vetë-qëndrueshëm dhe konstruktiv të menaxhimit të cilësisë së ajrit.

Vlerësimi i kapaciteteve është kryer përmes formularit të testit të vetë-vlerësimit duke i bërë bashkë të gjithë anëtarët e H/L dhe GP-H/L me 6 shkurt 2018 në periudhën e parë, 31 janar 2019 në periudhën e dytë dhe 25 shkurt 2020 në periudhën e tretë. Testet kishte disa pyetje me përgjigje PO ose JO, dhe pastaj u bë vetëvlerësimi i kapaciteteve aktuale në nivel individual, nivel organizativ dhe institucional/social e secilit aktivitet në Projekt. Rezultati i përsosur për secilën pyetje në test ishte pesë pikë dhe sistemi i rezultateve u vendos ashtu që sa më të larta të jenë kapacitetet edhe rezultati do të ishte më i lartë.

Komentet për këto rezultate të vlerësuara nga pikëpamja e JET-it janë dhënë si bashkëngjitje.

(1) Rezultati 1: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për ta shtjelluar inventarin e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera

Pasi që të kuptuarit e përgjithshëm të H/L për përgatitjen e inventarit të emisioneve përparoi përmes aktiviteteve nga periudha e parë, rezultatet në nivelin Individual dhe nivelin Organizativ janë të larta dhe janë rritur. Në anën tjetër, meqenëse zhvillimi i bashkëpunimit me organizatat relevante përmes aktiviteteve aktuale të mbledhjes së të dhënave nuk ka përparuar sa duhet, vlerësimi në nivelin Social është mjaft i ulët. Në periudhën e tretë, meqenëse kishte shumë aktivitete specifike për ta përgatitur inventarin e emisioneve, siç është mbajtja e TNP për llogaritjen e emisioneve nga secili sektor dhe kryerja e llogaritjes së zvogëlimeve të emisioneve, si pjesë e aktiviteteve mbështetëse për Rezultatit 8, H/L ishin në gjendje t'i vlerësojnë në mënyrë objektive kapacitetet e tyre. Prandaj, rezultatet e vetëvlerësimit në periudhën e tretë nuk u rritën aq shumë. JET mendon se ky është një trend i mirë.

Komentet nga ana e JET-it për këto rezultate të vlerësuara janë siç vijon.

	Pika fillestare	Pika përfundimtare
Niveli individual	Megjithëse H/L dinin për inventarin e emisioneve të ndotësve së ajrit, ata nuk kishin njohuri të mjaftueshme për metodën konkrete të llogaritjes dhe nuk kishin përvojë në përgatitjen e tij.	H/L thelluan të kuptuarit e tërë aktiviteteve për përgatitjen e inventarit të emisioneve. Për më tepër, pasi që ata krJENin vetë një sërë llogaritjesh të emisioneve në secilin sektor përmes TNP-së, kapaciteti i tyre po zhvillohej. Mirëpo, në mënyrë që H/L t'i kryer aktivitetet të pavarur në të ardhmen, siç është shtimi i ndotësve të synuar të ajrit, përgatitja e inventarit kombëtar të emisioneve dhe përpilimi i planit të përmirësimit të inventarit të emisioneve, është i nevojshëm zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve.
Niveli organizativ	MMPHI/MMPH nuk kishte përvojë në përgatitjen e inventarit të emisioneve të ndotësve të ajrit.	Shumë nga H/L i takojnë AMMK (MMPHI/MMPH) dhe AMMK po përgatit inventarin e emisioneve si organizatë dhe kapaciteti në nivel organizativ po rritet. Për më tepër, janë bërë të qarta rolet dhe përgjegjësitë përbrenda AMMK. Mirëpo, ka dallime në aftësitë individuale dhe situata aktuale është që ngarkesa në komponentin njerëz është duke u rritur. Për më tepër, kapaciteti i organizatës për ta thelluar

		bashkëpunimin me organizatat relevante nuk është i mjaftueshëm.
Niveli social	Kishte njohuri në nivel të ulët për inventarin e emisioneve të ndotësve të ajrit.	Pasi që për sa i përket aktivitetit të mbledhjes së të dhënave të inventarit të emisioneve, të dhënat nuk janë siguruar sa duhet nga organizatat relevante, situata nuk është e tillë që inventari i emisioneve të ketë mbizotëruar mjaftueshëm në nivelin social. Mirëpo, në Projekt, H/L ishin në gjendje ta përgatisin inventarin e emisioneve bazuar në të dhënat nga aktivitetet siç janë intervistat e hulumtimit për gjendjen aktuale të konsumit të lëndës djegëse në amvisëri dhe shërbime, numërimi i trafikut, etj., në bashkëpunim me komunat e synuara, Universitetin e Prishtinës, etj. Këto janë të dhënat e siguruar për herë të parë në Kosovë, dhe këto bëhen të dhëna të vlefshme nga pikëpamja administrative. Në të ardhmen, është e nevojshme të kryhen aktivitete të tilla si zhvillimi i inventarit kombëtar të emisioneve, përgatitja e inventarit të emisioneve duke zgjeruar ndotësit e synuar të ajrit dhe përdorimi i inventarit të emisioneve duke planifikuar, studiuar dhe vlerësuar Masat e Planit të Veprimit në bazë të Strategjisë së Cilësisë së Ajrit në Kosovë. Pritet që të kuptuarit e përgatitjes së inventarit të emisioneve do të nxitet edhe më tej përmes vetëdijesimit të gjerë publik dhe konsultimeve me më shumë organizata relevante.
Rezultati	<p>Është arritje e madhe që H/L përmes TNP kanë qenë në gjendje të kryejnë një sërë procedurash të llogaritjes për inventarin e emisioneve, siç është mbledhja e të dhënave të shumë viteve, regjistrimi i këtyre të dhënave, llogaritja dhe koordinimi i emisioneve për secilin vit, etj.</p> <p>Është një përparim i madh që pas të kuptuarit e konceptit të inventarit të emisioneve, H/L kuptuan rëndësinë e mbledhjes së dhënave dhe mblodhën vetë të dhënat nga organizata relevante. Për më tepër, në GP-H/L, H/L kanë informuar për situatën ku H/L kanë pasur vështirësi në krijimin e sistemit të</p>	

	<p>sigurimit të të dhënave në bashkëpunim me organizatat relevante. Meqenëse H/L i ka njohur problemet dhe përpiqen t'i zgjidhin ato, dhe është vërejtur qartë se ata në mënyrë të pavarur janë duke u munduar t'i trajtojnë këto çështje.</p> <p>Manuali për përgatitjen e inventarit të emisioneve i përgatitur nga JET-i përfshinë jo vetëm procedurën e llogaritjes së emisioneve por gjithashtu rekomandimin për kornizën institucionale duke përfshirë rolet dhe përgjegjësitë. Këto aktivitete kanë krijuar rrugën drejtuese për punën në të ardhmen në përgatitjen e inventarit të emisioneve.</p>
Çështjet/Propozimet	<p>Sfidat e tanishme janë se nuk është e lehtë të mblidhen të dhënat e kërkuara për inventarët kombëtarë të emisioneve, nuk është e lehtë të përgatiten inventarët e emisioneve për shumë ndotës të synuar të ajrit të kërkuara nga BE-ja dhe nuk është e lehtë për H/L që në mënyrë të pavarur ta bëjnë llogaritjen e shumë burimeve të emisioneve. Prandaj, rolet dhe përgjegjësitë duhet të përcaktohen jo vetëm për AMMK, por edhe për organizatat relevante siç janë organizatat të cilat sigurojnë të dhëna, dhe supozohet se nevojitet që të ndërmerret masa që përgatitja e inventarit të emisioneve të caktohet në mënyrë ligjore si aktivitet i MMPHI/MMPH. Si aktivitet me bazë ligjore, supozohet se përgatitja e inventarit të emisioneve caktohet si punë rutinore vjetore dhe caktohet si aktivitet thelbësor gjatë përpilimit të Planit të Veprimit në bazë të Strategjisë së Cilësisë së Ajrit në Kosovë. Këto janë të rekomanduara në Projekt.</p>

(2) Rezultati 2: Zhvillohen kapacitetet për matjen e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera.

Në aspektin e teknologjisë së matjes së gazit të shkarkuar, anëtarët e Grupit për matje kanë përvetësuar plotësisht teknologjinë e matjes. Ata kanë kuptuar jo vetëm parimet e matjes por gjithashtu edhe vështirësitë e matjes, dhe kanë arritur nivelin ku janë të aftë që vetë t'i kryejnë matjet.

Palës kosovare i janë dorëzuar në total dy komplete të pajisjeve të matjes (një komplet nga Aktiviteti Paraprak dhe tjetri nga Projekti), dhe IHMK dhe KEK-u kanë pranuar secila nga një komplet, meqenëse të dyja palët u aftësuan për të kryer matje të gazit të shkarkuar. Mirëpo, edhe IHMK e edhe KEK-u janë në situatë ku kërkohet përforsimi i stafit në mënyrë që ta bëjnë matjen në mënyrë të pavarur. Fillimisht Projekti kishte planifikuar t'ia japë palës kosovare edhe një komplet të pajisjeve për t'i zhvilluar agjencitë private për matje. Mirëpo, meqenëse është e vështirë për qeverinë që ta mbështesë një agjenci private të veçantë dhe nuk ka agjenci private të përshtatshme në Kosovë, kjo është anuluar.

Aktualisht nuk ka agjenci private e cila mund t'i bëjë matjet në mënyrë të duhur. Krijimi i kornizës institucionale ku fabrikat private bëjnë matje dhe i raportojnë rezultatet është larg nga realizimi. Në mënyrë që të zbatohet ligji në mënyrë të duhur janë të dëshirueshme

udhëzimet e duhura nga zyrtarët në MMPHI/MMPH, prandaj është e domosdoshme që të zgjerohet njohuria për matjen e gazit të shkarkuar dhe masat për zvogëlimin e emisioneve. Pasi që IHMK ka përvetësuar teknologjinë e matjes së gazit të shkarkuar, është krijuar mjedisi ku MMPHI/MMPH mund ta shfrytëzojë plotësisht këtë kapacitet dhe t'i udhëzojë fabrikat private në mënyrë të duhur. Është e rëndësishme që MMPHI/MMPH ta zhvillojë kapacitetin dhe ta shfrytëzojë teknologjinë e matjes së gazit të shkarkuar.

Komentet nga ana e JET-it për këto rezultate të vlerësuara janë siç vijon.

	Pika fillestare	Pika përfundimtare
Niveli individual	Transferimi i teknologjisë ka filluar nga Aktiviteti Paraprak. Në pikën fillestare H/L kanë pasuri njohuri deri në një masë për matjet.	Gjatë periudhës së Projektit H/L kanë përsëritur matjet për IDM përmes TNP dhe gjithashtu kanë kryer matje në burimet e tjera të palëvizshme. Përmes këtyre përvojave H/L kanë fituar aftësi të mjaftueshme.
Niveli organizativ	Një person nga DMMU/DMNI, një nga IHMK-ja dhe një nga KEK-u e kanë mësuar teknologjinë. Mirëpo, ata nuk kanë arritur nivelin ku mund t'i kryejnë vetë matjet.	Një person nga DMMU/DMNI, një nga IHMK-ja dhe dy nga KEK-u e kanë përvetësuar teknologjinë. Manualet për punët janë organizuar dhe janë vënë në dispozicion. Në rast se këta persona bashkëpunojnë mund të kryhet matje e duhur. Edhe IHMK e edhe KEK-u i posedojnë pajisjet e matjes dhe mund të kryejnë matje në mënyrë të pavarur. Mirëpo, në veçanti për matje të pluhurit kërkohen së paku tre persona dhe asnjëra palë nuk mund ta sigurojë numrin e nevojshëm të personave.
Niveli social	As MMPHI/MMPH e as fabrikat private nuk e kuptojnë plotësisht rëndësinë e matjes së gazit të shkarkuar.	Ligji qartas i obligon fabrikat private që të kryejnë matje dhe t'i raportojnë rezultatet, por në realitet ligji nuk zbatohet në nivel të mjaftueshëm. Anëtarët e DMMU/DMNI, IHMK dhe KEK-ut e kanë kuptuar rëndësinë e matjeve. Mirëpo, përveç anëtarëve të grupit të matjeve, zyrtarët në MMPHI/MMPH dhe fabrikat private nuk e kuptojnë rëndësinë. Matja e gazit të shkarkuar që është bazë për administrimin mjedisor nuk është përhapur dhe korniza institucionale nuk është në fazë

	ku mund të krijohet.
Rezultati	<p>MMPHI/MMPH ka organizuar sistemin ku si qeveri mund të bëjë matje dhe konfirmojë rezultatet, dhe IHMK dhe KEK-u kanë në posedim nga një komplet të pajisjeve të matjes dhe manualët e operimit janë organizuar dhe ofruar, gjë që mund t'i ndihmojë që t'i kryejnë matjet në mënyrë të pavarur.</p> <p>Anëtarët e grupit të matjeve mund të kryejnë një sërë punësh nga përgatitja për matje, matja, pastrimi i pajisjeve, organizimi i të dhënave, deri te përpilimi i raportit, dhe përfundimisht kanë fituar aftësinë për të kryer matje në mënyrë të duhur. Në veçanti anëtarët nga IHMK mund ta udhëheqin aktivitetin e matjes.</p> <p>Mirëpo, në veçanti për pluhur, nevojiten së paku tre persona, por edhe IHMK e edhe KEK-u kanë nga dy anëtarë për matje, dhe të dyja palët duhet ta përforcojnë stafin e vetë.</p> <p>MMPHI/MMPH ka përvetësuar teknologjinë e matjes përmes IHMK-së, por është çështje tjetër për MMPHI/MMPH ta shfrytëzojë këtë kapacitet.</p> <p>Projekti nuk ka mundur ta arrijë fazën për t'i promovuar agjencitë private të matjes. Prandaj, korniza për përhapjen e matjes së gazit të shkarkuar nuk është përgatitur, dhe si rezultat nuk është krijuar korniza institucionale.</p>
Çështjet/Propozimet	<p>Ligji i Kosovës qartas i obligon fabrikat që të kryejnë matje të gazit të shkarkuar dhe t'i raportojnë rezultatet, por në realitet ligji nuk zbatohet në nivel të mjaftueshëm, dhe ky është problem i madh.</p> <p>Shkaku supozohet të jetë se as zyrtarët në MMPHI/MMPH e as fabrikat private (burimet e tjera të palëvizshme) nuk e kuptojnë rëndësinë e matjes së gazit të shkarkuar dhe matja e gazit të shkarkuar nuk është pranuar në mënyrë të duhur. Rezultatet e matjes së gazit të shkarkuar janë vegël efektive jo vetëm për t'i menaxhuar emisionet por gjithashtu për ta konfirmuar funksionimin e pajisjeve për trajtimin e gazit të shkarkuar në rast se ka pajisje të tilla të instaluar.</p> <p>Për ta zgjeruar të pranuarit e matjes së gazit të shkarkuar, zyrtarët përgjegjës në MEA/MMPH duhet ta rrisin njohurinë dhe të akumulojnë përvojë për matjen e gazit të shkarkuar dhe masat për zvogëlimin e emisioneve. Kjo kërkon që zyrtarët që ta zgjerojnë njohurinë dhe të akumulojnë përvojë për matjen e gazit të shkarkuar dhe masat për zvogëlimin e emisioneve. Për ta realizuar këtë, mënyra më e përshtatshme është TNP ku personat të cilët trajnohen vetë bëjnë inspektimin e secilës fabrikë dhe kryejnë matjet, pasi që secila fabrikë private zakonisht ka proceset dhe rrjedhën e proceseve të veta, dhe mund të përdorin lloje të ndryshme të lëndës djegëse.</p> <p>Kur përmes këtyre aktiviteteve MMPHI/MMPH fiton aftësinë për t'i</p>

	udhëzuar fabrikat private, përhapet zbatimi i matjes së gazit të shkarkuar dhe pritjet të krijohet baza për promovimin e agjencive private për matje.
--	---

(3) Rezultati 3: Kryhen aktivitetet e monitorimit të cilësisë së ajrit

Rezultati 3 përfshinë aktivitetet lidhur me monitorimin e cilësisë së ajrit, që do të thotë monitorimin e cilësisë së ajrit nga SMCA-të, matjen e cilësisë së ajrit me pajisje portative në emergjenca dhe publikimin e rezultateve të monitorimit dhe përdorimin e tyre për vetëdijësim për mjedisin.

Në përgjithësi, nivelet janë përmirësuar shumë në nivelin individual, nivelin organizativ dhe nivelin social. Përgjigjet në pyetësonin nga pyetja e parë deri tek e pyetja e dyta janë përmirësuar ndjeshëm në nivelin individual, në nivelin organizativ dhe në nivelin shoqëror, por nga pyetja dy deri në pyetjen tre niveli është ulur, përveç matjes së cilësisë së ajrit të mjedisit me pajisje portative për emergjenca. Gjatë kësaj periudhe është bërë inspektimi i SMCA-ve, trajnimi për kalibrimin e analizatorëve, rehabilitimi i analizatorëve të SMCA-ve, përgatitja e manualit të mirëmbajtjes së SMCA-ve dhe trajnimi përmes manualit, si dhe udhëzimi për vendosjen e SMCA-ve. Në veçanti gjatë periudhës së tretë, MCC/MFK ka zëvendësuar analizatorët e në 7 SMCA jashtë zonës së Prishtinës, ka instaluar pajisjet meteorologjike në të gjitha 12 SMCA-të, ka kryer trajnim dhe ka pasur inspektimin për praninë. Kështu, orari i tyre ka qenë nganjëherë në të njëjtin orar të aktiviteteve të Projekti. Si rezultat pjesëmarrja e H/L u bë mjaft e kufizuar. Për më tepër, donatorët kanë përgatitur TER, për rehabilitimin të 5 SMCA-ve në zonën e Prishtinës nga JICA dhe për zëvendësimin e pajisjeve në 7 SMCA të tjera nga MCC/MFK. Kjo konsiderohet të jetë arsyeja për vlerësimin e ulët në nivelin organizativ dhe nivelin social veçanërisht nga periudha e dytë në periudhën e tretë, përpos matjes së cilësisë së ajrit të mjedisit me pajisje portative për emergjenca.

Monitorimi i saktë dhe i besueshëm filloi në qershor të vitit 2019 me 5 SMCA në zonën e Prishtinës dhe në nëntor të vitit 2019 me 7 SMCA në zonat e tjera. Në fund të gjitha 12 SMCA-të u rehabilituan me ndihmën e donatorëve. Mirëpo, gjatë inspektimit nuk janë detektuar dhe analizuar në nivel të mjaftueshëm vlerat e parregullta të të dhënave të matura të analizatorëve. Prandaj, nuk mund të konsiderohet se janë krijuar kapacitetet për ta gjetur dështimin e analizatorëve nga të dhënat.

Për sa i përket ekraneve për shfaqjen e të dhënave, Projekti i ka instaluar ato në katër lokacione në qytetin e Prishtinës dhe në një lokacion në qytetin e Obiliqit. Numri i qytetarëve të cilët po tregojnë interes dhe po ndalen para ekraneve është duke u rritur, dhe instalimi i ekraneve është raportuar në gazeta dhe televizion. Është e nevojshme të rritet numri i stafit përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe të sigurohet buxhet i qëndrueshëm për O dhe M.

Komentet nga ana e JET-it për këto rezultate të vlerësuara janë siç vijon

	Pika fillestare	Pika përfundimtare
Niveli individual	<p>Stafi i IHMK-së përveç menaxhimit të kontraktorit përgjegjës për mirëmbajtje, ka kryer vetëm detyra shumë të thjeshta si zëvendësimin e filtrave për mënjanimin e pluhurit etj.</p> <p>IHMK nuk kishte as pajisjet e as njohuri për matjen e cilësisë së ajrit në mjedis në raste emergjente.</p>	<p>H/L kanë kuptuar parimin e kalibrimit të analizatorëve të NOx, SO₂, CO dhe O₃, dhe janë aftësuar për t'i kalibruar këta analizatorë. Por ende ka nevojë për TNP. Për më tepër, është e nevojshme që të ketë trajnim për t'i dalluar të dhënat normale nga të dhënat e parregullta, dhe për ta zbuluar dështimin e analizatorit.</p> <p>Në anën tjetër, është bërë e mundur që të bëhet matja e ndotjes së ajrit të mjedisit me pajisje portative për emergjencë.</p>
Niveli organizativ	<p>Dymbëdhjetë SMCA-të janë instaluar nga viti 2009 deri në vitin 2012. Para fillimit të Projektit, buxheti i MMPHI/MMPH për mirëmbajtjen e SMCA-ve ka qenë rreth 60,000 Euro për tetë vite me radhë.</p> <p>Në tetor të vitit 2017, kur filloi Projekti, vetëm 4 SMCA nga 12 SMCA në Kosovë ishin në funksion.</p> <p>Për më tepër, kalibrimi i analizatorëve nuk ishte bërë për shumë vite.</p>	<p>Buxheti për O dhe M për vitin 2017 është rritur në rreth 150,000 Euro, dhe është mundësuar që të rikthehet funksioni i analizatorëve në më shumë se gjysmën e SMCA-ve.</p> <p>Për më tepër, është kryer edhe rehabilitimi nga Projekti dhe mund të konsiderohet se mund të sigurohen të dhëna të besueshme të cilësisë së ajrit nga pesë SMCA-të në zonën e Prishtinës. Pas JICA-s, MCC/MFK zëvendësoi analizatorët e 7 SMCA-ve të tjera në nëntor të vitit 2019, dhe si rezultat u rivendos sistemi i monitorimit të cilësisë së ajrit për të gjitha 12 stacionet në Kosovë.</p> <p>Aktualisht, dy punonjës të IHMK-së duhet t'i mirëmbajnë dhe menaxhojnë të dymbëdhjetë SMCA-të. Dy persona nuk janë të mjaftueshëm për t'i kryer të gjitha punët e O dhe M. Këta dy persona gjithashtu janë përgjegjës për punët laboratorike dhe është e nevojshme që të punësohet së paku edhe një person.</p>
Niveli social	<p>Stafi i IHMK-së përveç menaxhimit të kontraktorit përgjegjës për mirëmbajtje, ka kryer vetëm detyra shumë të thjeshta si</p>	<p>Në anën tjetër, në fund të muajit janar 2018 ndodhi gjendja me ndotje të madhe të ajrit rreth Zonës së Prishtinës për rreth një javë. Kjo u bë çështje e madhe sociale dhe shqetësim i qytetarëve. Kjo u bë një nga</p>

	<p>zëvendësimin e filtrave për mënjanimin e pluhurit etj.</p> <p>IHMK nuk kishte as pajisjet e as njohuri për matjen e cilësisë së ajrit në mjedis në raste emergjente.</p>	<p>arsyet përse është alokuar buxheti për mirëmbajtjen e SMCA-ve. Projekti instaloi ekranet për shfaqjen e të dhënave që tregojnë informacionin në kohë reale të ndotjes së ajrit në katër lokacione në qytetin e Prishtinës dhe një lokacion në Obiliq. Në anën tjetër, MCC/MFK integroi rrjetin e të dhënave për cilësinë e ajrit nga të dymbëdhjetë SMCA-të, dhe këto të dhëna u vënë në dispozicion për publikun përmes internetit që pasoi rrjetin e KE-së. Ndikimi në nivelin shoqëror për monitorimin e cilësisë së ajrit tani është në rritje.</p>
<p>Rezultati</p>	<p>Rezultatet janë: Për O dhe M të SMCA-ve janë kryer punët e nevojshme në vijim, 1) Rehabilitimi/Riparimi gjeneral i analizatorëve në 5 SMCA në zonën e Prishtinës, 2) Përgatitja e gazrave standarde dhe kalibruesit të nevojitura për kalibrimin e analizatorëve, 3) H/L kanë mësuar se si t'i kalibrojnë analizatorët, 4) Zëvendësimi i 3 kabinave të cilat ishin të papërshtatshme për mirëmbajtje, 5) TNP për riparimin e analizatorëve, 6) Përgatitja e manualit të mirëmbajtjes, 7) Udhëzimi për vendosjen e duhur të SMCA-ve dhe 8) Ushtrimi dhe PSO për përdorimin e pajisjes portative për emergjenca. Konsiderohet se monitorimi i cilësisë së ajrit më në fund mund të bëhet me një shkallë të caktuar të besueshmërisë dhe mund të përmbushen nevojat për riparime. Për më tepër, Projekti i ka instaluar ekranet për shfaqjen e të dhënave në katër lokacione në qytetin e Prishtinës dhe në një lokacion në qytetin e Obiliqit. Numri i qytetarëve të cilët po tregojnë interes dhe po ndalen para ekraneve është duke u rritur, dhe instalimi i ekraneve është raportuar në gazeta dhe televizion. Për më tepër, si rezultat i rrjetit të komunikimit të të dhënave të KE dhe rrjetit të MCC/MFK që e pasoi atë të KE, publiku i përgjithshëm tani mund ta shohin nivelin e ndotjes së ajrit në kohë reale përmes aplikacionit në smartfon.</p> <p>Në anën tjetër, ka pasur shumë pak mundësi për t'i ekzaminuar me kujdes të dhënat e cilësisë së ajrit, prandaj është e vështirë për H/L që të gjykojnë nëse janë të dhëna normale apo të dhëna të parregullta si dhe ta gjykojnë dështimin e analizatorit. Këto janë çështjet për të ardhmen. Për më tepër, nga tani e tutje çështje kryesore do të jenë mirëmbajtja sistematike dhe menaxhimi i buxhetit, siç është krijimi i ditarit të menaxhimit të pajisjeve dhe mbajtja e regjistrimit të kalibrimit për secilën pajisje.</p>	

Çështjet/Propozimet	<p>Nga shkurti deri në prill 2019, është bashkëngjitur një person me përvojë në O dhe M të SMCA-ve, mirëpo në të njëjtën kohë një person tjetër përgjegjës është larguar nga kjo detyrë. Si rezultat numri i personave përgjegjës ka mbetur i njëjtë. Dy H/L përgjegjës për SMCA në IHMK nuk janë të dedikuar vetëm për O dhe M të SMCA-ve, por gjithashtu bëjnë monitorimin e dheut, analiza me JK, marrin pjesë në punëtori të organizuara jashtë vendit, marrin pjesë në takime, etj. Aktualisht, kompanitë e mirëmbajtjes në Kosovë nuk kanë aftësitë për t'i kalibruar në mënyrë të duhur analizatorët e NO_x, analizatorët e SO₂, analizatorët e O₃ dhe analizatorët e CO. Është e nevojshme që të bëhet transferimi i teknologjisë. Mirëmbajtja e qëndrueshme do të jetë e vështirë pa punësimin e së paku edhe një personi. Për sa i përket ekraneve për shfaqjen e të dhënave të cilësisë së ajrit, është e nevojshme që të sigurohet buxheti për operimi të vazhdueshëm të qëndrueshëm.</p>
---------------------	---

- (4) Rezultati 4: Zhvillohen kapacitetet për analizat relevante mjedisore laboratorike për sa i përket matjes së emisioneve dhe monitorimit të cilësisë së ajrit.

Rezultati 4 përbëhet nga përvetësimi i teknologjisë së analizave laboratorike (4-1~4-6) përmes matjes së gazit të shkarkuar sipas Metodës Standarde Referente dhe vlerësimit (4-7 ~4-10) për analizën e metaleve të rënda në PM në ajër.

Për sa i përket analizës laboratorike, H/L nuk kishte ndonjë njohuri për Metodën Standarde Referente në periudhën e parë dhe për këtë arsye rezultatet ishin të ulëta. Në periudhën e dytë, megjithëse vlerësimi i kapaciteteve u bë para aktiviteteve, por megjithëse H/L menduan se do ta përvetësojnë teknologjinë së shpejti, vlerësimi dukej se kishte më shumë rezultate të larta.

Në gjysmën e dytë të periudhës së dytë, Projekti mbështeti ri-funksionalizimin dhe rregullimin e JK dhe rregullimin e AAS. Për më tepër, Projekti bëri analiza të gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente. Në periudhën e tretë, H/L kërkuan vetë trajnim shtesë, dhe zgjeruan njohurinë në punën jo vetëm me JK por gjithashtu edhe me ICP-MS. Në të njëjtën kohë, ata përvetësuan teknologjinë për kryerjen e duhur të analizës së gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente.

Mirëpo, aplikimi i Metodës Standarde Referente është i kufizuar pasi që vetë direktiva e BE-së, e cila është bazë për PKZE-në, e kërkon këtë metodë për IDM në Kosovë, dhe JK-në e posedon vetëm IHMK. Në anën tjetër, kjo teknologji e analizës mund të jetë e aplikueshme për analiza të cilësisë së ujit, dhe teknologjia për analiza në IHMK, duke përfshirë ri-funksionalizimin e ICP-MS, është përmirësuar. Duhet të sqarohen nevojat në të ardhmen për analiza dhe është e dëshirueshme që të zgjerohet aplikimi i këtyre teknologjive.

Mirëpo, numri i stafit përgjegjës është problem. Vetëm një person mund t'i kryejë këto analiza dhe nevojitet së paku një person më shumë. Gjithashtu është shumë e rëndësishme që të sigurohet buxheti. Këto analiza kërkojnë jo vetëm mirëmbajtje të analizatorëve por

gjithashtu blerjen e tretjeve standarde dhe shumë materialeve shpenzuese siç janë reagjentë dhe pajisjet ndihmëse.

Në të njëjtën kohë, IHMK si institucion ka për qëllim marrjen e EN17025, por është shumë larg nga krijimi i sistemit dhe mbesin shumë çështje që duhet zgjidhur. Për t'i zgjidhur çështjet IHMK duhet të fillojë t'i ndërmarrë masat bazike siç është përforcimi i stafit, përforcimi i sistemit të menaxhimit të laboratorit për analiza dhe analizatorëve, etj.

Për sa i përket vlerësimit të analizës së metaleve të rënda në PM në ajër, Projekti bëri mostrimin e PM në ajër, i dërgoi ato në Japoni dhe i analizoi në periudhën e parë. Si rezultat, pala kosovare vendosi t'i monitorojë metalet e rënda në PM në ajër. Për më tepër, për shkak se fabrika e cila mund të ishte burim i ndotjes nuk punonte gjatë periudhës së parë, në periudhën e dytë u bë mostrimi shtesë dhe mostrat u analizuan përsëri në Japoni. Si rezultat, pala kosovare vendosi t'i monitorojë metalet e rënda në PM në ajër në Drenas dhe Mitrovicë. Kështu, H/L kanë përvetësuar teknologjinë e mostrimit. Në anën tjetër, analiza e metaleve të rënda kërkon funksionalizimin e ICP-MS që H/L e posedon në IHMK. IHMK nuk e ka operuar asnjëherë ICP-MS prej kohës kur është sjellë në IHMK, prandaj niveli i vlerësimit ka qenë i ulët në periudhën e parë. Si rezultat i rregullimeve vijuese të projektit, në periudhën e dytë dhe të tretë përmes aktiviteteve të Projektit bashkë me një H/L u bë riparimi i ICP-MS, rregullimet për analiza të metaleve të rënda dhe zgjidhja e problemit të dukurisë së shuarjes së plazmës. Kjo është arsyeja pse vlerësimi është ngritur në periudhën e dytë. Është planifikuar që MCC/MFK ta bëjë trajnimin e stafit në IHMK përmes projektit të vetë. Por trajnimi është shtyrë për shkak të COVID-19. Komentet nga ana e JET-it për këto rezultate të vlerësuara janë siç vijon.

Metoda Standarde Referente dhe analizat laboratorike		
	Pika fillestare	Pika përfundimtare
Niveli individual	H/L nuk e kanë kuptuar se çka është Metoda Standarde Referente. JK (njëjtë si ICP-MS) nuk ishte përdorur për gjashtë ose shtatë vite pasi që është sjellë në IHMK rreth vitit 2012.	H/L kanë kaluar nëpër përvojën me Metoda Standarde Referente, i kanë kuptuar parimet dhe kanë përvetësuar teknikat e operimit. Paralelisht, u ri-funksionalizua JK dhe H/L mësuuan operimin e tij. Në të njëjtën kohë, gjithashtu u ri-funksionalizua ICP-MS.
Niveli organizativ	H/L nuk kanë mundur ta analizojnë gazin e shkarkuar përmes Metodës Standarde Referente. H/L gjithashtu nuk mund ta përdornin JK (njëjtë si	H/L kanë mësuar analizën e gazit të shkarkuar përmes Metodës Standarde Referente. Dy persona në IHMK mund ta përdorin JK-në për analiza. Mirëpo, në procesin nga mostrimi deri te analiza, vetëm njëri nga stafi

	ICP-MS).	mund ta bëjë mostrimin e gazit dhe vetëm njëri mund ta përdorë JK për analiza. Prandaj, është e vështirë që të kryhen këto analiza në mënyrë të qëndrueshme. Për sa i përket ICP-MS, vetëm stafi i njëjtë i cili mund ta përdorë JK-në mund ta përdorë edhe ICP-MS.
Niveli social	Deri më tani është përdorur vetë AAS dhe shtrirja e aplikimit të tij për analiza është e vogël. Për më tepër, ky rezultat është pothuajse i zënë i tëri me elemente teknike. Prandaj, njohuria në nivelin social është shumë e ulët.	Fillimi i punës së JK-së e bëri të mundur kryerjen e analizës së gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente për IDM e cila kërkohet nga Direktiva e BE-së, e cila është bazë për PKZE-në. JK dhe ICP-MS u ri-funksionalizuan dhe kapaciteti për analiza i IHMK-së është përmirësuar mjaft shumë. Mirëpo, IHMK nuk ka ndonjë plan tjetër të aplikimit përveç për detyrat e kryera në Projekt (JK: analiza e gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente, ICP-MS: analiza e metaleve të rënda në PM në ajër). Nuk mund të thuhet se këto analiza shfrytëzohen në nivel të mjaftueshëm. Është e nevojshme që të zgjerohet shtrirja e aplikimit të analizatorëve.
Rezultati	<p>IHMK si laborator ka përvetësuar teknologjitë bazike për analiza dhe këto aktivitete prodhuan rezultate të mira.</p> <p>Projekti bëri ri-funksionalizimin e JK dhe ICP-MS, dhe siguroi një komplet të tretjeve standarde të nevojshme, pajisjet ndihmëse, etj. prandaj analizat mund të vazhdoen për një kohë. Aplikimi i këtyre analizatorëve është i gjerë dhe ata janë të aplikueshëm për analiza të ndryshme.</p> <p>Ishte e nevojshme të bëhen analiza për punët e kryera në Projekt, pasi që Metoda Standarde Referente kërkohet nga direktiva e BE-së për matje të gazit të shkarkuar për IDM dhe gjithashtu nevojitet për monitorim të metaleve të rënda në PM në ajër.</p>	
Çështjet/Propozimet	<p>IHMK ka përvetësuar teknikat e operimit me JK dhe ICP-MS. Mirëpo, është vetëm një punonjës i cili mund të bëjë analiza dhe nevojitet së paku edhe një punonjës. Është gjithashtu shumë e rëndësishme që të sigurohet buxheti për mirëmbajtjen e rregullt të analizatorëve, materialet shpenzuese, pajisjet ndihmëse, etj. Analizat për zbatimin e qëndrueshëm të aktiviteteve të Projektit janë sigurisht të nevojshme, por është e vështirë të thuhet se IHMK</p>	

	<p>ka përvetësuar teknologjinë për analiza vetëm me kryerjen e këtyre analizave.</p> <p>IHMK deri më tani ka shpresuar se do të bëhet ri-funksionalizimi analizatorëve të ndryshëm. Mirëpo, vetëm ka shpresuar për ri-funksionalizim, përderisa nuk ka plan tjetër për aplikimin e analizatorëve përveç për detyrat e kryera nga Projekti. Është vështirë të thuhet se IHMK i shfrytëzon analizatorët si duhet. Është e nevojshme që të zgjerohet aplikimi i tyre.</p> <p>Për ta krijuar sistemin e analizave, kërkohen aktivitetet në vijim.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Për ta përdorur teknologjinë e analizave të përvetësuar rishtas, është e nevojshme të zgjerohet aplikimi i analizave dhe ato të vazhdojnë. Në të njëjtën kohë, është e domosdoshme që të forcohet stafi dhe të krijohet sistemi për analiza. 2) Gjendja ekzistuese në laborator tregon se nuk është duke u menaxhuar si duhet, për shembull pajisjet për analiza nuk përgatiten si duhet, laboratorit i analizave nuk mbahet pastër sa duhet (rrezik i lartë i kontaminimit), analizatorët, analizat, reagjentët, etj. nuk janë të menaxhuara mirë. <p>Disponueshmëria e analizatorëve është shumë e ulët në gjendjen aktuale dhe nuk ka më përmirësim të teknologjisë së analizave, dhe në të njëjtën kohë analizatorët mund të bëhen jo-operacional për shkak të karakteristikave të analizatorëve të cilat mbahen në gjendje normale përmes përdorimit të vazhdueshëm.</p> <p>Për t'i zgjidhur çështjet IHMK duhet të fillojë nga masat bazike siç është përfundimi i stafit, përfundimi i sistemit të menaxhimit për pastërti të laboratorit për analiza, analizatorë të mirëmbajtur si duhet, etj.</p>
--	---

Monitorimi i metaleve të rënda në PM në ajër		
	Pika fillestare	Pika përfundimtare
Niveli individual	Pajisja e mostrimit (mostruesi me vëllim të ulët) është dhënë si donacion nga KE-ja në 2011 ~ 2012, mirëpo H/L nuk kishin përvojë në mostrimin e PM vetë.	<p>Projekti ka vënë në dispozicion mostruesin me vëllim të lartë dhe H/L janë aftësuar për kryerjen e mostrimit të PM (TSP). Mirëpo, analiza e metaleve të rënda në PM është kryer në Japoni. Është konfirmuar se mostruesi me vëllim të ulët i përdorur më parë nuk është duke punuar si duhet.</p> <p>Në nivelin individual H/L ende nuk e ka përvetësuar tërë teknologjinë duke përfshirë analizën e metaleve të rënda. Pritet trajnimi</p>

		për ICP-MS nga MCC/MFK.
Niveli organizativ	H/L nuk kanë pasur kapacitete për ta kryer vetë mostrimin e PM dhe analizën e metaleve të rënda në PM.	<p>H/L u bënë të aftë për ta kryer mostrimin dhe mostrimi është bërë me mostrues me vëllim të lartë me metodën japoneze. Pala kosovare shpreson ta përdorë mostruesi me vëllim të ulët për mostrimin e PM₁₀ në përputhje me standardin e BE-së, por pasi që mostruesi me vëllim të ulët nuk është në dispozicion, deri në blerjen e mostruesit me vëllim të ulët pala kosovare do ta përdorë mostruesin me vëllim të lartë.</p> <p>Për sa i përket analizës së metaleve të rënda, përmes aktiviteteve të Projektit, një nga H/L u bë i aftë për ta riparuar ICP-MS, për të bërë rregullime për analizë të metaleve të rënda dhe për t'i trajtuar problemet lidhur me shuarjen e plazmës. IHMK është duke pritur për trajnimin për ICP-MS nga MCC/MFK.</p>
Niveli social	Kosova ka burime të mëdha të metaleve të rënda dhe ka shqetësim të kontaminimit nga metalet e rënda nga industrinë.	<p>Shqetësimet janë të mëdha dhe rezultatet e analizës së mesatares ditore kanë treguar praninë e metaleve të rënda në PM në ajër në nivel më të lartë se vlerat udhëzuese në Japoni (mesatarja vjetore). H/L ka vendosur të vazhdojë me monitorimin e metaleve të rënda.</p> <p>MMPHI/MMPH ende nuk ka bërë të ditur praninë e metaleve në PM në ajër.</p>
Rezultati	<p>H/L u aftësuan për ta kryer mostrimin e PM, mirëpo ende nuk mund ta bëjnë analizën e metaleve të rënda në ajër. Për më tepër, IHMK ka në posedim mostruesin me vëllim të ulët, që është metoda standarde e BE-së, por është konfirmuar se nuk është duke punuar si duhet. Prandaj, Projekti rekomandon që të përdoret përkohësisht mostruesi i ajrit me vëllim të lartë. Projekti ka funksionalizuar përsëri ICP-MS dhe është planifikuar trajnimi për ICP-MS nga MCC/MFK.</p> <p>Mirëpo, njëjtë siç është cekur më lartë, numri i personave përgjegjës është i pamjaftueshëm dhe në të njëjtën kohë kërkohet më shumë përvojë në analiza. Për më tepër, ekziston edhe problemi i gjendjes së laboratorit i cili nuk është i organizuar si duhet për kryerjen e analizave.</p>	

	<p>Për më tepër, operimi i ICP-MS kërkon mbështetje buxhetore siç është mbështetja për blerjen e vazhdueshme të gazit të argonit dhe blerja e materialeve shpenzuese shtesë nga MMPHI/MMPH.</p>
Çështjet/Propozimet	<p>Niveli i metaleve të rënda në PM në ajër duhet të vlerësohet në baza të mesatares vjetore, prandaj është e dëshirueshme që të bëhet mostrimi dhe analiza një herë në muaj. Është e nevojshme që mostrimi dhe analiza të bëhen së paku katër herë në vit dhe të llogaritet mesatarja vjetore. Prandaj, kërkohet së paku edhe një punonjës.</p> <p>Për ta kryer analizën e metaleve të rënda në përputhje me standardin e BE-së, kërkohet mostrimi i PM₁₀ dhe për këtë nevojitet blerja e mostruesit me vëllim të ulët. Mirëpo, metoda e mostrimit me mostruesi me vëllim të ulët është e njëjtë si ajo me mostrues me vëllim të lartë, prandaj nuk ka problem me mostrim.</p> <p>Megjithëse është vonuar për shkak të COVID-19, ICP-MS do të futet në operim pas trajnimit nga MCC/MFK.</p> <p>Pala kosovare ende nuk i ka publikuar rezultatet e analizës për sa i përket metaleve të rënda në ajër. MMPHI/MMPH planifikon t'i publikojë ato pas diskutimit me komunën e Drenasit dhe Mitrovicës. Është e dëshirueshme që kjo çështje të trajtohet sa më parë që është e mundur.</p>

(5) Rezultati 5: Zhvillohen kapacitetet për modelimin e simulimit të cilësisë së ajrit.

Rezultati 5 ka pasur për qëllim zhvillimin e kapacitetit teknik për modelimin e simulimit të ndotjes së ajrit. H/L kanë mësuar qëllimin e modelit të simulimit, si të operojnë me programin dhe si t'i analizojnë kushtet e ndotjes së ajrit duke krijuar harta të shpërndarjes së përqendrimit me përdorimin e GIS. Disa nga H/L ishin në gjendje ta operojnë dhe ekzekutojnë programin vetë nën udhëzimin e JET-it, por ata ende nuk e kanë arritur nivelin ku ata mund ta llogaritin modelin e simulimit të pavarur duke përfshirë gjetjen dhe trajtimin e gabimeve. Për të fituar përvojë të mëtutjeshme dhe për t'i ruajtur/përmirësuar aftësitë teknike, është e nevojshme që të përcaktohen detyrat për krijimin dhe shfrytëzimin e modelit të simulimit në përshkrimin e punës së MMPHI/MMPH, dhe gjithashtu janë të rëndësishme edhe përpjekjet individuale.

Në vijim keni përmbledhjen e situatës aktuale nga këndvështrimi i JET-it.

	Pika fillestare	Pika përfundimtare
Niveli individual	H/L pothuajse nuk kishin njohuri/përvojë me modelin e simulimit, dhe vetëm disa nga H/L dinin për rezultatin e modelit të simulimit të	Disa nga H/L u bënë të aftë që t'i operojnë programet nën udhëzime të JET-it. Mirëpo, nuk është kuptuar plotësisht kuptimi i secilit manipulim.

	zbatuar nga donatorë të tjerë. Gjithashtu kapaciteti për përdorimin e kompjuterit dhe për llogaritjet në Excel nuk ishte i mjaftueshëm.	
Niveli organizativ	Edhe MMPHI/MMPH e dhe IHMK janë të interesuar për modelin e simulimit. Në pikën filluese, IHMK-ja duhej të ishte organizata primare për kryerjen e këtij aktiviteti	H/L nga MMPHI/MMPH dhe IHMK kanë marrë pjesë në trajnime, dhe deri më tani të dy organizatat janë bashkëpunuese në këtë aktivitet. Në anën tjetër, për ta ruajtur kapacitetin pas projektit, rekomandohet që përshkrimi i punës së MMPHI/MMPH t'i përcaktojë detyrat e modelit të simulimit.
Niveli social	Megjithëse qytetarët janë shumë të interesuar për shkaqet e ndotjes së ajrit, modeli i simulimit nuk është i njohur si vegël për ta analizuar këtë.	Nuk ka ndryshime nga pika filluese Modeli i simulimit nuk përdoret për vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit, shpalesje të informacioneve për publikun, etj. Pasi që harta e përqendrimit është vegël e dobishme për shpërndarjen e informacionit tek publiku, rekomandohet që modelimi i simulimit të shfrytëzohet për përpilimin e Planit të Veprimit të MMPHI/MMPH për kontrollin e ndotjes së ajrit, dhe për shpalesje të informacionit dhe komunikim me publikun.
Rezultati	H/L kanë mësuar qëllimin e modelit të simulimit, si të operojnë me programin dhe si t'i analizojnë kushtet e ndotjes së ajrit duke krijuar harta të shpërndarjes së përqendrimit me përdorimin e GIS. Përmes një sërë ushtrimesh praktike, disa nga H/L u bënë të aftë t'i ekzekutojnë programet duke përdorur manualin e modelimit të simulimit nën udhëzimin e JET-it. Në nivelin organizativ, grupi punues për simulim, i organizuar kryesisht nga anëtarët e IHMK-së dhe në bashkëpunim me stafin e AMMK-së, ka qenë i organizuar dhe i gatshëm ta operojë modelimin e simulimit duke përfshirë mbledhjen e të dhënave dhe manipulimin me GIS. Në anën tjetër, për ta ruajtur dhe mbajtur kapacitetin pas projektit, rekomandohet që përshkrimi i punës së MMPHI/MMPH t'i përcaktojë detyrat e modelit të simulimit.	
Çështjet/Propozimet	Në këtë projekt është bërë trajnimi vetëm i çështjeve bazike në programin CALPUFF dhe kjo nuk adreson përmbajtjen e aplikuar. Individët përbrenda H/L ndryshojnë për sa i përket arritjes së kompetencës teknike dhe vetëm	

	<p>disa prej H/L kanë aftësinë për ta ekzekutuar modelin e simulimit të pavarur duke përdorur manualin. Ende mbetet si çështje të kuptuarit më të thellë të përmbajtjes së llogaritjeve dhe interpretimi i rezultateve.</p> <p>Në nivelin organizativ, përshkrimi i punës së H/L nuk përfshinë zbatimin e modelit të simulimit si pjesë të detyrave të tyre. Për ta mbajtur sistemin dhe aftësitë për të kryer simulime pas përfundimit të projektit, duhet të specifikohen detyrat në rregulloren e punës së ministrisë për t'i sqaruar rolet dhe përgjegjësitë së secilës organizatë përkatëse.</p> <p>Është e nevojshme që të sqarohen qëllimet dhe situatat në të cilat mund të shfrytëzohet modeli i simulimit dhe të arrihet konsensusi ndërmjet organizatave përkatëse.</p> <p>Kur të zgjidhen çështjet e ndërlidhura me kapacitetin dhe sistemet për modelimin e simulimit, do të jetë e mundur që të përdoret modeli i simulimit për vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit dhe shpalosjen e informacionit tek publiku.</p>
--	---

(6) Rezultati 6: Pala kosovare përmirëson vendimmarrjen bazuar në të dhënat teknike për kontrollin e ndotjes së ajrit.

Rezultati 6 ka pasur për qëllim që H/L t'i kuptojë masat për zvogëlimin e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera të palëvizshme dhe vetë t'i studiojnë dhe të japin udhëzime për masat. Staf i KEK-ut ka thelluar njohuritë për studimin e masave për zvogëlimin e emisioneve për IDM përmes procesit të zbatuar në TC Kosova A ku Projekti ka studiuar, propozuar dhe zbatuar masat për zvogëlimin e emisioneve. Për sa i përket pluhurit, janë propozuar masat për zvogëlim dhe ato janë pranuar. Propozimi rezultoi me zbatimin e modifikimit. Mirëpo, për masat për zvogëlimin e SO₂ dhe NO_x nevojitet investim jo i vogël dhe është vështirë që të realizohen ato. Aktualisht, investimet në TC Kosova A janë të kufizuara dhe të vështira për shkak të mbylljes së planifikuar për vitin 2023, pas fillimit të punës së TC Kosova e Re.

Në anën tjetër, për sa i përket burimeve të tjera të palëvizshme, realiteti i situatës është bërë i qartë përmes matjes së gazit të shkarkuar dhe studimit të masave për zvogëlimin e emisioneve nga Projekti, ku nuk bëhet plotësisht zbatimi i matjes së gazit të shkarkuar dhe raportimi, ose rezultatet e matjes nuk janë të sakta edhe pse matja kryhet. Kjo supozohet se shkaktohet nga fakti se MMPHI/MMPH si autoritet kompetent nuk mund t'i shqyrtojë rezultatet e matjes, të gjykojë përshtatshmërinë e rezultateve, etj. Çështje për të ardhmen është rritja e kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës në MMPHI/MMPH ku zyrtarët përgjegjës përmirësojnë njohurinë dhe përvojën për matje dhe masat për zvogëlimin e emisioneve, dhe në të njëjtën kohë inspektojnë rezultatet e matjes duke shfrytëzuar kapacitetin për matje të gazit të shkarkuar të përvetësuar nga IHMK, etj.

Komentet nga ana e JET-it për këto rezultate të vlerësuara janë siç vijon.

	Pika fillestare	Pika përfundimtare
Niveli individual	<p>Personat përgjegjës kishin pak njohuri për masat e zvogëlimit të emisioneve për IDM-të dhe burimet e tjera të palëvizshme.</p>	<p>Seminaret, etj. për masat për zvogëlimin e emisioneve janë përsëritur shumë herë gjatë periudhës së Projektit. Stafii përgjegjës në KEK kanë përmirësuar njohurinë e tyre dhe kanë thëlluar të kuptuarit e tyre. Mirëpo, zyrtarët përgjegjës në MMPHI/MMPH nuk e kuptojnë mirë dhe sapo kanë filluar ta kuptojnë mungesën e njohurisë.</p>
Niveli organizativ	<p>Ligjet lidhur me rregullimin e emisioneve dhe obligimin për raportimin e emisioneve janë të organizuara mirë, mirëpo këto ligje nuk zbatohen në nivel të duhur.</p>	<p>Në TC Kosova A, për shkak të planit që të mbyllet pas fillimit të punës së TC Kosova e Re në të ardhmen është e vështirë të investohet, prandaj njësitë nuk mund t'i përmbushin VKE-të dhe nuk mund të ndërmerret asnjë masë.</p> <p>Për sa i përket burimeve të tjera të palëvizshme, zyrtarët në MMPHI/MMPH nuk kanë arritur nivelin për t'i udhëzuar fabrikat private për përmirësime nga pikëpamja teknike, dhe në të njëjtën kohë, operatorët e fabrikave private nuk e kuptojnë rëndësinë e matjes së gazit të shkarkuar, etj. Aktualisht nuk është situatë ku ligji është duke u zbatuar mirë.</p>
Niveli social	<p>Për sa i përket burimeve të palëvizshme, shqetësimi veçanërisht për pluhurin është shumë i madh për shkak të ankesave nga popullata. Por, ata nuk kanë njohuri të mjaftueshme për SO₂ dhe NO_x.</p> <p>Shqetësimi për PM_{2,5} është shumë i lartë.</p>	<p>MMPHI/MMPH i mungon kapaciteti për t'i udhëzuar IDM-të dhe burimet e tjera të palëvizshme.</p> <p>Ka shumë ankesa nga qytetarët për IDM, por masat për zvogëlimin e emisioneve do të zbatohen me mbështetjen e BE-së.</p> <p>Në anën tjetër, zyrtarët në MMPHI/MMPH nuk i udhëzojnë në mënyrë të duhur fabrikat private (burimet e tjera të palëvizshme). Momentalisht në Kosovë industrinë nuk janë aq të zhvilluara, prandaj shqetësimi si nga MMPHI/MMPH po ashtu edhe nga qytetarët nuk është i madh për burimet e tjera të palëvizshme.</p>

<p>Rezultati</p>	<p>Për sa i përket TC Kosova A, Projekti ka propozuar masat për zvogëlimin e pluhurit me investimet më të vogla të mundshme. Propozimet janë në drejtim të zbatimit dhe një pjesë e modifikimeve është aplikuar. Këto masa janë studiuar në bashkëpunim me UP dhe rezultatet e studimit u aplikuan, dhe kjo u bë një nga rezultatet më të mëdha. Gjithashtu janë propozuar masat për zvogëlimin e SO₂ dhe NO_x, por është vështirë që të aplikohen për shkak të investimit të nevojitur.</p> <p>Në anën tjetër, për sa i përket burimeve të tjera të palëvizshme, nga rezultatet e matjes së gazit të shkarkuar në burimet e tjera të palëvizshme të kryera nga Projekti, u bë e qartë se shumica e fabrikave nuk janë në pajtueshmëri me VKE-të e tyre. Gjithashtu u bë e qartë situata aktuale se as MMPHI/MMPH si autoritet kompetent e as operatorët e fabrikave private nuk e njohin rëndësinë e matjes dhe nuk i kontrollojnë emisionet. Është gjetur se zyrtarët në MMPHI/MMPH duhet ta rrisin njohurinë për matje të gazit të shkarkuar dhe masat për zvogëlimin e emisioneve, gjë që do të çojë drejt përfitimit të kapacitetit për t'i udhëzuar fabrikat private.</p>
<p>Çështjet/Propozimet</p>	<p>Masat për zvogëlimin e pluhurit për TC Kosova A janë duke u aplikuar tani, por aplikimi i masave për zvogëlimin e SO₂ dhe NO_x është vështirë për t'i zbatuar për shkak të planit për ndërtimin e TC Kosova e Re. Rehabilitimi i TC Kosova B tani është në proces e sipër dhe është e nevojshme që të përcillet progresi. Në anën tjetër, aktualisht plani për ndërtimin e TC Kosova e Re është në pritje, dhe është e nevojshme të pritet për përgjigjen e qeverisë, duke përfshirë rishikimin e PKZE-së.</p> <p>Për sa i përket burimeve të tjera të palëvizshme, është e nevojshme që MMPHI/MMPH t'i udhëzojë burimet e tjera të palëvizshme për të kryer matje të gazit të shkarkuar, pra pikë së pari ta kuptojnë gjendjen e emisioneve nga secila fabrikë private dhe t'i udhëzojë ato. Për ta realizuar këtë, është e domosdoshme që zyrtarët në MMPHI/MMPH të marrin njohuri për matjen e gazit të shkarkuar dhe masat për zvogëlimin e emisioneve. Udhëzimet përmes TNP siç është kur e bëjnë inspektimin e fabrikave dhe kryejnë matje, pasi që secila fabrikë ka proceset e veta, rrjedhën e procesit, lëndën e konsumuar djegëse, etj. duhet të jenë mënyra më e përshtatshme për rritjen e aftësisë.</p>

(7) Rezultati 7: Zhvillohen masat e kontrollit të emisioneve në IDM.

Në Rezultatit 7, pasi që përbërja e gazit të shkarkuar shpesh ndryshon për shkak të përbërjes së linjitet që është lëndë djegëse e përdorur nga IDM-të, synohet që të qartësohet sjellja e gazit të shkarkuar dhe të kuptohet teoria bazë për masat për burimet e emisioneve, në mënyrë që IDM-të të mund të zhvillojnë masa të cilat mund të arrihen me metodën e

operimit të kaldajës dhe me investimet e vogla vetanake

Për sa i përket masave për zvogëlimin e Pluhurit, Pluhuri pritet se mund të jetë në pajtueshmëri me VKE-të nëse zbatohen masat për përmirësimin e performancës së FES-it bazuar në rezultatet e testeve të ndryshme të kryera në këtë Projekt.

Pika të cilat duhet zbatuar në anën e FES-it tashmë janë në proces e sipër përmes modifikimit aktual, por masat për zvogëlimin e sasisë së gazit të shkarkuar të cilat duhet të zbatohen nga ana e kaldajës (si zvogëlimi i sasisë së ajrit që rrjedhë në para-nxehësin e ajrit) nuk janë zbatuar për shkak se nevojitet investim. Në anën tjetër, aktualisht plani për ndërtimin e TC Kosova e Re është në pritje, dhe është e nevojshme të pritet për përgjigjen e qeverisë, duke përfshirë rishikimin e PKZE-së.

Për sa i përket masave për zvogëlimin e SO₂ dhe zvogëlimin e NO_x, është e vështirë që vetëm përmes përmirësimit të metodës së operimit të kaldajës të arrihet në nivel të pajtueshmërisë me VKE-të. Masat janë propozuar bazuar në rezultatet e testeve, por ato është vështirë të zbatohen sepse kërkojnë investime. Arsyeja është se investimet në TC Kosova A janë të kufizuara meqenëse planifikohet që të mbyllet në vitin 2023.

Përmes procesit të ekzaminimit, propozimeve për përmirësim dhe zbatimit të masave për zvogëlimin e emisioneve në TC Kosova A, H/L kuptuan gjendjen aktuale të përbërjes së gazit të shkarkuar në IDM dhe mënyrën se si të vazhdohet me masat për kontrollin e emisioneve.

Për sa i përket zvogëlimit të emisioneve për IDM, përveç njohurisë për matjen e gazit të shkarkuar, kërkohet njohuri e gjerë për kaldajën dhe pajisjet ndihmëse. Megjithëse numri i H/L të cilët mund ta kuptojnë të tërën është i kufizuar, konsiderohet se personi kyç ka arritur nivelin në të cilin masat për zvogëlimin e emisioneve të zbatuara në këtë projekt mund të ekzekutohen edhe nëse JET-i nuk është prezent.

Në periudhën e tretë JET- ka dhënë mbështetje nga Japonia në mënyrë që H/L të mund të vazhdojnë aktivitetet e tyre. Si rezultat, rezultati i përgjithshëm i vlerësimit është më i lartë në krahasim me rezultatin e periudhës së dytë, dhe mendohet se kjo është për shkak të entuziazmit të H/L për parandalimin e ndotjes së ajrit

Komentet nga ana e JET-it për këto rezultate të vlerësuara janë siç vijon.

	Pika fillestare	Pika përfundimtare
Niveli individual	Personi përgjegjës ka pak njohuri teknike për zvogëlimin e emisioneve të IDM.	Edukimi përmes seminareve, etj. është përsëritur. Personeli në TC Kosova A kishte njohuri më të mirë. Mirëpo, personat përgjegjës në MMPHI/MMPH nuk e kanë thelluar të kuptuarit e tyre dhe janë në fazën kur e pranojnë mungesën e njohurisë. Masat për zvogëlimin e emisioneve përmes operimit të kaldajës janë masa bazike të cilat

		nuk kërkojnë investim, por vetëm disa prej H/L kanë njohuri për operimin e kaldajës, dhe personeli përveç atyre të TC Kosova A janë më pak të interesuar.
Niveli organizativ	Megjithëse ka ligje dhe rregullore të ndërlidhura me rregullimin e emisioneve, janë disa aspekte të cilat aktualisht nuk mund të zbatohen.	MMPHI/MMPH nuk është në nivel ku mund të ofrojë udhëzime për fabrikat, etj. nga pikëpamja teknike, ndërsa në anën tjetër, KEK-u është duke e zgjeruar njohurinë e vetë teknike. TC Kosova A nuk ka mundësi të jetë në pajtueshmëri me VKE-të për shkak të kufizimeve në investime, planin për mbyllje në të ardhmen, etj.
Niveli social	Për sa i përket IDM-ve ka interes të madh për Pluhurin, sepse është i dukshëm dhe ka shumë ankesa nga banorët, por ka shumë pak interes për SO ₂ dhe NOx.	MMPHI/MMPH ka mungesë në aftësinë për të ofruar udhëzime teknike për IDM dhe nuk ka mundësi që të përgjigjet në nivel të mjaftueshëm. Në veçanti, ankesat nga banorët tek KEK-u janë të shumta, dhe megjithëse është planifikuar zvogëlimi i emisioneve të Pluhurit përmes rehabilitimit të TC Kosova B, aftësia për t'i vlerësuar pajisjet që do të instalohen është i pamjaftueshëm. Investimi në masat mjedisore ndikon në tarifat e energjisë elektrike, por si duket konsumatorët nuk kanë njohuri të mjaftueshme për këtë çështje. Për sa i përket përmirësimit të FES-ve, janë zbatuar rezultatet e studimit përmes bashkëpunimit ndërmjet industrisë, akademisë dhe qeverisë, dhe kjo është bërë një nga rezultatet më të mëdha të Projektit.
Rezultati	Masat për zvogëlimin e emisioneve për IDM dallojnë për secilin impiant. Prandaj, kërkohet gjykimi i vlerave të emisioneve dhe njohuria teknike, por ka mangësi në burimet njerëzore të H/L të cilët e kanë këtë njohuri. Për sa i përket masave për zvogëlimin e emisioneve me përmirësimin e metodës së operimit të kaldajës, H/L përgjegjës në TC Kosova A pothuajse ka arritur nivelin ku vetë mund ta bëjë ekzaminimin, dhe ata do të jenë në gjendje të gjejnë mënyra për t'i menaxhuar emisionet dhe ta operojnë	

	<p>kaldajën në mënyrë që mundësisht t'i zvogëlojnë emisionet me pajisjet aktuale.</p> <p>Për sa i përket TC Kosova A, janë propozuar dhe janë duke u zbatuar metodat e zvogëlimit të SO₂ dhe NOX me përmirësimin e metodës së operimit të kaldajës si dhe masat për zvogëlimin e Pluhurit të cilat mund të zbatohen me investim të vogël.</p> <p>Disa përmirësime tashmë i janë aplikuar FES-ve bazuar në rezultatet e studimit të kryer në këtë Projekt përmes bashkëpunimit industri-akademi me Universitetin e Prishtinës, dhe ky ishte një rezultat i madh i Projektit.</p> <p>Janë bërë propozime për sa i përket masave për zvogëlimin e SO₂ dhe NOx, por këto kërkojnë investime të konsiderueshme dhe është vështirë që të aplikohen për shkak se përfshijnë modifikimin e kaldajës.</p>
Çështjet/Propozimet	<p>Për sa i përket zvogëlimit të emisioneve për IDM, rehabilitimi i TC Kosova B, ndërtimi i Termocentralit të ri (TC Kosova e Re), ndalja e TC Kosova A për shkak të fillimit të punës së Termocentralit të ri janë të planifikuara zë përfundojnë rreth vitit 2023.</p> <p>Prandaj, masat për zvogëlimin e emisioneve në TC Kosova A kanë problemin e anës financiare (financimi dhe ndikimi në tarifa) dhe është problem i madh sepse zbatimi i tyre nuk është i lehtë.</p> <p>Masat për zvogëlimin e emisioneve me përmirësimin e metodës së operimit janë masa bazike të cilat nuk kërkojnë investim, dhe gjithashtu mund të aplikohen në TC Kosova B e cila do të vazhdojë operimin.</p> <p>Gjatë futjes në përdorim të pajisjeve mjedisore në të ardhmen, është e rëndësishme që të zvogëlohen emisionet nga kaldaja për aq sa është e mundur në mënyrë që të minimizohet kosto e pajisjeve për zvogëlimin e emisioneve.</p>

(8) Rezultati 8: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit

Aktivitetet e Rezultatit 8 filluan me seriozitet në mes të periudhës së dytë, dhe aktivitete mjaft të përqendruara u kryen në periudhën e tretë. Në periudhën e dytë, rishikimet e Masave të përgatitura tashmë në Kosovë dhe projektin tjetër të JICA-s ishin kryesisht të përqendruara, por në periudhën e tretë u konsideruan më gjerësisht planifikimi i Masave, llogaritja e zvogëlimeve të emisioneve dhe kosto - efektiviteti i Masave duke përdorur inventarin e emisioneve, studimin e metodës dhe çështjeve të zbatimit për sa i përket Masave, dhe rezultatet u përmbledhën si fletë e vlerësimit të Masave. Meqenëse përmes këtyre aktiviteteve u zhvillua kapaciteti dhe u qartësuan sfidat në zbatimin e Masave, zhvillimi i kapaciteteve u rrit në nivelin individual, nivelin organizativ dhe social, dhe u sqaruan fushat të cilat mungonin. Kjo u reflektua në rezultatin e testit të vetëvlerësimit.

Vlerësimi i zhvillimit të kapacitetit të H/L i gjykuar nga JET-i është përmbledhur si në vijim.

	Pika fillestare	Pika përfundimtare
Niveli individual	H/L ishin në gjendje t'i përpilojnë Masat, mirëpo ata nuk ishin në gjendje ta bëjnë vlerësimin e plotë të arsyeshmërisë teknike, ekonomike dhe sociale të Masave.	Përmes përgatitjes së fletës së vlerësimit për Masat, u thellua të kuptuarit e nevojës për të dhëna shkencore dhe teknike në planifikimin, studimin dhe vlerësimin e Masave. Në të njëjtën kohë, H/L thelluan të kuptuarit e konsideratave socio-ekonomike. Përmes Projektit, H/L ishin në gjendje ta thellojnë të kuptuarit e tyre për rolet e qeverisë për sa i përket Masave. Në anën tjetër, nuk ka përvojë të mjaftueshme të H/L për planifikimin, studimin, vlerësimin dhe zbatimin e Masave në mënyrë të pavarur në të ardhmen.
Niveli organizativ	Ishte situatë ku masat janë konsideruar jo si MMPHI/MMPH por si individë. Për më tepër, nuk ishte situatë ku masat janë përpiluar duke marrë parasysh arsyeshmërinë teknike, ekonomike dhe sociale.	Meqenëse aktivitetet siç janë kuantifikimi i zvogëlimeve të emisioneve duke përdorur inventarin e emisioneve dhe studimi i rezultateve të modelimit të simulimit u shkëmbyen përmes përgatitjes së fletës së vlerësimit të Masave, u përmirësua zhvillimi i kapacitetit në nivelin organizativ. Mirëpo, MEA/MMPH është ende në fazën e përpjekjes për ta krijuar kornizën institucionale për Masat dhe nuk është në gjendje që në mënyrë sistematike dhe të pavarur të planifikoj, studioj, vlerësoj dhe zbatoj Masat në të ardhmen.
Niveli social	Megjithëse nevoja për Masat është kuptuar, të kuptuarit e masave konkrete ka qenë i paktë.	Pasi që përmes Projektit i cili ka përfshirë aktivitetet e përgatitjes së Fletës së Vlerësimit të Masave, aktivitetet për planifikimin, studimin, vlerësimin dhe zbatimin e Masave janë kryer përmes diskutimeve dhe konsultimeve me organizatat përkatëse, u rritën kapacitetet në nivelin social. Për më tepër, përmes aktiviteteve të

		<p>Projektit të mbuluara nga mediat, siç janë hulumtimet masive në terren nga shumë studentë nën Projekt, etj., të kuptuarit në nivelin social gradualisht është duke avancuar.</p>
<p>Rezultati</p>		<p>Pasi që përmes përgatitjes së fletës së vlerësimit të Masave, është kryer kuantifikimi i zvogëlimeve të emisioneve dhe kosto - efektiviteti, konsiderimi i metodës dhe çështjeve të zbatimit, vlerësimi në aspektin teknik dhe social, etj., kapaciteti për secilin proces të Masave si planifikimi, studimi, vlerësimi dhe zbatimi i Masave janë përmirësuar.</p> <p>Duke përdorur 17 Objektivat e OZHQ-ve si tregues të vlerësimit në nivelin social për Masat, H/L ishin në gjendje ta bënin vlerësimin e efekteve sociale të Masave në mënyrë objektive jo arbitrare.</p> <p>Meqenëse kuantifikimi i zvogëlimeve të emisioneve është llogaritur duke përdorur inventarin e emisioneve, H/L me mbështetjen e JET-it ishin në gjendje që vetë t'i caktonin kushtet e llogaritjes dhe llogaritnin zvogëlimet e emisioneve në bashkëpunim me grupin e Rezultatit 1. Në të njëjtën kohë, H/L me mbështetjen e JET-it ishin në gjendje ta llogaritin dhe vlerësonin kosto - efektivitetin sipas skenarit të zvogëlimit të emisioneve duke diskutuar koston e kushteve të llogaritjes.</p> <p>Për sa i përket metodës së zbatimit të Masave, u bë e mundur të ketë diskutime më të thella lidhur me masat duke u konsultuar jo vetëm me anëtarët e H/L por edhe policinë e trafikut (MPBAP/MPB) dhe kompaninë e ngrohjes qendrore publike (Termokos).</p>
<p>Çështjet/Propozimet</p>		<p>Meqenëse rezultatet e Projektit do të ndahen me shoqërinë në të ardhmen dhe aktivitetet e donatorëve të huaj si MCC/MFK gjithashtu janë duke përparuar, pritet që të kuptuarit në të ardhshmen i Masave në nivelin social do të përparojnë.</p> <p>Meqenëse udhëheqësja e H/L, e cila ka zbatuar planin e Masave në mënyrë proaktive në MMPHI/MMPH, u pensionua nga MMPHI/MMPH para fillimit të periudhës së tretë, personit të ri përgjegjës për Masat i mungonte përvoja. Mirëpo, pasi që Projekti e punësoi këtë udhëheqëse të mëparshëm si konsulente vendore dhe ofroi fushat e diskutimeve më të thella, puna për Masat ishte në gjendje të merrej përsipër. Në të ardhmen, do të jetë e nevojshme të përmirësohen kapacitetet, duke u përqendruar kryesisht tek ky person i ri.</p> <p>Në të ardhmen, do të jetë e nevojshme të kryhet planifikimi, studimi, vlerësimi dhe zbatimi i Masave në nivel të vendit. Për ta bërë këtë, është e nevojshme të merren parasysh Masat për shumë fusha siç janë kategoria e</p>

	industrisë prodhuese, sektori i bujqësisë dhe sektori i mbeturinave, të cilat nuk janë konsideruar plotësisht në Projekt. Për më tepër, në lidhje me Masat e marra në parasysh nga Projekti, është e nevojshme mbështetja për planifikimin, studimin, vlerësimin dhe zbatimin e Masave të mëtutjeshme, duke përdorur të dhënat e hollësishme siç është konsiderimi i Masave sipas performancës aktuale të emisioneve në Kosovë dhe sipas rajonit.
--	---

3.12 Aktiviteti i marrëdhënieve me publikun dhe prezantimet për ministra

Projekti ka prezantuar përmbajtjen e Projektit Ministrave të MMPHI/MMPH dhe ka kërkuar për bashkëpunim. Projekti gjithashtu në mënyrë aktive i ka ofruar informacione publikut përmes mediave.

Aktivitetet kanë qenë publikimi i buletineve informuese, bashkëpunimi në raportet e mediave, etj.

3.12.1 Prezantimet për ministrat

Gjatë periudhës së projektit, ministri i MMPHI/MMPH është ndërruar katër herë si rezultat i zëvendësimit dhe/ose ndërrimit të qeverisë. Përmbajtja e prezantimeve për ministrat është paraqitur në vijim. Prezantimet janë bashkëngjitur në Shtojcën-1.

(1) Prezantimi i parë për ministren (Znj. Albena RESHITAJ)

1 nëntor 2017 (e mërkurë)

Aktivitete e planifikuara i janë prezantuar ministres dhe ministrja dha disa komente për Projektin. Pas prezantimit ministrja dha deklaratë për publikun përmes komunikatës për shtyp.



(2) Prezantimi i dytë për ministren (Znj. Albena RESHITAJ)

12 Shkurt (e hënë) 2018

Nga ministrja kishte një propozim të papritur për takim lidhur me ndotjen e ajrit që ndodhi në fund të muajit janar, dhe u prezantua përmbajtja e Projektit lidhur me kontrollin e ndotjes së ajrit.

Projekti kryesisht prezantoi përmbajtjen e tri fushave të cilat po zbatoheshin në atë moment.



- (3) Prezantimi i tretë për ministren (Znj. Albena RESHITAJ)
11 qershor 2018 (e mërkurë)

Janë prezantuar aktivitetet e Projektit në periudhën e parë dhe aktivitetet e planifikuara për periudhën e dytë. Pas prezantimit kishte komunikatë për shtyp.



- (4) Prezantimi i katërt për ministrin (Z. Fatmir MATOSHI)
29 tetor (e hënë) 2018

Ministri i ri u emërua (pas dorëheqjes së ministres paraprake), dhe Ministrit iu prezantuan pasqyra e Projektit dhe progresi i aktivitetëve në fushën e inventarit të emisionëve.



- (5) Prezantimi i pestë për ministrin (Z. Fatmir MATOSHI)
25 janar 2018 (e martë)

Ministrit iu prezantuan rezultatet e simulimit të raportuara në takimin e katërt të KPK-së. Gjatë prezantimit, Projekti ka shpjeguar se rezultatet e simulimit ende kishin pika të cilat duhet të studioheshim më shumë dhe se ishte e domosdoshme që rezultatet të trajtoheshin me shumë kujdes.



(6) Prezantimi i gjashtë për ministrin (Z. Lumir ABDIXHIKU)
19 shkurt 2020 (e mërkure)

JET-i morri pjesë në takimin përshëndetës për ministrin e ri nga përfaqësuesi kryesor i zyrës së JICA-s për Ballkanin. Pasi që përfaqësuesi bëri prezantimin e aktiviteteve të JICA-s, Projekti shpjegoi aktivitetet e Projekti gjatë kokës së shkurtër në dispozicion.



(7) Prezantimi i gjashtë për ministrin (Z. Liburn ALIU)
11 maj 2021 (e martë)

Kosova kishte zgjedhjet e përgjithshme parlamentare në shkurt të vitit 2021, dhe qeveria ndryshoi dhe qeveria e re ka marrë detyrën. Për shkak të këtij ndryshimi, u mbajt një takim virtual. Zyra Qendrore e JICA-sa dhe Zyra e JICA-s për Ballkanin ia prezantuan Ministrin të ri (Z. Liburn Aliu) dhe Sekretarin të Përgjithshëm (Z. Izedin Bytyqi) pasqyrën e aktiviteteve dhe aktivitetet e JICA-a në Kosovë. Në të njëjtën kohë, u kërkua bashkëpunimi për aktivitetet siç është Seminari Përfundimtar, etj. Ministri shprehi mirënjohje për aktivitetet e Projektit dhe tregoi vullnet për bashkëpunim.

3.12.2 Buletinet

Projekti ka publikuar katër buletine informuese. Ato janë të bashkëngjitura në Shtojcën-3. Meqenëse aktivitetet e Projektit ishin të përqendruara kryesisht në krijimin e bazës së të dhënave për studimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit, buletini informues u përqendrua në prezantimin e këtyre aktiviteteve.

Përmes aktiviteteve të Projektit H/L ka marrë njohuri dhe informacione për kontrollin e ndotjes së ajrit deri në një masë, por Projekti nuk i ka shpalosur disa informacione të rëndësishme për shkak të arsyeve në vijim.

Për sa i përket rezultateve të simulimit, rezultatet ishte e vështirë të publikohen për shkak të vështirësisë për t'i vërtetuar ato për shkak të besueshmërisë së të dhënave të cilësisë së ajrit nga e kaluara. Për më tepër, shkak i vlerësuar për ndotje të ajrit mund të ketë kundërshtime nga qytetarët nëse publikohet ashtu si është. Për këto arsye JET-i ia la shpalosjen e informacioneve të përmendura më lartë krejtësisht MMPHI/MMPH dhe për këtë arsye Projekti nuk ofroi informacione. Për sa i përket emisioneve nga IDM dhe burimet e tjera të palëvizshme, shpalosja e të dhënave është e vështirë pasi që një pjesë e komponentëve tejkalojnë VKE-të. Për arsye të njëjtë, JET-i gjithashtu ia la shpalosjen e informacioneve MMPHI/MMPH.

Tabela 3-136 Buletinet

Buletini	Data e publikimit	Përmbajtja
No.1	Janar 2018	Prezantimi i aktiviteteve të Projektit
No.2	Shkurt 2018	Prezantimi i aktiviteteve për inventarin e emisioneve dhe monitorimin e cilësisë së ajrit
No.3	Gusht 2018	Prezantimi i aktiviteteve të intervistave të hulumtimit për konsumin e lëndës djegëse dhe numërimin e trafikut në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës
No.4	Gusht 2018	Prezantimi i aktiviteteve për forcimin e aftësisë për matjen e gazit të shkarkuar për IDM

3.12.3 Publikimet në media

Përmes aktiviteteve të projektit, Projekti gjithashtu në mënyrë aktive ka dhënë informacione në bashkëpunim me media. Aktivitetet janë siç vijon.

Tabela 3-137 Aktivitetet me media

1 nëntor 2017 (e mërkurë) Intervista për shtyp	Pas prezantimit për ministren u mbajt intervista për shtyp me ministren.	
27 janar (e shtunë) 2018 Intervista në TV	Kur gjendja e ajrit ishte shumë e keqe nga 25 deri 29 janar 2018, një anëtar i JET-it morri pjesë në mënyrë jozyrtare në intervistë.	
14 shkurt 2018 (e mërkure) Titulli i programit: Jeta në Kosovë	Kur gjendja e ajrit ishte shumë e keqe nga 25 deri 29 janar 2018, një anëtar i JET-it morri pjesë në programin televiziv dhe shpjegoi aktivitetet e Projektit të kërkuara nga MMPHI/MMPH.	
28 prill (e shtunë) 2018 Raporti në media	Kishte intervistë për sa i përket aktivitetit të numërimit të vëllimit të trafikut.	
1 qershor 2018 (e martë) Intervista në TV	Kishte intervistë për sa i përket aktivitetit të mostrimit të PM në ajër në Drenas dhe Mitrovicë	

<p>19 prill (e premte) 2019 Intervista në TV</p>	<p>Në fillim të aktivitetit për mbledhjen e të dhënave për informacionet për automjetet, Projekti u intervistua kur e vizitoi kompaninë publike të autobusëve të qytetit të Prishtinës.</p>	
<p>11 janar 2019 (e martë) Komunikata për shtyp</p>	<p>U mbajt ceremonia e dorëzimit-pranimit të pajisjeve nga JICA tek pala kosovare dhe u bënë intervistat nga media. Pas ceremonisë u bë prezantimi i pajisjeve.</p>	
<p>25 tetor 2019 (e premte) Intervista në TV</p>	<p>U mbajt ceremonia e dorëzimit-pranimit të ekraneve për shfaqjen e të dhënave të cilësisë së ajrit nga JICA tek pala kosovare dhe pas ceremonisë pati intervista.</p>	
<p>4 nëntor 2019 (e hënë) Raporti në media</p>	<p>Në kohën e takimit me kryetarin e Obiliqit, Projekti propozoi instalimin e ekranit për shfaqjen e të dhënave të cilësisë së ajrit. Kjo ngjarje u mbulua nga gazeta.</p>	
<p>4 janar 2020 (e enjte) Raporti në media</p>	<p>Shpjegimi për ushtruesin e detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, i cili do të jetë kryesuesi i ardhshëm i KPK-së, për sa i përket pasqyrës së Projektit dhe rishikimit të plan-programit të Projektit për shkak të COVID-19.</p>	

4. Sfidat dhe Mësimet e Mësimet e mësuara nga aktivitetet e Projektit

Projekti është marrë me shumë sfida në aktivitete në mënyrë që të vazhdojë me zbatimin pa probleme të Projektit. Në të njëjtën kohë, Projekti ka mësuar shumë mësimet. Sfidat dhe mësimet e mësuara janë përshkruar siç vijon.

4.1 Sfidat dhe masat

Pasi që Projekti mbulon një gamë të gjerë të aktiviteteve nga Rezultati 1 deri te Rezultati 8, në secilën vizitë Projekti ka planifikuar orarin për secilin anëtar të JET-it, ka ndarë orarin me H/L para vizitës dhe ka organizuar orarin. Për më tepër, H/L dhe JET-i e kanë shqyrtuar orarin çdo javë gjatë qëndrimit të JET-it, dhe H/L dhe JET-i gjithmonë janë përpjekur që ta ndajnë dhe organizojnë orarin.

Gjatë qëndrimit të JET-it, çdo dy javë është mbajtur takimi i rregullt në të cilat kanë marrë pjesë koordinatorët e secilit Grup Punues, dhe përmes këtyre takimeve anëtarët e H/L dhe anëtarët e JET-it kanë shkëmbyer informacione dhe kanë organizuar aktivitete ndërmjet Grupeve Punuese dhe JET-it.

Në takimin e dytë të KPK-së, JICA dhe pala kosovare u pajtuan për mekanizmin se si të shkohet para me koordinimin me donatorët e tjerë. Përmbajtja është “Të dy palët do ta bëjnë koordinimin me donatorët e tjerë gjatë zbatimit të Projektit për t’iu shmangur dyfishimit dhe për ta maksimizuar efektin e sinergjisë në rast se donatorë të tjerë ofrojnë asistencë për Kosovën në fushat përkatëse të Projektit. Është e rëndësishme që pala kosovare t’i ofrojë JICA-s informacione lidhur me këtë në kohën e duhur, pasi që mund të ketë ndikim në zbatimin e projektit”.

Në aktivitetet e Projektit, mekanizmi caktoi pikën fokale të palës kosovare, gjë që mundësoi që pala kosovare të vazhdojë me diskutime bashkëpunuese në mënyrë proaktive dhe efikase. Në veçanti, në fushën e monitorimit të cilësisë së ajrit, duke përdorur mekanizmin projekti pati mundësinë që të vazhdojë me detyra në mënyrë funksionale, megjithëse gjatë periudhës së Projektit shumë aktivitete të JICA-s dhe MCC/MFK ndodhën në të njëjtën kohë.

Përmbajtja lidhur me koordinimin me donatorë është siç vijon. (Në takimin e dytë të KPK-së MMPHI/MMPH ende ishte “MMPH” dhe në fjalitë në vijim përdoret shkurtesa MMPH).

- i. Përgjegjësia e përgjithshme në koordinimin me donatorët e tjerë
Projekti ka propozuar MMPH/Znj. Nezakete Hakaj (si pikë fokale) të jetë personi përgjegjës për koordinimin me donatorë të tjerë
- ii. Shkëmbimi i informacioneve ndërmjet Projektit dhe donatorëve të tjerë
JET-i do të ofrojë informacione me kërkesë të donatorëve të tjerë nëse nuk ka kundërshtim nga pika fokale e MMPH-së dhe JICA
- iii. Diskutimet në nivel teknik ndërmjet Ekipit të Ekspertëve të JICA (JET), GP-H/L dhe donatorëve të tjerë.
Pika fokale në MMPH merr pjesë në diskutimet me donatorët e tjerë.
- iv. Raportimi nga pika fokale në MMPH dhe JET-i tek pala kosovare
Pika fokale e MMPH do të raportojë në mbledhjet e rregullta tek pala kosovare për përmbajtjen e diskutimeve me donatorët e tjerë dhe veprimet e rekomanduara përbrenda zbatimit të Projektit

v. Marrja e vendimeve dhe marrëveshja për zbatimin e Projektit

Në rast se kërkohet ndonjë ndryshim në Projekt, pala kosovare, JET-i dhe JICA do ta diskutojnë një ndryshim të tillë në Takimin e KPK-së me qëllim të marrjes së vendimit.

Pala kosovare diskuton paralelisht me donatorët e tjerë për t'i pasqyruar rezultatet e diskutimeve të tilla dhe për të rënë dakord për çfarëdo aranzhimi të kërkuar në kuadër të asistencës nga donatorët e tjerë

vi. Shkëmbimi i vëzhguesve në mes të Projektit dhe donatorëve të tjerë

Në takimet e KPK-së dhe GP-H/L do të ftohen vëzhgues nga donatorët e tjerë

4.1.1 Skemat për Rezultatin 1

(1) Shfrytëzimi i Udhëzuesit EMEP/EEA

Meqenëse Kosova gjendet në rajonin e Ballkanit, u sugjerua që sistemi ligjor i BE-së do të kishte ndikim të madh, kështu që u vendos që inventari i e emisioneve të përgatitet bazuar në udhëzuesin EMEP/EEA. Për më tepër, koncepti i Udhëzuesit EMEP/EEA është i njëjtë me Udhëzimet IPCC 2006, dhe mënyra e llogaritjes së inventarit të emisioneve ishte e njohur për një anëtarë të H/L të Rezultatit 1 i cili ishte gjithashtu personi përgjegjës për inventarin kombëtar të Gazrave Serrë (këtu e tutje "GHG") në të Kosovës. Si rezultat, të kuptuarit e H/L për inventarin e emisioneve u lehtësua dhe aktivitetet e Rezultatit 1 ishin në gjendje të zbatoheshin me efikasitet. Për më tepër, gjatë diskutimit me donatorë të tjerë të huaj, përmbajtja e aktiviteve u shkëmbye shumë lehtë kur u bë prezantimi i përmbajtjes së aktivitetit të përgatitjes së inventarit të emisioneve të realizuar nga Projekti i JICA-s.

(2) Procedura për zbatimin e ligjëratave

Në periudhën e parë, së pari u dhanë ligjëratat për H/L për përmbajtjen bazike lidhur me përgatitjen e inventarit të emisioneve, dhe të kuptuarit e H/L u zgjerua. Pas kësaj, filloi aktiviteti i mbledhjes së të dhënave dhe vazhdoi përgatitja e inventarit të emisioneve. Prandaj, në fillim të Projektit në dhjetor të vitit 2017, u realizuan një sërë ligjëratash në një orar shumë të ngjeshur. Përmes këtyre aktiviteve, u krijua baza për përgatitjen e inventarit të emisioneve nga H/L, dhe aktivitetet e ndryshme pasuese u zbatuan pa probleme.

(3) Përdorimi i burimit nga inventari i Gazrave Serrë

Në kohën e ligjëratave për H/L dhe diskutimit me H/L, u ilustrua në mënyrë të përshtatshme metoda për inventarët e Gazrave Serrë, dhe u konfirmua gjendja e përgatitjes së inventarit të Gazrave Serrë në Kosovë. Përmes këtyre aktiviteve, u promovua të kuptuarit e H/L, dhe në Kosovë ku burimet janë të kufizuara, ishte e mundur që H/L të bëhen të vetëdijshëm se është e mundur të përgatitet inventari i emisioneve të ndotësve të ajrit duke përdorur burimet nga inventarit i Gazrave Serrë. Si rezultat, stimulimi për përgatitjen e inventarit të emisioneve të ndotësve të ajrit u rrit, dhe u studiua krijimi i kornizës institucionale siç është paraqitur në Figura 3-2, Tabela 3-4 dhe Tabela 3-5.

(4) Promovimi i të kuptuarit për efektivitetin e inventarit të emisioneve

Në aktivitetin e studimit dhe vlerësimit të Masave në Rezultatin 8, nga JET-i u ftuan të marrin pjesë anëtarët e H/L të Rezultatit 1, dhe përveç diskutimit për Masat, anëtarët e H/L të Rezultatit 1 kryen aktivitetin e TNP për llogaritjen e zvogëlimeve të emisioneve. Përmes këtyre aktiviteteve ishte e mundur të prezantohej shembulli i shfrytëzimit të inventarit të emisioneve.

(5) Klasifikimi i fushave të aktiviteteve për inventarin e emisioneve dhe modelimin e simulimit

Pasi që emisionet e organizuara në inventarin e emisioneve janë të dhënat kryesore hyrëse të modelimit të simulimit, ishte e nevojshme të klasifikohen detyrat përgjegjëse për aktivitetet e Rezultatit 1 dhe Rezultatit 5. Meqenëse të dhënat hyrëse të modelimit të simulimit varen nga modeli dhe kushtet e llogaritjes së përdorur dhe është e dëshirueshme të përdoret formati i tabelës vjetore të emisioneve për secilin sektor kur bëhet krahasimi me inventarin e emisioneve ose inventarin e Gazrave Serrë të shteteve të tjera, roli i krijimit të të dhënave hyrëse për modelimin e simulimit për shpërndarjen hapësinore dhe rezolucionin kohor të emisioneve u vendos të ishte aktiviteti i Rezultatit 5, i cili është grupi i modelimit të simulimit. Si rezultat, rezultati i përgatitjes së inventarit të emisioneve u qartësua si tabelë e emisioneve vjetore sipas sektorit dhe kategorisë. Për më tepër, u bë më e lehtë për t'i krahasuar inventarin e emisioneve dhe inventarët e GHG me shtetet e tjera. Për më tepër, u qartësua procedura për krijimin e të dhënave hyrëse të modelimit të simulimit nga inventari i emisioneve.

(6) Zbatimi i intervistave të hulumtimit nga studentët

Meqenëse Kosova ka qenë e pavarur për vetëm rreth 10 vjet, supozohej se nuk ka të dhëna të mjaftueshme statistikore. Prandaj, nga faza e planifikimit të Projektit, ishte planifikuar të kryheshin intervista të hulumtimit nga studentët në mënyrë që të plotësoheshin të dhënat statistikore dhe të gjeneroheshin të dhënat e aktivitetit të nevojshme për inventarin e emisioneve. Pas fillimit të aktivitetit të mbledhjes së të dhënave, dhe konfirmimit të serishëm se nuk kishte të dhëna të mjaftueshme për djegien e lëndës djegëse që konsiderohej të ishte veçanërisht e rëndësishme si burim i emisioneve, u planifikuan dhe zbatuan intervistat e hulumtimit nga studentët. Rezultatet e këtyre intervistave të hulumtimit ishin të dhënat e para të siguruara në Kosovë lidhur me konsumin aktual të lëndës djegëse nga secila shtëpi dhe zyrë, dhe u bënë të dhëna jashtëzakonisht të dobishme jo vetëm për përgatitjen e inventarit të emisioneve, por edhe për studimin e Masave.

4.1.2 Skemat për Rezultatin 2

Për të kryer matjen e gazit të shkarkuar nuk nënkupton thjesht matjen e ndotësve në gazin e shkarkuar, por do të thotë që është e nevojshme të kuptohet procesi, rrjedha e procesit dhe lënda

djegëse e konsumuar, të përcaktohet lokacioni dhe koha e matjes dhe të përzgjidhet metoda e duhur e matjes dhe ajo të aplikohet. Në përgjithësi, duke qenë se operatorët e fabrikave janë të familjarizuar mirë me fabrikën dhe personat përgjegjës për matje janë të familjarizuar me metodën e matjes, matja e duhur është e mundur përmes bashkëpunimi midis tyre. Në të njëjtën kohë, pajisjet e matjes të përgatitura mirë mund ta sigurojnë matjen e saktë.

Mirëpo, në Kosovë, matja në Aktivitetin Paraprak ishte pothuajse përvoja e parë, përveç në rastin kur vinin agjencitë e huaja dhe krJENin matje. As fabrikat e as ana e matjes nuk kanë njohuri të mjaftueshme për matjet dhe për këtë arsye Projekti ka ndërmarrë qasje të ndryshme për zhvillimin e kapacitetit të H/L.

(1) Aktivitetet e matjes së gazit të shkarkuar

1) Përgatitja për matje

i) Inspektimi i procesit dhe rrjedhës së procesit të fabrikës

Projekti tashmë kishte informacione të mjaftueshme për TC Kosova A dhe TC Kosova B përmes Aktivitetit Paraprak. Për sa i përket burimeve të tjera të palëvizshme, JET-i paraprakisht vizitoi fabrikat bashkë me H/L, inspektoi proceset dhe rrjedhën e proceseve bashkë dhe ndau informacionet me H/L.

ii) Inspektimi i operimit dhe specifikimi i lokacionit të matjes

Në vizitën preliminare, JET-i dhe H/L intervistuan operatorin e fabrikës për operimin dhe specifikuan lokacioni për matje. Në të njëjtën kohë, JET-i dhe H/L kërkuan sipas nevojës instalimin e vrimave të matjes dhe/ose platformës për matje të sigurt dhe të duhur.

iii) Përgatitja e pajisjeve për matje

JET-i dhe H/L konfirmuan bashkë pajisjet për matje dhe i përgatitën ato për matje.

2) Kryerja e matjes

i) Regjistrimi i kushteve të operimit siç është sasia e prodhimit, konsumi i lëndës djegëse, etj.

ii) Sigurimi i komunikimit gjatë matjeve

Gjatë matjes në IDM, etj. Lokacioni i vrimës për mostrimin e gazit dhe ajo e pajisjeve të matjes (pjesa e poshtme) janë zakonisht larg nga njëra-tjetra dhe rrethina është shumë e zhurmshme. Prandaj, Projekti ka blerë uoki-toki dhe ka kryer matjet përmes komunikimit pa probleme me anë të uoki-tokive.

iii) Sigurimi i sigurisë dhe shëndetit

Për sigurimin e sigurisë dhe shëndetit janë marrë masat në vijim

- Masat për punët në vende të larta (parandalimi i rënies me përdorimin e veglave për parandalimin e rënies dhe rripave të sigurisë, përdorimi i shportave dhe litarit për ngritjen e pajisjeve, etj.)
- Masat parandaluese për djegie (përdorimi i dorezave rezistuese ndaj djegies, etj.)

- Përdorimi i karrocës për transportimin e pajisjeve shumë të rënda
- Mbrojtja e shëndetit (përdorimi i veshmbathjes mbrojtëse Tyvek, maska për pluhur, etj.)

3) Pastrimi/organizimi i pajisjeve pas matjes

- i) Pas matjes pajisjet janë pastruar, inspektuar dhe organizuar në mënyrë që të përdoren për matjen e ardhshme. Për sa i përket organizimit të pajisjeve, JET-i ka blerë raftet dhe ka udhëzuar H/L që t'i vendosin pajisjet në renditje të duhur në vende të caktuara të rafteve. Në të njëjtën kohë, JET-i udhëzoi H/L të vendosin najlon të vinilit në pjesën e parme të rafteve për t'i mbrojtur pajisjet nga pluhuri. Këto masa e bëjnë përgatitjen e ardhshme më të lehtë.

4) Organizimi i rezultateve të matjes

- i) Janë ofruar fletë të punës Excel në mënyrë që H/L t'i organizojë më lehtë të dhënat e matjes. Fleta e punës Excel i ka ekuacionet paraprake për llogaritje, dhe rezultatet mund të llogariten vetëm duke i regjistruar rezultatet e matjes.
- ii) JET-i ka ofruar formularin e raportit të matjes dhe mbështeti H/L në përpilimin e raporteve.

(2) Krijimi i kornizës për matjen e gazit të shkarkuar

Projekti ka kompletuar krijimin e kornizës së matjes së gazit të shkarkuar përbrenda MMPHI/MMPH. Mirëpo, nuk është krijuar korniza e matjes për sektorin privat. Për t'u përhapur matja e gazit të shkarkuar është e nevojshme që rëndësia e matjes së gazit të shkarkuar të pranohet në nivel të përgjithshëm. Në Kosovë, nuk pranohet në nivel të mjaftueshëm matja e gazit të shkarkuar dhe është çështje e madhe për të ardhmen. Prandaj, Projekti mbajti një seminar për fabrikat private dhe agjencinë vendore për matje në mënyrë që ata ta kuptojnë rëndësinë e matjes së gazit të shkarkuar.

4.1.3 Skemat për Rezultatin 3

- (1) Pika në të cilën u përqendrua projekti ishte të theksohet motivimi i H/L që marrin pjesë në projekt ndërsa kishin punët e tyre normale ditore. Për shembull, Projekti ka mbajtur trajnimin për kalibrimin e analizatorëve në SMCA duke shfrytëzuar situatën siç është mbështetja për t'i zgjidhur problemet urgjente dhe të ndërlikuara në analizatorë, etj. Për shembull, projekti vizitoi SMCA-në ku analizatori tregonte vlerë atë parregullt, solli gazrat standarde dhe kalibruasin, dhe bëri TNP për kalibrimin e analizatorit si dhe zgjidhjen e problemeve. Si rezultat, në disa raste H/L kanë gjetur dështime të analizatorëve. Përmes aktiviteteve të cilat përmbushin nevojat e H/L, Projekti mund të ofronte aktivitete më praktike dhe pragmatike ku H/L kanë mundur të përfitojnë përmes përvojës.

- (2) Projekti u përpoq të ofrojë mbështetje të fuqishme edhe kur JET-i nuk ishte në Kosovë. Në gjysmën e dytë të vitit 2019 dhe 2020, H/L shpesh ka dërguar pyetje përmes SMS nga SMCA ku H/L bënte kalibrimin e analizatorëve. Në shumë raste, ishte pyetje që mund të zgjidhej menjëherë thjesht duke lexuar manualin. Mirëpo, meqenëse CH/L nuk e kishin zakon t'i referoheshin dokumenteve, H/L dërgonin fotografi të problemeve. Edhe pse ishte e shkruar në manualin e mirëmbajtjes ose manualin udhëzues për pajisje, Projekti i është përgjigjur pyetjeve duke treguar pjesët korresponduese në manualin e mirëmbajtjes. H/L kanë ditur se ata mund të merrnin mbështetje në çdo, dhe në këtë mënyrë Projekti u mundua t'i bëjë H/L të aftë që ta ekzekutonin atë që mësuan në trajnim. Duke marrë parasysh këtë situatë, Projekti e ka bërë manualin e mirëmbajtjes më të kuptueshëm për H/L duke përdorur sa më shumë që ishte e mundur diagrame dhe fotografi.
- (3) Projekti u mundua që t'i ofrojë palës kosovare mënyra për të kursyer për mirëmbajtje Si shembull, tubi nga tefloni i cili bart ajrin e mostruar nga distributori (i quajtur elementi me shumë dalje) deri tek analizatori brenda SMCA-ve duhet të zëvendësohet me një të ri në baza periodike, por kjo shumë shpesh injorohet. Pasi që tubi nga tefloni është pjesë rezervë e shtrenjtë, shumë shpesh zëvendësimi i tij shtyhet. Mirëpo, ekziston metoda për ta pastruar brendësinë e tubit nga tefloni duke e kaluar disa herë përbrenda tubit një tel me garzë të lagur me alkool etilik. Kjo metodë e bënë pjesën e brendshme të tubit të jetë e pastër posi të ishte e re. Për rehabilitim, Projekti soll nga Japonia tela të pianos dhe garza dhe i a dha ato H/L. Projekti u përpoq ta bartë njohurin dhe përvojën në mënyrë që lejon mirëmbajtjen të vazhdojë përderisa kursen kostot.

Për sa i përket ekraneve për shfaqjen e të dhënave të cilësisë së ajrit, Projekti vendosi ta shfaqë AQI të përcaktuar në BE në mënyrën më të thjeshtë të mundur. Për ekranet Projekti morri parasysh tri pikat në vijim.

- (1) Ta bëjë sistemin të lehtë për mirëmbajtje

Të dhënat e shfaqura pranohen nga data serveri si të dhëna për një orë, e të cilat përpunohen nga të dhënat nga rrjeti i komunikimit të të dhënave i MCC/MFK dhe të dhënat shfaqen në mënyrë të drejtpërdrejt.

- (2) Për t'i shfaqur të dhënat në mënyrë të qëndrueshme në të ardhmen

Për t'i shfaqur të dhënat në mënyrë të qëndrueshme është e rëndësishme mirëmbajtja duke përfshirë komunikimet dhe softuerin, si dhe reagimi i shpejtë ndaj problemeve. Meqenëse nga MMPHI/MMPH dhe IHMK nuk pritet që t'i kryejnë punët e mirëmbajtjes dhe reagimin e shpejtë ndaj problemeve, JET-i dhe H/L kanë bërë vlerësimin e kontraktorit nga pikëpamja jo vetëm e kostos por edhe aftësisë për mirëmbajtje dhe reagim të shpejtë.

- (3) Të shfaqen të dhëna të cilat janë të kuptueshme për qytetarët

Projekti e ka konsideruar shumë të rëndësishme që qytetarët ta kuptojnë gjendjen e cilësisë së ajrit dhe ka përzgjedhur shfaqjen e të dhënave e cila është e kuptueshme për qytetarët. Projekti kishte ide që ekranet për shfaqjen e të dhënave në qytetin e Prishtinës dhe qytetin e Obiliqit të shfaqin të dhëna nga një numër më i madh i SMCA-ve, por shumë pak qytetarë dinë për ekzistencën e numrit më të madh të SMCA-ve. Në të njëjtën kohë, kur AQI është i ndryshëm nga një SMCA tek tjetri mund të shkaktojë huti tek qytetarët. Prandaj, u vendos që ekranet të shfaqin të dhëna vetëm nga një SMCA. Të dhënat nga SMCA-të e tjera mund të gjeten në shërbimin përmes internetit të ofruar nga MCC/MFK³³.

4.1.4 Skemat për Rezultatin 4

Për sa i përket analizave laboratorike, Projekti ka bërë ri-funksionalizimin e JK-së dhe ICP-MS, dhe ka kryer analizat e gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente.

Pesë analizatorë i janë dhënë si donacion IHMK-së nga BE-ja rreth vitit 2012, mirëpo vetëm AAS ishte përdorur deri në kohën e fillimit të Projektit. Projekti bëri ri-funksionalizimin e JK dhe ICP-MS. Këta analizatorë janë instrumente shumë profesionale dhe duke pasur parasysh nivelin e lartë të ndërlikueshmërisë vetëm prodhuesi mund ta bëjë riparimin. Prandaj, Projekti paraprakisht përmes emailave bëri aranzhime me prodhuesin dhe e kreu punën e ri-funksionalizimit.

Projekti përzgjodhi si anëtar të JET-it një person i cili është përgjegjës për analiza laboratorike në baza ditore, dhe ky person ka qenë përgjegjës jo vetëm për transferimin e teknologjisë por gjithashtu për transferimin e njohurive të rëndësishme siç janë procedurat e analizës, menaxhimi i laboratorit për analiza, etj.

Në të njëjtën kohë, në përgjithësi shumë pak vëmendje i kushtohet mostrimit të gazit për analiza të gazit të shkarkuar, por mostrimi i gazit është gjithashtu punë e rëndësishme dhe Projekti e ka vlerësuar këtë punë shumë.

Aktivitetet të konsideruara si të rëndësishme janë siç vijon.

- 1) Projekti i bëri inspektimet paraprake për ri-funksionalizimin e analizatorëve, i ofroi informacionet nga inspektimi dhe diskutoi procedura me prodhuesin, si dhe u përpoq që ta sigurojë punën e ri-funksionalizimit.

Për sa i përket JK-së, pritej që JK të ketë bllokim në tubin për kalimin e likuidit, prishje në pjesët e brendshme, etj. të shkaktuara nga periudha e gjatë e mospërdorimit. Në periudhën e parë JK u diagnostikua nga agjenti i prodhuesit dhe u listuan pjesët e nevojshme rezervë. Në periudhën e dytë u blenë pjesët e nevojshme rezervë dhe ri-funksionalizimi u bë pa asnjë problem.

Për sa i përket ICP-MS, përmes inspektimit paraprak u gjet dëmtimi i telave brenda ICP-MS, dhe u vendos që në vend se ICP-MS të diagnostikohet në IHMK të dërgohet tek prodhuesi në mënyrë që të bëhet riparimi i telave dhe diagnostikimi. Si rezultat ICP-MS është ri-funksionalizuar pa asnjë problem.

³³ Portali i Cilësisë së Ajrit : <https://airqualitykosova.rks-gov.net/en/>

- 2) Kur kryhen analiza, përgatitja për analiza është shumë e rëndësishme, siç është përgatitja e tretjeve, PSO-të, etj. si dhe operimi i analizatorëve. Prandaj, Projekti e përzgjedhi si ekspert personin që është përgjegjës për analiza në baza ditore, dhe u përpoq që ta bëjë transferimin jo vetëm të teknologjisë së analizave por edhe të detyrave të rëndësishme siç janë përgatitja, procedurat, organizimi i të dhënave, etj. Në të njëjtën kohë, pajisjet ndihmëse siç janë epruvetat, etj. janë sjellë në IHMK dhe u mundua që të krijohet mjedisi i përshtatshëm për analiza.
- 3) Analizat mjedisore kërkojnë mostrimin e gazit dhe analizat mund të kryhen vetëm pasi të bëhet mostrimi i gazit. Prandaj, Projekti gjithashtu vendosi rëndësinë mbi mostrimin e gazit dhe bëri përpjekje që ta transferojë njohurinë e duhur dhe teknologjinë e mostrimit.
- 4) Për mostrimin e metaleve të rënda, Projekti u përpoq që sa më shumë që është e mundur t'i përmbushë nevojat urgjente të H/L. Si rezultat i analizës së metaleve të rënda në PM në Japoni, është gjetur se disa komponentë në PM të mostruar në Mitrovicë tejkalojnë vlerat udhëzuese të Japonisë, dhe MMPHI/MMPH do të vazhdojë ta bëjë monitorimin e metaleve të rënda në PM në ajër në Mitrovicë. Mirëpo, kur u bë mostrimi i PM në ajër në Drenas në maj të vitit 2018, fabrika e cila supozohet se mund të jetë burim i mundshëm i metaleve të rënda në ajër ishte e mbyllur. Prandaj, projekti iu përgjigj pozitivisht kërkesës së H/L për ta bërë mostrimin përsëri. Pas marrjes së miratimit të shpejtë nga zyra qendrore e JICA-s, u bë mostrimi kur fabrika ishte në operim. Si rezultat, u zbulua sasi e metaleve të caktuara të rënda të cilat tejkalojnë vlerën udhëzuese në Japoni, dhe kjo ishte një ndër të arriturat e Projektit.

4.1.5 Skemat për Rezultatit 5

Pasi që llogaritjet e modelit të simulimit ishin përvoja e parë e MMPHI/MMPH, bashkë me aktivitetet e Projektit JET i kushtoi vëmendje pikave në vijim.

(1) Përforcimi i grupit punues me ekspertë për të dhënat GIS

Të dhënat e GIS janë mjet shumë i dobishëm teknik për shpërndarjen hapësinore të emisioneve dhe përqendrimit në modelimin e simulimit. Pas diskutimeve me H/L për t'i sqaruar të dhënat e GIS të nevojshme për këtë projekt, zyrtarë nga departamenti i GIS brenda MMPHI/MMPH iu shtuan anëtarëve të H/L dhe u siguruan të dhëna të ndryshme të dobishme GIS. Kjo lehtësoi punën në mënyrë efikase, dhe përmirësoi të kuptuarit e H/L për nevojën dhe dobinë e të dhënave të GIS.

Në Kosovë, "Projekti i Zhvillimit të Burimeve Njerëzore për Informacionin Gjeo-Hapësinor për Zbatimin e Planit Hapësinor të Kosovës" (këtu e tutje "Projekti GIS") u zbatua nga JICA me AKK-në si H/L kryesor, dhe në të kaluarën është bërë përgatitja e të dhënave themelore të GIS siç janë hartat topografike. Zyrtari për GIS gjithashtu morri pjesë

në punëtoritë e publikimit të Projektit GIS, dhe u demonstrua efekti i sinergjisë ku të dy projektet e integruan dhe u shfrytëzuan.

- (2) Aktivitetet e zhvillimit të kapaciteteve bazuar në aftësisë e H/L për t'i përdorur Kompjuterët
- U pa se disa nga H/L kishin aftësi të pamjaftueshme për përdorimin e Kompjuterit, përfshirë se si ta përdorin aplikacionin Excel. Prandaj, në transferimin e teknologjisë së modelit të simulimit, shpjegimi i bazuar në manual se si ta përdorin modelin nuk ishte i mjaftueshëm që ata të zbatonin modelin vetë. Prandaj në Projekt, H/L-ve jo vetëm që iu dha ligjëratë për modelin e simulimit, por gjithashtu u trajnuan duke i përdorur vetë Kompjuterët. Si rezultat, problemet që u shfaqën kur H/L krJENin llogaritjen u sqaruan dhe u bë i mundur transferimi më praktik i teknologjisë.

- (3) Rregullimi i procesit të mbledhjes së të dhënave varësisht nga disponueshmëria e të dhënave të nevojshme

Meqenëse Kosova fitoi pavarësinë vetëm pak më shumë se dhjetë vite, pritej që vendi të mos kishte në posedim të dhëna të mjaftueshme të kërkuara për llogaritjen e simulimit. Në mungesë të të dhënave të tilla, ishte e nevojshme të merrej parasysh se si të merreshim me situatën. Pasi JET propozoi gjendjen e të dhënave të nevojshme, H/L mori kryesimin në mbledhjen e të dhënave, gjë që lejoi H/L ta ri-zbulonte gjendjen e mbledhjes së të dhënave në Kosovë. Përmes procesit të të menduarit se si të merreshin me situatën, H/L kanë thelluar të kuptuarit e tyre për modelin e simulimit.

4.1.6 Skemat për Rezultatin 6

Projekti ka studiuar masat e kontrollit të ndotjes për IDM dhe burimet e tjera të palëvizshme. Çështja është e njëjtë si me matjen e gazit të shkarkuar ku zyrtarët në MMPHI/MMPH kanë pak njohuri për proceset industriale, dhe gjithashtu operatorët e fabrikave private kanë pak njohuri për matjen e gazit të shkarkuar. Për më tepër, të dy palët kanë pak njohuri për masat për zvogëlimin e emisioneve.

Pasi që inxhinierët në TC Kosova A dhe TC Kosova B kanë njohuri të mjaftueshme për proceset, puna e matjes së gazit të shkarkuar dhe masave për zvogëlimin e emisioneve u kryen pa asnjë problem. Në anën tjetër, për sa i përket burimeve të tjera të palëvizshme, pasi që JET-i pa domosdoshmërinë e përmirësimit të njohurisë së zyrtarëve në MMPHI/MMPH, JET-i bëri përpjekje që bashkë me zyrtarët ta bëjë inspektimin e rrjedhës së proceseve, etj. dhe intervistën me operatorët lidhur me operacionet.

Në Projekt, përmes aktiviteteve të lartpërmendura JET-i zbuloi se zyrtarët në MMPHI/MMPH dhe operatorët e fabrikave private nuk kanë njohuri të mjaftueshme për matjen e gazit të shkarkuar dhe masat për zvogëlimin e emisioneve. Kjo supozohet se çon nga situata ku në përgjithësi nuk njihet rëndësia e matjes së gazit të shkarkuar dhe raportimit.

Projekti mbajti ligjëratë dhe seminare të ndryshme në periudhën e parë dhe të dytë.

Mirëpo, Projekti mendoi se H/L nuk kishte marrë njohuri të mjaftueshme, prandaj në periudhën e tretë përsëri u mbajtën ligjërata për masat për zvogëlimin e emisioneve në mënyrë që të përmirësohet njohuria.

Në ligjërata, rëndësia u vendos mbi transferimin e njohurisë minimale për emisione, siç është efekti i emisioneve në mjedis nga secila fabrikë, qasjet e përgjithshme për zvogëlimin e emisioneve, metoda për parashikimin përmes llogaritjes së difuzionit të ndotjes, etj. dhe përmes këtyre ligjëratave Projekti u përpoq që H/L ta kuptojnë domosdoshmërinë e zvogëlimit të emisioneve. Shumë H/L morën pjesë në mënyrë aktive në ligjërata dhe ishin të interesuar për këto çështje, por situata është se ka nevojë për më shumë njohuri dhe përvojë për t'i inspiruar H/L që të fitojnë njohuri për emisionet.

4.1.7 Skemat për Rezultatin 7

- (1) Kaldajat në TC Kosova A janë të degraduara, e të cilat janë ndërtuar pothuajse 50 vite më parë, dhe ka pak dokumentacion për impiantin. Për më tepër, numri i instrumenteve të instaluar në kaldajë është minimal (për shembull, nuk mund të matet shkalla e rrjedhës së Linjtit) dhe saktësia e instrumenteve nuk është aq e lartë. Pasi që nuk ka data loger (regjistrim të vazhdueshëm të të dhënave të operimit), i cili zakonisht është i instaluar në kaldajat moderne, për ta kuptuar marrëdhënien ndërmjet ndryshimeve në gjendjen e kushteve të kaldajës dhe përbërjes së gazit të shkarkuar, është e nevojshme që të bëhet krahasimi në detaj i të dhënave të kaldajës të mbledhura në mënyrë manuale dhe rezultateve të matjes së gazit të shkarkuar në terren çdo gjysmë ore.

Prandaj, të dhënat e mbledhura të operimit të kaldajës dhe të dhënat e matura në terren janë konsoliduar në formatin e përgatitur Excel në mënyrë që të bëhet studimi i zvogëlimit të emisioneve.

- (2) Në fillim operatori i kaldajës nuk ishte i gatshëm t'i ndryshojë parametrat e operimit duke qëndruar me metodën e zakonshme të operimit, dhe testi nuk shkante aq mirë as pritej. Prandaj, testi për ndryshimin e parametrave të operimit u bë pasi që u dha miratimi pas shpjegimit paraprak se çfarë do të ndodhte kur të ndryshohen parametrat e operimit. Si rezultat u bë e mundur që të bëhet testi pa probleme pasi që stafi kuptoi procedurën.
- (3) Kushtet e djegies ndryshojnë shpesh edhe kur përbërja e Linjtit tregon pak ndryshime në parametrat e analizës normale. Është zbuluar se madje edhe një ndryshim i vogël në kushtet e djegies në vatër shkakton ndryshim të vogël në temperaturën e gazit në vatër, që si rezultat ndikon në efektin e de-sulfurimit në vatër dhe rezulton me ndryshim në përqendrimin e SO₂. Në këtë kaldajë, parametrat e operimit që mund ta ndryshojnë temperaturën e gazit të vatrës janë të kufizuar, por për t'i gjetur ato u organizuan dhe u analizuan të gjitha të dhënat e akumuluar deri në atë moment, dhe mund të gjeten parametrat e mundshme të operimit për ta ndryshuar temperaturën e gazit në vatër.

- (4) Në punën në terren siç është matja e gazit të shkarkuar, është mbajtur trajnim për t'i siguruar masat e sigurisë dhe për t'i mbajtur pesë S-të (Seiri; Organizimi, Seiton; Aranzhimi, Seisou; Pastrimi, Seiketsu; Mbajtja e pastërtisë, Shitsuke; Disiplina), të cilat janë rregullat bazike të punës në terren.
- (5) Për sa i përket matjes së shpërndarjes së rrjedhës brenda FES-it, përmes bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve të TC, UP dhe JET-it janë bërë studimi i masave për përmirësimin e uniformitetit të shpërndarjes së rrjedhës duke përdorur modelin CFD bazuar në rezultatet e matjes, përpilimi i planit të modifikimit të FES-it aktual dhe zbatimi i punës së rimodelimit.
- Kjo është përvoja e parë e kësaj natyre në Kosovë. Prandaj, pasi që kishte koordinim ndërmjet të gjitha palëve të përfshira dhe mbështetje për secilën fushë, u arrit rezultat i mirë.
- (6) Kur u bë matja e shpërndarjes brenda FES-it nuk kishte platforma të përshtatshme të cilat nevojiten për matje brenda FES-it, prandaj në avancë u punua një pajisje e veçantë e cila lëvizë Anemometrin (pajisje për matjen e rrjedhës së ajrit) në mënyrë transversale dhe u instaluan çikrikët në majë të FES-it në mënyrë që Anemometri të mund të lëvizet lartë dhe poshtë me anë të manipulimit nga platforma e poshtme brenda FES-së.
- Pas instalimit të pajisjeve brenda FES-it, në avancë u kryen shumë prova dhe rregullime për t'u siguruar se traversa e Anemometrit lëvizë pa problem.
- Në kohën e matjes së shpërndarjes së rrjedhës ishte e nevojshme që të futet në funksion ventilatori thithës në gjendjen ku personi është duke hyrë në FES. Pasi që të mbyllet dera hyrëse e FES-it, fillon matja pa mundësi të komunikimit me personat jashtë FES-it dhe kjo mund të jetë e rrezikshme. Për të punuar në mjedis me nivel të lartë të Pluhurit dhe zhurmë të madhe nga ventilatori, është e nevojshme që t'i kushtohet kujdes masave të sigurisë siç është siguri i komunikimit përmes dërgimit të sinjaleve për personat jashtë me anë të goditjeve me çekan. Në këtë mënyrë u bënë përgatitjet dhe ndarja e roleve për secilin anëtar.

4.1.8 Skemat për Rezultatit 8

Për sa i përket aktiviteteve të Rezultatit 8, janë kryer masat e mëposhtme.

- (1) Krijimi i mundësisë për studimin bashkëpunues të Masave
- Gjatë studimit dhe vlerësimit të masave të kontrollit të ndotjes së ajrit (Masat), inventari i emisioneve dhe harta e shpërndarjes së përqendrimit të cilësisë së ajrit në nivel të tokës, duke përdorur modelimin e simulimit janë vegla shumë të rëndësishme. Në veçanti, është e dëshirueshme që kosto dhe sasia e zvogëlimit të emisioneve të llogariten në bazë të inventarit të emisioneve. Masat duhet të planifikohen bazuar në këto të dhëna shkencore dhe teknike duke konsideruar skenarin në të ardhmen, dhe është supozuar se H/L nuk kanë përvojë të mjaftueshme. Prandaj, në veçanti, në periudhën e tretë, janë kryer masa të tilla si caktimi në mënyrë aktive i vendit për t'i studiuar Masat në bashkëpunim me anëtarët e Rezultatit 1. Anëtarët e Rezultatit 1 gjithashtu morën pjesë në diskutime të studimit të Masave, përcaktimin e kushteve të llogaritjes për zvogëlimin e emisioneve përmes masave

dhe diskutimin për vlerësimin e kostos së Masave. Në të njëjtën kohë, zvogëlimet e emisioneve janë llogaritur nga anëtarët e Rezultatit 1. Për të kryer aktivitete të tilla, JET-i foli në mënyrë aktive me secilin anëtar të Rezultatit 1 dhe Rezultatit 8, koordinoi orarin dhe u përpoq shumë për ta krijuar një vend për bashkëpunim. Si rezultat, DMMU/DMNI dhe AMMK, të cilët nuk kishin bashkëpunuar aq shumë deri më tani, për herë të parë ishin në gjendje t'i krJENin bashkë aktivitetet për Masat përbrenda aktiviteteve të qeverisë. Për më tepër, H/L ishin gjithashtu në gjendje t'i kuptonin plotësisht rolet dhe përgjegjësitë e këtyre organeve qeveritare përmes aktiviteteve të Projektit.

(2) Përpilimi i fletëve të vlerësimit

Projekti ka përmbledhur secilën masë të studiuar dhe vlerësuar të kontrollit të ndotjes së ajrit në fletë të vlerësimit e cila mundësoi që masat të krahasohen krahas krahas. Si rezultat, H/L mundën ta thellojnë të kuptuarit e tyre duke krahasuar pikat siç janë sasia e zvogëlimit të emisioneve, kosto - efektiviteti, çështjet në zbatimin e masave ndër masat e kontrollit të ndotjes së ajrit. Meqenëse H/L duhet ta shpjegojnë në të njëjtën kohë një numër të masave për vendimmarrësit, fletët e vlerësimit janë bërë material i dobishëm i bazuar në të dhëna shkencore dhe teknike.

(3) Metodologjitë për llogaritjen e kostos

Për llogaritjen e kostove janë marrë parasysh kosto e operimit dhe kosto fillestare. Përmes diskutimeve me H/L, është marrë parasysh kosto e operimit për dhjetë vite pasi që pajisjet e futura në funksion supozohet të përdoren për një periudhë kohore dhe është më mirë të bëhet krahasimi i kostos së operimit ndërmjet para dhe pas masave. Në të njëjtën kohë, janë vlerësuar kosto fillestare dhe kosto e operimit në anën e kërkesës siç janë amvisëritë, etj. duke marrë parasysh mbështetjen në të ardhmen nga qeveria, siç janë subvencionet, kreditë preferenciale, etj. Kjo e bën më të lehtë që të kuptohen çështjet si vlerësimi e kosto - efektivitetit dhe zbatimi i masave.

(4) Shfrytëzimi i shtatëmbëdhjetë objektivave të OZHQ-ve

Supozohet se shumë pika që do të studiohen do të kanë shtrirje të gjerësisht kur vlerësohen pranueshmëria dhe nevojat socio-ekonomike. Në fillim, H/L dhe JET-i studiuuan për të vendosur për pikat që do të studiohen. Mirëpo, në këtë rast mund të përjashtohen disa pika të nevojshme dhe është e mundur që do të jetë e vështirë t'u shpjegohet politik-bërësve dhe palëve me interes arsyeja se përse janë përzgjedhur pikat të cilat do të studiohen. Prandaj, Projekti vendosi që t'i përdorë shtatëmbëdhjetë objektivat e OZHQ-ve të përdorura në Kombet e Bashkuara dhe të përpiqet ta zgjidhë problemin duke sqaruar treguesit e vlerësimit. Si rezultat, janë zhvilluar kapaciteti për studimin dhe vlerësimin e masave me pikëpamje globale dhe tregues të qartë të vlerësimit, si dhe H/L kanë mundur ta thellojnë të kuptuarit e shtatëmbëdhjetë objektivave të OZHQ-ve.

4.2 Mësimet e mësuara

Shumë donatorë si BE, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, etj. kanë ndërmarrë aktivitete për t'i përmirësuar teknologjitë, sistemet, etj. Është konfirmuar sjellja e shumë instrumenteve dhe pajisjeve të avancuara. Në të njëjtën kohë, gjithashtu është konfirmuar se ligjet janë të organizuara. Mirëpo, në fushat e projekti, janë gjetur shumë shembuj të këqij si instrumentet dhe pajisjet e sjella nuk shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe/ose nuk mund të përdoren për shkak të mirëmbajtjes së dobët. Kur instrumentet dhe pajisjet nuk funksionojnë si duhet, pala kosovare mbështetet në donatorë që ta bëjnë riparimin ose zëvendësimin e tyre, që do të thotë se pala kosovare ka tendencë të mos e respektojë përdorimin efektiv dhe mirëmbajtjen e instrumenteve dhe pajisjeve të sjella. Në fushën e ligjeve, është gjetur se ligji nuk zbatohet mirë sa duhet për shkak të mungesës së njohurisë teknike.

Është e rëndësishme që të shfrytëzohen mirë njohuria dhe teknologjitë e sjella, dhe rëndësia e aktiviteteve mbështetëse duhet të vendoset mbi përdorimin e njohurisë dhe teknologjive, si dhe krijimin e sistemeve (sistemi, numri i staf, etj.) për përdorim të qëndrueshëm të tyre.

Mësimet e mësuara përmes aktiviteteve të Projektit janë përshkruar siç vijon.

4.2.1 Mësimet e mësuara nga Rezultati 1

(1) Zhvillimi i kornizës së qëndrueshme institucionale për përgatitjen e inventarit të emisioneve

Për ta përgatitur inventarin e emisioneve është e nevojshme të bashkëpunohet me shumë organizata relevante. Në Projekt, ministritë përkatëse dhe Komuna e Prishtinës u bënë anëtarë të grupit të punës të H/L, dhe përveç kësaj, u identifikuan organizatat që sigurojnë të dhëna dhe të dhënat të cilat duhet përdorur, si dhe u përcaktuan rolet dhe përgjegjësitë e organizatave relevante dhe orari për përgatitjen e inventarit të emisioneve.

Organizatave që ofrojnë të dhëna nuk kanë asnjë detyrim të raportojnë tek MMPHI/MMPH, nuk mbledhin të dhëna për përgatitjen e inventarit të emisioneve të ndotësve të ajrit dhe nuk janë në pozitë të kontribuojnë në kontrollin e cilësisë së inventarëve të emisioneve të përgatitura me të dhënat e siguruar. Prandaj, nuk ishte e lehtë për AMMK-në që të mbledhë të dhëna në mënyrë efikase dhe ta kryejë kontrollin e cilësisë së inventarëve të emisioneve. Gjithashtu nuk ishte e lehtë të ndërtohej një marrëdhënie bashkëpunuese me organizatat që sigurojnë të dhëna, dhe nuk ishte e lehtë për AMMK-në që t'i mbledhë të dhënat.

Për shembull, në periudhën e parë dhe të dytë, H/L me anë të emailit pyeti për të dhëna komunën e Fushë Kosovës dhe të Obiliqit, por kërkesa përmes emailit nuk ishte e qartë për ta. Për më tepër, H/L gjithashtu pyeti MMPHI/MIT në lidhje me informacionin për automjetet, por kërkesa përmes emailit nuk ishte e qartë edhe për ta. Prandaj, H/L me mbështetjen e JET-it vizitoi drejtpërdrejt stafin përgjegjës për regjistrimin e automjeteve në MMPHI/MIT dhe stafin përgjegjës për menaxhimin mjedisor të secilës komunë, dhe zhvilloi diskutime duke shkëmbyer pyetësorët e përgatitur nga H/L. Duke zhvilluar diskutime të tilla ballë për ballë me shkëmbimin e mendimeve, u promovua mirëkuptimi i ndërsjellë, dhe si rezultat H/L ishin në gjendje të siguronin të dhëna të dobishme nga këto organizata për përgatitjen e inventarit të emisioneve.

Kur krijohet sistemi i ri i përgatitjes së inventarit të emisioneve në zona të tjera, kur krijohet sistemi kombëtar i përgatitjes së inventarit të emisioneve ose kur shtohen të dhëna që sigurojnë organizatat relevante si pjesë e aktiviteteve të ardhshme të përmirësimit në përgatitjen e inventarit të emisioneve, etj., duhet të krijohet sistemi i bashkëpunimit pas diskutimit ballë për ballë me organizatat relevante.

(2) Kontrolli i cilësisë së inventarit të emisioneve

Nga pikëpamja e kontrollit të cilësisë dhe sigurimit të cilësisë, përgatitja e inventarit të emisioneve duhet të eliminojë kutitë e zeza (procesi i panjohur i llogaritjes) dhe konfigurimet speciale në procesin e llogaritjes, në mënyrë që kushdo të mund ta verifikojë në mënyrë objektive procesin e llogaritjes. Në Projekt, inventari i emisioneve është përgatitur duke përdorur tabelën spreadsheet (Excel). Ky koncept është i njëjtë me atë të Projektit të MCC/MFK, gjë që është konfirmuar nga konsulentët ndërkombëtarë (NIRAS), dhe inventari kombëtar i emisioneve të ndotësve të ajrit gjithashtu përdor tabelat spreadsheet (Excel) të krijuar nga ekspertët e Agjencisë Mjedisore të Austrisë.

Dosjet e llogaritjes së inventarit të emisioneve përbëhen nga disa fletë të punës. Të dhënat e mbledhura çdo vit regjistrohen në një fletë të punës, dhe parametrat dhe faktorët e emisionit caktohen paraprakisht në një fletë tjetër të punës. Struktura e llogaritjes është siç vijon: 1) të dhënat e aktivitetit, të cilat janë të dhëna bazë për emisionet llogariten duke përdorur të dhënat e mbledhura dhe ato regjistrohen; dhe 2) emisionet llogariten më pas duke përdorur të dhënat e aktivitetit, parametrat dhe faktorët e emisionit. Është konfirmuar që kjo qasje ishte efektive dhe e drejtpërdrejtë përmes TNP për inventarin e emisioneve. Kur përgatiten inventarët e emisioneve, kjo qasje duhet të vazhdohet të adoptohet dhe përmirësohet.

(3) Anëtarët e GP-H/L

Është situatë mjaft e mirë sepse anëtarët aktualë të GP-H/L janë të përbërë nga niveli i stafit i cili aktualisht kryen punën. Meqenëse përzgjedhja e anëtarëve vendoset nga secili institucion, fushëveprimi i kontrollit si MMPHI/MMPH në realitet është i kufizuar, dhe në projektin e ardhshëm të ngjashëm, MMPHI/MMPH duhet të kërkojë që personat e tillë të përzgjidhen nga secili institucion.

(4) Procedura e aktiviteteve të përgatitjes së inventarit të emisioneve

Anëtarët e GP-H/L kryen së bashku aktivitetin për mbledhjen e të dhënave dhe përgatitjen e inventarit të emisioneve, si dhe shfrytëzimin e inventarit të emisioneve për analizimin e Masave siç janë studimi i Masave dhe llogaritja e zvogëlimit të emisioneve përmes secilës Masë. Këto aktivitete ishin shumë të dobishme për zhvillimin e kapacitetit të secilit anëtar. Projektet e ngjashme në të ardhmen duhet të zbatohen në mënyrë të ngjashme, ashtu që të ofrohet mbështetja për H/L për ta kryer mbledhjen e të dhënave, llogaritjen dhe analizën në kushte ku H/L merr iniciativën në aktivitete.

(5) Pyetësorët e intervistave të hulumtimit nga studentët

Lidhur me pyetësorin për intervistat e hulumtimit nga studentët, në hulumtimin e parë, meqë pyetjet siç ishte modeli i përdorimit të ngrohjes u përshkruan në mënyrë të lirshme, përmbajtja e përgjigjes ndryshonte dhe ishte e vështirë për t'i shqyrtuar dhe analizuar të dhënat. Prandaj, në intervistat e hulumtimit të kryera në periudhën e dytë, H/L me mbështetje nga JET-i përgatitën pyetësorët duke përdorur metodën e përzgjedhjes sa më shumë që ishte e mundur dhe u kryen intervistat e hulumtimit nga studentët. Në të ardhmen, gjatë kryerjes së hulumtimeve duke angazhuar studentë dhe intervistat në formë të pyetjeve për qytetarëve, etj., duhet të përgatitet formulari i pyetësorëve që përdor metodën e përzgjedhjes në mënyrë që as personi që bën pyetjet e as personi i cili i përgjigjet pyetjeve të mos kenë problem me përgjigjet. Si rezultat, do të jetë e mundur të kryhet analiza e të dhënave pa probleme.

(6) Përgatitja e memove për çdo diskutim dhe seminar

JET-i ka përgatitur memo për çdo takim nga distanca dhe diskutim për Rezultatit 1 nga Nëntori 2020 deri në Mars 2021. Këto memo janë shumë të dobishme për H/L, sepse H/L dhe JET-i kanë shkëmbyer përmbajtjet e diskutimeve dhe konkluzioneve. Veçanërisht, përmes aktiviteteve nga distanca, këto memo kanë qenë shumë të rëndësishme për ta konfirmuar progresin e aktiviteteve tona. Ky është një Mësim i mësuar. Në të ardhmen, H/L duhet të përgatisë memo të tilla pas diskutimeve me organizata të tjera, përfshirë donatorët e huaj, në mënyrë që të shkëmbejnë idetë dhe të sigurojnë që të mos ketë mospërputhje në rezultatet e diskutimeve.

(7) Mësimet e Mësuara në Aktivitetet nga Distanca për Përgatitjen e Inventarit të Emisioneve

Në kushte të pandemisë takimi fizik ishte i vështirë. Mirëpo, përmes aktiviteteve nga distanca, H/L me mbështetjen e JET-s kanë arritur rezultate të mira në përgatitjen e inventarit të emisioneve. Teknologjia Informative (këtu e tutje "TI"), kjo vegël e re miqësore ndaj mjedisit duhet të përdoret në të ardhmen, kur takimet ballë për ballë janë të pamundura. Megjithëse ekziston një kufi i asaj se çfarë mund të arrihet përmes aktiviteteve nga distanca, gjithashtu u pa se mund të arrihen rezultate të mira duke identifikuar se çfarë mund të bëhet dhe duke konfirmuar rregullisht progresin e njëri-tjetrit. Në të ardhmen, nëse ndodh një situatë e ngjashme, duhet të identifikojmë se cilat aktivitete mund t'i kryejmë në rrethana të tilla kufizuese

4.2.2 Mësimet e mësuara nga Rezultati 2

Gjatë dhe pas matjes është e nevojshme që të bëhet llogaritja duke përdorur fletat e punës Excel, por në Kosovë jo shumë njerëz janë të familjarizuar me përdorimin e aplikacioneve të Microsoft Office. Megjithëse H/L iu dhanë manuallet e operimit të cilat i shpjegonin llogaritjet, shumë nga ta nuk i kuptonin manuallet. Prandaj, Projekti bëri përsëritjen e llogaritjes duke

përdorur fletat e punës Excel përmes TNP, veçanërisht gjatë kohës së matjes.

Në matjet e kryera në periudhën e fundit të Projektit, H/L i kanë kryer matjet dhe llogaritjet megjithëse iu është nevojitur shumë kohë. Kjo ishte përvoja e parë për H/L që e matnin gazin e shkarkuar duke filluar nga përgatitja deri në llogaritje, dhe H/L e kryen këtë detyrë deri në një masë. Në këtë rast, TNP ka funksionuar shumë në mënyrë efektive. Nga tani e tutje, H/L duhet ta përsërisin vazhdimisht matjen e gazit të shkarkuar duke filluar nga përgatitja deri te raportimi.

Për sa i përket matjes së gazit të shkarkuar, në projekte të ngjashme, krijimi i programit TNP është shumë efektiv për zhvillimin e kapaciteteve.

4.2.3 Mësimet e mësuara nga Rezultati 3

(1) Mësimi i mësuar është vështirësia për përshtatjen e orarit kur H/L është duke zbatuar projekte të donatorëve të shumëfishtë në periudhën e njëjtë. Projekti bëri marrëveshje me MCC/MFK për përmbajtjen e aktiviteteve. Në të njëjtën kohë, Projekti informoi dhe rregulloi orarin me MCC/MFK në mënyrë që të mos të kishte dyfishime të orarit. Mirëpo, në rastin e projekteve të MCC/MFK, nuk është vetë MCC/MFK por janë konsulentët e kontraktuar ata të cilët i kryejnë aktivitetet. Si rezultat, disa herë kanë ndodhur dyfishime të orarit ndërmjet Projektit dhe konsulentit të MCC/MFK. Nga tani e tutje, kur bëhet përshtatja e orarit me donatorë në shtetet e tjera, është e nevojshme që të përshtatet orari me konsulentin përgjegjës.

(2) Në kohën e projektit të donacionit të pajisjeve EU-IPA³⁴ e zbatuar nga BE për IHMK në vitin 2012, EU ka dhënë si donacion pesë SMCA, Kromatografin e Gazit me Spektrometri në Masë (këtu e tutje “GC-MS”), GC-MS me pajisjen e desorbimit termik, JK, ICP-MS dhe gjeneratorin e gazit standard për laboratorët e kalibrimit, pesë pajisje për mbledhjen e VOC, pesë mostrues me vëllim të ulët për PM₁₀, etj. Në atë kohë anëtarët e stafit të IHMK kanë pasur disa ditë të trajnimit në të cilat është ekzekutuar përdorimi i thjeshtë i secilës pajisje. Mirëpo, në kohën e fillimit të Projektit (tetor 2017), pajisjet që ishin funksionale kanë qenë vetëm pesë kompletet të analizatorit të NO_x, analizatorit SO₂, analizatorit O₃, analizatorit të CO dhe PM₁₀/PM_{2.5} në pesë SMCA. Pajisjet e tjera nuk ishin të përdorshme si mostruesi me vëllim të ulët për PM₁₀ dhe gjeneratori i gazit standard i laboratorit të kalibrimit, që mund të përdoreshin në aktivitetet tona për operim paralel për krahasim, sepse pajisjet ishin kontaminuar për shkak të kushteve të papërshtatshme të ruajtjes. Për më tepër, H/L nuk ju kujtohej se si ta përdorin atë.

Si mësim i mësuar kur pajisjet jepen si donacion përmes një projekti, duke marrë parasysh që pajisjet e siguruara shfrytëzohen mirë në të ardhmen, duhet të vlerësohen kushtet e mëposhtme në mënyrë gjithëpërfshirëse me kritere të rrepta.

- Nevojat e vërteta të H/L
- Numri i stafit në organizatë dhe ndër ta numri i stafit me ekspertizë të veçantë,

³⁴“Projekti EU-IPA: Furnizimi me Stacione të Monitorimit të Cilësisë së Ajrit, Laborator Analitik dhe Pajisjet e Laboratorit për Kalibrim në vitin 2012”

- Konfirmimi i hapësirës për të shtuar punë shtesë për të cilën mund të përdoren pajisjet e reja, e që do të jepen si donacion për punën e tyre ditore
- Konfirmimi i kushteve të laboratorit ku ruhen dhe operohen pajisjet (hapësira për instalim, mjedisi (pastërtia, etj.), etj.)

4.2.4 Mësimet e mësuara nga Rezultati 4

Në fushën e analizave laboratorike është bërë ri-funksionalizimi i JK-së dhe ICP-MS, dhe është transferuara teknologjia e analizës së gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente.

Pesë analizatorë i janë dhënë si donacion IHMK-së rreth vitit 2012, por vetëm njëri nga ta ishte funksional në kohën e fillimit të Projektit. Projekti i vuri në dispozicion edhe dy analizatorë dhe në total tre analizatorë mund të përdreshin. IHMK dëshironte që të bëhet ri-funksionalizimi i analizatorëve dhe kjo u bë nga Projekti. Përmes këtyre aktiviteteve Projekti ka mësuar mësimet në vijim.

- (1) Është e rëndësishme që analizatorët të mbahen në kushte normale duke i përdorur ata së paku një herë në muaj, nëse është e mundur një herë në javë. JK do të përdoret për Metodën Standarde Referente e cila është trajnuar përmes Projektit, por momentalisht nuk ka synime të tjera për të përpos për këtë qëllim. Që nga koha kur është dhënë si donacion rreth vitit 2012, JK nuk ishte operuar kurrë, dhe u bë jo-operacional për shkak të bllokimit, etj., të analizatorit. Pas trajnimit nga Projekti, gjendja e JK mbahet normale përmes operimit periodik rreth dy herë në muaj. Mirëpo, është e nevojshme të përdoret më shpesh përmes sqarimit të nevojave për analiza dhe duke bërë një plan të analizave për JK. E njëjta gjë rekomandohet për rastin e ICP-MS. Në rast të mbështetjes nga projekte të tjera në të njëjtën fushë, paraprakisht duhet të analizohen nevojat.
- (2) Është gjetur se gjendja e laboratorit nuk është e përshtatshme për analiza, dhe ky është problem i madh. Ka probleme si menaxhimi i pastërtisë së laboratorit, analizatorëve, mostrave, etj. dhe rezultatet e analizës mund të ndikohen nga këto kushte. Në Projekt nuk ka pasur probleme për shkak të numrit të vogël të mostrave dhe analizave, por është e nevojshme që të konfirmohen dhe përmirësohen kushtet e laboratorit në të ardhmen. Kjo çështje u bë e qartë pasi që Projekti përzgjedhi si ekspert një anëtar i cili është përgjegjës për analiza në Japoni, dhe duhet të konfirmohen kushtet e laboratorit nga eksperti para kohës së fillimit të projektit.
- (3) Pasi që laboratori në IHMK kishte shumë analizatorë por aktivitetet e analizës nuk janë bërë aq shpesh, Projekti përzgjedhi një anëtar i cili është përgjegjës për analiza në baza ditore në Japoni. Si rezultat, eksperti bëri transferimin e jo vetëm teknologjisë së analizave por gjithashtu teknologji të tjera të rëndësishme si procedurat e analizave, menaxhimi i laboratorit, etj. të cilat ishin shumë të përshtatshme për nevojat e H/L. Ky ekspert nuk ka përvojë pune jashtë shtetit, nuk ka përvojë me projekte dhe nuk e flet mirë gjuhën angleze. Mirëpo, vlerësimi i këtij eksperti nga H/L ka qenë shumë i lartë, pasi që H/L gjithashtu kanë

pasur shumë mbështetjet e tjera nga ky ekspert për të gjitha aktivitetet në laborator. Kjo tregon se ka shumë ekspertë në Japoni të cilët janë të përshtatshëm për aktivitete në shtete të tjera. Duke marrë parasysh se qëllimi i projekteve të bashkëpunimit teknik është zhvillimi i kapaciteteve duke shfrytëzuar njohuritë dhe përvojat në Japoni, ekspertët duhet të përzgjidhen nga pikëpamja e nevojave të shtetit mikpritës, duhet të konsiderohen jo vetëm bazuar në përvojën jashtë shtetit por përvojat e punës dhe arritjet nga pikëpamja e gjerë.

- (4) Në operacionet lidhur me monitorimin e metaleve të rënda, si përgjigje ndaj kërkesës së H/L, në maj dhe qershor të vitit 2018, për testim krahasues janë përdorur paralelisht mostruesi me vëllim të lartë që është pajisja e dhënë donacion nga Projekti dhe mostruesi me vëllim të ulët në pronësi të H/L. Mirëpo, PM i mostruar me mostruesin me vëllim të ulët tregoi vlera të parregullta. Për sa i përket mostruesit me vëllim të ulët, ai mund të jetë kontaminuar pasi që kanali i gazit të mostruar nuk ishte pastruar dhe ishte mbajtur në dhomën laboratorike me nivel të ulët të pastërtisë për një kohë të gjatë që nga testi i punës në vitin 2012. Kjo mund ta miratojë komentin e cekur në (2).

Ky supozim sugjeron se është e nevojshme të bëhet planifikimi i transferimit të teknologjisë lidhur me zhvillimin e kapaciteteve për analiza laboratorike dhe aktivitetet të cilat përdorin instrumente laboratorike duke marrë parasysh kontaminimin e laboratorit dhe instrumenteve.

Projekti ka mësuar mësimin e cekur më lartë dhe ka ofruar rekomandime, mirëpo ende mbeten shumë çështje si mungesa e numrit të mjaftueshëm të stafit, sigurimi i buxheti (për reagjentë, materiale ndihmëse, mirëmbajtje të analizatorëve, etj.), si dhe menaxhimi i pastërtisë së laboratorit.

4.2.5 Mësimet e mësuara nga Rezultati 5

- (1) Shfrytëzimi i të dhënave GIS

Për llogaritjen e modelit të simulimit, emisionet e llogaritura nga inventar i emisioneve është dashur të alokohen në zonën e përcaktuar. Kështu që JET-i përpiloi një listë të të dhënave që Kosova pritej t'i ketë dhe i diskutoi me H/L. H/L mblodhi një listë të të dhënave të mundshme të dobishëm dhe i rishikoi ato bashkë me JET-in. Në fund, janë mblodhur të dhëna hyrëse për standardin e modelit të simulimit, siç janë rrjeti 1km x 1km i standardit të Kosovës, hartat topografike, popullsia në secilin rrjet dhe informacioni për përdorimin e tokës sipas secilit rrjet.

Gjatë kryerjes së modelimit të simulimit në projekte të ngjashme në të ardhmen, duhet të përgatitet një vegël llogaritëse për të gjeneruar të dhëna hyrëse bazuar në karakteristikat e të dhënave të aktivitetit të inventarit të emisioneve, si dhe duke marrë parasysh të dhënat e GIS të mbajtura në vendin mikpritës. Lidhja e të dhënave të GIS me inventarin e emisioneve të secilit lloj të burimeve të emisioneve (nën-kategoritë) do të ishte e dobishme për ta përmirësuar llogaritjen në të ardhmen.

(2) Vërtetimi i vlefshmërisë së modelit të simulimit me të dhëna të pamjaftueshme

Në këtë projekt, modeli i simulimit nuk mund të vërtetohej në nivel të mjaftueshëm sepse nuk kishte në dispozicion të dhëna të SMCA-ve me saktësi të mjaftueshme në të kaluarën. Është më mirë të analizohet situata e ndotjes së ajrit dhe të studiohen masat bazuar në informacionin nga SMCA-të, pasi ato të jenë zhvilluar mirë. Mirëpo, është mjaft e mundshme që masat e kontrollit të ndotjes së ajrit duhet të zbatohen sa më shpejt që të jetë e mundur paralelisht me mbledhjen e informacionit për cilësinë e ajrit, për shkak të rritjes së shpejtë ekonomike dhe fluksit të popullsisë drejt qyteteve, veçanërisht në vendet në zhvillim. Pritet që shumë vende duhet t'i përgatisin inventarët e emisioneve dhe ta kryejnë modelimin e simulimit për t'i studiuar, vlerësuar dhe zbatuar masat ndaj ndotjes së ajrit, madje edhe pa të dhëna të mjaftueshme, njëjtë si Projekti.

Në raste të tilla, është e mundur të vlerësohen shkaqet e ndotjes së ajrit deri në një masë duke bërë analogjinë me situatën në vendet fqinje ose vendet e ngjashme, në mënyrë që të merren parasysh masat ndaj ndotjes së ajrit. Për këtë qëllim, të dhënat e SMCA-ve dhe të dhënat e inventarit të emisioneve duhet të shkëmbehen ndërmjet vendeve në bashkëpunim me donatorët dhe organizatat ndërkombëtare, për ta promovuar mbështetjen për masat e kontrollit të ndotjes së ajrit në vendet në zhvillim. Në Projekt, rezultatet nga Projekti do të shkëmbehen përmes konferencës rajonale dhe do të bëhet tërheqëse nevoja për publikimin dhe shkëmbimin e të dhënave. Në këtë mënyrë, duhet të mbahet takime siç ishte konferenca rajonale për t'i ftuar vendet fqinje për ta shkëmbyer informacionin e rezultateve nga Projekti.

(3) Aktivitetet shtesë përmes takimeve virtuale

Për shkak të pandemisë COVID-19, aktivitetet pas marsit 2020 janë kryer përmes një sërë takimesh nga distanca duke përdorur Microsoft Teams. Kjo ishte përvoja e parë si për JET-in ashtu edhe për H/L, kështu që diskutuam përparësitë dhe mangësitë në lidhje me takimet nga distanca dhe dhamë rekomandime për takime më të mira nga distanca. Opinionet e mbledhura janë paraqitur në Tabela 4-1.

Tabela 4-1 Mësimet e Mësuara për takimet nga largësia

Përparësitë	Mangësitë	Për takim më të mirë nga largësia
<ul style="list-style-type: none"> • Vazhdimi i aktiviteteve edhe në situatë të pandemisë • Kursim i kohës dhe parave • Shumë mirë i organizuar me kohë të kufizuar (2 orë) dhe një pushim, dhe ndërveprues për ta mbajtur përqendrimin. • Një herë në javë (lehtë për të marrë pjesë) • Incizimi i manipulimeve 	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutimi është më i vështirë. Gjatë takimeve sy më sy mund ta përdorim kohën e pushimit për diskutim. • Nëse kompjuteri përdoret për kohë të gjatë, pjesëmarrësit kanë tendencë ta humbin përqendrimin • Pyetja e pyetjeve të detajuara është më e vështirë se sa në takimet fizike. 	<ul style="list-style-type: none"> • Dy orë takim me një pushim është më mirë, dhe jo gjithë ditën ku pjesëmarrësit mund ta humbin përqendrimin. • Duhet të bëhet incizimi i takimit • Është më mirë të përdoret ueb kamera për të parë se si po shkon takimi • <u>Takimi fizik është më i miri nëse është i mundur!</u>

4.2.6 Mësimet e mësuara nga Rezultati 6

Si pjesë e MMPHI/MMPH, DMMU/DMNI është divizioni i cili i lëshon fabrikave leje mjedisore dhe Inspektorati është divizion i cili hyn dhe i inspekton fabrikat në operim, dhe i udhëzon ato sipas nevojës.

Projekti, duke përfshirë Aktivitetin Paraprak, filloi matjen e gazit të shkarkuar dhe studimin e masave për zvogëlimin e emisioneve, dhe bëri renditjen e prioriteteve të punës për t'u marrë me PKZE-në. Në pjesën e fundit të Projektit, filloi studimi i masave për zvogëlimin e emisioneve për burimet e tjera të palëvizshme, dhe është zbuluar se ligji në realitet nuk zbatohet në nivel të mjaftueshme. Kjo çështje ka dalë në pah për herë të parë nga Projekti, dhe kjo nuk është përmendur nga donatorë të tjerë.

Në rast se masat mjedisore vlerësohen për sektorët industrialë në shtete të tjera, është e nevojshme që të vlerësohet jo vetëm kapaciteti për matje të gazit por në të njëjtën kohë gjithashtu edhe masat për zvogëlimin e emisioneve në sektorët industrialë. Do të bëhet sqarimi i masave mjedisore nga fabrikat dhe gjithashtu do të bëhet e qartë situata aktuale e zbatimit të ligjit.

4.2.7 Mësimet e mësuara nga Rezultati 7

(1) Puna e stafit të TC-së është e specializuar, nuk është asnjëri që din diçka tjetër pos punës për të cilën janë përgjegjës dhe asnjëri nuk e kupton kaldajën si të tërë. Personi përgjegjës për operimin e kaldajës e di nga përvoja se si do të ndryshojnë kushtet e kaldajës varësisht nga metoda e operimit, megjithëse nuk e di teorinë. Është e rëndësishme që të kuptohen karakteristikat e kaldajës dhe të gjeten parametrat e përshtatshëm të operimit për t'i zvogëluar emisionet. Për ta bërë këtë është e nevojshme jo vetë, të mblidhen informacionet

dhe të dhënat por gjithashtu që t'u jepet informacioni i cili ju nevojitet dhe të ndërtohet besimi reciprok.

- (2) Megjithëse përmes Projektit janë dhënë shumë lloje të pajisjeve, Kosova ende nuk ka pajisje dhe materiale të mjaftueshme. Mirëpo, edhe pse materialet (makineria dhe materialet) nuk ishin përgatitur mirë, të gjithë shkëmbyen njohuritë dhe përvojën e tyre në mënyrë që të arrihen rezultatet e dëshiruara. Në projektin e ardhshëm, është e rëndësishme që JET-i jo vetëm t'i përgatisë pajisjet e nevojshme për termocentrale, burime të palëvizshme, etj. por gjithashtu të krijojë hapësirë për shkëmbimin e njohurive dhe përvojave në terren, ashtu si është bërë në këtë projekt.
- (3) Është e pamundur që të pritët që të gjithë H/L ta kuptojnë 100% të çështjes, por ishte praktike të gjeten personat kyç që të kuptojnë dhe ta përmirësojnë njohurinë e tyre, dhe të jenë në gjendje që ta përhapin njohurinë e tyre tek të tjerët. Në projektet e ardhshme, projekti duhet të bëhet në mënyrë efikase duke i mësuar të gjithë H/L dhe duke i gjetur personat kyç në fazë të hershme.
- (4) Është e vështirë për H/L që të marrin pjesë në projekt përderisa kryejnë punët e tyre ditore. Është e rëndësishme që menaxhmenti të ketë vullnet dhe t'i japë prioritet pjesëmarrjes në projekt dhe gjithashtu është e rëndësishme mbështetja përbrenda organizatës. Për këtë arsye, aktivitete duhet të planifikohen në atë mënyrë që H/L dhe menaxhmenti i tyre të mund ta kuptojnë efektivitetin e projektit sa më parë që është e mundur pas fillimit të projektit.
- (5) Në përgjithësi, duke përfshirë edhe Kosovën, industria qëndron dobët me teori, përderisa akademia ka tendencë të mos e dijë situatën aktuale por vetëm teorinë, prandaj përpjekjet përmes bashkëpunimit industri-akademi janë mënyrë efektive për zgjerimin e bazës së teknologjisë. Në të ardhmen, projektet e tjera duhet të zbatohen duke marrë parasysh mundësinë e bashkëpunimit industri-akademi.

4.2.8 Mësimet e mësuara nga Rezultati 8

Mësimet e mësuara nga Rezultati 8 janë siç vijon.

(1) Zbatimi i studimit të Masave përmes bashkëpunimit

Gjatë studimit dhe vlerësimit të Masave, jo vetëm anëtarët e H/L të Rezultatit 8, por edhe anëtarët e H/L të Rezultatit 1 morën pjesë në shumë aktivitete së bashku dhe mësuan shumë gjëra. Në veçanti, gjatë llogaritjes së zvogëlimit të emisioneve, llogaritja u krye duke përdorur dosjet e inventarit të dytë të emisioneve, dhe llogaritja u krye kryesisht nga anëtarët e Rezultatit 1. Me rastin e përzgjedhjes së rendit të prioritetit të Masave, rendi i prioritetit i Masave që duhet planifikuar u identifikua duke iu referuar hartës së përqendrimit të cilësisë së ajrit në nivelin e tokës dhe rezultateve të llogaritjes së vlerësimit të kontributit nga modelimi i simulimit. Për sa i përket konsiderimit të ndotësve të synuar të

ajrit, të dhënat nga SMCA-të u analizuan dhe u krahasuan me standardet mjedisore për cilësi të ajrit, dhe u përcaktua që PM₁₀ kishte përparësi të madhe.

Në të ardhmen, është gjithashtu e nevojshme të vazhdohet me studimin e Masave bazuar në të dhëna të ndryshme shkencore dhe teknologjike. Në atë kohë, Masat duhet të studiohen në konsultim me personat përgjegjës për fushat e tyre përkatëse të specializuara, dhe duhet të caktohet një vend për bashkëpunim në mënyrë që të punohet bashkërisht për përparimin e hartimit të politikave për cilësi të ajrit. Për më tepër, kur donatorët e huaj ofrojnë mbështetje për aktivitetet e qeverisë në Kosovë, sigurimi i një vendi të tillë duhet të përfshihet në mënyrë aktive në funksion të procesit si tërësi.

(2) Krijimi i kornizës institucionale për Masat

Në të ardhmen, gjatë studimit dhe vlerësimit të masave, duhet të bëhet renditja e prioriteteve dhe vlerësimi i Masave duke iu referuar inventarit të emisioneve dhe hartave të përqendrimit të llogaritura duke përdorur modelimin e simulimit. Për ta bërë këtë, duhet të identifikohen rolet dhe përgjegjësitë e entiteteve në vijim: 1) entiteti për përgatitjen e inventarit të emisioneve dhe llogaritjen e zvogëlimeve të emisioneve, 2) entiteti për llogaritjen e modelimit të simulimit, 3) entiteti për monitorimin e cilësisë së ajrit, dhe 4) entiteti për planifikimin, studimin dhe vlerësimin e Masave, etj. Përveç kësaj, si MMPHI/MMPH është e nevojshme të caktohet një vend për ekzaminim bashkëpunues dhe të krijohet dhe zbatohet në mënyrë gjithëpërfshirëse Strategjia për Cilësi të Ajrit dhe Plani i Veprimit për Cilësi të Ajrit.

(3) Shfrytëzimi i fletëve të vlerësimit për përpilimin e Planit të Veprimit

H/L e kanë kuptuar që fletët e vlerësimit të hartuara në Projekt janë informacioni dhe të dhënat themelore të bazuara në të dhëna shkencore dhe teknike për hartimin e Planit të Veprimit. Në të njëjtën kohë, H/L kanë kuptuar procedurën administrative që, pas hartimit të tij Plani i Veprimit duhet të finalizohet përmes konsultimit me Grupin e Punës për Planin e Veprimit. Në të njëjtën kohë, ata gjithashtu kanë kuptuar se është e lehtë të krahasohet efektiviteti i masave duke shfrytëzuar fletët e vlerësimit. Pothuajse nuk ka një qasje të tillë në projektet nga donatorët e tjerë, dhe në këtë moment, nuk është e lehtë të realizohet kjo qasje në mënyrë të pavarur. Pala kosovare po kërkon mbështetje për hartimin e Planit të Veprimit dhe duke kërkuar më shumë mbështetje për planifikimin dhe vlerësimin e masave shtesë të kontrollit të ndotjes së ajrit, siç është për përdorimin e fletëve të vlerësimit të kryer në Projekt.

Për projekte të ngjashme si ky Projekt rekomandohet mbështetja për disa masa ashtu që ato të mund të pasqyrohen në politika bazuar në të kuptuarit e procedurave të politik-bërjes. Secili tregues i përdorur në fletët e vlerësimit është pikë e përbashkët që mund të zbatohet jo vetëm në Kosovë por edhe në vendet e tjera, dhe kjo metodë duhet të përdoret si qasje për t'i përmbledhur masat e studiuara.

(4) Përgatitja e memove për çdo diskutim dhe seminar

JET-i ka përgatitur memo për çdo takim nga distanca dhe diskutim për Rezultatin 1 nga Nëntori 2020 deri në Mars 2021. Këto memo kanë qenë shumë të dobishme për H/L, sepse H/L dhe JET-i kanë shkëmbyer përmbajtjet e diskutimeve dhe konkluzioneve. Veçanërisht, përmes aktiviteteve nga distanca, këto memo kanë qenë shumë të rëndësishme për ta konfirmuar progresin e aktiviteteve tona. Ky është një Mësim i mësuar. Në të ardhmen, H/L duhet të përgatisë memo të tilla pas diskutimeve me organizata të tjera, përfshirë donatorët e huaj, në mënyrë që të shkëmbejnë idetë dhe të sigurojnë që të mos ketë mospërputhje në rezultatet e diskutimeve.

(5) Krijimi i procedurave të përgatitjes së Masave

Në të ardhmen, gjatë studimit dhe vlerësimit të masave, duhet të bëhet renditja e prioriteteve dhe vlerësimi i Masave duke iu referuar inventarit të emisioneve dhe hartave të përqendrimit të llogaritura duke përdorur modelimin e simulimit. Pasi që H/L kanë mësuar “Si të identifikojnë dhe adresojnë arsyet që qëndrojnë në bazë të këtij 'boshllëku' në zbatimin e politikës së cilësisë së ajrit”, DMMU përgatisin fletët e reja të vlerësimit bazuar në inventarin e emisioneve për të gjithë Kosovën dhe t’ia dorëzojë ato grupit të punës për politika që t’i konsiderojë ato gjatë ndryshim-plotësimit të planit të veprimit.

(6) Krijimi i procedurave të zbatimit të Masave

Pasi që H/L kanë mësuar “Si ta kuptojnë më mirë zbatimin e politikave të nevojshme për t’i mbështetur politikat aktuale dhe ato të rishikuara të ajrit; së pari, duke i identifikuar sfidat në zbatim, dhe së dyti, duke përmirësuar njohuritë për mjetet e politikave që mund t’i adresojnë këto sfida”, DMMU do të veprojë siç vijon.

DMMU përgatitë politikat e rishikuara të ajrit me mbështetje të donatorëve të huaj duke përfshirë JICA-n në përputhje me fletët e vlerësimit të zhvilluara nga Projekti. DMMU bashkëpunon me Inspektoratin në mënyrë që të identifikohen sfidat e zbatimit, të cilat do të merren parasysh në hartimin/ndryshim-plotësimin e dokumenteve strategjike (Strategjia/Plani i Veprimit për Cilësinë e Ajrit).

(7) Krijimi i punës bashkëpunuese për Masat

Pasi që H/L kanë mësuar “Si të krijohet një punë më bashkëpunuese ndërmjet organeve të ndryshme për t’i zhvilluar kapacitetet dhe njohuritë, në mënyrë që të krijohen politika në mënyrë më efektive në ndjekje të objektivave të dakorduar”, DMMU do të ndërtojë kanale më të mira për t’i identifikuar organizatat dhe organet më relevante që do të jenë pjesë e grupit të punës për politika gjatë hartimit/ndryshim-plotësimin të dokumenteve strategjike.

5. Vlerësimi i arritjeve të Projektit dhe Çështjet për të ardhmen dhe Rekomandimet

5.1 Arritja e qëllimit të Projektit dhe qëllimit të përgjithshëm

Qëllimi i përgjithshëm dhe qëllimi i Projektit janë përshkruar përsëri në vijim.

Synimi i përgjithshëm:

Pala kosovare i zhvillon kapacitetet për kontrollin e ndotjes së ajrit dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit bazuar në të dhëna teknike.

Qëllimi i projektit:

Të zhvillohen aftësitë teknike të palës kosovare për t'i kontrolluar burimet e emisioneve në ajër në zonën e synuar të Projektit.

(1) Arritjet për qëllimin e Projektit

Projekti ka pasur për synim Zonën e Prishtinës dhe ka forcuar kapacitetin teknik për menaxhimin e cilësisë së ajrit të palës kosovare në tri fusha të cilat janë inventari i emisioneve dhe modelimi, monitorimi i cilësisë së ajrit, dhe matjet dhe masat për zvogëlimin e emisioneve. Kjo mundësoi aktivitetin e Vlerësimit për Vendimmarrje (fusha e katërt), dhe është rritur kapaciteti për propozimin dhe vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit. Projekti e bëri të kuptueshme situatën aktuale të cilësisë së ajrit përmes zhvillimit të inventarit të emisioneve dhe simulimit të cilësisë së ajrit për Zonën e Prishtinës. Në të njëjtën kohë, masat e kontrollit të ndotjes së ajrit anë vlerësuar në aspektin sasior përmes shfrytëzimit të hartës së shpërndarjes së përqendrimit të ndotësve në nivelin e tokës të nxjerrë nga inventari i emisioneve dhe simulimi. Në fushën e monitorimit të cilësisë së ajrit, Projekti ka bashkëpunuar me MCC/MFK dhe ka organizuar sistemin e monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë, si dhe ka krijuar sistemin për t'i ofruar qytetarëve informacione të sakta. Në të njëjtën kohë, ka filluar ofrimi i të dhënave për qytetarët. Në matjet dhe masat për zvogëlimin e emisioneve, projekti ka propozuar masa konkrete për TC Kosova A dhe një pjesë e tyre është vënë në praktikë. Për sa i përket burimeve të tjera të palëvizshme, përmes ligjëratave është transferuar njohuria e përgjithshme për masat për zvogëlimin e emisioneve.

Vlerësimi i Treguesve objektivisht të verifikueshëm për qëllim të Projektit është përshkruar në vijim. Vlerësimi i Treguesve objektivisht të verifikueshëm për secilin Rezultat është përshkruar në secilin shpjegim për Rezultatet në Kapitullin 3.

Treguesit objektivisht të verifikueshëm për qëllimin e Projektit në MDP janë siç vijon.

- 1) Masat konkrete për zvogëlimin e emisioneve iniciohen në Impiante me Djegie të Mëdha (IDM).
- 2) Bëhet shtjellimi i masave të kontrollit të ndotjes së ajrit për burimet e tjera të emisioneve.
- 3) Ndotësit dhe burimet e emisioneve me prioritet përfshirë IDM, burimet e tjera të palëvizshme dhe burimet e tjera të emisioneve identifikohen në bazë të monitorimit të cilësisë së ajrit, inventarit të emisioneve dhe modelimit të simulimit dhe rishikohen dy herë gjatë Projektit për vendimmarrje.

Për sa i përket IDM-ve, siç është përshkruar në “3-8 Rezultati 7: Zhvillohen masat e kontrollit të emisionit në IDM”, Masat për zvogëlimin e emisioneve janë propozuar për TC Kosova A, dhe nga këto propozime, masat për Zvogëlimin e emisioneve janë vënë në praktike dhe janë bërë një rezultat i madh i Projektit.

Për sa i përket masave të kontrollit të ndotjes së ajrit për burimet e tjera të emisioneve, siç është përshkruar në “3-9 Rezultati 8: Zhvillohen kapacitetet e palës kosovare për vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit”, janë studiuar tetë masa konkrete për kontrollin e ndotjes së ajrit, duke përfshirë llogaritjen e zvogëlimit të emisioneve, vlerësimin e kosto - efektivitetit, mënyrën e zbatimit të masave, etj.

Për sa i përket ndotësve dhe burimeve të emisioneve me prioritet, dy herë është bërë zhvillimi i inventarit të emisioneve dhe llogaritja e simulimit bazuar në inventarin e emisioneve, dhe përmes këtij rishikimi janë specifikuar ndotësit dhe burimet e emisioneve të cilat kontribuojnë në ndotjen e ajrit. Bazuar në studim, siç është përshkruar në “3-9 Rezultati 8: Zhvillohen kapacitetet e palës kosovare për vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit”, janë studiuar masat e kontrollit të ndotjes së ajrit bashkë me masat e zvogëlimit të emisioneve për burimet e tjera të emisioneve, dhe janë zhvilluar fletët e vlerësimit për masat e arsyeshme, ku masat janë vlerësuar në mënyrë sasiore.

Përmes aktiviteteve të lartpërmendura , qëllimi i Projektit është arritur.

(2) Arritjet për qëllimin e përgjithshëm

Përmes aktiviteteve të Projektit është organizuar sistemi për përvetësimin e të dhënave bazike për studimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit. Projekti listoi masat e kontrollit të ndotjes së ajrit dhe përzgjedhi disa nga masat të cilat kishin arsyeshmërinë e lartë, si dhe vlerësoi sasinë e zvogëlimit të emisioneve dhe kosto - efektivitetin, efektin në përmirësimin e cilësisë së ajrit, studimin e metodës së zbatimit, etj. për secilën metodë. Në të ardhmen është e dëshirueshme që të krijohet cikli i menaxhimit të cilësisë së ajrit i paraqitur në Figura 1-2 ku pala kosovare përzgjedh masat, i fut ato në veprim, vlerëson efektin bazuar në rezultatet e monitorimit të cilësisë së ajrit dhe bazës së rishikuar të të dhënave, si dhe rishikon dhe i ripërtërinë planet.

Në vijim është treguar prospekti për arritjen e Treguesve objektivisht të verifikueshëm për qëllimin e përgjithshëm. Treguesit objektivisht të verifikueshëm për qëllimin e përgjithshëm në MDP janë siç vijon.

- 1) MMPHI nxjerr raport periodik/vjetor për cilësinë e ajrit duke përfshirë inventarin e emisioneve, vlerësimin e cilësisë së ajrit dhe rezultatet e matjes së emisioneve.
- 2) Plani i Veprimit i palës kosovare rishikohet në bazë të të dhënave teknike.

Është zhvilluar inventari i emisioneve për zonën e Prishtinës dhe pala kosovare ka përfutuar kapacitetin. Në të njëjtën kohë, pala kosovare ka fituar aftësinë për ta kryer simulimin e ndotjes së ajrit bazuar në inventarin e emisioneve. Për sa i përket të dhënave të cilësisë së ajrit, janë rehabilituar analizatorët në të gjitha SMCA-të në të gjithë Kosovën përmes mbështetjes nga bashkëpunimi ndërmjet JICA-s dhe MCC/MFK, dhe jo vetëm që

është përmirësuar saktësia e të dhënave të cilësisë së ajrit por gjithashtu është realizuar ruajtja e duhur dhe shpalosja e shpejtë e të dhënave të cilësisë së ajrit. Për sa i përket matjes së gazit të shkarkuar, pala kosovare e ka përvetësuar teknologjinë. Përmes këtyre aktiviteteve është krijuar sistemi për publikimin e të dhënave të cilësisë së ajrit për raportet vjetore bazuar në të dhëna teknike.

Në Kosovë raportet vjetore përpilohen për vit kalendarik. Pasi që inventari i emisioneve vetëm sa është kompletuar dhe për shkak të efektit të COVID-19, rezultatet ende nuk janë reflektuar në raporte. Rezultatet e simulimit të ndotjes së ajrit ende nuk janë publikuar dhe reflektuar në raporte pasi që vlefshmëria e llogaritjes ende nuk është verifikuar dhe MMPHI/MMPH është duke e konsideruar shpalosjen, meqenëse nevojitet vëmendje për sa i përket përmbajtjes së publikimit. Të dhënat e cilësisë së ajrit ende nuk janë reflektuar në raporte pasi që rehabilitimi i analizatorëve në SMCA është kompletuar tek në nëntor të vitit 2019, por të dhënat raportohen në raportin mujor³⁵ nga IHMK. Shpalosja e rezultateve të matjes së gazit të shkarkuar është nën konsiderim nga MMPHI/MMPH pasi që janë disa rezultate të cilat nuk i përmbushin VKE-të.

Për sa i përket inventarit të emisioneve, është e nevojshme që të përmirësohet saktësia e të dhënave përmes sigurimit të të dhënave të matjeve aktuale, mbledhjes së të dhënave më të detajuara të aktivitetit, etj. Për sa i përket vlerësimit të cilësisë së ajrit, sigurimi i të dhënave sistematike të cilësisë së ajrit është bërë i mundshëm, por nga tani e tutje është e nevojshme që të promovohet sigurimi i besueshmërisë së të dhënave dhe vlerësimi i cilësisë së ajrit bazuar në të dhëna. Për sa i përket matjes së gazit të shkarkuar, është e dëshirueshme që matja të bëhet në mënyrë aktive pasi që pala kosovare ka përvetësuar teknologjinë dhe pritet që të fuqizohet zbatimi i rregulloreve për burimet e emisioneve përmes kësaj aftësie të përvetësuar.

Siç është përmendur më lartë, mbledhja e të dhënave dhe sistemi i mbledhjes së të dhënave, etj. janë krijuar, por është e nevojshme që të forcohet shfrytëzimi efektiv i këtyre të dhënave.

Plani aktual i Veprimit është përpiluar si “Plani i Veprimit për Cilësi të Ajrit 2017 - 2019” bazuar në “Strategjinë e Cilësisë së Ajrit 2013 - 2022”, dhe ky është synimi për Projektin. Plani i Ardhshëm i Veprimit është vonuar për shkak të COVID-19 dhe afati kohor ende nuk është përcaktuar. Projekti ka rekomanduar në Figura 3-58 sistemin për ofrimin e draft Planit të Veprimit. Pasi që të përpilohet Plani i Veprimit i dërgohet Zyrës së Kryeministrit, etj. në mënyrë që të merren mendime dhe më pastaj miratohet nga Qeveria. Pritet që rezultatet e studimit nga Projekti të reflektohen në Planin e ardhshëm të Veprimit. Në të njëjtën kohë, është e dëshirueshme që nga tani e tutje pala kosovare të kryejë aktivitete konkrete.

5.2 Çështjet për të ardhmen dhe propozimet

Projekti ka arritur qëllimet origjinale dhe aktivitetet kryesore kanë qenë transferimi i teknologjisë

³⁵ <https://www.ammk-rks.net/?page=1,163>

bazike dhe njohurisë. Pala kosovare ka marrë njohurinë dhe ka përvetësuar teknologjitë, dhe është e rëndësishme për palën kosovare t'i shfrytëzojë ato në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive dhe ta ngritë nivelin e aktiviteteve.

Në fushën e Inventarit të Emisioneve dhe Modelimit, pala kosovare ka marrë njohurinë dhe ka përvetësuar teknologjitë bazike, mirëpo është ende e dyshimtë nëse pala kosovare mund të shkojë përmes një sërë punësh, nga zhvillimi i inventarit të emisioneve deri te zbatimi i simulimit duke përfshirë mbledhjen e të dhënave, etj. dhe është e nevojshme që të merret më shumë përvojë në të ardhmen. Në fushën e Monitorimit të Cilësisë së Ajrit, është siguruar sistemi i të dhënave të cilësisë së ajrit nga bashkëpunimi ndërmjet JICA-s dhe MCC/MFK dhe është krijuar struktura sistematike për matje dhe mbledhjen e të dhënave të cilësisë së ajrit. Mirëpo, është e vështirë të thuhet se është krijuar sistemi i menaxhimit të të dhënave, dhe është e nevojshme që të krijohet sistemi i O dhe M për mirëmbajtjen e duhur të analizatorëve dhe sistemeve, si dhe e sistemit të menaxhimit të të dhënave për sigurimin e besueshmërisë së të dhënave të cilësisë së ajrit. Për sa i përket analizave laboratorike, kërkohet që të përmirësohen shumë probleme bazike siç është krijimi i sistemit bazik për analiza, sistemi i menaxhimit të laboratorit, etj. Në fushën e Matjes dhe Masave për Zvogëlimin e Emisioneve, janë studiuar dhe zbatuar masa për zvogëlimin e emisioneve për TC Kosova A, që është bërë një nga rezultatet e mëdha të Projektit. Në anën tjetër, shumë çështje janë gjetur tek burimet e tjera të palëvizshme përmes matjes së gazit të shkarkuar siç është se shumë fabrika nuk kryejnë matjen e duhur të gazit të shkarkuar dhe raportimin, dhe ka raste të fabrikave ku emisionet nuk janë në pajtueshmëri me VKE-të. Pala kosovare ka përvetësuar teknologjinë e matjes së gazit të shkarkuar, prandaj është e dëshirueshme që pala kosovare ta zbatojë në mënyrë aktive matjen e gazit të shkarkuar, dhe të synojë fuqizimin e rregulloreve dhe përhapjen e matjes së gazit të shkarkuar.

Në të njëjtën kohë, bazuar në gjetjet e Projektit, është e vështirë të thuhet se numri i stafit dhe buxhet për zbatimin e teknologjisë së transferuar janë të mjaftueshme, dhe priten përmirësime në të ardhmen.

Kur merret parasysh zhvillimi në të ardhmen në Kosovë, ka çështje që mbesin siç është përmendur më lartë. Projekti ka përmbledhur propozimet për përmirësime lidhur me këto çështje si dhe kërkesat nga pala kosovare. Këto çështje duhet të renditen në bazë të prioritetit në mënyrë që të mbështetet zhvillimi i kapaciteteve të palës kosovare, duke marrë parasysh të kuptuarit e vlerësimit sasior të problemeve me ndotjen e ajrit në Kosovë, progresin e menaxhimit të cilësisë së ajrit, nevojat për anëtarësim në BE, etj. Për më tepër, është e rëndësishme të merret mbështetje nga donatorët e jashtëm përmes klasifikimit dhe organizimit të aktiviteteve jo vetëm për t'iu shmangur dyfishimeve të përmbajtjes por gjithashtu të bëhet koordinimi në mënyrë sinergjike. Në këtë rast, është e rëndësishme që pala kosovare t'i klasifikojë dhe organizojë aktivitetet në mënyrë aktive, dhe të konfirmojë se këto aktivitete mund t'i mbështesin aktivitetet e pavarura dhe të qëndrueshme administrative të palës kosovare në të ardhmen.

Për më tepër, ka propozim nga pala kosovare që Projekti të informojë në mënyrë aktive publikun për aktivitetet. Pala kosovare ka thënë se aktivitetet ditore, etj. siç janë ligjëratat për inventarin e emisioneve, TNP, etj. duhet t'i prezantohen publikut përmes faqes së internetit, etj. Donatorë të tjerë shfrytëzojnë Facebook-un, etj. dhe përpiqen që t'i publikojnë aktivitetet në nivel të gjerë. Është e

nevojshme që të studiohet mundësia e përdorimit të faqes së internetit të MMPHI/MMPH dhe/ose të publikohen përmbajtjet.

5.2.1 Çështjet për të ardhmen dhe propozimet për Inventarin e emisioneve dhe Modelimin (Rezultati 1 dhe 5)

Rezultati 1: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për ta shtjelluar inventarin e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera.

Rezultati 5: Zhvillohen kapacitetet për modelimin e simulimit të cilësisë së ajrit.

(1) Përmbledhja dhe vlerësimi i aktiviteteve të Projektit

Në aktivitetet e inventarit të emisioneve dhe modelimit të simulimit të Projektit, u përgatit inventari i emisioneve dhe u krye modelimi i simulimit të cilësisë së ajrit në bazë të këtij inventari. Kjo është përgatitur si metodë për planifikimin dhe vlerësimin e masave kundër ndotjes së madhe të ajrit, veçanërisht në sezonin e dimrit.

Në këtë aktivitet, janë përgatitur dy inventarë të emisioneve, inventari i parë i emisioneve dhe inventari i dytë i emisioneve. H/L kanë punuar me iniciativë në krijimin e inventarit të dytë të emisioneve përmes TNP, në mbledhjen e të dhënave të fundit statistikore, rregullimin e të dhënave hyrëse dhe llogaritjen e të dhënave të aktivitetit dhe sasive të emisioneve. Është kryer modelimi i simulimit bazuar në inventarët e emisioneve.

Për më tepër, janë arritur edhe rezultatet e tjera, siç është progresi në kornizën institucionale për krijimin e inventarit të emisioneve, dhe manuali i inventarit të emisioneve. Kjo do të thotë se është vendosur baza për H/L që të jenë në gjendje ta bëjnë inventarin e emisioneve në mënyrë të pavarur.

Në përgjithësi, ekzistojnë dy qasje për t'i bërë inventarët e emisioneve: qasja nga lart-poshtë dhe qasja nga poshtë-lart. Në qasjen nga lart-poshtë, emisionet totale llogariten bazuar në të dhënat statistikore kombëtare dhe ato do të alokohen në zonën e synuar duke përdorur tregues siç janë popullsia dhe sipërfaqja e tokës. Qasja nga poshtë-lart është metodë e llogaritjes duke grumbulluar emisionet e llogaritura bazuar në të dhënat e detajuara të aktivitetit të mbledhura nga qeveritë lokale në zonën e synuar. Një shembull i qasjes nga poshtë-lart është llogaritja e sasisë së emisioneve nga secila fabrikë dhe akumulimi i sasive të këtyre emisioneve nga secila fabrikë në zonën e synuar, në mënyrë që të dihet sasia e emisioneve industriale. Qasja nga lart-poshtë ka karakteristikat e mëposhtme: shpesh është lehtë për ta llogaritur sasinë e emisioneve dhe hendeku bëhet i vogël ndërmjet sasisë së emisioneve kombëtare dhe shumës së sasive të emisioneve nga secili rajon i vendit. Qasja nga poshtë-lart na mundëson të kuptojmë karakteristikat e zonave që do të llogariten në mënyrë më të saktë dhe t'i konsiderojmë masat në më shumë detaje. Udhëzuesi EMEP/EEA ofron udhëzime për gamën e metodave të llogaritjes, nga ato të thjeshta (Tier 1) deri te ato të detajuara (Tier 3). Në përgjithësi, metodë e thjeshtë e llogaritjes është qasja nga lart-poshtë, dhe metodë e detajuar e llogaritjes është qasja nga

poshtë-lart. Prandaj, qasja nga poshtë-lart duhet të përdoret për nënkategoritë e rëndësishme të burimeve të emisioneve për të cilat duhet të merren parasysh masat ndaj ndotjes së ajrit.

Anëtarët e H/L të Rezultatit 1 morën pjesë në aktivitetet e Rezultatit 8, që iu mundësoi atyre të mësojnë se si ta përdorin inventarin e emisioneve në procesin e planifikimit, rishikimit dhe vlerësimit të masave. Si rezultat, ata ishin në gjendje të thellojnë të kuptuarit e tyre për rëndësinë e qasjes nga poshtë-lart, e cila u përdor në këtë projekt.

Më poshtë janë propozimet e marra nga aktivitetet dhe kërkesat nga pala kosovare.

(2) Propozimet nga aktivitetet e Projektit

1) Propozimet nga aktivitetet e Projektit (Rezultati 1)

Për ta përgatitur inventarin e emisioneve të ndotësve të ajrit në të ardhmen, është e nevojshme të zhvillohet korniza institucionale. Sipas Udhëzuesit EMEP/EEA, inventari i emisioneve kërkohej të ketë ‘Saktësi’, ‘Krahasueshmëri’, ‘Plotësi’ dhe ‘Konsistencë’. Për qëllimin e krijimit të tyre, është e nevojshme të përmirësohet vazhdimisht cilësia e inventarit të emisioneve siç vijon.

i) Mbështetje për vullnetin e H/L në zhvillimin e kapaciteteve për përgatitjen e inventarit të emisioneve

Anëtarët kyç të grupit punues të H/L kanë qenë shumë të motivuar për përgatitjen e inventarit të emisioneve, dhe ata morën pjesë në pothuajse të gjitha aktivitetet në Projekt. JET-i ka gjykuar se ata e kanë përmirësuar mjaft shumë kapacitetin e tyre përmes aktiviteteve të Projektit. Një nga arsytet e qasjes së tyre të vullnetshme supozohet të jetë koincidenca midis nevojave të H/L dhe aktiviteteve të mbështetura nga Projekti. Kapaciteti i H/L është forcuar shumë nga aktivitetet ku H/L me ndihmën e JET u bë organi kryesor për t'i përgatitur të dhënat e nevojshme për inventarin e emisioneve dhe për ta kryer llogaritjen aktuale për përgatitjen e inventarit të emisioneve, sidomos përmes zbatimeve të hulumtimit nga studentët, shumë seminare, trajnimet përmes TNP, etj. Në projekte të ngjashme në të ardhmen të mbështetura nga donatorët e huaj, projektet duhet të krijohen në atë mënyrë që kapaciteti i H/L të rritet duke e bërë H/L organin kryesor të aktiviteteve bazuar në nevojat e tyre.

ii) Bashkëpunimi ndërmjet AMMK dhe DMMU/DMNI

Bashkëpunimi ndërmjet AMMK dhe DMMU/DMNI ishte problem, por ata ishin në gjendje të bashkëpunojnë ngushtë në hapin e aktiviteteve të mbledhjes së të dhënave për përgatitjen e inventarit të emisioneve, hapin e përpilimit të inventarit të emisioneve dhe hapin e planifikimit të masave dhe llogaritjes së zvogëlimit të emisioneve. Përmes këtyre aktiviteteve është bërë zhvillimi i kapaciteteve të H/L. AMMK duhet të jetë në gjendje t'i përgatisë inventarët e emisioneve, por DMMU/DMNI duhet të dijë vetëm pasqyrën e përgjithshme inventarëve të

emisioneve dhe mënyrën e shfrytëzimit të tyre. Secili ka rolin e vet, dhe ajo që është e rëndësishme është të punojnë së bashku në fushën e administrimit e ajrit të atmosferës. Në mënyrë që të vazhdojmë të bashkëpunojnë në administrimin e ajrit të mjedisit në të ardhmen, është e dëshirueshme të krijohet korniza institucionale dhe të kryhet bashkëpunim i vazhdueshëm ndërmjet AMMK dhe DMMU/DMNI.

iii) Përgatitja e inventarit të emisioneve përmes qasjes nga poshtë-lart

Lidhur me inventarin e emisioneve të përgatitur nga Projekti, të dhënat janë mbledhur dhe janë vlerësuar emisionet nga secili burim i emisioneve në nivelin e nën-kategorisë në zonën e Projektit. Kjo është llogaritje përmes qasjes nga poshtë-lart dhe sugjerohet se kjo metodologji e inventarit të emisioneve mund të shfrytëzohet mjaftueshëm për planifikimin e Masave. Për sa i përket komunave në lidhje me ndotjen e ajrit, është më mirë të përgatitet inventari i emisioneve i cili mund të shfrytëzohet për njohuritë dhe qasjen e adoptuar në Projekt, dhe ato duhet t'i studiojnë dhe vlerësojnë masat e kontrollit të ndotjes së ajrit për Planin e Veprimit.

iv) Aplikimi në të Ardhmen i Manualit për Përgatitjen e Inventarit të Emisioneve

Në përputhje me manualin për përgatitjen e inventarit të emisioneve, inventari i emisioneve duhet të përgatitet çdo vit. Përmes qëndrueshmërisë së këtyre aktiviteteve, supozohet se 'Saktësia' dhe 'Konsistenca' e inventarit të emisioneve të kërkuara nga BE-ja do të përmbushen.

v) Zhvillimi i faktorëve të emisioneve të Kosovës në të ardhmen

Nuk ka faktorë të mjaftueshëm të emisionit për gazin e shkarkuar nga automjetet, burimet e emisioneve nga amvisëritë dhe burimet e palëvizshme nga industria terciare, dhe për këtë arsye, Projekti i ka përdorur faktorët e emisionit nga Udhëzuesi EMEP/EEA. Për këtë arsye, veçanërisht për burimet e emisioneve nga amvisëria dhe burimet e palëvizshme nga industria terciare, pala kosovare duhet t'i zhvillojë faktorët e saj të emisionit në disa kategori duke kryer matjen e gazit të shkarkuar për këto burime të emisioneve në mënyrë që ta përmirësojë saktësinë e inventarit të emisioneve. Matja aktuale duhet të kryhet në bashkëpunim me grupin për matjen e emisioneve duke përdorur pajisjet e matjes të dorëzuara nga Projekti dhe duke përdorur përvojën dhe njohuritë për matjen e IDM-ve dhe burimeve të tjera të palëvizshme. Faktorët e emisionit që rrjedhin nga matja aktuale mund të përdoren për vlerësimin e masave, dhe bazuar në rezultatet e matjes mund të ofrohen informacionet për pajisje me nivel të ulët të emisioneve.

vi) Të kuptuarit e informacionit të detajuar për llojet e lëndëve djegëse përmes statistikave

Për sa i përket burimeve të palëvizshme të emisioneve nga amvisëritë, emisionet janë vlerësuar nga regjistrimi i vitit 2011. Mirëpo, pasi që këto të dhëna janë mjaft të vjetra si të dhëna statistikore, të dhënat e emisioneve duhet të rishikohen bazuar në të dhënat e regjistrimit të ardhshëm të planifikuar për vitin 2021 dhe/ose duhet të zhvillohet metoda e re e hulumtimit statistikor për gjendjen e konsumit të lëndës djegëse për amvisëri. Në veçanti, në bashkëpunim me ASK është shumë e rëndësishme të kuptohen lëndët e reja djegëse siç është peleti, i cili nuk ekzistonte në regjistrimin e mëparshëm të vitit 2011. Këto të dhëna mund të përdoren jo vetëm për inventarin e emisioneve, por edhe parashikimin e emisioneve në të ardhmen, dhe kjo gjithashtu mund të korrespondojë me direktivën NEC.

vii) Zhvillimi i të dhënave vjetore të emisioneve për burimet e palëvizshme

QeK tashmë ka vendosur Lejen PKIN dhe Lejen Mjedisore (Lejet). Këto të dhëna kontribuojnë jo vetëm në përmirësimin e saktësisë dhe plotësisë së inventarit të emisioneve, por gjithashtu edhe në shfrytëzimin e studimit dhe vlerësimit të Masave. Si rezultat, është e mundur që të korrespondojnë me kërkesat e BE-së siç është përgatitja për direktivën NEC dhe synimi kombëtar për tavani e emisioneve, etj.

Pala kosovare për çdo vit duhet ta shtjellojë procedurën e mbledhjes së të dhënave nga Lejet. Për ta bërë këtë formularët e aplikacionit për Leje duhet të përmirësohen dhe përpiluesi i Inventarit duhet të kërkojë që të promovohen zbatimi dhe raportimi i matjes së gazit të shkarkuar, pasi që matja ende nuk është e përhapur në fabrikat aktuale.

viii) Zhvillimi i të dhënave të aktivitetit për industrinë terciare

Për burimet e palëvizshme të emisioneve në industrinë terciare ka nevojë për informacione themelore siç është numri i zyrave, sipërfaqja bruto e ndërtesave, konsumi aktual i energjisë, etj. Mirëpo, megjithëse është krijuar sistemi për regjistrim dhe raportim të emisioneve i përshkruar në vii), ende është e vështirë që të gjeten të gjitha emisionet, pasi që ende ka shumë biznese të tjera të vogla të cilat nuk janë të përfshira në sistem. Zakonisht burime të tilla të vogla të emisioneve shpesh vlerësohen nga lloje të ndryshme të informacioneve statistikore, por Kosova nuk është e situatë që të ketë të dhëna të mjaftueshme statistikore.

Projekti është përpjekur të mbledhë lloje të ndryshme të të dhënave si numri i zyrave, etj., por të dhënat ishin të kufizuara, dhe është e nevojshme të sigurohen të dhëna më të detajuara dhe më të sakta. Të dhënat e tilla do të përdoren jo vetëm për inventarin e emisioneve, por edhe parashikimin e emisioneve në të ardhmen, dhe për të qenë në gjendje të përmbushet direktiva e BE-së për NEC.

Në këtë situatë, duhet të promovohet shkëmbimi i llojeve të ndryshme të të dhënave statistikore ndërmjet institucioneve përkatëse. Në të njëjtën kohë,

statistikat duhet të përmirësohen edhe më shumë duke përdorur të dhëna të reja statistikore sipas nevojës. MMPHI/MMPH duhet të kërkojë nga qeveria dhe/ose ASK përmirësimin e të dhënave statistikore për studimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit. Për më tepër, MMPHI/MMPH duhet ta përgatisë vendimin për mbledhjen e këtyre të dhënave të detajuara duke iu referuar UA për Gazra Serrë.

ix) Zhvillimi i metodës së llogaritjes për nënkategoritë e pavlerësuara

Për ta përmirësuar plotësinë dhe krahasueshmërinë e inventarit të emisioneve, duhet të zhvillohet metoda e llogaritjes për nën-kategoritë e Pa Vlerësuara (NV) siç janë emisionet fugitive nga automjetet, punimet e ndërtimit dhe shkatërrimit, pajisjet jashtë-rrugore, gurë thyerja, etj. Për më tepër, për sa i përket nënkategorive që Nuk Ndodhin (NN) dhe Nuk janë të Aplikueshme (NA), ato duhet të rishikohen përsëri, dhe sipas nevojës duhet të llogariten emisionet. Këto rekomandime do ta përmirësojnë saktësinë e inventarit të emisioneve.

x) Përmirësimi i llogaritjes së emisioneve nga sektori i PIPP

Në mënyrë që të përmirësohet inventari i emisioneve të ndotësve të ajrit për sektorin IPPU, duhet të sigurohen jo vetëm të dhënat për konsumin e lëndës djegëse por edhe të dhënat për lëndët e para në industrinë prodhuese duke i përdorur Lejet. Për llogaritjen e emisioneve nga përdorimi i produktit gjithashtu kërkohen të dhënat nga përdorimi i produktit. Aktivitetet e tilla për mbledhjen e të dhënave do ta përmirësojnë cilësinë e të dhënave të aktivitetit dhe llogaritja e emisioneve nga sektori i PIPP do të përmirësohet. Në të njëjtën kohë, përdorimi i të dhënave do të zgjerohet në inventarin e Gazrave Serrë, etj. dhe do të çojë drejt zhvillimit të kapaciteteve të aktiviteteve administrative në fushën e mjedisit. Është e dëshirueshme që këto aktivitete të kryhen paralelisht me ato në ix).

xi) Përmirësimi i llogaritjes së emisioneve nga sektori i mbeturinave

Për ta përmirësuar inventarin e emisioneve të ndotësve të ajrit nga sektori i mbeturinave, duhet të mblidhen ose vlerësohen informacionet për sasinë e mbeturinave të ngurta komunale siç janë mbeturinat e gjeneruara, mbeturinat e trajtuara, mbeturinat e deponuara, mbeturinat e ricikluara, dhe mbeturinat e mbledhura dhe të trajtuara në mënyrë ilegale. Mbledhja këtyre të dhënave do ta përmirësojë cilësinë e të dhënave të aktivitetit dhe rezultatet e llogaritjes së emisioneve të ndotësve të ajrit në sektorin e mbeturinave. Si rezultat, aktiviteti jo vetëm që përmirëson cilësinë e inventarit të emisioneve për ndotësit e ajrit, por gjithashtu zgjeron përdorimin e tij në inventarin e Gazrave Serrë, gjë që do të çojë drejt zhvillimit të kapaciteteve të aktiviteteve administrative në fushën e mjedisit.

- xii) Përmirësimi i vetë-mbështetur dhe i qëndrueshëm i inventarit të emisioneve nga pala kosovare

Në mënyrë që të përmirësohet cilësia e inventarit të emisioneve në mënyrë të qëndrueshme, manuali i përgatitjes së inventarit të emisioneve duhet të vazhdojë të përmirësohet bazuar në përvojën dhe njohuritë nga rishikimi i përgatitjes së inventarit të emisioneve. Në atë kohë, vëmendja duhet t'i kushtohet jo vetëm përmirësimit të saktësisë, por edhe plotësisë, krahasueshmërisë dhe konsistencës. Në veçanti, në rast se metodologjia e llogaritjes përmirësohet, kërkohet që në të njëjtën kohë të rishikohet metodologjia e kaluar, gjë që garanton konsistencën.

- xiii) Konsistenca me formën e raportimit të BE-së

Forma e raportimit tek BE-ja kërkon jo vetëm të dhënat konkrete numerike, por edhe simbolet si informacion mospërcaktim të të dhënave (NV, NN, NA, etj.) dhe origjinat e të dhënave, dhe është e nevojshme të shkruhen qartë vlerat, simbolet dhe të origjinat e të dhënave për të gjitha burimet e emisioneve në nën-kategori. Këto veprime garantojnë plotësinë dhe krahasueshmërinë e inventarit të emisioneve.

- xiv) Klasifikimi i fushave të aktivitetit

Pala kosovare duhet të ndërmarrë iniciativë për klasifikimin e fushave të aktivitetit, pasi pritet që nga tani e tutje kapaciteti për zbatimin e masave administrative për ajrin e mjedisit do të rritet me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm.

2) Propozimet nga aktivitetet e Projektit (Rezultati 5)

Për shkak të mungesës së besueshmërisë së të dhënave të monitorimit të cilësisë së ajrit, është e vështirë të vërtetohet vlefshmëria e rezultateve të simulimit të kryer në kuadër të Projektit dhe për këtë arsye modeli i simulimit nuk është vërtetuar plotësisht. Në anën tjetër, të dhëna më të besueshme të monitorimit kanë qenë në dispozicion nga nëntori i vitit 2019 për shkak të rehabilitimit të analizatorëve të instaluar në SMCA në të gjithë Kosovën në nëntor të vitit 2019 dhe krijimit të rrjetit të komunikimit të të dhënave. Në të njëjtën kohë, janë instaluar instrumentet meteorologjike në secilin SMCA dhe sistemi për sigurimin e informacionit për motin tani është i gatshëm.

- i) Qasja ndaj Zhvillimit të Kapaciteteve të H/L

Forcimi i aftësive për llogaritjen e modelit të simulimi kërkon njohuri shkencore dhe teknike, si dhe aftësi themelore të TI-së. Megjithëse ata janë të vetëdijshëm se nuk kanë arritur ende nivelin në të cilin mund ta kryejnë vetë llogaritjen, ata ishin në gjendje t'i përmirësojnë aftësitë e tyre dhe ta thellojnë të kuptuarit e tyre për modelin e simulimit, duke punuar me vetë iniciativë përmes TNP dhe diskutimit. Pasi që TNP është shumë efektive për zhvillimin e kapaciteteve, është e rëndësishme

që H/L të kenë më shumë mundësi për të ndërtuar në mënyrë praktike modele të simulimit në rajone të ndryshme në projekte të zhvillimit të kapaciteteve nga donatorët.

ii) Krijimi i Modelit të Simulimit

Për shkak të mungesës së besueshmërisë së të dhënave të monitorimit të cilësisë së ajrit, është e vështirë të vërtetohet vlefshmëria e rezultateve të simulimit të kryer në kuadër të Projektit dhe modeli i simulimit nuk është vërtetuar plotësisht. Në anën tjetër, të dhëna më të besueshme të monitorimit kanë qenë në dispozicion nga nëntori i vitit 2019 për shkak të rehabilitimit të analizatorëve të instaluar në SMCA në të gjithë Kosovën në nëntor të vitit 2019 dhe krijimit të rrjetit të komunikimit të të dhënave. Në të njëjtën kohë, janë instaluar monitorët meteorologjikë në secilin SMCA dhe sistemi për sigurimin e informacionit për motin tani është i gatshëm.

Për ta vërtetuar vlefshmërinë e rezultateve të simulimit, është e dëshirueshme t'i krahasosh ato në të paktën katër sezone të të dhënave të monitorimit të cilësisë së ajrit gjatë një viti (nëse është e mundur, për disa vite). Megjithatë koncepti i vërtetimit të vlefshmërisë është transferuar tek H/L përmes ligjëratave, është e nevojshme të vërtetohet vlefshmëria e modelit të simulimit me të dhëna të besueshme të monitorimit të cilësisë së ajrit, në mënyrë që të shfrytëzohet rezultati i tij për vlerësimin e masave.

iii) Shfrytëzimi i modelit të simulimit për rishikimin e Strategjisë për Cilësinë e Ajrit/Planit të Veprimit

Pasi që pala kosovare nuk kishte përvojë në zbatimin e modeleve të simulimit, aktualisht nuk ka asnjë dispozitë për përdorimin e tyre. Duhet të përcaktohet një procedurë e veprimit administrativ në mënyrë që modeli i simulimit të mund të përdoret për vlerësimin preliminar të masave të propozuara dhe sigurimin e informacionit për vendimmarrësit në rishikimin e ardhshëm të Planit të Veprimit.

Kërkohej shumë punë për ta ndërtuar një model të simulimit, duke përfshirë mbledhjen e të dhënave meteorologjike, të dhënave të emisioneve dhe të dhënave për cilësinë e ajrit. Mirëpo, pasi të krijohet modeli i simulimit, modeli mund të përdoret në disa vite të ardhshme vetëm duke përditësuar informacionin e emisioneve nëse nuk ka ndonjë ndryshim të madh në kushtet e motit. Për shembull, modeli i simulimit mund të krijohet një herë në çdo pesë vite, në vitin kur përpilohet Strategjia për Cilësinë e Ajrit/Plani i Veprimit. Në këto pesë vite vetëm ndryshimet e emisioneve do të konsiderohen dhe korrigjohen nga të dhënat statistikore. Procesi i menaxhimit të progresit të Strategjive/Planeve të Veprimit për cilësi të ajrit duke të përfshijë shfrytëzimin e modeleve të simulimit.

- iv) Përmirësimi i modelit të simulimit duke përmirësuar cilësinë e të dhënave të monitorimit të ajrit në shtresën e lartë

Në Kosovë, mungesa e të dhënave të monitorimit të ajrit në shtresën e lartë është çështje për përmirësimin e cilësisë së llogaritjeve të modelit të simulimit në zonën e Prishtinës. Kushtet meteorologjike, përfshirë shtresën e lartë, kanë ndikim të madh në ndotjen e ajrit. Mirëpo, meqenëse të dhënat meteorologjike të ajrit në shtresën e lartë nuk janë monitoruar në Kosovë, për modelimin e simulimit u përdorën të dhënat nga vendet fqinje. Monitorimi i ajrit në shtresën e lartë nga vetë Kosova mund të jetë një zgjidhje, por kjo nuk është e mundur tani për tani për shkak të kostove dhe trajnimit të stafit. Një zgjidhje alternative është përdorimi i modelit të motit siç është Studimi i Motit dhe Modeli i Parashikimit (këtu e tutje “WRF”) për t’i llogaritur të dhënat meteorologjike të ajrit në shtresën e lartë.

- v) Përmirësimi i modelit të simulimit përmes zgjerimit të monitorimit të cilësisë së ajrit në zonën e Prishtinës

Mungesa e të dhënave të mjaftueshme të monitorimit të cilësisë së ajrit në Prishtinë është çështje për përmirësimin e cilësisë së llogaritjeve të modelit të simulimit.

Ekzistojnë pesë SMCA në Zonën e Prishtinës, por tri prej tyre ndodhen afër qytetit të Obiliqit, ku janë të vendosura termocentralet, dhe dy prej tyre janë të vendosura brenda qytetit të Prishtinës. Nuk ka SMCA në Fushë Kosovë ku ka dyqane të mëdha dhe një të transportit dhe në Prishtinën lindore ku ndotja e ajrit supozohet të jetë serioze për shkak të numrit të madh të popullsisë dhe shpërndarjes së shtëpive të veçuara, dhe kjo mund ta kufizojë saktësinë e modelit të simulimit.

Prandaj, JET-i ka propozuar instalimin e SMCA-ve të ri në këto zona. Një mundësi tjetër është që IHMK të përvetësojë teknologji të reja të matjes së cilësisë së ajrit, si p.sh. përmes rehabilitimit të stacionit të lëvizshëm për monitorim, blerjes së pajisjeve portative të vogla matëse, zbatimit të metodës zyrtare të matjes (matja në grumbull), etj. Sapo të përvetësohet kjo teknologji, ajo mund të jetë një vegël efektive pasi që cilësia e ajrit mund të monitorohet kudo në Kosovë, kështu që rekomandohet zgjerimi tek një vegël e tillë plotësuese si alternativë.

- vi) Krijimi i kornizës për zbatimin e qëndrueshëm të simulimit

Siç është përshkruar në iii), pasi të krijohet modeli i simulimit, është e mundur të ndiqen politika siç është Plani i Veprimit, etj. Për këtë qëllim, është e nevojshme të krijohet korniza për zbatimin e vazhdueshëm të simulimit. Grupi i modelimit të simulimit në koordinim me AMMK-në dhe DMMU-në ka krijuar tabelën e roleve dhe përgjegjësi për modelimin e simulimit. Si hap i ardhshëm, AMMK do ta organizojë GP të përbërë nga:

- Zyrtarët nga sektori i monitorimit të ajrit dhe sektori i meteorologjisë, IHMK;
- Zyrtarët nga sektori GIS dhe Inventari i Emisioneve, DVGjM
- Zyrtarët nga Divizioni për Menaxhimin e Ndotjes Industriale/DMNI

Pasi që të organizohet qeveria e re, IHMK do t'ia dërgoi ministrit të ri një propozim për vendimmarrje lidhur me përcaktimin e përgjegjësive për modelimin e simulimit.

IHMK ka insistuar se ju nevojiten katër zyrtarë shtesë (dy për IHMK, dhe dy për Inventar) në mënyrë që ta kryejnë modelimin e simulimit në mënyrë të pavarur.

JET-i u pajtua me tabelën e propozuar të roleve dhe përgjegjësive, dhe kërkoi nga pala kosovare që ta rrisë numrin e stafit dhe burimeve për ta përbushur kornizën e qëndrueshme për modelim të simulimit.

vii) Zhvillimi i kapaciteteve duke krijuar modelin e simulimit në qytete të tjera

Siç është cekur në propozimet në Rezultatin 8, nëse MMPHI/MMPH ka mundësi ta krijojë modelin e simulimit për qytete të tjera të ndotura në Kosovë, do të jetë përvojë e mirë për stafin përgjegjës që ta përjetojnë të gjithë procesin e përgatitjes së inventarëve të emisioneve dhe mbledhjen e të dhënave meteorologjike dhe të cilësisë ajrit, gjë që do të jetë e dobishme në mbajtjen dhe rritjen e kapacitetit të H/L.

viii) Shfrytëzimi për shpalosjen e informacionit dhe vetëdijesimin e publikut

Harta e përqendrimit të ndotësve së ajrit e llogaritur nga modeli i simulimit është vegël shumë e dobishme e komunikimit për shpalosjen e informacioneve për publikun dhe rritjen e vetëdijesimin të publikut, sepse mund ta tregojë gjendjen e ndotjes së ajrit në mënyrë vizuale dhe të kuptueshme. Kur modeli i simulimit të mund të vërtetohet në nivel të mjaftueshëm, pritet që rezultati i tij të përdoret për të ofruar informacione për publikun dhe për ta rritur vetëdijesimin.

(3) Kërkesa nga pala kosovare

1) Kërkesa për Rezultatin 1

Siç është përshkruar në 1-6, Republika e Kosovës dhe BE kanë nënshkruar MSA. Prandaj, Kosova duhet ta bëjë transpozimin e secilës direktivë të BE-së në ligjet e brendshme. Kjo përfshin direktivat për Cilësinë e Ajrit, dhe në këtë fushë ekziston direktiva NEC e cila kërkon që Kosova ta përbushë synimin e BE-së për zvogëlimin e emisioneve kombëtare të ndotësve të caktuar të ajrit.

Direktiva NEC imponon detyrimin ndaj shteteve anëtare për t'i zvogëluar pesë ndotës të caktuar (Dyoksidin e sulfurit (SO₂), oksidet e azotit (NO_x), komponimet organike të avullueshme jo-të-metanit (NMVOC), amoniakun (NH₃) dhe grimcat e imëta (PM_{2.5}), të cilat kanë ndikime të konsiderueshme negative dhe rreziqe për shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Si rezultat, bazuar në nenin 8 dhe 10 të Direktivës,

nga Kosova kërkohet që ta raportojë inventarin e emisioneve kombëtare çdo vit dhe projeksionin e emisioneve kombëtare çdo dy vite tek Komisioni Evropian dhe Agjencia Evropiane e Mjedisit. Shtetet Anëtare duhet të veprojnë në përputhje me Tavanet Kombëtare të Emisioneve të përcaktuara në Direktivën NEC. Ndotësit e mbuluar nga legjislacioni i BE-së për Emisionet Kombëtare dhe synimet e tyre për 2030 janë SO₂ -79%, NH₃ -19%, NMVOC -40%, NO_x -63% dhe PM_{2,5} -49 %%%.

Kosova ende nuk ka filluar ta bëjë transpozimin e kësaj Direktive në ligjet vendore, por është shumë e rëndësishme që të ketë veprim për këtë Direktivë. Përgatitja e inventarit të emisioneve kombëtare dhe projeksionet e emisioneve kombëtare janë informacione themelore për ta filluar këtë proces. Pasi që është e nevojshme të merren parasysh masat për të gjithë sektorët, zhvillimi i skenarëve për të ardhmen, përgatitja e inventarëve të emisioneve në ardhmen, zbatimi i projeksioneve të emisioneve dhe pastaj të caktohet tavani kombëtar i emisioneve, nevojat e palës kosovare për përgatitjen e inventarit të emisioneve janë në rritje.

Në këto rrethana, pala kosovare ka kërkuar përmbajtjen në vijim.

i) Mbështetjen për Direktivën NEC

Pala kosovare ka kërkuar mbështetjen për përgatitjen e inventarit vjetor kombëtar të emisioneve dhe parashikimit të emisioneve kombëtare për çdo dy vite. Inventari i emisioneve për ndotësit e ajrit në Projekt ishte prova e parë për palën kosovare, dhe zona e synuar ishte vetëm zona e Prishtinës dhe ndotësit e synuar ishin të kufizuar. Për t'i përmbushur kërkesat e BE-së dhe promovuar masat e kontrollit të ndotjes së ajrit për trajtimin e problemeve serioze në Kosovë, pala kosovare shpreson ta ketë mbështetjen për përgatitjen e inventarit të emisioneve duke u përqendruar në Direktivën NEC

Për t'iu përgjigjur kërkesave të BE-së, është e nevojshme të rritet numri i ndotësve të synuar dhe të zgjerohet zona e synuar në tërë Kosovën. MMPHI/MMPH gjithashtu duhet ta zbatojë administrimin e ajrit të mjedisit në tërë Kosovën. Zyrtarët e MMPHI/MMPH kanë fituar një nivel të caktuar të njohurisë për përgatitjen e inventarit të emisioneve përmes ligjëratave, TNP-ve, etj. të zbatuara në Projekt. Mirëpo, ata nuk kanë asnjë përvojë në kompletimin e inventarit të emisioneve në mënyrë të pavarur. Prandaj, pala kosovare dëshiron të ketë mbështetje të qëndrueshme nga donatorët e huaj. Pala kosovare shpreson të ketë mbështetje në përmirësimin e cilësisë së inventarit të emisioneve, në veçanti për çështjet siç janë zhvillimi i faktorëve të pavarur të emisioneve për fabrikat dhe pajisjet bazuar në matjen e gazit të shkarkuar, krijimi i sistemit për mbledhjen e të dhënave për emisionet nga burimet e palëvizshme, përmirësimi i cilësisë së të dhënave të aktivitetit, etj.

ii) Mbështetja për caktimin e synimit për Tavanin e Emisioneve Kombëtare

Në mënyrë që Kosova t'i përgjigjet caktimit të tavanit të emisioneve kombëtare të kërkuar nga BE, duhet të llogariten emisionet nga të gjitha burimet të paraqitura në metodën e llogaritjes në Udhëzuesin EMEP/EEA dhe emisionet nga burimet e mëdha të emisioneve duhet të llogariten me saktësi të madhe. Pastaj duhet të vlerësohen emisionet në të ardhmen. Për ta bërë këtë, janë shumë të rëndësishme informacionet për emisionet nga termocentralet me thëngjill, informacioni për emisionet nga burimet e palëvizshme të emisioneve si industritë prodhuese, terciare dhe amvisëritë, si dhe informacioni për emisionet nga automjetet. Pasi që inventari kombëtar i emisioneve është e dhëna themelore për caktimin e tavanit të emisioneve kombëtare, pala kosovare po kërkon mbështetje për caktimin e tavanit të emisioneve kombëtare. Metoda e llogaritjes së emisioneve për tavanin e emisioneve kombëtar duhet të konsiderohet nga kërkesat e BE-së dhe situata e emisioneve të Kosovës.

iii) Zhvillimi i skemës së ardhme për përgatitjen e inventarit të emisioneve

Pala kosovare po kërkon mbështetje për përmirësimin e cilësisë së inventarëve të emisioneve dhe forcimin e mëtejshëm të kornizës institucionale për përgatitjen e inventarëve të emisioneve. Pala kosovare gjithashtu po kërkon mbështetje për kërkesat e BE-së si më sipër i) dhe ii). Për shembull, sistemet e mbledhjes së të dhënave të emisioneve për burimet e palëvizshme të emisioneve të përdorura në industritë prodhuese dhe terciare janë të dhëna të rëndësishme jo vetëm për caktimin e tavanit kombëtar të emisioneve dhe inventarët e emisioneve, por edhe drejtpërdrejt për planifikimin dhe vlerësimin e masave. Informacioni për emisionet nga amvisëritë, emisionet nga automjetet dhe PKZE janë gjithashtu të rëndësishme.

Duke i përfshirë mbledhjen e informacionit dhe të dhënave dhe aktivitetet e analizës në skemën e përgatitjes së inventarit të emisioneve, MMPHI/MMPH do të jetë në gjendje ta bëjë vlerësimin e parashikimit të emisioneve bazuar në përgatitjen e inventarit të emisioneve dhe planifikimin e masave në të ardhmen. Përmes aktiviteteve të administrimit të ajrit të mjedisit në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe integruar siç është përmendur më lartë MMPHI/MMPH do të jetë në gjendje që ta kryejë punën në mënyrë efikase. Pala kosovare po kërkon mbështetje për zhvillimin e sistemit që kontribuon në përmirësimin e aktiviteteve të tilla.

iv) Ndërtimi i sistemit mbështetës nga komuniteti akademik

Lidhur me llogaritjen e emisioneve nga automjetet, etj., burimet vetanake të MMPHI/MMPH dhe MMPHI/AMMK janë të kufizuara, dhe pala kosovare beson se është e nevojshme mbështetja nga komuniteti akademik siç janë universitetet. Prandaj, pala kosovare po kërkon mbështetje siç është ekzaminimi dhe praktikimi

se si duhet të rregullohen aktivitetet e komunitetit akademik brenda kornizës institucionale për përgatitjen e inventarëve të emisioneve.

2) Kërkesat për Rezultatin 5

Meqenëse ekzistojnë ndryshime individuale në nivelin e arritjes së kompetencës teknike, dhe situata se a do të përdoret simulimi në të ardhmen apo jo ende nuk është përcaktuar qartë, ka dyshime nëse teknologjia e transferuar e modelimit të simulimit do të zbatohet në mënyrë të vazhdueshme pas Projektit apo jo.

i) Mbështetja për zhvillimin e sistemit për zbatimin e vazhdueshëm të modelimit të simulimit

Pala kosovare kërkon mbështetje për ta krijuar një hap për përdorimin e modelit të simulimit në procesin administrativ dhe për të vazhduar ta rrisë kapacitetin për zbatimin e modelimit të simulimit.

ii) Përcaktimi i përgjegjësisë për zbatimin e modelimit të simulimit në përshkrimin e punës

Vetëm një numër i kufizuar i H/L kanë aftësinë për të zbatuar modelin e simulimit në mënyrë të pavarur sepse progresi i përvetësimit të aftësive teknike ndryshon nga personi në person. Në mënyrë që stafi përgjegjës të fitojë dhe ruajë kapacitetin për zbatimin e modelimit të simulimit, H/L mendojnë se është e nevojshme të specifikohet zbatimi i modelimit të simulimit në përshkrimin e punës dhe të përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e organizatës përkatëse siç është IHMK. Si përgjigje ndaj kërkesës së H/L, Projekti ka mbështetur zhvillimin e kornizës institucionale në aktivitetet shtesë në periudhën e tretë.

iii) Zhvillimi i mbështetjes akademike për krijimin e modeleve të simulimit

Në ndërtimin e modelit të simulimit, MMPHI/MMPH dhe AMMK kanë nevojë për mbështetje nga organizata akademike siç janë universitetet. IHMK do të dëshironte ta krijonte sistemin e vetë të zbatimit në të ardhmen, por është e vështirë të bëhet realizimi i kësaj tani për tani për shkak të mungesës së stafit e kështu me radhë. Prandaj, duhet të konsiderohet përfshirja e akademisë në kornizën institucionale për zbatimin sistematik të modelit të simulimit.

5.2.2 Çështjet për të ardhmen dhe propozimet për Monitorimin e Cilësisë së Ajrit (Rezultati 3 dhe 4)

Rezultati 3: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për ta shtjelluar inventarin e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera.

Rezultati 5: Zhvillohen kapacitetet për modelimin e simulimit të cilësisë së ajrit.

(1) Përmbledhja dhe vlerësimi i aktiviteteve të Projektit

Në fushën e monitorimit të cilësisë së ajrit, IHMK është në qendër të aktiviteteve. Në këtë fushë aktivitete kryesore janë monitorimi i cilësisë së ajrit përmes matjeve, mbledhja dhe menaxhimi i të dhënave të cilësisë së ajrit. Këto të dhëna bëhen bazë për të gjitha studimet lidhur me cilësinë e ajrit dhe këtu IHMK ka një rol të rëndësishëm.

Për sa i përket të dhënave të cilësisë së ajrit, të gjitha detyrat e nevojshme për ta krijuar sistemin siç është rehabilitimi i analizatorëve, instalimi i instrumenteve meteorologjike, ndërtimi i rrjetit të komunikimit të të dhënave, etj. kanë përfunduar në nëntor të vitit 2019. IHMK dhe kompanitë e kontraktuar për O dhe M gjithashtu kanë fituar deri diku aftësitë për O dhe M të analizatorëve. Pala kosovare ka menduar se besueshmëria e të dhënave të cilësisë së ajrit ka arritur në 100%. Mirëpo, është shumë e rëndësishme që të forcohet menaxhimi i të dhënave siç është kontrolli dhe finalizimi i të dhënave ditore, llogaritja dhe finalizimi i të dhënave statistikore si dhe mbajtja e O dhe M të përshtatshme e sistemit për të siguruar të dhëna të sakta. Kjo është çështje e madhe për të ardhmen. Pala kosovare si duke nuk e kupton rëndësinë e menaxhimit të të dhënave, por menaxhimi i të dhënave është element i rëndësishëm për sigurimin e të dhënave të sakta. Si aktivitete të dyta shtesë, Projekti mbajti një ligjëratë për menaxhimin e të dhënave, por ende është i nevojshëm trajnimi nga donatorët e huaj për krijimin e sistemit.

Për sa i përket aktiviteteve të tjera në fushën e Monitorimit të Cilësisë së Ajrit, Projekti ka instaluar ekranet për shfaqjen e të dhënave të cilësisë së ajrit, ka kryer trajnimin (ushtrimin) për matjen e cilësisë së ajrit në raste emergjente dhe ka propozuar vendosjen optimale të SMCA-ve.

Për sa i përket analizave laboratorike, përveç AAS i cili tashmë përdorej në IHMK, u ri-funksionalizua JK, dhe për më tepër ICP-MS do të fillonte operimin.

Ri-funksionalizimi i JK-së e mundësoi kryerjen e analizës së gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente e cila kërkohet nga Direktiva e BE-së, e cila është bazë për PKZE-në. Mirëpo, pasi që në Kosovë JK është në posedim vetëm të IHMK-së dhe aplikimi i Metodës Standarde Referente është e kufizuar vetëm për TC Kosova A dhe TC Kosova B, kërkohet që KEK-u dhe IHMK të bashkëpunojnë për kryerjen e matjes së gazit të shkarkuar për Metodën Standarde Referente

Për më tepër, IHMK shpreson për ri-funksionalizimin e GC-MS, marrjen e certifikatës për laborator (ISO/IEC 17025), etj. Mirëpo, përmes aktiviteteve të Projektit është bërë e qartë se menaxhimi i kushteve laboratorike, siç është përmirësimi i mjedisit të laboratorit, ndërtimi i sistemit të analizave, etj., nuk është i mjaftueshëm. Për më tepër, ekziston një çështje tjetër se nuk ka plan tjetër për përdorimin e analizatorëve të ri-funksionalizuar përveç punës së zhvilluar nga Projekti (JK: analiza e gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente, ICP-MS analiza e metaleve të rënda në PM). Është i dëshirueshëm përdorimi më i shpeshtë i analizatorëve, që do t'i mundësonte palës kosovare që vetë të përvetësojnë më tej operimin e analizatorëve, dhe kjo duhet të jetë prioritet. Për më tepër, për ta siguruar cilësinë e matjeve dhe analizave, është e dëshirueshme që të arrihet sistemi i

menaxhimit të cilësisë (ISO 9001). Certifikimi (ISO/IEC1702) për laborator ka një aspekt të veçantë siç është miratimi i analizës së komponentëve një nga një. Mirëpo, pasi që të krijohet sistemi i menaxhimit të cilësisë, është e mundur të merret miratimi për komponentin e nevojitur në momentin kur të kërkohet. Sistemi i menaxhimit të cilësisë është bazë për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë, dhe kur kjo të arrihet do ta bëjë më të lehtë miratimin për komponentët e nevojshëm në ISO/IEC1702 në të ardhmen.

Për sa i përket monitorimit të metaleve të rënda në PM në ajër, është gjetur se disa nga metalet e rënda tejkalojnë vlerat udhëzuese të Japonisë si në Mitrovicë po ashtu edhe në Drenas. Operimi i ICP-MS që është planifikuar të trajnohet nga MCC/MFK do ta bëjë të mundur analizën e metaleve të rënda në PM dhe monitorimin e tyre nga tani e tutje. Mirëpo, është çështje se si të shpalosen rezultatet e analizës, megjithëse pala kosovare planifikon t'i shpalosë të dhënat pas shpjegimit dhe diskutimit të tyre me të dy komunat.

Duke i marrë parasysh kushtet e lartpërmendura janë listuar propozuar në vijim, por në të njëjtën kohë është e domosdoshme që të përforcohet stafi në mënyrë që të zgjidhen këto çështje.

(2) Propozimet nga aktivitetet e Projektit

1) Forcimi i menaxhimit të të dhënave të cilësisë së ajrit (Rezultati 3)

Të dhënat e cilësisë së ajrit janë të dhëna për monitorimin e gjendjes së cilësisë së ajrit dhe ato bëhen bazë për të gjitha aktivitetet e cilësisë së ajrit, dhe për këtë arsye sigurimi i të dhënave të sakta është misioni kryesor i IHMK-së.

Momentalisht, IHMK mbështetet në sistemin automatik për gjykimin e parregullsive dhe nuk është në gjendje t'i kryejë aktivitetet siç janë kontrolli ditor të të dhënave të cilësisë së ajrit me njohuri të ekspertit, fshirja e të dhënave të parregullta dhe korigjimi i të dhënave sipas nevojës. Në këtë kuptim, nuk kryhet menaxhimi i të dhënave, besueshmëria e të dhënave duket të jetë e vogël, dhe për këtë arsye është e nevojshme të krijohet sistemi i menaxhimit të të dhënave përmes mbështetjes së donatorëve.

Menaxhimi i të dhënave përbëhet nga elementet e mëposhtme.

- i) Finalizimi i të dhënave të matjes: Kontrolli ditor, konsiderimi i transformimit të regjistrave të O dhe M në të dhëna, ekzaminimi i detajuar i të dhënave, trajtimi i të dhënave të parregullta dhe procedura e fshirjes së të dhënave, metoda e korigjimit të të dhënave, etj.
- ii) Ruajtja e të dhënave të matjes: Është e nevojshme të ruhen të dhënat e papërpunuara të matjes si dhe të dhënat e finalizuara përmes procedurës 1) Finalizimi i të dhënave të matjes
- iii) Trajtimi i të dhënave të matura: Finalizimi i të dhënave për orë, mesatarja e 8 orëve maksimale ditore, mesatarja ditore, mujore dhe vjetore
- iv) Sigurimi i të dhënave: Publikimi raporteve duke përfshirë të dhënat statistikore, etj. pas finalizimit të të dhënave

Të dhënat e cilësisë së ajrit janë të dhëna të vëzhguara në mënyrë konstante dhe ato duhet të kenë jo vetëm cilësi të lartë për gjithashtu edhe vazhdimësi. Prandaj, analizatorët kërkojnë mirëmbajtje të duhur. Mirëpo, të dhënat e matjes mund të kenë parregullsi për shkak të dështimit të analizatorëve, etj. dhe është e nevojshme që të ketë procedura për trajtimin e këtyre të dhënave.

Konkretisht, është e nevojshme që të krijohet struktura sistematike e O dhe M siç është krijimi i ditarit të menaxhimit të pajisjeve i cili ka datën e prodhimit, regjistrin e riparimeve, regjistrin e kalibrimeve, regjistrin e të dhënave të parregullta, memorandumit për çdo gjë që është vërejtur rreth SMCA-ve, etj. Në Kosovë aktualisht ende nuk është krijuar menaxhimi i lartpërmendur dhe kjo është çështje e madhe.

Trajnimi TNP është mënyra më e përshtatshme për ta forcuar menaxhimin e të dhënave. Trajnimi do ta bëjë transferimin e teknologjisë e jo vetëm si të kontrollohen të dhënat por gjithashtu se si të reagohet ndaj riparimeve emergjente, etj.

Është e domosdoshme që të përforcohet stafi me të paktën një person më shumë për ta kryer menaxhimin e të dhënave. Në disa vende, shpesh ndodhë që qeveria ia beson këto detyra kompanive private, por në Kosovë nuk mund të gjetet një kompani e tillë dhe IHMK duhet të mësojë se si ta bëjë këtë vetë. Në të njëjtën kohë, sigurimi i buxhetit është gjithashtu i rëndësishëm për ta mbajtur mirëmbajtjen të qëndrueshme në të ardhmen.

2) Aktivitetet e tjera për Monitorimin e Cilësisë së Ajrit (Rezultati 3)

Për sa i përket ekraneve për shfaqjen e të dhënave të cilësisë së ajrit, parakusht është funksionimi i rrjetit të komunikimit të të dhënave të cilësisë së ajrit. Gjithashtu është e dëshirueshme që ekranet për shfaqjen e të dhënave të cilësisë së ajrit të mirëmbahen nga ekspertët për shkak të rëndësisë së instrumenteve të O dhe M, komunikimit të të dhënave dhe menaxhimit të softuerit. Projekti ka ndërtuar kornizën për t'ia lënë mirëmbajtjen ekspertëve dhe ia ka dorëzuar të gjitha sistemet H/L. Prandaj, është shumë e rëndësishme që nga tani e tutje pala kosovare ta sigurojë buxhetin për O dhe M.

Për sa i përket trajnimit (ushtrimit) për matje të cilësisë së ajrit në raste emergjente, rekomandohet që ushtrimi të bëhet një herë në vit përmes bashkëpunimit ndërmjet IHMK-së dhe KEK-ut. Në Kosovë, nuk ka fabrika të mëdha siç janë fabrikat e kimikateve, fabrika me deponi të mëdha të kimikateve, etj., dhe është efektive që të kryhet matja si përgjigje ndaj ankesave nga banorët duke kryer matje të PM₁₀, PM_{2.5}, SO₂ dhe NO_x në drejtimin e erës nga fabrika të tilla.

3) Përgatitja për rehabilitimin dhe/ose zëvendësimin e ardhshëm të analizatorëve në SMCA (Rezultati 3)

Nga viti 2018 deri në vitin 2019, si rezultat i bashkëpunimit ndërmjet JICA-s dhe MCC/MFK është bërë i mundshëm vëzhgimi i cilësisë së ajrit dhe i kushteve

meteorologjike dhe kjo është duke funksionuar normalisht. Mirëpo, këta analizatorë dhe instrumente meteorologjike kanë jetëgjatësinë e tyre të pritur. Në rast të analizatorëve ka dallime individuale, por jetëgjatësia do të jetë dymbëdhjetë deri në trembëdhjetë vite nëse mirëmbahen si duhet. Analizatorët në SMCA në Zonën e Prishtinës do të duhet të zëvendësohen në vitin 2024 deri 2025 dhe analizatorët në zonat e tjera do të duhet të riparohen në mënyrë gjenerale në vitin 2026 deri 2027 dhe pastaj të zëvendësohen në vitin 2032 deri 2033. Stafi përgjegjës për analizatorë duhet të përgatitet paraprakisht për këto aktivitete duke planifikuar, siguruar buxhetin, etj. dhe t'i kryejë këto aktivitete vetë.

4) Ndërtimi i sistemit si laborator (Rezultati 4)

Në kohën e fillimit të Projektit kushtet në laboratorin e IHMK-së ishin të tilla që mostrat mund të kontaminoheshin dhe të ndikonin në rezultatet e analizave, si për shembull acidi i fortë dhe/ose alkalini i fortë janë ruajtur në dhomën ku gjendeshin analizatorët, dhe u gjet shumë pluhur në laborator, etj. Në Projekt, këto çështje u zgjidhën një nga një përmes aktiviteteve të Projektit. Mirëpo, si çështje për të ardhmen, administrimi laboratorik është prioritet, siç është organizimi i pajisjeve laboratorike, mbajtja sa më e pastër e dhomës së analizatorëve, inspektimi i kushteve të përgatitjes dhe analizatorëve para analizave, regjistrimi i zbatimit të rezultateve të analizave, etj.

Saktësia është thelbi i matjeve dhe analizave. Menaxhimi i laboratorit është i domosdoshëm për t'i garantuar rezultatet e analizave, pa marrë parasysh numrin e analizave. Përvetësimi i sistemit të administrimit të laboratorit në të ardhmen është qëllimi kryesor i IHMK-së, por situata aktuale është larg nga kjo. Hapi i parë është të fillohet krijimi i sistemit të menaxhimit të laboratorit përmes arritjes së sistemit të kontrollit të cilësisë (ISO9001).

Për më tepër, për t'i operuar analizatorët si duhet, është shumë i rëndësishëm prokurimi i tretjeve standarde, reagjentëve dhe materialeve ndihmëse, siç është gazi i argonit për ICP-MS, etj., si dhe mirëmbajtja periodike e analizatorëve. Është e nevojshme të përgatitet plani i prokurimit dhe mirëmbajtjes së analizatorëve, dhe të sigurohet buxheti për këtë.

5) Zgjerimi i shtrirjes së aplikimit të analizatorëve (Rezultati 4)

BE dha si donacion pesë lloje të analizatorëve rreth vitit 2012, por vetëm AAS ishte duke punuar në kohën e fillimit të Projektit. Në Projekt, JK dhe ICP-MS u ri-funksionalizuan si përgjigje ndaj domosdoshmërisë së aktiviteteve të Projektit, si dhe kërkesës së fuqishme nga pala kosovare. Në përgjithësi, këto lloje të analizatorëve mund të mbahen në gjendje të mirë duke i operuar të paktën një herë në muaj, nëse është e mundur një herë në javë. Mirëpo, aktualisht operimi i të dy analizatorëve është i kufizuar në detyrat e zhvilluara nga Projekti, siç është matja e gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente për JK dhe analiza e metaleve të rënda në PM për

ICP-MS. Meqenëse shpeshësia është një herë në tre deri në gjashtë muaj, është e vështirë të mbahet teknologjia e analizave, dhe për më tepër, analizatorët mund të bëhen jo-operacional për shkak të shpeshësisë së ulët të operimit, njëjtë si më parë. Kjo mund të bëhet problem përsëri.

Në anën tjetër, operimi i JK-së mundëson analizën e gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente, por mbetet çështja se në kohën e matjes së gazit të shkarkuar rezultatet e analizës me Metodën Standarde Referente tregojnë vlera më të mëdha sesa rezultatet e regjistruara me analizator automatik. Duket se është e nevojshme të kryhet analiza dhe matja për gazin e njëjtë, dhe të bëhet krahasimi i rezultateve. Në periudhën e tretë, Projekti ka kryer këtë test. Mirëpo, nuk janë arritur rezultate të qarta dhe kjo mbetet çështje për të ardhmen.

JK mund ta analizojë jon sulfatin, jon nitratin, etj. në ujë, dhe ICP-MS mund të aplikohet edhe për metalet e rënda në ujë. Të dy analizatorët kanë një shtrirje të gjerë të aplikimit. Sqarimi i nevojave për analiza mjedisore mund ta zgjerojë aplikimin për këta analizatorë. Rritja e shpeshësisë së analizave mund ta përmirësojë trajtimin dhe teknologjinë e analizave.

Pritet që duke përmirësuar paralelisht teknologjinë e analizave dhe mjedisin laboratorik, do të realizohen hapa të avancuar siç është ri-funksionalizimi i GC-MS. Në anën tjetër, në të vërtetë është vetëm një staf në IHMK i cili mund të kryejë analiza, dhe është e domosdoshme të forcohet stafi me të paktën një person.

6) Përforcimi i mbledhjes së të dhënave të cilësisë së ajrit

Përmes bashkëpunimit ndërmjet Projektit dhe MCC/MFK, është bërë e mundur për palën kosovare që të mbledhë të dhëna nga të dymbëdhjetë SMCA-të në Kosovë të cilat janë të instaluar në lokacione fikse. Në anën tjetër, IHMK posedon një stacion mobil (SO_2 , NO_x , PM_{10} , $\text{PM}_{2.5}$, O_3 , CO) i cili mundëson monitorimin e cilësisë së ajrit në çfarëdo lokacioni. Mirëpo, analizatorët në stacionin mobil nuk janë të mirëmbajtur sa duhet dhe duhet të rehabilitohen. Ky stacion është shumë efektiv për monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së ajrit në lokacione pa SMCA dhe preferohet rehabilitimi i analizatorëve.

Për më tepër, për sa i përket ndotësve të ajrit siç janë SO_2 , NO_x , NH_3 , etj. dhe metaleve të rënda në ajër, është e dëshirueshme të rritet kapaciteti për teknologji të analizave siç janë mostrimi që korrespondon me Direktivën e BE-së dhe analizat duke përdorur JK-në dhe ICP-MS, në mënyrë që të mundësohet mbledhja e të dhënave në lokacione arbitrare. Këto teknologji jo vetëm që do të japin të dhëna nga lokacionet arbitrare por gjithashtu sigurojnë konfirmimin e të dhënave të marra në përputhje me Direktivën e BE-së. Për më tepër, kjo do të çojë në përmirësimin e teknologjisë së analizave me JK dhe ICP-MS.

Për të ardhmen gjithashtu do të bëhet e nevojshme që të studiohet instalimi i SMCA-ve të reja. Projekti gjithashtu ka propozuar lokacione të përshtatshme për instalimin e tyre.

7) Monitorimi i metaleve të rënda në PM në ajër

Për sa i përket monitorimit të metaleve të rënda në PM në ajër, është vendosur që metalet e rënda të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme në Drenas dhe Mitrovicë. Pasi që vlerat duhet të llogariten si mesatare vjetore si në standardin e Be-së po ashtu edhe në vlerat udhëzuese të Japonisë, mostrimi duhet të bëhet së paku katër herë në vit ose nëse është e mundur një herë në muaj për t'u bërë llogaritja e vlerës mesatare vjetore. Së shpejti përmes trajnimit të operimit të ICP-MS nga MCC/MFK, pritet se IHMK do të jetë në gjendje ta kryejë analizën e metaleve të rënda në PM në ajër.

IHMK shpreson ta bëjë vlerësimin e metaleve të rënda në PM₁₀ të mostruar me mostrues me vëllim të ulët, por nevojitet kohë për IHMK-në ta blejë mostruesin me vëllim të ulët për shkak të sigurimit të buxhetit dhe prokurimit, dhe Projekti propozoi të përdoret mostruesi me vëllim të lartë i siguruar nga Projekti. Rezultatet e analizës së metaleve të rënda në TSP të mostruara me mostrues me vëllim të lartë gjithmonë vlerësojnë përmbajtjen e metaleve të rënda në anë më të sigurt sesa ato të vlerësuara në metale të rënda në PM₁₀ të mostruara me mostrues me vëllim të ulët. Prandaj, nuk do të ketë probleme për një kohë. Është e dëshirueshme që në të ardhmen të futet në funksion mostruesi me vëllim të ulët.

Është e dëshirueshme që rezultatet e lartpërmendura të publikohen sa më shpejt që të jetë e mundur duke marrë parasysh masat në të ardhmen.

8) Analiza e komponentëve në PM_{2.5}

PM_{2.5} është një nga substancat më të dëmshme për shëndetin e njeriut e cila shkakton sëmundje të frymëmarrjes. Në Kosovë, PM_{2.5} dhe PM₁₀ janë ndotësit që më së shumti tejkalojnë vlerat kufitare dhe bëhen shqetësim i madh. Analiza e komponentëve në PM_{2.5} do ta mbështesë analizën e burimeve të emisioneve duke marrë parasysh gjenerimin sekondar të PM_{2.5}, gjë që do të çojë drejt identifikimit të burimeve të emisioneve dhe planifikimit të masave efektive.

Nëse kryhet ky aktivitet, duhet të planifikohet orari i Mostrimit për katër sezone, dhe bazuar në plan duhet të bëhet mostrimi i PM_{2.5} (rreth 300) dhe të analizohet bazuar në komponentët e tij. Rezultatet e analizës do ta mbështesin analizën efektive për specifikimin e burimeve të emisioneve të PM_{2.5}. Në këtë rast analiza do të kryhet në Japoni, pasi që pala kosovare nuk ka kapacitetet për t'i analizuar komponentët dhe për t'i studiuar rezultatet.

9) Përforcimi i stafit dhe sigurimi i buxhetit në IHMK (Produkti 3 & 4)

Siç u përmend më lart, përforcimi i stafit dhe sigurimi i buxhetit janë elemente thelbësore për krijimin e O dhe M për të dhënat e cilësisë së ajrit dhe ndërtimin e sistemit të analizave laboratorike. IHMK është përgjegjës për këto detyra, dhe pa përforcimin e stafit dhe sigurimin e buxhetit këto detyra nuk mund të zbatohen.

Kur bëhet përmbledhja e vërejtjeve të lartpërmendura në fushën e monitorimit të Cilësisë së Ajrit, rekomandohen aktivitetet në vijim. Në të njëjtën kohë, është listuar numri i nevojshëm për përforcimin e stafit, pajisjeve, etj.

Çështjet kryesore në të ardhmen janë krijimi i sistemit të menaxhimit të të dhënave dhe zhvillimi i kapaciteteve për teknologjinë e analizave, si dhe krijimi i sistemit të menaxhimit të laboratorit.

Fusha	Pikat e çështjeve	Prioriteti	Para-kushtet dhe pajisjet, etj.	Vërejtjet
Krijimi i sistemit të menaxhimit të të dhënave	Sistemi i menaxhimit të të dhënave për finalizimin e të dhënave të matura	I Lartë	<ul style="list-style-type: none"> • Është i domosdoshëm përforcimi me një punonjës më shumë (Sistemi i menaxhimit të të dhënave) • Nuk nevojiten pajisje 	<p>Është thënë se sistemi i mbledhjes së të dhënave i siguruar nga MCC/MFK e ka funksionin e gjykimit automatik të të dhënave.</p> <p>Prandaj, pala kosovare ka tendencë të mendojë se sistemi i menaxhimit është i panevojshëm. Mirëpo, kjo është çështje e rëndësishme.</p>
	Rritja e aftësisë për analizimin e të dhënave	I Lartë	<ul style="list-style-type: none"> • Kjo është një sërë punësh me sistemin e menaxhimit të të dhënave • Nuk nevojiten pajisje 	Pala kosovare ka tendencë të mos jetë e brengosur për aftësitë e analizave, por kjo është çështje me rëndësi.
Sistemi i mostrimit të të dhënave	Analiza e Cilësisë së Ajrit në lokacionet pa SMCA	I Lartë	<ul style="list-style-type: none"> • Është e mundur që formacioni momental të jetë në gjendje të merret me këtë aktivitet. • Kërkohej buxhet i lartë. 	
	Instalimi i SMCA-ve të reja	I ulët	<ul style="list-style-type: none"> • Kërkohej buxhet i lartë. 	Prioriteti i palës kosovare do të jetë i lartë, por është problem i madh se si të sigurohet buxheti.
	Zëvendësimi i analizatorëve në SMCA në Zonën e Prishtinës	Elementi	<ul style="list-style-type: none"> • Kërkohej buxhet i lartë. 	Prioriteti për palën kosovare duhet të jetë i lartë pasi që analizatorët do ta kalojnë jetë gjatësinë e tyre në disa vite. Mirëpo, është çështje serioze se si të sigurohet buxheti.
Analizat Laboratorike	Përforcimi i teknologjisë së analizave	I Lartë	<ul style="list-style-type: none"> • Rekrutimi i punonjësve për ta zëvendësuar stafin që do të pensionohet së shpejti (dy punonjës) • Është i domosdoshëm 	Të bëhet teknologjia e përvetësuar më e sigurt dhe më e qëndrueshme

			<p>përforcimi me së paku një staf për punën e analizave</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nevojiten disa pajisje 	
Mbështetja për krijimin e sistemit të menaxhimit të laboratorit	I Lartë		<ul style="list-style-type: none"> • Rekrutimi i punonjësve për ta zëvendësuar stafin që do të pensionohet së shpejti (dy punonjës) (Njëjtë) • Është i domosdoshëm përforcimi me së paku një staf për krijimin e sistemit të menaxhimit të analizave • Nuk ka nevojë për pajisje 	Krijimi i sistemit të kontrollit të cilësisë bëhet bazë për përvetësimin e sistemit të menaxhimit të laboratorit (ISO17025) në të ardhmen.
Rritja e numrit të elementeve të analizuara (ri-funksionalizimi i GC-MS)	I ulët		<ul style="list-style-type: none"> • Janë dy GC-MS, dhe për operim nevojitet përforcimi me një staf/një GC-MS • Janë të nevojshme puna e rehabilitimit dhe trajnimi për operim të GC-MS, 	Është shumë e mundur që IHMK do ta kërkojë fuqimisht ri-funksionalizimin e GC-MS. Mirëpo, kjo mund të bëhet pasi që të përmbushen dy pikat më lartë, dhe pastaj kjo do të jetë e arsyeshme. Është shumë herët që të zbatohet ky aktivitet.
Analiza e komponentëve në PM _{2.5}	I Lartë		<ul style="list-style-type: none"> • Është e nevojshme kosto e mostruesit dhe analizave 	Analizat kryhen në Japoni. Është e nevojshme mbështetja nga pala kosovare

Prioriteti (rekomandohet nga JET)

I Lartë: Aktivitetet me prioritet të lartë të cilat duhet të adoptohen me përforcimin e stafit.

Mesatar: Aktivitetet të cilat duhet të kryhen kur të plotësohen kushtet

I ulët: Aktivitetet të cilat duhet të kryhen kur të plotësohen kushtet dhe nevoja e palës kosovare të bëhet e lartë

(3) Kërkesa nga pala kosovare

Pasi që sistemi i matjes dhe mbledhjes së të dhënave të cilësisë së ajrit në Kosovë është krijuar, pala kosovare si duket mendon se sistemi është kompletuar, prandaj nuk ka ndonjë kërkesë të veçantë nga pala kosovare. Mirëpo, çështjet e rëndësishme të lartpërmendura mbesin.

Për sa i përket Monitorimit të Cilësisë së Ajrit, IHMK shpreson jo vetëm për ri-funksionalizimin e ICP-MS por gjithashtu edhe marrjen në të ardhmen të certifikatës për laborator (ISO/IEC17025). Mirëpo, kushtet ekzistuese janë larg nga të qenit të përshtatshme për marrjen e certifikatës. Gjëja e parë që duhet bërë është të krijohet sistemi i analizave dhe sistemi i menaxhimit të laboratorit përmes procesit të arritjes së sistemit të menaxhimit të cilësisë (ISO9001), etj. Për ta realizuar këtë, është e nevojshme të rritet numri i stafit, të trajnohen ata dhe të krijohet sistemi i menaxhimit përmes mbështetjes nga donatorët e huaj,

etj. Paralelisht, IHMK duhet ta përforcojë stafin, pastaj t'i rrisë komponentët e analizës, dhe të ketë njohuri dhe përvojë për matjet dhe analizat. Kjo mund t'ia mundësojë IHMK-së arritjen e ISO17025 në të ardhmen. Është e domosdoshme që të përforcohet stafi dhe të akumulohet njohuri dhe përvojë, dhe edhe nëse gjithçka shkon mirë, do të duhen të paktën pesë vite për ta arritur ISO17025. Është e dëshirueshme që IHMK ta bëjë një Plan të Veprimit dhe ta krijojë bazën hap pas hapi në përputhje me Planin e Veprimit.

Për sa i përket monitorimit të metaleve të rënda në PM, Projekti ka bërë analizën e metaleve të rënda në PM (TSP) të mostruara me mostrues me vëllim të lartë të siguruar nga Projekti, por IHMK dëshiron ta bëjë analizën e metaleve të rënda në PM₁₀ të mostruar me mostrues me vëllim të ulët, pasi që rregullorja e BE-së kërkon analizën e përmbajtjes së metaleve të rënda në PM₁₀.

5.2.3 Çështjet për të ardhmen dhe propozimet për Matjen dhe Masat për Zvogëlimin e Emisioneve (Rezultati 2, 7 dhe 6)

Rezultati 2: Zhvillohen kapacitetet për matjen e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera.

Rezultati 7: Zhvillohen masat e kontrollit të emisioneve në IDM.

Rezultati 6: Përmirësohet vendimmarrja nga pala kosovare bazuar në të dhënat teknike për kontrollin e ndotjes së ajrit.

(1) Përmbledhja dhe vlerësimi i aktiviteteve të Projektit

Transferimi i teknologjisë së matjes së gazit të shkarkuar dhe zhvillimi i kapaciteteve për masat e zvogëlimit të emisioneve për IDM janë aktivitetet që pasuan Aktivitetet Paraprake, dhe në Projekt aktiviteti u zgjerua tek burimet e tjera të palëvizshme.

Për sa i përket matjes së gazit të shkarkuar, synimi origjinal ishte formimi i grupit për matje dhe forcimi i mekanizmit të mbikëqyrjes për emisionet nga burimet e palëvizshme. Megjithëse kanë kaluar pesë vjet nga Aktiviteti Paraprak, teknologjia e matjes është transferuar kryesisht në IHMK, dhe në të njëjtën kohë edhe KEK-u ka përvetësuar teknologjinë. Të dy grupet janë aftësuar që të kryejnë matje në mënyrë të pavarur. Mirëpo, MMPHI/MMPH nuk e ka arritur ende synimin për ta forcuar mekanizmin e mbikëqyrjes si administratë. Projekti ka pasur për synim krijimin e kornizës institucionale për matjen e gazit të shkarkuar, por asnjë agjenci private nuk është nxitur gjatë periudhës së Projektit. Është bërë transferimi i teknologjisë së matjes së gazit të shkarkuar. Mirëpo, është shqetësim i madh se aktualisht përhapja e matjes së gazit të shkarkuar është shumë e ulët pasi që nuk ka mekanizëm për ta shfrytëzuar teknologjinë në MMPHI/MMPH, dhe nuk është gjetur mënyra për ta përhapur zbatimin e matjes dhe raportimit.

Për sa i përket masave për zvogëlimin e emisioneve për IDM, Projekti i ka studiuar ato për TC Kosova A si synim, për katër vite nga Aktiviteti Paraprak deri në periudhën e dytë të Projektit. Është e rëndësishme të kuptohet gjendja e gazit të shkarkuar në mënyrë që të studiohen masat për zvogëlimin e emisioneve për Pluhur, SO₂ dhe NO_x. H/L kanë arritur

nivelin ku janë në gjendje t'i studiojnë masat për zvogëlimin e emisioneve pa JET-in, pasi që përmes TNP ata kanë mësuar një sërë punësh siç janë instalimi i vrimave të matjes, përgatitja e pajisjeve për matje në vend-matje, bashkëpunimi me palët përkatëse për matje, organizimi i pajisjeve për matje, rregullimi i të dhënave pas matjes, etj. Megjithëse aktiviteti ishte i kufizuar në TC Kosova A, Projekti ka kryer disa lloje të testeve dhe ka propozuar disa masa. Nga këto masa, masa për zvogëlimin e Pluhurit është pranuar dhe kjo masë është në zbatim e sipër. Kjo është bërë një nga rezultatet e mëdha të Projektit. Për sa i përket përmirësimit të performancës së FES-it si masa për zvogëlimin e Pluhurit, anëtarët në TC Kosova A, Universiteti i Prishtinës, MMPHI/MMPH dhe JET-i, përmes bashkëpunimit industri-akademi-qeveri, studiuuan dhe propozuan masën për përmirësimin e shpërndarjes së rrjedhës brenda FES-it përmes një sërë punësh siç është matja e shpërndarjes së shpejtësisë së rrjedhës brenda FES-it dhe analiza e rrjedhës me CFD bazuar në rezultatet e matjes. Ishte një rezultat i madh të mund të transferohej procesi për t'i trajtuar dhe zgjidhur problemet, dhe është e dëshirueshme që problemet në të ardhmen të trajtohen në të njëjtën mënyrë. Masat për zvogëlimin e emisioneve për SO₂ dhe NO_x kërkojnë investime jo aq të vogla, dhe për këtë arsye, adoptimi i tyre nuk është i lehtë, por kapaciteti i KEK-ut si H/L kryesor mund të zhvillohet përmes këtyre aktiviteteve. Në të njëjtën kohë, përmes seminareve Projekti ka ofruar parimet e pajisjeve për zvogëlimin e emisioneve dhe pikat për vëmendje kur ato aktualisht adoptohen, dhe ka ofruar informacion të dobishëm për rastin kur futen në përdorim pajisjet për zvogëlimin e emisioneve.

Nuk ka asnjë plan të rinovimit për ndonjë pajisje pasi që planifikohet që TC Kosova A të ndalet, dhe për këtë arsye, nuk ka asnjë aktivitet që do të kryhet. Mirëpo, është e dëshirueshme të jepet mbështetje në rast se zbatohet futja në funksion e kontrollit të energjizimit me ndërprerje për FES.

Për sa i përket masave të zvogëlimin të emisioneve për burimet e tjera të palëvizshme, përmes matjes së gazit të shkarkuar është zbuluar se fabrikat private kanë shumë probleme. Si rezultat, është gjetur se pothuajse të gjitha këto fabrika nuk janë nuk janë në pajtueshmëri me VKE-të. Çështjet janë që nuk kryhet matja e gazit të shkarkuar dhe për këtë arsye rezultatet nuk raportohen, dhe në të njëjtën kohë MMPHI/MMPH nuk mund t'i interpretojë rezultatet e matjes edhe nëse ato dorëzohen dhe nuk mund t'i udhëzojë siç duhet fabrikat private, fabrikat private nuk e kuptojnë rëndësinë e zbatimit të matjes së gazit të shkarkuar, etj. Shumë çështje janë grumbulluar dhe nevojitet zhvillimi i kapaciteteve të MEEA/MMPH.

(2) Propozimet nga aktivitetet e Projektit

1) Rritja e kapacitetit të zyrtarëve të MMPHI/MMPH për t'i udhëzuar fabrikat private bazuar në matjen e gazit të shkarkuar (Rezultati 2 dhe 6)

Është efektive për MMPHI/MMPH (Inspektorati, DMNU/DMN, etj.) t'i udhëzojë fabrikat private duke shfrytëzuar plotësisht teknologjinë e matjes së gazit të shkarkuar të përvetësuar nga IHMK. Zakonisht fabrikat e mëdha private kanë stafin përgjegjës për

çështje mjedisore dhe monitorojnë emisionet, por fabrikat e mesme dhe të vogla private shumë rrallë kanë një staf të tillë dhe nuk kanë ndonjë menaxhim të emisioneve.

MMPHI/MMPH duhet ta kryejë në mënyrë aktive matjen e gazit të shkarkuar për fabrikat private. Në rast se emisionet nuk janë në përputhje me rregulloret, MMPHI/MMPH duhet ta ndërmarrë procesin e përmendur më poshtë, ku MMPHI/MMPH dhe fabrikat private inspektojnë shkaqet, studiojnë masat dhe i zbatojnë masat në praktikë. Ky proces do t'i mbështesë të dy palët që ta rrisin njohurinë dhe përvojën e tyre.

Në këtë rast, MMPHI/MMPH duhet t'i udhëzojë fabrikat private duke ndërmarrë hapat e procedurës administrative si më poshtë. Ky është shembulli ji Japonisë.

- i) Të kërkohet nga fabrika t'i shpjegojë shkaqet dhe t'i propozojë masat përmes dokumenteve (në rast se nuk ka propozime, mund të ndërmerret pezullimi i operimit)
- ii) Të jepet leja e përkohshme për operim kur MMPHI/MMPH i studion masat dhe i gjykon ato si të arsyeshme
- iii) Të përcaktohet afatin brenda të cilit fabrika ndërmerr masa
- iv) Të miratohet vazhdimi i operimit kur MMPHI/MMPH gjykon se masat janë të përshtatshme bazuar në rezultatet e matjes të paraqitura para afatit të fundit kohor
- v) Sipas nevojës të konfirmohen masat përmes matjes së gazit të shkarkuar
Ky aktivitet gjithashtu forcon zbatimin e ligjit.

Për t'i realizuar procedurat e lartpërmendura, është e nevojshme që MMPHI/MMPH (DMMU/DMNI dhe Inspektorati) t'i rrisë njohuritë për t'i kuptuar rezultatet e matjes dhe masat e zvogëlimit të emisioneve, si dhe ta përmirësojë aftësinë për t'i udhëzuar fabrikat.

Mënyra më efektive për këtë aktivitet është TNP ku MMPHI/MMPH inspekton një fabrikë aktuale dhe e bënë matjen e gazit të shkarkuar, pasi që zakonisht secila fabrikë private ka procesin dhe pajisjet e veta. Është e dëshirueshme që TNP të zbatohet përmes mbështetjes së donatorëve. Zyrtarët përgjegjës në MMPHI/MMPH duhet të specializohen në këtë punë gjatë këtij aktiviteti, dhe zyrtarët dhe donatorët duhet ta kryejnë këtë punë në mënyrë të integruar.

Është e dëshirueshme që procesi i lartpërmendur të dokumentohet dhe institucionalizohet. Mirëpo, dokumentimi dhe institucionalizimi i tillë duhet përcaktohet duke marrë parasysh situatën aktuale në Kosovë të ekzaminuar me anë të aktiviteteve të studimit të emisioneve përmes TNP.

Si shembull, në Kosovë petrol-koksi lejohet të përdoret si lëndë djegëse, dhe në realitet petrol-koksi konsumohet për shkak të çmimit të lirë. Petrol-koksi përmban nivel të lartë të Sulfurit dhe zakonisht është e pamundur të konsumohet pa ndonjë pajisje për de-sulfurim. Konsumi i petrol-koksit në mënyrë të pashmangshme e bën përqendrimin e SO₂ në gazin e shkarkuar shumë të lartë, dhe për këtë arsye, kryerja e matjes së gazit të shkarkuara dhe forcimi i udhëzimit do ta kufizojë në mënyrë automatike dhe drastike

përdorimin e petrol-koksit. Në Japoni, petrol-koksi trajtohet si mbeturinë dhe është e nevojshme të rishikohet ligji nga kjo pikëpamje.

Mirëpo, numri i zyrtarëve përgjegjës aktualisht nuk është i mjaftueshëm, dhe është e nevojshme të përforcohet personeli me të paktën një person më shumë, nëse është e mundur dy, në mënyrë që të zgjerohet aktiviteti brenda vendit për Inspektoratin.

Pritet që pala kosovare përmes mbështetjes nga donatorët, të bëhet e aftë t'i udhëzojë fabrikat private bazuar në rezultatet e matjes së gazit të shkarkuar në një mënyrë të vetë-qëndrueshme.

Gjithashtu pritet që matja e gazit të shkarkuar të përhapet si rezultat i të kuptuarit të rëndësisë së matjes për fabrikat private. Edhe pse, për një kohë, matja e gazit të shkarkuar duhet të mbështetet në IHMK-në ose agjencitë e huaja, mund të themelohet si biznes kur të kuptuarit e rëndësisë së matjes së gazit të shkarkuar përhapet dhe rritet në Kosovë.

2) Forcimi i kapacitetit dhe strukturës së matjes së gazit të shkarkuar (Rezultati 2)

Projekti ka realizuar matjen për IDM dhe katër burime të tjera të palëvizshme në Kosovë. Bazuar në këto përvoja, H/L kanë fituar shumë njohuri. Mirëpo, teknologjia mund të humbet nëse matja nuk kryhet në mënyrë të qëndrueshme. Në të njëjtën kohë, është e nevojshme të akumulohen përvoja siç është specifikimi i metodës së matjes dhe lokacioneve në përgjigje të procesit dhe rrjedhës së procesit për secilën fabrikë. Në këtë kuptim, është shumë efektive të kryhet procesi 1) i përmendur më lart. Në anën tjetër, janë vetëm dy punonjës përgjegjës për matjen e gazit të shkarkuar në IHMK, dhe është e domosdoshme të përforcohet stafi me të paktën një punonjës më shumë. KEK-u gjithashtu ka përvetësuar teknologjinë e matjes dhe pritet të vazhdojë aktivitetin e matjes, por KEK-u gjithashtu ka vetëm dy punonjës përgjegjës për matje, dhe gjithashtu kërkohet përforcim i stafit. Në të njëjtën kohë, është gjithashtu e rëndësishme të blihen materiale të ndryshme shpenzuese dhe të bëhet mirëmbajtja e instrumenteve. Është e nevojshme të bëhet plani i prokurimit dhe të sigurohet buxheti për të. Për më tepër, IHMK duhet ta sigurojë një automjet për t'i transportuar pajisjet për matje.

Si zhvillim i mëtejshëm në matjen e gazit të shkarkuar, ekziston aktiviteti i vlerësimit për emisionet nga ngrohja në amvisëri me përdorim të lëndës së ngurtë djegëse, etj. Ky aktivitet do ta mbështesë llogaritjen e faktorëve të emisionit për pajisjet e ngrohjes, gjë që mundëson më shumë efekt konkret në ajër. Ndikimi më i pritur është që do të vlerësohen emisionet nga pajisje të ndryshme dhe lloje të ndryshme të lëndëve të ngurta djegëse, dhe më pas, informacioni për kombinimin më të mirë të pajisjeve të ngrohjes dhe lëndës djegëse për cilësi të ajrit do t'i ofrohet publikut. Ky aktivitet do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Në mënyrë që pala kosovare ta kryejë këtë aktivitet në mënyrë të qëndrueshme, është e dëshirueshme që pala kosovare të instalojë strukturën e testimit dhe ta përvetësojë teknologjinë e vlerësimit.

Në anën tjetër, emisionet nga automjetet vlerësohen përmes Udhëzuesit EMEP/EEA. Mirëpo, ka shumë automjete të vjetra në Kosovë dhe është efektive të maten emisionet gjatë kohës kur automjetet në të vërtetë janë duke lëvizur. Në mënyrë që të mësohet kjo teknologji, është e nevojshme të futen në përdorim pajisjet e matjes (Sistemi portativ i matjes së emisioneve: PEMS) dhe të ketë trajnim për ta operuar pajisjen. Në të njëjtën kohë, për ta bërë këtë matje janë të domosdoshëm tre punonjës.

3) Studimi i masave për zvogëlimin e emisioneve në IDM (TC Kosova A) (Rezultati 7 dhe 2)

TC Kosova A planifikohet ta ndalë operimin në vitin 2023, dhe investimet janë të kufizuara. Mirëpo, plani për termocentralin e ri (TC Kosova e Re) tani është në pritje, dhe është e nevojshme të pritet përgjigja nga pala kosovare. Mirëpo, TC Kosova A është shumë e vjetërsuar dhe efikasiteti i gjenerimit të energjisë elektrike është i ulët. Nëse merret në konsideratë investimi për TC Kosova A, kjo kërkon jo vetëm studimin për masat e zvogëlimin të emisioneve, por gjithashtu studimin gjithëpërfshirës siç është rinovimi i pajisjeve, zgjatja e jetës, rritja e efikasitetit të gjenerimit të energjisë elektrike, etj. Prandaj, investimi është shumë i vështirë për t'u zbatuar.

Kaldajat janë shumë të vjetra pasi që ato janë instaluar rreth pesëdhjetë vite më parë. Është shumë e vështirë të gjeten masa për t'i përmirësuar emisionet pasi që përbërja e lëndës së parë (linjitet) nuk është e qëndrueshme dhe ndikon mjaft shumë në gazin e shkarkuar. Mirëpo, Projekti transferoi procedurat e testeve, siç janë bërja e planeve të testit dhe procedurave të testit, krijimi i sistemit të testit, organizimi i të dhënave të testit, ekzaminimi i rezultateve të testit, etj., dhe është e nevojshme që H/L të vazhdojnë me këto lloje të procedurave në mënyrë që t'i studiojnë masat për zvogëlimin e emisioneve për të ardhmen. Mirëpo, numri i anëtarëve që mund t'i kryejnë aktivitetet është i kufizuar. Për t'i vazhduar këto aktivitete kërkohet jo vetëm ngritja e inxhinierëve të ri por edhe vazhdimësia e matjes së gazit të shkarkuar.

Nëse zbatohen masat e zvogëlimin të emisioneve për TC Kosova A, është e nevojshme që investimi të bëhet sa më i vogël që është e mundur në mënyrë që të shmangen specifikimet e tepërta dhe të përmbushen specifikimet optimale përmes të kuptuarit të kapacitetit ekzistues të objektit dhe kushteve të operimit.

Për ta përmirësuar gazin e shkarkuar është i nevojshëm menaxhimi i djegies së kaldajave dhe mirëmbajtja e pajisjeve. Projekti ka propozuar çështjet afatshkurtra në vijim. Nëse lejohen investimet, ato masa janë të realizueshme, por është e nevojshme të bëhet studimi duke marrë parasysh fotografimin e plotë të planeve për TC Kosova A. Në të njëjtën kohë, nëse zbatohen masat e përmendura më poshtë, është e nevojshme të kryhen matjet e gazit të shkarkuar dhe të vlerësohet efekti i tyre.

i) Kompletimi i masave për zvogëlimin e Pluhurit të cilat janë në proces e sipër

- Përmirësimi përmes aplikimit të sistemit të kontrollit të energjizimit me ndërprerje për FES
 - Përmirësimin e pllakës drejtuese në hyrje të FES-ve (për FES-ët në të cilët nuk është zbatuar)
- ii) Investime shtesë për t'i bërë masat për zvogëlimin e pluhurit më të sigurt dhe më të qëndrueshme
- Zvogëlimi i rrjedhjes së ajrit nga ana e ajrit në anën e gazit në para-nxehësin e ajrit (rregullimi i mekanizmit të mbylljes ajër - gaz i shkarkuar ose zëvendësimi i mekanizmit të mbylljes)
 - Pastrimi i sipërfaqes së transferimit të nxehtësisë të kaldajave (inspektimi, pastrimi dhe instalimi i fryrësve shtesë të blozës)
- iii) Përmirësimi i gazit të shkarkuar nga kaldaja
- Përmirësimi i shkëmbimit të nxehtësisë tek para-nxehësi i ajrit (inspektimi i elementit të nxehjes dhe/ose zëvendësimi i tij)
 - Krijimi i operimit më të mirë për zvogëlimin e SO₂ përmes përmirësimit të pajisjeve (kontrolli nga larg i hapjes së flegërës së flakadanit, instalimi i termometrit shtesë, etj.)
- iv) Masat për zvogëlimin e NO_x
- Për ta zvogëluar NO_x kërkohet instalimi i djegies në dy faza dhe flakadanit me nivel të ulët të NO_x. Mirëpo, meqenëse kushtet e djegies dhe temperatura e vatrës do të ndryshojnë me instalimin e flakadanit NO_x, operimi optimal i kaldajës duhet të gjetet përmes vëzhgimit të kushteve të operimit të kaldajës. Në të njëjtën kohë, instalimi i flakadanit NO_x ka mundësi ta zvogëlojë SO₂. Mirëpo, për t'i gjetur kushtet e zvogëlimin të SO₂, përveç masave tashmë të testuar në Projekt, është e nevojshme të kryhen teste shtesë siç janë ndryshimi në hapjen e flegërës së flakadanit (hapja e flakadanit duhet të kontrollohet nga larg pas instalimit të flakadanit me nivel të ulët të NO_x), ndryshimi në sasinë e ajrit sekondar për djegien në dy faza, etj. për shkak të ndryshimit të kushteve të djegies dhe temperaturës së vatrës.
- v) Masat për zvogëlimin e SO₂
- Instalimi i pajisjeve të de-sulfurimit është i domosdoshëm për ta siguruar zvogëlimin e SO₂. Mirëpo pasi që investimi është shumë i madh, është i nevojshëm konsiderimi i kujdesshëm. Në anën tjetër, bazuar në njohuritë në Projekt, zvogëlimi i SO₂ është i mundur nëse kontrollohen kushtet e djegies siç janë temperatura dhe O₂ në gazin e djegies në zonën e de-sulfurimit. Nëse përmirësimet e përmendura më lart, siç janë djegia në dy faza dhe flakadani me nivel të ulët të NO_x, kontrolli nga larg i hapjes së flegërës së flakadanit, instalimi i termometrit shtesë, etj., mund ta mundësojnë kontrollin e djegies, dhe në të njëjtën kohë, nëse ndryshimi në përbërjen e linjitit mund të kontrollohet deri në një masë, mund të realizohet zvogëlimi i SO₂.

Nëse përmirësimi i përmendur më lart zbatohet, duhet të bëhet konfirmimi i zvogëlimit të SO₂. Mirëpo, nëse SO₂ edhe më tej nuk mund të zvogëlohet, masa tjetër e vetme që duhet ndërmarrë është instalimi i pajisjeve të de-sulfurimit.

4) Përgjigja për TC Kosova B pas rehabilitimit (Rezultati 7 dhe 2)

Për sa i përket TC Kosova B, rinovimi dhe instalimi i pajisjeve të reja për trajtimin e gazit të shkarkuar është planifikuar të bëhet në kohën e rehabilitimit të tij nga BE. Mirëpo, pas instalimit, është e domosdoshme matja e gazit të shkarkuar nga pala kosovare dhe duhet të konfirmohet performanca e pajisjeve të reja. Instalimi i pajisjeve për trajtimin e gazit të shkarkuar nuk garanton performancën, dhe matja e gazit të shkarkuar është mënyra e vetme për ta konfirmuar performancën e pajisjeve për trajtimin e gazit të shkarkuar. Është shumë e rëndësishme të vazhdohet me matjen e gazit të shkarkuar.

Kur bëhet përmbledhja e të lartpërmendurave në fushën e Matjeve dhe Masave për zvogëlimin e emisioneve, rekomandohen aktivitetet e mëposhtme. Në të njëjtën kohë, është listuar numri i nevojshëm për përforcimin e stafit, pajisjeve, etj.

Çështje kryesore për të ardhmen janë shfrytëzimi i matjes së gazit të shkarkuar, përhapja e zbatimit të matjes dhe raportimit nga fabrikat, si dhe përmirësimi i njohurive dhe forcimi i kapacitetit për udhëzim për masat e zvogëlimit të emisioneve.

Fusha	Pikat e çështjeve	Prioriteti	Para-kushtet dhe pajisjet, etj.	Vërejtjet
Teknologjia për vlerësimin e performancës	Vlerësimi i performancës dhe emisioneve nga ngrohja me lëndë djegëse të ngurta në amvisëri, etj.	I Lartë	<ul style="list-style-type: none"> Është i domosdoshëm përforcimi me një staf për punën e analizave Është i nevojshëm sigurimi i vendit për testim, blerja e pajisjeve për ngrohje, etj. 	<p>Pajisjet e testimit dhe matjes duhet të instalohen rishtazi, dhe stafi duhet të trajnohet.</p> <p>Mirëpo, substancat e synuara janë të kufizuara në SO₂, NO_x dhe Pluhur.</p>
	Vlerësimi i gazit të shkarkuar nga automjetet	I Lartë	<p>Është parakusht që pala kosovare ta organizojë ekipin për matje (Kërkohen tre (3) anëtarë)</p> <ul style="list-style-type: none"> Pajisjet e matjes: kërkohet buxhet i madh. 	Ky aktivitet bënë instalimin e pajisjes së matjes në automjete të ndryshme dhe vlerëson gazin e shkarkuar.
Matja e gazit të	Përhapja e matjes së	I Lartë	<ul style="list-style-type: none"> Përforcimi me dy punonjës është i domosdoshëm: një për 	Inspektori, stafi i IHMK-së, stafi i DMNI gjatë këtij aktiviteti duhet

shkarkuar dhe Masat për zvogëlimin e emisioneve	gazit të shkarkuar		<p>Inspektoratin dhe një për matje</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rekomandohet fuqimisht pjesëmarrja e DMNI-së • Nuk nevojiten pajisje shtesë 	<p>të angazhohen në këtë punë me orar të plotë. Aktivitetet kryhen për diku pesë fabrika.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Numri i personave që nevojiten për matje është tre (3)
	Përvetësimi i njohurive dhe aftësive themelore për matjen e gazit të shkarkuar dhe masat për zvogëlimin e emisioneve	I Lartë	<ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrësit në pikën e përshkruar më lartë duhet të marrin pjesë në ligjëratat e mbajtura përmes këtij aktiviteti. 	<p>Ky aktivitet kryhet bashkë me pikën e përshkruar më lartë. Përmes ligjëratave pjesëmarrësit do të marrin njohuri themelore për gazin e shkarkuar.</p>
	Matja e gazit të shkarkuar në TC Kosova dhe TC Kosova B	I ulët	<ul style="list-style-type: none"> • Aktualisht nuk ka aktivitet konkret dhe nuk mund të përcaktohet përmbajtja e zbatimit. • Nuk nevojiten pajisje 	<p>Rehabilitimi i TC Kosova B planifikohet të fillojë nga viti i ardhshëm. Mirëpo, pala japoneze nuk mund të përfshihet në këtë pasi që rehabilitimi kryhet nga BE-ja.</p>
	Futja në funksion e kontrollit të energjizimit me ndërprerje për FES	I Lartë	<ul style="list-style-type: none"> • Prioriteti do të jetë i lartë kur në të vërtetë futet në funksion kontrolli i energjizimit me ndërprerje për FES. 	<p>Futja në funksion e kontrollit të energjizimit me ndërprerje për FES është rekomanduar nga Projekti.</p>

Prioriteti (rekomandohet nga JET)

I lartë: Aktivitetet me prioritet të lartë të cilat duhet të adoptohen me përforsimin e stafit.

Mesatar: Aktivitetet të cilat duhet kryer kur kushtet të jenë plotësuar

I ulët: Aktivitetet që duhet të kryhen kur kushtet të jenë plotësuar dhe nevoja e palës kosovare bëhet e lartë

(3) Kërkesa nga pala kosovare

Pala kosovare ka përvetësuar teknologjinë e matjes së gazit të shkarkuar dhe ka llogaritur dhe përmbledhur rezultatet e matjes. Prandaj, pala kosovare nuk ka ndonjë kërkesë të veçantë. Nga tani e tutje, është e rëndësishme që të mbahet mirëmbajtja e pajisjeve dhe të sigurohet prokurimi i pajisjeve ndihmëse.

Për sa i përket masave për zvogëlimin e emisioneve për TC Kosova A, H/L (veçanërisht TC Kosova A) kanë mësuar disa lloje të masave për zvogëlimin e emisioneve, mirëpo për shkak të kufizimit në buxhet vetëm masa për zvogëlimin e Pluhurit është vënë në praktikë.

Mirëpo, nëse miratohet, H/L shpresojnë të aplikojnë më shumë masa për përmirësime. Mirëpo, TC Kosova A është mjaft e vjetër, prandaj nëse ka ndonjë investim është e nevojshme që të bëhet konsiderimi i kujdesshëm i prioriteteve.

Për sa i përket burimeve të tjera të palëvizshme, MMPHI/MMPH dëshiron t'i rregullojë emisionet nga ta, por situata nuk është ashtu si duhet të jetë për shkak të mungesës së njohurisë dhe përvojës për matjen e gazit të shkarkuar dhe masat për zvogëlimin e emisioneve. Kërkohet zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe rritja e aftësive të MMPHI/MMPH për të dhënë udhëzime.

5.2.4 Çështjet për të ardhmen dhe propozimet në Vlerësimin për Vendimarrje (Rezultati 8)

Rezultati 8: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit.

(1) Përmbledhja dhe vlerësimi i aktiviteteve të Projektit

Pala kosovare ka mësuar hapin për t'i planifikuar masat dhe për ta vlerësuar efektin e masave.

Në periudhën e dytë, Projekti rishikoi masat në Strategjinë/Planin e Veprimit për ajër të planifikuar nga Kosova dhe në periudhën e tretë, i zbërtheu ato në masa me skenarë që bënë të mundur vlerësimin konkret, si dhe përgatiti fletët e vlerësimit.

Në veçanti, aktivitetet ishin për t'i identifikuar ndotësit e synuar të ajrit, përzgjedhur burimet e emisioneve që do të studiohen përmes përdorimit të hartës së përqendrimit të ndotësve në nivelin e tokës bazuar në inventarin e emisioneve dhe llogaritjen e simulimit, krijuar skenarët e masave dhe kushtet e llogaritjes bazuar në të dhënat e inventarit të emisioneve, ofruar sasinë e zvogëlimit të emisioneve të llogaritur nga inventari i emisioneve, llogaritur hartën e përqendrimit të ndotësve në nivelin e tokës para dhe pas masave, vlerësuar kosto - efektivitetin, studiuar metodën e zbatimit të masave, listuar çështjet për zbatimin e masave, vlerësuar masat nga këndvështrimi teknik dhe shoqëror, etj.

Përveç anëtarëve të Rezultatit 8 të ngarkuar me aktivitete, edhe anëtarët e Rezultatit 1 morën pjesë në aktivitete. Kjo e bëri që krijimi i kornizës institucionale të shkojë përpara, pasi anëtarët mund t'i diskutonin masat më në thellësi gjatë procesit të planifikimit, studimit, vlerësimit, etj. dhe procedurat konkrete, rolet dhe përgjegjësia u bënë më të qarta.

Në anën tjetër, është bërë e qartë se masat për burimet e tjera nuk janë studiuar sa duhet. Është e nevojshme që të kuptohet gjendja e emisioneve nga automjetet, impiantet me djegie të vogël, etj., dhe të studiohen masat për zvogëlimin e këtyre emisioneve. Nevoja e palës kosovare po rritet për sa i përket rishikimit të Planit të Veprimit, etj. përmes studimit dhe vlerësimit të masave.

(2) Propozimet nga aktivitetet e Projektit

Është shumë e rëndësishme që të planifikohen dhe vlerësohen masat nga informacioni dhe të dhënat bazuar në të dhëna shkencore dhe teknike. Në Kosovë, ministrinë dhe

komunat mbledhin shumë lloje të informacionit, dhe për këtë arsye, është e nevojshme të forcohet bashkëpunimi me to dhe të krijohet sistemi për ta mbledhur informacionin e nevojshëm. Gjithashtu është e nevojshme jo vetëm të organizohen informacionet dhe studiohet si të mblidhen informacionet për emisionet por gjithashtu të studiohet se si të ndërtohet sistemi i ri i informacionit sipas nevojës.

Propozimet e dala nga aktivitetet e Projektit janë siç vijon.

1) Vullneti i H/L për aktivitetet e Projektit

H/L menaxhuan orarin e tyre dhe i dhanë përparësi pjesëmarrjes në takime. Veçanërisht në periudhën e tretë, kur Projekti diskutoi në mënyrë intensive për studimin e masave, ata i dhanë përparësi pjesëmarrjes në takimet e Projektit duke menaxhuar orarin e tyre sipas orarit të paraqitur. Si rezultat i aktiviteteve shumë të motivuara, kapaciteti i H/L për studimin dhe vlerësimin e masave është forcuar dhe është arritur përpilimi i fletëve të vlerësimit që janë materialet themelore për rishikimin e planit të veprimit. Nga tani e tutje, në rast të projekteve të mbështetura nga donatorë të tjerë të huaj, aktivitetet duhet të përputhen me dhe t'i plotësojnë nevojat e vendeve mikpritëse dhe H/L, gjë që rritë vullnetin e H/L për punët e tyre dhe rritë kapacitetin e tyre.

2) Mbështetja për përforcimin e mekanizmit për shkëmbimin e informacioneve dhe pjesëmarrja aktive në masat e kontrollit të ndotjes së ajrit

Në Kosovë, ndotja e ajrit në sezonin e dimrit është veçanërisht serioze dhe bashkëpunimi ndërmjet ministrive, institucioneve përkatëse dhe komunave është i rëndësishëm. Prandaj, kërkohet të krijohet platforma për shkëmbimin dhe sigurimin e informacionit dhe të shkëmbehen dhe shpalosen informacionet në mënyrë aktive për publikun.

Për t'i planifikuar masat, është e nevojshme të hulumtohet se çfarë lloje të informacioneve kanë ministrinë, institucionet përkatëse dhe komunat kanë dhe të kuptohet se çfarë janë ato. Bazuar në informacione, është e dëshirueshme të njihen informacionet dhe të dhënat e pamjaftueshme për masat e planifikimit dhe të kërkohen metoda të tjera të mbledhjes ose metoda të reja për përgatitjen e të dhënave.

Në mënyrë që gjërat të ecin para, është e nevojshme të forcohet mekanizmi për shkëmbimin e i informatave dhe pjesëmarrja aktive në punë, si dhe marrja e përgjegjësisë në zbatimin e masave. Gjithashtu është e nevojshme të përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse të lartpërmendura në lidhje me planin e kornizës institucionale për planifikimin, studimin, vlerësimin dhe zbatimin e masave të studiuara në Projekt. Për më tepër, në procesin e aktiviteteve të MMPHI/MMPH siç është rishikimi i Planit të Veprimit, masat e kontrollit të ndotjes së ajrit duhet të planifikohen, studiohen, vlerësohen dhe zbatohen përmes kornizës institucionale të krijuar.

Megjithëse masat janë studiuar nga Projekti, çështja kryesore është se si të zbatohen masat e vlerësuara. Është e dëshirueshme që të kryhen një seri e punëve siç janë si planifikim, studimi, implementimi dhe vlerësimi i masave bazuar në kornizën e krijuar institucionale, duke përfshirë përcjelljen dhe informacionin prapa-kthyes të studimit të detajuar të zbatimit, dhe rezultatet.

3) Mbështetja për hulumtimin lidhur me mbledhjen e informacionit dhe të dhënave dhe metodën e mbledhjes së të dhënave të nevojshme

Të dhënat e cilësisë së ajrit, emisionet nga kategoria e prodhimit, emisionet nga burimet e vogla siç janë burimet e palëvizshme rezidenciale dhe burimet e palëvizshme të industrisë terciare, etj., janë informacione bazike shumë të rëndësishme për planifikimin e masave. Megjithëse këtë herë të dhënat e cilësisë së ajrit janë të organizuara, aktualisht të dhënat e tjera nuk arrijnë nivelin për t'u gjykuar për sa i përket besueshmërisë së tyre.

Pala kosovare ka nevojë për më shumë mbështetje në identifikimin e opsionit më të mirë për zvogëlimin e ndotjes së ajrit nga amvisëritë, si kontribuues të mëdhenj në ndotjen e ajrit.

4) Aplikimi i Fletësve të Përpiluara të Vlerësimit të Masave

Fletët e vlerësimit të përpiluara nga Projekti duhet të përdoren si materiale për studim dhe diskutim në Grupin e Punës të krijuar në kohën e përgatitjes së Planit të Veprimit në përputhje me Strategjinë e Cilësisë së Ajrit në Kosovë. Në Projekt, u zhvillua diskutimi me policinë e trafikut të MPBAP/MPB, etj., ngjashëm si me Grupin e Punës.

Pala kosovare ka nevojë për mbështetje të mëtejshme për zhvillimin e kapaciteteve në përgatitjen e fletëve të vlerësimit përmes TNP nga projekte mbështetëse të donatorëve të huaj për llogaritjen e zvogëlimit të emisioneve, vlerësimin e kostos dhe hartat e përqendrimit në bashkëpunim me organet e tjera.

Është e dëshirueshme që të hartohet Plani i Veprimit duke ndërmarrë hapa në përgatitjen e fletëve të vlerësimit bazuar në të dhënat teknike duke shfrytëzuar njohuritë dhe qasjen në Projekt dhe duke studiuar masat në mënyrë sasiore.

5) Shfrytëzimi i Veglave të ndryshme Administrative

Përmes Projektit pala e Kosovës ka përvetësuar vegla të ndryshme administrative siç janë të dhënat për cilësinë e ajrit, inventari i emisioneve, simulimi, matja e gazrave të shkarkuara, analiza, etj. Të dhënat e cilësisë së ajrit dhe inventari i emisioneve janë vegla shumë të rëndësishme për planifikimin, studimin dhe vlerësimin e masave, dhe ato duhet të shfrytëzohen shumë. Për ta përmirësuar cilësinë e të dhënave për inventarin e emisioneve janë të domosdoshme teknologjia e matjes dhe e analizës së gazit shter matja e gazit të shkarkuar dhe teknologjia për analiza. Përmirësimi dhe shfrytëzimi i

këtyre teknologjive në mënyrë të qëndrueshme janë shumë të rëndësishme. Në të njëjtën kohë, kur masat planifikohen bazuar në të dhënat teknike, besueshmëria dhe efektiviteti i masave do të jenë të larta. Cilësia e politikave për kontrollin e ndotjes së ajrit duhet të rritet paralelisht me përmirësimin e qëndrueshëm të cilësisë së këtyre veglave.

6) Zbatimi i studimit të masave për zvogëlimin e Emisioneve për Industrinë e Prodhimit

Në Projekt, përmes matjes së gazit të shkarkuar dhe studimit për masat e zvogëlimin të emisioneve janë gjetur shumë çështje për burimet e tjera të palëvizshme. Pala kosovare duhet t'i identifikojë emisionet nga industria prodhuese dhe t'i studiojë dhe vlerësojë masat e kontrollit të ndotjes së ajrit në industrinë prodhuese përmes përgatitjes së inventarit të emisioneve.

Është i nevojshëm zhvillimi i mëtejshëm i kapacitetit të inspektorëve përmes TNP për matjen e gazit të shkarkuar për burimet e palëvizshme përmes mbështetjes së donatorëve të huaj siç është JICA. Për palën kosovare kërkohet që ta përmirësojë aftësinë e zyrtarëve për t'i udhëzuar operatorët për matjet e gazrave të shkarkuara dhe masat e zvogëlimin të emisioneve përmes mbështetjes nga projektet e donatorëve të huaj. Për më tepër, pala kosovare ka nevojë për më shumë mbështetje në zhvillimin e kapacitetit të zyrtarëve për t'i kuptuar rezultatet e matjeve të gazrave të shkarkuara dhe masat e zvogëlimin të emisioneve për burimet e palëvizshme.

Në të njëjtën kohë, zvogëlimet e emisioneve nga industrinë e prodhimit duhet të bëhen përmes ndërrimit të lëndës djegëse, përmirësimit të procesit industrial, etj. Prandaj, pala kosovare duhet t'i zhvillojë skemat për Taksa mbi Lëndë Djegëse dhe Subvencione me qëllim të zvogëlimin të emisioneve nga burimet e palëvizshme duke iu referuar vlerësimin të masave të kryera nga Projekti. Kjo është një nga masat për zvogëlimin e emisioneve si aktivitete administrative, duke përdorur jo vetëm rregulloren, por edhe mekanizmin e tregut. Në lidhje me këtë, aktualisht pala kosovare ka nevojë për më shumë mbështetje nga donatorët e huaj.

7) Zbatimi i studimit të masave për zvogëlimin e emisioneve nga automjetet

Sipas informacionit të regjistrimit të automjeteve, etj. është gjetur se përdoren shumë automjete me rregullore të vjetër të BE-së për emisione. Projekti në veçanti gjeti emisione të larta të NO_x nga automjetet. Mirëpo, masat e duhura në përputhje me situatën aktuale nuk mund të studiohen pasi që nuk janë siguruar faktorët e emisionit të automjeteve në Kosovë. Është e nevojshme të bëhet identifikimi më i saktë i emisioneve bazuar në matjen e emisioneve, dhe të studiohen dhe vlerësohen masat për emisionet e automjeteve përmes inventarit të emisioneve.

Pala kosovare ka nevojë për mbështetje në zhvillimin e kapaciteteve për matjen e gazit të shkarkuar nga automjetet dhe analizën e emisioneve nga sektori i transportit.

Gjithashtu është e nevojshme të studiohen dhe vlerësohen masat për t'i zvogëluar emisionet nga automjetet duke futur në funksion zhvendosjen modale siç janë zgjerimi i transportit publik, zvogëlimi i vëllimit të trafikut, etj. Për ta vlerësuar efektin është e nevojshme të mblidhen të dhëna, të cilat kërkohen për ta caktuar vëllimin e trafikut sipas llojit të kategorisë dhe shpejtësisë së vozitjes para zbatimit të masave.

8) Krijimi i procedurave administrative për hartimin e Planeve të Veprimit

Kur të studiohet Plani konkret i Veprimit, përmbajtja thelbësore do të jenë fletët e vlerësimit të përgatitura nga Projekti. Për ta rishikuar Planin e Veprimit, MMPHI/MMPH me ndihmën e donatorëve të huaj duhet t'i përdorë fletët e vlerësimit dhe ta zgjerojë studimin e masave, dhe ta bëjë një plan jo vetëm për të çuar tek zgjidhja e problemeve të ndotjes së ajrit në Kosovë, por gjithashtu për t'i përmbushur kërkesat e BE-së.

Pala kosovare ka nevojë për mbështetje në rishikimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Cilësi të Ajrit përmes zhvillimit të kapaciteteve për identifikimin e masave bazuar në analizën e burimeve të emisioneve.

9) Mbështetja për zbatimin e ligjit për "Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja"

MMPHI/MMPH ka hartuar ligjin për "Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja" në përputhje me direktivat e BE-së dhe ligji do të zbatohet së shpejti.

Pala kosovare ka nevojë për zhvillim shtesë të kapacitetit të zyrtarëve në nivelin Komunal për t'i kuptuar dhe identifikuar masat duke përfshirë analizën e burimeve të emisioneve. DMMU/DMNI duhet ta mbështesë përgatitjen e Planit të Veprimit të nivelit lokal, por në të njëjtën kohë DMMU/DMNI ka nevojë për më shumë mbështetje nga donatorët e huaj siç është JICA.

Për më tepër, zbatimi aktual i ligjit ka ende shumë probleme. Çështjet janë arritja e ISO17025 nga IHMK, zbatimi i matjeve të gazit të shkarkuar dhe raportimit nga agjencitë private, udhëzimi për fabrikat private nga inspektorët, etj. dhe çdo çështje ka nevojë për nxitjen e stafin përmes edukimit dhe trajnimit, institucionalizimit të mekanizmit të zbatimit, etj., dhe kjo kërkon kohë. Prandaj, është e dëshirueshme që të hartohet Plani i Veprimit dhe të vazhdohet me planin në mënyrë të planifikuar duke përdorur mbështetjen nga donatorët e huaj, etj.

(3) Kërkesa nga pala kosovare

Përmes Projektit, pala kosovare ishte në gjendje për herë të parë t'i konsideronte masat në mënyrë sasiore duke i shfrytëzuar të dhënat teknike. Prandaj, njohuritë dhe përvoja e fituar nga Projekti do të shfrytëzohen për zbatimin e Planit të rishikuar të Veprimit për cilësinë e ajrit, përgatitjen për zbatimin e masave të ndryshme në Kosovë të kërkuara nga BE, etj.

Pala kosovare kërkon mbështetje të mëtejshme për këto aktivitete.

1) Zbatimi i masave për zvogëlimin e SO_{2.5}

Termi PM_{2.5} është mjaft i njohur për qytetarët e Kosovës, dhe si MMPHI/MMPH, është substancë thelbësore për t'u ekzaminuar në mënyrë që të trajtohet problemi i ndotjes së ajrit. Prandaj, pala kosovare po kërkon studimin e masave gjithëpërfshirëse përfshirë analizën e kontributit të burimeve për PM siç janë PM₁₀ dhe PM_{2.5}.

Prandaj, si përgjigje ndaj kësaj kërkesë nga pala kosovare JET-i bën rekomandimet në vijim. Kur është e nevojshme të konsiderohet PM i tillë i prodhuar nga ndonjë reaksion kimik në atmosferën e mjedisit (gjenerimi sekondar), ndotësit e ajrit siç janë komponimet organike të avullueshme (VOC) dhe amoniaku (NH₃) gjithashtu supozohet të jenë të rëndësishme. Kur ndotësit e ajrit si amoniaku janë çështje të shqyrtimit, pritët që do të jetë e rëndësishme të merren parasysh masat sektorin e bujqësisë dhe sektorin e mbeturinave.

Mbështetja e përmbajtjeve siç janë analiza e kontributit të burimeve të PM_{2.5}, etj. duhet të studiohet bazuar në mësimet e nxjerra nga projektet si 'Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Qytetin Ulaanbaatar Faza 3' dhe 'Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Qytetin Teheran' që janë në zbatim e sipër.

2) Zbatimi i studimit të masave të zvogëlimit për një gamë më të gjerë të burimeve të emisioneve

Për ta rishikuar Planin e Veprimit, MMPHI/MMPH duhet t'i konsiderojë masat për të gjithë Kosovën dhe për të gjithë sektorët, kategoritë dhe nënkategoritë. Pala kosovare kërkon mbështetje për aktivitete të tilla. Nëse PM duhet të merret parasysh siç është përshkruar më sipër, jo vetëm emisionet nga burimet e djegies së lëndës djegëse në sektorin e energjisë, por duhet të merren parasysh edhe ndotësit e tjerë të ajrit. Pritët që do të jetë e nevojshme të merren parasysh dhe të vlerësohen masat për të gjithë sektorët nëse është e nevojshme.

Prandaj, pala kosovare duhet ta rishikojë në mënyrë të pavarur Planin e Veprimit ndërsa merr mbështetje nga donatorët e huaj. Nëse përmirësohen cilësia e inventarit të emisioneve siç janë emisionet aktuale bazuar në rezultatet e matjeve aktuale nga burimet kryesore të emisioneve dhe cilësia e të dhënave të aktivitetit, atëherë mund të propozohen masa të bazuara në cilësi më të lartë të të dhënave shkencore dhe teknologjike. Prandaj, pala kosovare do të kryejë në mënyrë të integruar aktivitete administrative për ajrin e mjedisit siç janë hulumtimet e performancës së emisioneve, përgatitja e inventarit të emisioneve, llogaritjet e simulimit dhe vlerësimi i masave duke punuar së bashku me donatorë të huaj nëse është e nevojshme.

3) Zbatimi i masave të kontrollit të ndotjes së ajrit në rajone të tjera

Rehabilitimi i SMCA-ve ka përfunduar në nëntor të vitit 2019 dhe saktësia e të dhënave nga SMCA-të në të gjithë vendin është përmirësuar, dhe problemi i ndotjes së ajrit në sezonin e dimrit në qytete të tjera si Prizreni, Gjilani dhe Peja po del të jetë i ngjashëm me atë të qytetit të Prishtinës. Prandaj, pala kosovare kërkon mbështetje për shqyrtimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit për komuna të tjera pasi që pritet që planet e veprimit do të jenë të nevojshme.

Prandaj, si përgjigje ndaj kësaj kërkesë nga pala kosovare JET-i bën rekomandimet në vijim. Teknologjia e përgatitjes së inventarit të emisioneve dhe modelimit të simulimit i përvetësuar përmes Projektit mund të zbatohet gjithashtu për analizën e situatës në komuna të tjera. Prandaj, duke përdorur Projektin si projekt model, pala kosovare duhet të konsiderojë në mënyrë të pavarur masat për këto qytete duke mbledhur dhe analizuar informacione. Pasi që disa komuna mund të kenë çështjet e tyre të veçanta, supozohet se pala kosovare duhet të zbatojë masa të veçanta për disa qytete.

Për më tepër, pasi që ekziston edhe çështja e monitorimit të metaleve të rënda në PM në ajër në Drenas dhe Mitrovicë, është e dëshirueshme që të monitorohen vazhdimisht metalet e rënda në PM dhe të publikohen vlerat lidhur me matjen dhe analizën.

4) Mbështetja për përgatitjen e NEC

QeK, veçanërisht MESPI, duhet ta përgatisë NEC në përputhje me kërkesat e BE-së. Mirëpo, meqenëse përgatitja e NEC ka nevojë për shumë procedura administrative, procedura duhet të kryhet hap pas hapi me mbështetjen e projekteve të donatorëve të huaj.

NEC ka nevojë për skenarët e ardhshëm dhe planet e ardhshme të veprimit sepse NEC është synimi i zvogëlimit të emisioneve për të ardhmen. Për përgatitjen e synimit të zvogëlimit të emisioneve, janë të nevojshme skenarët WOM, WEM dhe WAM. Këto gjithashtu janë të dhëna teknike.

Duke iu referuar këtyre të dhënave teknike, MMPHI duhet t'i përgatisë dokumentet administrative siç janë UA, rregulloret e nevojshme dhe planet e veprimit. Pala kosovare ka nevojë për këto aktivitete mbështetëse për zonën e synuar të projektit të ardhshëm.

Nga pikëpamja e menaxhimit të cilësisë së ajrit, MMPHI/MMPH ka nevojë për aktivitete të bashkëpunimit me organizata të tjera përkatëse për përpilimin e NEC. Përmes bashkëpunimit me organizatat përkatëse, MESPI/MMPH do t'i finalizojë skenarët e ardhshëm si WOM, WEM dhe WAM, dhe do t'i përcaktojë caqet e zvogëlimit të emisioneve për vitet e synuara si NEC.

Lista e Anekseve dhe Shtojcave

ANEKSI-1 Dokumentet e ndërlidhura me Takimet e Komitetit të Përbashkët Koordinues

Shtojca-1 Materialet e rezultuara nga Projekti

Shtojca-2 Vlerësimi i Kapaciteteve

Shtojca-3 Buletinet informuese